

RAPORT AUDITIMI
NË
SPITALIN PSIKIATRIK “ALI MIHALI” VLORE

Tiranë, TETOR 2021

PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
I PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-9
1.Pershkrim i shkurtër i Auditimit	
2.Pershkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.Konkluzioni përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II. HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit)	9-14
1./2. Titulli & Marrësi	
3. Objektivat dhe qëllimi	
4. Identifikimi i çështjes	
5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
6. Përgjegjësitë e audituesve	
7. Kriteret e vlerësimit	
8. Standardet e auditimit	
9. Metodatat e auditimit	
10. Dokumentimi i rezultateve të auditimit	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	14-190
Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	14-15
2.1 Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	15-41
2.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	41-44
2.3 Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative..	44-52
2.4 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	52-56
2.5 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.....	56-75
2.6 Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve).....	75-153
2.7 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).....	153-177
2.8 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.....	177-180
2.9 Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	180-189
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	190-210
V. ANEKSE I-V.....	211-216

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.149/1 datë 28.01.2021 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.02.2021-deri në 07.05.2021 datë në subjektin Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë për periudhën nga 01.03.2017 deri ne 31.01.2021 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, nga ku po paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

2. Pershkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportimin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “AGS” shpk për kontratën bazë nr. 26, datë 29.03.2016 “ <i>Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik</i> ” rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit “AGS” shpk vlera prej 2,245,711 lekë, si rrjedhoje e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”.		I Lartë	Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës 2,245,711 lekë me TVSH nga sipërmarrësit “AGS” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2	Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “S. AL” shpk për kontratën bazë nr. 568, datë 30.04.2013 “ <i>Shërbim katering u për “Spitalit Psikiatrik”.</i> Vlorë rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit “S. AL” shpk vlera prej 3,216,180 lekë, si rrjedhoje e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”.		I Lartë	Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës 3,216,180 lekë me TVSH nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3	Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “S. AL” shpk për kontratën bazë nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 “ <i>Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik</i> ” rezulton se nga SPV		I Lartë	Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e

	<p>janë likuiduar në favor të subjektit “S. AL” shpk vlere prej 1,686,701 lekë, si rrjedhoje e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”.</p>			<p>dëmit në vlerës 1,686,701 lekë me TVSH nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
4	<p>Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë janë likuiduar për zërin e shërbimit “<i>Pastrim i brendshëm</i>”, sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m² që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qera. Nga periudha 01.03.2017 deri me 13.07.2020 në lidhje me zbatimin e kontratës “<i>Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë</i>” konstatohet se SPV ka paguar OE “S. AL” shpk për “Pastrim i brendshëm” të ambienteve të dhëna me qera, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në vlerën prej 1,767,275 lekë me TVSh duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit përkatësisht për ambientin: a. <i>Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m²</i> në vlerën 715,807 lekë me TVSh dhe për b) <i>Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m²</i> në vlerën 1,051,469 lekë me TVSh.</p> <p>1.1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës “<i>Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë</i>” konstatohet se për zërin “Pastrim i brendshëm” çdo muaj nga periudha 01 Mars 2017 deri më 20.07.2020 është paguar për sipërfaqen 7354 m². Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, si dhe në DT është përcaktuar se sipërfaqja “Pastrim i brendshëm” është në sasinë 7,347 m², çka rezulton me një tejkalim të kontratës prej 7m². Nga SPV për këtë periudhë ka paguar OE “S. AL” shpk më tepër për vlerën 47,181 lekë pa TVSh (56,618 lekë me TVSH), duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit. Veprime në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur midis OE dhe AK, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006.</p>		I Lartë	<p>Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për shpërblimin e dëmit në vlerës 1,823,982 lekë me TVSH nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme” të cilat janë dhanë me qira, si dhe të tejkalimit të sipërfaes së pastrimin përtej kushteve të kontratës dhe Dokumentat e Tenderit (DT).</p>
5	<p>Procedura ë prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lvanterise dhe zëvendësimi me inventar te imët”, e hapur me date 26.09.2019.</p> <p>Komisioni i vlërsimit të ofertave e ka skulifikuar pa të drejtë OE ”U. S.” me ofertë më të ulët për pikat</p> <p><i>1. Mungese deklarate per paraqitjen e ofertës se pavarur, sipas shtojcës 1/1.</i></p>		I Lartë	<p>Nga SPV të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 14,985,160 lekë, nga Komisionet e Vlersimit si dhe grupi i punës, për</p>

<p>2. <i>Ofertuesi ka paraqitur çertifikata ISO ne gjuhe te huaj, te pa perkthyer ne gjuhen shqipe.</i></p> <p>Perkatësisht për pikën e parë pavarshisht se nga Njesia e hartimit të dokumentave standard është kërkuar tek kriteret e vecanta Shtojca 1/1, por nga auditimi rezultoi se ne dokumentat e tenderit nuk gjendet e bashkangjitur kjo shtojce si pjesë përbërëse e dokumentave standarde, fakt i cili nga KVO është trajtuar si arsye skualifikimi për OE.</p> <p>Ndërkohe për pikën e dytë konstatojmë se ISOT janë hedhur në Sistemit Elektronik të Prokurimeve por nuk janë të përkthyer ne gjuhen shqipe, por theksojme se ISOT jane çertifikata nderkombetare dhe në to mund të përkthehet vetëm numri i ISOS. Referuar nenit 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndrshuar i cili citon se: <i>“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”</i> nga grupi i auditimit është gjykuar së ky është një devijim i vogel i cili nuk prek themelin e procedures. Kjo vendimmarrje ka cuar në skualifikim e OE me vlerë më të ulet i cili do ti kursente buxhetit të shtetit vlerën 14,985,160 lekë, diferencë midis OE të shpallur fitues dhe OE te s’kualifikuar me ofertë më të ulët.</p>			<p>skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulët.</p>
--	--	--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

I. Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i kualifikuar¹)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, në rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, garantimin e të drejtave për mbrojtje e përfshirje sociale dhe për përkujdesje sociale, (kriteret e auditimit Përputhshmërie), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit. Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit Përputhshmërie të KLSH-së, i kryer në subjektin Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar mbi përputhshmërinë.***

Baza për kualifikimin e opinionit mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit Përputhshmërie”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar të auditimit².***

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Nga auditimi i zërave të aktiveve u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.
- Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël së shumës 9,677,600 lekë në llogarisë 202 “Studime e kërkime” ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime” si dhe nënvlerësimin e “Aktiveve Afatgjata Materiale”.
- Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2019 dhe 2020 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë.
- Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 2,245,711 lekë me TVSH nga keq interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimin të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.
- Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 3,216,180 lekë me TVSH nga keq

¹-Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, dhe MAP të KLSH-së kapitulli VII, pika 7.3.3: *Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë materiale, por jo të përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura*
²**ISSAI 1500**– *Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij. Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.*

interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.

-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,686,701 lekë me TVSH nga keq interpretimi i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.

- Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,814,456 lekë për mos përllogaritje e saktë e sipërfaqeve të ambientit, për të cilën realizohet “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme”, si dhe mos zbritja e sipërfaqeve të ambienteve të dhëna me qera në procesverbalet e monitorimit si dhe në situacionet e realizimit të shërbimit.

-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 201,894 lekë me TVSH ndaj sipërmarrësit “C. F.” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme” të cilat janë dhanë me qira.

-Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 159,400 lekë me TVSH, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE “E. B&B” dhe “A.” shpk

- Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 15,626,549 lekë me TVSH nga s’kualifikimi i padrejtë i Operatorëve ekonomik me oferte më të ulët.

- Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 997,152 lekë me TVSH nga mbivendosja e kontratës së Shërbimit Evadim i mbetjeve urbane & Shërbim pastrim gjelbërimi

- Dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën 3,498,119 lekë nga mos rakordimi mbi shpenzimet me karburantin në fletë udhëtimet e shoferëve dhe sistemit elektronik të kartave të karburantit.

-Shpenzim pa ekonomikitet, efience dhe efektivitet në vlerën 5,490,480 lekë, nga mosverifikimi i shpenzimeve të kryera.

-Shpenzim pa ekonomikitet, efience dhe efektivitet në vlerën 614,389 lekë, pasaktësi në përzgjedhjen e fituesit.

-Vlera në total e dëmit ekonomik shkaktuar nga SPV prej situatave të trajtuara në material është 29,448,162 lekë.

-Vlera në total e shpenzime të kryera nga SPV pa efikasitet, ekonomikitet si dhe efience është 6,104,869 lekë me TVSH.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Menaxhimi i SPV është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionet e auditimit janë të përshtatshme. Në arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

II. Hyrja

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.149/1 datë 28.01.2021 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.02.2021-deri në 07.05.2021 datë në subjektin Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë për periudhën nga 01.03.2017 deri në 31.01.2021u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë në Spitalin Psikiatrik ‘Ali Mihali’” Vlorë) nga:

Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.E. K., Përgjegjës Grupi
- 2.J. G., Auditues
- 3.K. F., Auditues
- 4.A. Z., Auditues
- 5.S. H. Auditues.

1) Titulli:

Raporti mbi përputhshmërinë në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.

2) Marrësi:

Ky Raport i adresohet Drejtorit të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, znj.O. G.

3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit. Objektivat e auditimit synojnë:

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë.

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime³.

4) Identifikimi i çështjes: Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësi të institucionit të SPV, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Spitalit Psikiatrik Ali Mihali” Vlorë, për periudhën objekt auditimi nga 01.03.2017 deri në 31.01.2021, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të SPV, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, respektimin e kritereve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, kontratat koncesionare etj. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 149/1, datë 28.01.2021, i ndryshuar.

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Niveli menaxherial i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

6) Përgjegjësitë e audituesve. Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e marrë.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) nëse janë zbatuar konstatimet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga auditues jashtë KLSH, etj.

d) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, paragrafi 47, ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjevesh mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.

Objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe gjatë kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në institucionin e SPV në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

7) Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- ✓ Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.
- ✓ Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.
- ✓ Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”.
- ✓ Udhëzimi nr. 7/2 datë 07.07.2018 “Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”.
- ✓ Udhëzim i posaçëm nr.24, datë 29.12.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit 2018”.
- ✓ Ligj nr. 99, datë 3.12.2018 Për buxhetin e vitit 2019”.
- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.1 date 17.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2019”.
- ✓ Udhëzimin nr.9, date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde te Zbatimit te Buxhetit”.
- ✓ Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.
- ✓ Udhëzimi nr. 8, datë 22.02.2019 të Ministrit të Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2020-2022”.
- ✓ Udhëzimi nr. 21, datë 10.07.2019 të Ministrit të Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2020-2022”.
- ✓ Ligji nr.88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

- ✓ Udhëzimi Plotësues nr.2 date 20.01.2020.
- ✓ Udhëzimi Plotësues shtesë nr.26 date 08.07.2020.
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- ✓ [Urdhër i MF nr.89, datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njërive Publike"](#).
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

8)Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”;
- ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Standardet për auditimin e përputhshmërisë”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Adituesve (ECA); Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të adituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”.

9)Metodat e auditimit. Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 2320 dhe ISSAI 2450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu për institucionin Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore, niveli i materialitetit për vitin 2017 rezultoi 3,516,134 lekë, për vitin 2018 rezultoi 3,681,302 lekë, për vitin 2019 rezultoi 3,698,850 lekë dhe për vitin 2020 rezultoi 3,579,552 lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi.

8. Raporte dhe Informacione.

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

10) Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe

rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe trajtimit të observacioneve të sjella nga subjekti i audituar, u përgatit ky Raport Auditimit.

II. PËSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Sipitali Psikiatrik siguron kushte për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor, nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor dhe e ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor” si dhe ligjit nr.9106 datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 62/2013 “Për disa ndryshime të ligjit nr.9106 datë 17.07.2003” .

Objektivi i spitali Psikiatrik “Ali Mihali” ka shërbimin dhe trajtimi për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Kategoritë e shërbimit të këtij spitali janë:

Shërbimet shëndetësore, përmes të cilave ofrohet kujdes për shëndetin mendor, janë:

- a)shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor;
- b)shërbimet komunitare të shëndetit mendor;
- c)shërbimet ambulatorë të specializuara;
- ç) shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër;
- d)institucionet mjekësore të posaçme.

Parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor janë:

- a) Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.
- b) Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.
- c) Krijimi i lehtësive për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.
- ç) Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.
- d) Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, në përputhje me aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2014 deri më 28.02.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 143/13, datë 03.07.2017 dhe “Mbi zbatimin e rekomandimeve” të lëna nga grupi i mëparshëm i zbatimit të rekomandimeve bazuar në Vendimin nr.75, datë 30.06.2017 se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, në bazë të cilës institucioni nuk është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, po për secilën masë organizative dhe të c’ dëmtimit janë nxjerrë urdhrat nr.1303 prot. 27.09.2017, nr. 1304 prot

datë 27.09.2017, nr.1305 prot datë 27.09.2017, nr.1306 prot datë 27.09.2017 nr.1307prot datë 27.09.2017,nr.1308 prot datë 27.09.2017, nr.1309 prot datë 27.09.2017 nr.1093prot datë 14.08.2017, nr.933 prot datë18.07.2017, nr.1258 prot datë 27.09.2017, nga Drejtori i Spitalit Psikiatrik, për zbatimin e detyrave të rekomandimeve.

- Nga ana e subjektit, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor.**

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **9** masa organizative, të cilat, janë zbatuar 2 zbatuar pjesërisht 1, në proces 5 dhe janë pa zbatuar 1.
- b. Masa për shpërbllim dëmi janë lënë **14** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2, në proces 12.
- c. Masa për eliminimin e efekteve negative 3E janë lënë **7** rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2, në proces 1 dhe pazbatuar 4.
- d. Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;
-4 masa disiplinore nuk janë zbatuar , 2 masë disiplinore janë zbatuar.
-Sipas Statusit të Nëpunësit Civil janë lënë 0 masa disiplinore
-Sipas Kodit të Punës, janë lënë 6 masa disiplinore e përkatësisht 4 ‘*vërejtje me shkrim*’ deri në ‘*largim nga puna*’ dhe 2 masa ‘*largim nga puna*’.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A.MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Për periudhën objekt auditimi, SPV ka realizuar gjithsej **75 procedura me negociim pa shpallje paraprake të kontratës** (procedura të reja dhe shtesa 20% të kontratës së mëparshme), në vlerën e përgjithshme **87,762,676 lekë**. Nga auditimi u konstatua se për **43 procedura me negociim pa shpallje paraprake të kontratës**, në vlerën **39,717,998 lekë**, **AK nuk ka vërtetuar, argumentuar dhe dokumentuar se nevoja ekstreme apo situata emergjente ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK**, si dhe **nuk ka vërtetuar nevojën e kryerjes së këtyre procedurave**, e për pasojë këto procedura nuk duheshin zhvilluar me negociim por duhet të zhvilloheshin procedura të hapura në zbatim të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 5, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 36.

-Në të gjithë rastet, dosjet pas inventarizimit nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e juristit të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 83, pika 2.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave është ngritur në fillim të vitit kalendarik, duke e ushtruar veprimtarinë për gjithë vitin, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, gërma ç dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58, ku përcaktohet se ky komision ngrihet me urdhër të veçantë.

-Duke qenë se KVO ka qenë e ngritur në fillim të vitit kalendarik, për procedurat e prokurimit të medikamenteve, pajisjeve mjekësore, karburantit, blerjes së pajisjeve të lavanderisë, shërbimit të riparimit të lavanderisë, shërbimit të riparimit të automjeteve etj., KVO nuk ka në përbërë të saj specialistë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për

rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, gërma ç dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58.

-Vendosja e V. N. me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i SPV, si kryetari i KVO për të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 5.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për të gjitha procedurat e prokurimit, nuk konstatohet kërkuesi i mallit ose shërbimit, në mënyrë që të përcaktohej nevoja e mallit ose e kryerjes së shërbimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Në të gjitha rastet, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/ç dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës”.

-Në 5 raste, nuk konstatohet të jetë argumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, gërma a.

-Në të gjitha rastet, nuk janë vendosur kërkesa për garancinë e mallrave apo shërbimeve që janë prokurohen.

-Në 9 raste, nuk janë vendosur specifikime teknike për mallrat apo shërbimet që do prokurohen, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 1, gërma c dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “F.V. Pajisje teknologjike për spitalin e ri psikiatrik (Lavatriçe 20 kg 2 copë dhe Tharëse 20 kg 2 copë)”, Janar 2015, me vlerë kontrate 8,940,000 lekë me tvsh, specifikimet teknike, konstatohet se janë të karakterit të përgjithshëm shpjegues, nuk përmbajnë të dhëna për garancinë e pajisjeve, si dhe konstatohet se **janë të njëjta dhe të përkthyer nga anglishtja në shqip, si në shpjegime dhe në cilësime, me ato të katalogut të OE të shpallur fitues për këtë procedurë Ë.C. SHPK**, duke përdorur dhe të njëjtën markë “UNILINCTM”, si dhe në DT kërkohet **Tharëse me kapacitet 20 kg**, ndërsa në specifikimet teknike të tharëses përcaktohet se **kapaciteti i peshës së tharjes do jetë 16 kg**. Për më tepër, specifikimet teknike (përmasa, fuqi motorike, operationale etj.) të kërkuara të lavatriçeve dhe tharëseve, janë të njëjta me ato të katalogut të OE Ë.C. SHPK, i shpallur fitues për këtë procedurë tenderimi. Pra AK në këtë procedurë, ka paracaktuar si fitues OE Ë.C. SHPK, për arsye se më këto kriterë nuk mund të shpallej fitues asnjë OE tjetër nga KVO.

-Në rastet e prokurimit të medikamenteve, konstatohet se kërkesat janë të miratuara nga komisioni mjekësor i SPV, pjesë e të cilit është dhe G. N. me detyrë mjekë psikiatre pranë SPV, e cila është bashkëshortja e V. N. me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i SPV, si dhe kryetari i KVO për të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, çka përbën një *konflikt të mundshëm interesi*. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3 pika 1 dhe pika 4, gërma c, si dhe neni 4.

-Në të gjitha rastet, në procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar arsyen e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 5, gërma c dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 36, pika 4.

-Në të gjitha rastet e shtesave të kontratave në fillim të vitit, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar nevojën e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 5 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 36.

-Në të gjitha rastet, nuk është kryer ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, në mënyrë që të përcaktohet përgjegjësia individuale e tyre.

-Në të gjitha rastet, AK nuk ka analizuar shkaqet e anulimit të procedurës, përpara nisjes së procedurës së re, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 2.

-Në 2 raste, është vendosur si mbikëqyrës i kontratës së punimeve, punonjësi i spitalit i cili nuk është i pajisur me licencën përkatëse të mbikëqyrjes së punimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.

-Në 2 raste (“Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” dhe “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm” viti 2016), AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e materialeve dhe shërbimeve, të cilat janë objekt i prokurimit të përqendruar nga Ministria e Brendshme, pa marrë më parë miratimin e kësaj Ministrie, në kundërshtim me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, pika 1.

-Në 2 raste, AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e shërbimeve për një periudhë 4-vjeçare. Por nga Autoriteti Kontraktor nuk është argumentuar arsyeja e kryerjes së këtyre shërbimeve për periudhën 4 vjeçare, duke qenë se këto janë mallra dhe shërbime, për të cilat bëhen planifikime dhe përdorime vjetore, e që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratës”.

-Në 2 raste, është përcaktuar privatizimi i shërbimit të lavanderisë dhe pastrimit, por nga AK **nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e veçantë për trajtimin dhe marrjen në punë të punonjësve të SPV**, të cilët me Urdhrin e drejtorit të AK K. Ll. nr. 238, datë 29.04.2016, i janë ndërprerë në mënyrë kolektive marrëdhëniet e punës me SPV, në kundërshtim me Kodin e Punës. Konkretisht për këtë shërbim, u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve të lavanderisë dhe 28 punonjësve të pastrimit.

-Në një rast, nuk konstatohet procesverbali i miratimit të DT nga njësia e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 2.

-Në një rast, nga njësia e prokurimit në DT është përdorur emri i markës pa përdorur fjalët “ose ekuivalent”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në 6 raste, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar.

-Në 13 raste, nga njësia e prokurimit janë vendosur kritere diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

-Në një rast, është shtyrë afati i ekzekutimit të kontratës, si pasojë e mos pasjes gati të vendit të instalimit të lavatriçeve dhe tharëseve nga AK dhe mos përcaktimit të saktë të kohës së lëvrimit të kontratës në DT, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 9 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet nevoja e prokurimit të shërbimeve dhe/ose mallrave, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Në një rast, është vendosur V. N. kryetari i KVO, i cili në të njëjtën kohë ka marrë pjesë në grupin e punës për përlogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58.

-Në një rast, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për anëtarët e komisionit për përcaktimin e vlerës së kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik", i ndryshuar, neni 56. (Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim:

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

2. -Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.
3. -Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.
4. -Nga Drejtori i Spitalit t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.
5. -Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.
6. -Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit". Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.
7. -Nga titullari i AK, të merren masa që për kontratat e lidhura për periudhë mbi 1-vjeçare, pagesa ndaj kontraktorëve të kryhet vetëm për punimet e kryera.
8. -Nga AK dhe Nëpunësi zbatues, të merren masa që faturimi i karburantit të prokuruar, të jetë në përputhje me kushtet e kontratës.
9. -Titullari i Spitalit Psikiatrik Vlorë, si personi përgjegjës për zhvillimin e procedurave të tenderit, të marrë masa që në kontratat shtesë, zërat e punimeve të jenë të miratuara nga projektuesi dhe të argumentuara teknikisht, si dhe për punimet e domosdoshme por të palidhura teknikisht me kontratën bazë, të zhvillojë procedura prokurimi sipas legjislacionit të prokurimit.

Përgjigja e institucionit:

SPV lidhur me procesin e punës për zhvillimin dhe realizimin në vazhdimësi të procedurave të tenderit, ka ngarkuar secilin person përgjegjës për detyrat e marra.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në funksionimin e strukturave drejtuese, u konstatua se:
-Rregullorja e SPV është miratuar nga Drejtori i Spitalit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 23, pika 2, e cila përcakton se: "2. Ministri i Shëndetësisë përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloret e funksionimit të spitaleve publike".

- Këshillit Administrativ, theksohet se SPV është një institucion shëndetësor i cili nuk punon me bord drejtues sipas ligjit nr.9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në R.Sh." i ndryshuar.- Në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, ekziston pozicioni i "Zëvendësdrejtorit ekonomik", bazuar në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 18, gërma c.

-Nuk është miratuar Rregullorja e funksionimit të komisionit mjekësor, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, gërma g

Për sa më sipër rekomandoj:

- Nga Drejtori i Spitalit të merren masat pranë Ministrisë së Shëndetësisë për miratimin e Rregullores së funksionimit të spitalit, në përputhje me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përgjigja e institucionit:

SPV vazhdon të funksionojë në bazë të Rregullores së Brendshme të vitit 2013.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***pjesërisht i zbatuar.***

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore, u konstatua se:

-Në 4 raste, në dhënien me qira të ambienteve nga SPV, nuk është zhvilluar procedurë konkurrimi, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu I, pika 5, gërma a.

-Në 4 raste, kontrata e qiradhënies për afat mbi 1 vit, është lidhur në tejkalim të kompetencave administrative nga Drejtori i SPV, për arsye se për kontrata mbi 1 vit, e drejta e lidhjes së kontratës i takon organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit, në këtë rast Ministrisë së Shëndetësisë, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu I, pika 6, gërma b.

-Në 4 raste, nuk konstatohet dokumentacioni i dhënies me qira të objekteve, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu II, pika 1.

-Në 4 raste, nuk konstatohet dokumentacioni i marrjes me qira të objektit nga qiramarrësi, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu II, pika 7.

-Në 3 raste, kontrata e qiradhënies, është nënshkruar pa marrë më parë miratimin e Ministrit të Shëndetësisë, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”.

-Në një rast, Këshilli Tekniko-Administrativ i SPV, ka marrë vendim për dhënien me qira të një sipërfaqe 105 m², me objekt “Bar-Bufë”, për një periudhë 10-vjeçare, në tejkalim të kompetencave, për arsye për kontratat mbi 1 vit, e drejta e lidhjes së kontratës i takon organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit, në këtë rast Ministrisë së Shëndetësisë. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu I, pika 6, gërma b. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e këshillit tekniko-administrativ.

-Nga verifikimi fizik i ambientit të dhënë me qira me objekt “Bar-Bufë”, konstatohet se qiramarrësi “D.” SHPK, nuk ka lidhur kontrata me OSHEE dhe UK Vlorë, për furnizimin me ujë dhe energji elektrike, në kundërshtim me kontratën e qirasë nr. 310/8, datë 04.07.2016, neni 6.2, paragrafi 7. Në mungesë të kontratave të veçanta, si dhe duke marrë parasysh që shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm për këto ambiente, vijnë së bashku me shpenzimet e SPV, grupi i auditimit nuk mundi të ndajë vlerën e detyrimit të këtyre shpenzimeve, që shoqëria “D.” SHPK i detyrohet Spitalit Vlorë.

Për sa më sipër rekomandoj:

-Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për ambientet e dhëna me qira.

-Nga Drejtori i Spitalit dhe drejtorja e financës të merren masat ndaj shoqërisë “D.” SHPK, për lidhjen e kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe ujë për ambientin e marrë me qira, në zbatim të kontratës së qirasë nr. 310/8, datë 04.07.2016, neni 6.2, si dhe të merren masa për përlllogaritjen e detyrimeve për energji elektrike dhe ujë për periudhën e shfrytëzimit të qirasë që kjo shoqëri i detyrohet Spitalit Vlorë.

Përgjigja e institucionit:

3.Kontrata me subjektin "D." sh.p.k është mbyllur, është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e kostos mesatare të konsumit të energjisë elektrike si dhe konsumin e ujit të pijshëm, po rëndë nuk është njoftuar subjektin "D." sh.p.k, për të bërë likuidimet përkatëse.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë komision i ngritur nga titullari për nxjerrjen e kostos mesatare të konsumit të energjisë elektrike si dhe konsumin e ujit të pijshëm, si dhe shuma e përlllogaritur.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *i pazbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi:

-Në lidhje me konsumin e karburantit për sistemin e kaldajave që përdoren për ngrohje, në ambientet e spitalit, ngrohen edhe ambientet e guzhinës dhe ambientit të Barit, të cilat janë brenda të njëjtës ndërtesë, dhe janë në shfrytëzim të operatorëve ekonomik të cilët i kanë marrë me qira këto ambiente nga SPV, ndërkohë që nuk paguan asnjë shpenzim për ngrohje. Nga ana e titullarit nuk është ngritur një komision për të bërë një studim dhe të përcaktojë se sa është konsumi që i nevojitet ambienteve të cilat janë në shfrytëzim nga qiramarrësi i cili nuk paguan asnjë tarifë për ngrohje, shpenzime të cilat nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

-Në dokumentet justifikues të shpenzimeve për karburant për automjetet e SPV, konstatohet se në fletë-udhëtimet e shoferëve janë shënuar kilometra më tepër nga distancat reale që ekzistojnë për lëvizjet e automjeteve. Referuar fletë-udhëtimeve dhe dokumentacionit justifikues të konsumit të karburantit konstatohet se ka një papërgjegjshmëri në përlllogaritjen e kërkesave për furnizimin me karburant, duke rritur fiktivisht kërkesat për karburant, duke kryer procedura prokurimi të panevojshme, duke sjellë një keq menaxhim të shpenzimeve për karburant, pasi nuk është e mundur që të konsumohet e gjithë kjo sasi që prokurohet, duke lënë të kuptohet se abuzohet me konsumin e këtij zëri të shpenzimeve, si në kilometrat e përshkuara, si në shpenzimet për riparimin e mjeteve, konsum goma, bateri, vaj, filtra, pjesë këmbimi etj., si dhe në çdo lloj shpenzimi që kryhet për automjetet, pasi janë shpenzime të cilat lidhen ngushtë me njëra tjetrën, me lëvizjen e automjetit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandoj:

-Nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, të merren masat për të përcaktuar konsumin e sasisë së karburantit i cili shfrytëzohet për ngrohje nga ambientet të cilat janë dhënë me qira, duke nxjerrë saktë shpenzimet për këto ambiente dhe t'u bëhet faturimi në ngarkim të tyre, si dhe të dokumentohet çdo proces pune duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, të merren masat për të kryer një sistem kontrolli financiar në lidhje me shpenzimet për karburantin i cili konsumohet për lëvizjen e automjeteve, duke përcaktuar saktë distancat e përshkuara nga shoferët, si dhe duke monitoruar mënyrën e shpenzimeve të karburantit me dokumentacion vërtetues dhe justifikues të rregullt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e institucionit:

-Për konsumin e karburantit i cili shfrytëzohet për ngrohje nga ambientet e dhëna me qira, është ngritur grupi i punës me urdhrin nr.1303 datë 27.09.2017,të cilët në relacionin nr.1689 datë 14.12.2017, përcaktohet se ambientet e dhëna me qira nuk shfrytëzojnë për ngrohje karburantin e Spitalit Psikiatrik.

-Lidhur me shpenzimet për karburantin për automjetet, është mbajtur procesverbali nr.865 prot., datë 10.07.2017, i cili ka të bëjë me procesin e punës për përcaktimin sa më të saktë të KM në vazhdimësi nga shoferët e spitalit.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *në proces*.

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, u konstatua se:

-Për vitin 2014, konstatohet një tejkalim në zërin “Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre” në masën 3,44% dhe në vlerën 150,000 lekë, në zërin “Shpenzime transporti” ka një tejkalim në masën 6,51% dhe në vlerën 220,000 lekë, si dhe në zërin “Shpenzime udhëtimi” ka një tejkalim në masën 21,95% dhe në vlerën prej 153,000 lekë.

-Për vitin 2015, konstatohet një tejkalim në zërin “Shpenzime transporti” në masën 30,6% dhe vlerën 960,000 lekë, në zërin “Shpenzime udhëtimi” ka një tejkalim në masën 23.67% dhe në vlerën 142,000 lekë, si dhe në zërin “Detyrime dhe kompensime legale” ka një tejkalim në masën 23.25% dhe në vlerën 465,000 lekë.

-Për vitin 2016 konstatohet një tejkalim në zërin “Shpenzime udhëtimi” në masën 8.14% dhe në vlerën 57,000 lekë, në zërin “Detyrime dhe kompensime legale” ka një tejkalim në masën 147.72% dhe në vlerën prej 1,331,000 lekë si dhe në zërin “Shpenzime të tjera operative” në masën 2.25% dhe në vlerën 18,000 lekë.

-Projektbuxhetet për vitet 2014-2016, janë hartuar dhe dërguar nga Drejtori dhe shefi i financës të spitalit, dhe jo nga Këshilli Administrativ, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, kreu II, neni 14, pika c.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat dhe të ndiqen të gjitha hapat e duhur për hartimin, miratimin dhe zbatimin e procesit të buxhetit të institucionit, duke respektuar hierarkinë institucionale dhe në ndryshimin e buxhetit, si dhe të kryhen analiza e të jepen shpjegimet përkatëse në lidhje me tejkalimin e zërave të shpenzimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e institucionit:

Për Projekt buxhetin për vitet 2018-2020 dhe në vazhdim, janë ndjekur hapat e rekomanduar duke marrë informacione dhe relacione nga të gjitha drejtoritë.

Komenti i grupit të Auditimit

Mungojnë raportet monitoruese, 4, 8 dhe 12 mujore.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *në proces*.

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave u konstatua se:

-Në 7 raste të personave të punësuar rishtazi në vitin 2014, nuk konstatohet miratimi i Ministrit për procedurën e marrjes në punë.

-Në të gjitha rastet e largimit nga puna për periudhën 2014-2016 më përjashtim të rasteve kur personi largohet me dëshirë, mbaron kontrata e punës ose del në pension (2 raste në vitin 2014, 13 raste në vitin 2015 dhe 2 raste në vitin 2016), nuk është marrë miratimi i Ministrit.

-Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të 15 punonjësve janë konstatuar mangësi në procedurën e përzgjedhjes së aplikantëve, ku mungojnë njoftimet në Buletinin e Njoftimeve Publike ose vlerësimi nga komisioni ad-hoc krahas mungesës së aprovimit të Ministrit.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506 datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”.

-Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Psikiatrik Vlorë është paditur nga 22 persona, nga të cilat 12 janë në proces gjykimimi për të cilët pretendohet një dëmshpërblim në vlerë totale **6,158,765 lekë** fituar në shkallën e parë të gjykimit, me një efekt negativ financiar të pritsëm, ndërsa 10 çështje janë përfunduar duke e detyruar Spitali Psikiatrik Vlorë të paguajë vlerën **7,737,491 lekë**, **vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shtetit**.

-Në datën 01.05.2016 është kryer procedura e pushimit kolektiv nga puna për 28 persona si pasojë e privatizimit të shërbimit të pastrimit, lavanderisë dhe gjelbërimit në kundërshtim me

Kodin e Punës, Neni 148 ku numri maksimal për pushimin kolektiv është 15 punonjës për shoqëritë me 100-200 punonjës. Nuk është zbatuar procedura e njoftimit me shkrim të organizatave përfaqësuese për pushimin nga puna të këtyre punonjësve si dhe nuk është marrë miratimi i Ministrit për procedurën e largimit të këtyre punonjësve.

Për sa më sipër rekomandoj:

-Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masat që marrja në punë e punonjësve të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duke ndjekur etapat e duhura deri në shpalljen fitues të konkurrentit.

-Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori i Financës, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Përgjigja e institucionit:

-Për rekrutimin e punonjësve në Spitalin Psikiatrik Vlorë, është ngritur grupi i punës për analizimin e rasteve të largimit nga puna me urdhrin nr.1304 prot.,datë 27.09.2017, ku është përgatitur relacionin nr.1557 prot., datë 14.11.2017.

Rekrutimi i punonjësve në Spitalin Psikiatrik Vlorë bëhet duke zbatuar:

- Urdhër Nr.511, datë 13.12.2011 të Ministrit të Shëndetësisë “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik”.
- Urdhër Nr.506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambjentëve dhe hapsirave ,në institucionet shëndetësore”.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***i zbatuar.***

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zërit kontabël “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 252,955, 299 lekë në vitin 2016, konstatohet se 6 godina janë të regjistruara në ZVRPP Vlorë, ndërsa 2 godina në vlerën 35,975,605 lekë nuk kanë certifikatë pronësie, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 158 datë 15.04.2016 të Ministrisë e Shëndetësisë për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë”.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtori i Spitalit, Sektori i Financës dhe juristi, të merren të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e identifikimit dhe regjistrimit të aseteve në ZVRPP Vlorë dhe vënien në shfrytëzim të tyre për interesat e shoqërisë.

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të Urdhrit nr. 158, datë 15.04.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e M.SH”, ka filluar procesi i punës për inventarizimin e pronave të paluajtshme. Me shkresën nr. 235/15 prot., datë 07.12.2016 i është dërguar materiali Ministrisë së Shëndetësisë duke i bashkëngjitur formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit konstatoi se “Ndërtesa e konstruksione”, janë të regjistruar në kontabilitet, por nuk janë regjistruar në ZVRPP Vlorë, pra nuk kanë certifikatë pronësie, bazuar në gjetjen nr.7 ku citohet se: Nga auditimi i zërit kontabël “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 252,955, 299 lekë në vitin 2016, konstatohet se 6 godina janë të regjistruara në ZVRPP Vlorë, ndërsa 2 godina në vlerën 35,975,605 lekë nuk kanë certifikatë pronësie, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 158 datë 15.04.2016 të Ministrisë e Shëndetësisë për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë”

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, **në proces.**

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i gjendjeve debitorë rezulton se institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin e detyrimeve dhe menaxhimin e debitorëve dhe nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar ndër vite në vlerën 14,808,039 lekë. Institucioni i dërgon personave debitorë një njoftim për

arkëtim nëpërmjet postës dhe ka hartuar Urdhrin nr. 121 datë 21.10.2016, si dhe Urdhrin nr. 152 datë 23.11.2016, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve. Përpos urdhrave të hartuar, institucioni nuk ka mundur të arkëtojë debitin e krijuar në mospërputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 36-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit, Sektori i Financës dhe juristi i shoqërisë, të analizohet situata e debitorëve, nga ku të dalin përfundime për zgjidhjen e situatave të ndryshme të krijuara, dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme, pavarësisht nga vlera.

Përgjigja e institucionit:

SPV ka nxjerrë urdhrin nr.285 prot., datë 13.12.2017, urdhër i cili përcakton mënyrën që duhet ndjekur për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve.

Rezulton se aktualisht ka debitor kundrejt Spitalit Psikiatrik Vlorë.

Sqarohet se përsa i përket shumës së debitorëve 14,808,039 vlera prej 14,147,876 janë detyrimet për muajin dhjetor për paga dhe sigurime shoqërore të cilat paguhën në muajin janar të vitit pasardhës, kurse shuma prej 660,163 janë debitorët ndërvite të konstatuar. Është marrë vendimi për mos procedim në mënyrë gjyqësore për arkëtimin e shumës me shkresën nr.528/13 prot., datë 04.01.2017 duke qenë se janë parashkruar afatet për ngritjen e padisë.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***i zbatuar***.

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi imenaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit brendshëm në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë rezulton se ky sistem ka funksionuar në nivele shumë të ulëta, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është kuptuar duke funksionuar vetëm në disa hallka të njësisë. Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. (Trajtuar më hollësisht në faqet 207-211, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

-Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm e menaxhimit financiar, duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet konstatuara.

-Të merren masa për ngritjen e kapaciteteve në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Përgjigja e institucionit:

Ka filluar puna për zbatimin e kontrollit të brendshëm, janë ngritur grupe kontrolli duke raportuar mbi punën e kryer në institucionin. Sipas nenit 27 të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe sipas pikës 2.2.6 të Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhrin nr.108 datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit Financiar” nga Ministri i Financave ku citohet se “*cdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë...*” me urdhrin e brendshëm nr. 217 datë 20.09.2019 “Për krijimin e Girupit Për Menaxhimin Strategjik” i miratuar nga titullari i institucionit, është ngritur GMS, e përberë nga titullari i institucionit, N/drejtor ekonomik, N/drejtor teknik, si dhe shefat e sektorëve.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik në vlerën **26,353,753 lekë** dhe dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen në vlerën **31,254,789 lekë**. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, Shkurt 2016, me vlerë kontrate 112,009,392 lekë me tvsh, me afat 4 vite (01.05.2016-30.04.2020), **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përlllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës, është në vlerën **3,918,620 lekë** për vitin e parë të kontratës. (*Rrajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,918,620 lekë**, nga operatori ekonomik “AGS” SHPK, për punime të pakryera në procedurën e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”.

-Nga Drejtori i Spitalit të merren masa e duhura ligjore për ndërprerjen pa asnjë kosto shtesë të kësaj kontrate, për arsye se në rast të vazhdimit me këto kushte, do ishte e lartë përgjegjësia e titullarit të spitalit, për **dëmin ekonomik të mundshëm** në të ardhmen në vlerën **11,755,860 lekë**, për 3 vitet e tjera të kontratës.

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr.1252 prot., datë 20.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Ndaj Vendimit të Gjykatës Administrative e shkallës së parë Vlorë nr.231,datë 22.02.2018 e cila ka vendosur pranimin e Padisë është bërë Kërkesë Ankimore ndaj Gjykatës së Apelit Administrativ për ndryshimin e vendimit, vendim për pranim ankimi nr.1852/219 Akti,datë 12.03.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Përsa i përket ndërprerjes së kontratës nuk është marrë asnjë masë.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***pjesërisht i zbatuar***.

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt “Shërbime për pastrim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik Vlorë”, **dëmi ekonomik** i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përlllogaritja e gabuar e zbatimit të vlerës së kontratës, është në vlerën **5,131,297.25 lekë** me tvsh për 10 muaj të zbatimit të kontratës. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **5,131,297.25 lekë**, të përfituara padrejtësisht nga operatori ekonomik “S. Al” SHPK, në zbatimin kontratës me objekt “Shërbime për pastrim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik Vlorë”.

-Nga Drejtori i Spitalit të merren masa e duhura ligjore për ndërprerjen pa asnjë kosto shtesë të kësaj kontrate, për arsye se në rast të vazhdimit me këto kushte, do ishte e lartë përgjegjësia e titullarit të spitalit, për **dëmin ekonomik të mundshëm** në të ardhmen në vlerën **19,498,929 lekë**, për 3 vitet e tjera të kontratës.

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr.1220 prot., datë 14.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Me vendimin nr 1066, datë 20.09.2018 është vendosur rrëzimi i Kërkesë-Padisë, është bërë ankim nr.2053,datë 05.11.2018 mbi vendimin 1066. Vendim mbi pranim ankimi nr.2053/1,datë 04.12.2018 .

Komenti i grupit të Auditimit

Përsa i përket ndërprerjes së kontratës nuk është marrë asnjë masë.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***pjesërisht i zbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi:

Për kontratën e Shërbimit nr. 927 prot., datë 11.05.2015, me objekt “Mirëmbajtje e lavanderisë”, me afat deri më 31.12.2015, nga auditimi i kryer, nuk konstatohet dokumentacion vërtetues e provues për funksionimin e lavatriçeve dhe tharëseve të vjetra, si dhe nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së shërbimit të riparimit, për arsye se SPV ka lidhur kontratën nr. 26, nr. 590 prot., datë 12.03.2015, me objekt “F.V. Pajisje teknologjike për spitalin e ri psikiatrik (Lavatriçe 20 kg 2 copë dhe Tharëse 20 kg 2 copë)”, pajisje të cila janë pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim më datë 04.05.2015. Për pasojë, pagesa e riparimit të lavatriçeve dhe tharëseve pas kësaj date, në vlerën **1,357,776 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të Buxhetit të Shtetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **1,357,776 lekë**, nga titullari i AK K. Ll. dhe Nëpunësi Zbatues V. N., për kryerjen e procedurës me objekt “Mirëmbajtje e lavanderisë” për vitin 2015, për të cilën nuk konstatohet dokumentacion vërtetues e provues për funksionimin e lavatriçeve dhe tharëseve të vjetra, si dhe nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së shërbimit të riparimit.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1260 prot., datë 21.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqimit.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka një përgjigje lidhur me arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

4. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, Shkurt 2016, me vlerë kontrate 112,009,392 lekë me tvsh, në specifikimet teknike janë kërkuar dhe materiale të buta “Përparëse sanitari”, të cilat janë objekt i procedurës së prokurimit “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm”, pra këto mallra janë prokuruar 2 herë. Për pasojë blerja e materialeve të pastrimit në vlerën **80,579 lekë** përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **80,579 lekë**, nga anëtarët e njësisë së prokurimit S. Xh., K. Xh. dhe E. M., titullari i AK K. Ll. dhe shefi i financës V. N., për prokurimin e zërave “Përparëse Sanitari” dhe “Larje Përparëse Sanitari”, në procedurën e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, për arsye se të këto zëra janë dhe objekt i procedurës së prokurimit “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm”, pra këto zëra janë prokuruar 2 herë.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1264 prot., datë 21.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqimit. Me vendimin nr.591, datë.10.04.2019 është vendosur pushimi i gjyqimit të çështjes civile me nr.884, datë.24.01.2019, është bërë Ankim Civil me nr.873 prot., datë.13.05.2019.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *në proces*.

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës për “Shërbimin e ruajtjes së spitalit me roje private”, për vitin 2014, rezultoi se në ambientet godinës së spitalit psikiatrik, nuk ishin dy vendroje por një vendroje dhe operatori ekonomik është paguar më tepër në shumën **1,197,720 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit si përfitim i padrejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “S. S.” SHPK dhe “E.” SHPK. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **1,197,720 lekë** nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “S. S.” SHPK. dhe “E.” SHPK, si përfitim i padrejtë për shërbim të pakryer.

Përgjigja e institucionit:

Rekomandimi është zbatuar, me shkresën nr.1240 prot., datë 19.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Në datë 16.01.2018 Gjykata Administrative e Sh.I Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë. Do të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. është bërë Ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë nr.697 prot., datë.11.04.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e vlerës nga operatorët ekonomikë.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *në proces*.

6. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës për “Shërbimin e ruajtjes së spitalit me roje private”, për vitin 2015, rezultoi se pagesat e bëra nga AK në lidhje me këtë kontratë janë kryer vetëm në bazë të faturës tatimore dhe një situacioni të paraqitur nga kontraktori, pa asnjë dokument tjetër vërtetues dhe mbështetës, dhe në ambientet e spitalit nuk vërtetohet fakti se ka patur dy vendroje dhe referuar kontratës së lidhur konstatohet se është paguar më tepër vlera **2,192,602 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit si përfitim i padrejtë nga operatori ekonomik “S. S.” SHPK.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën “Kërkesë për propozim” dhe për 9 procedurat “Me negociim pa shpallje”, për tenderët me objekt “Shërbimin e ruajtjes së spitalit me roje private”, për vitin 2016, rezultoi se pagesat e bëra nga AK në lidhje me këtë kontratë janë kryer vetëm në bazë të faturës tatimore dhe një situacioni të paraqitur nga kontraktori, pa asnjë dokument tjetër vërtetues dhe mbështetës, dhe në ambientet e spitalit nuk vërtetohet fakti se ka patur dy vendroje dhe referuar kontratave të lidhura konstatohet se është paguar më tepër vlera **2,564,961 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit si përfitim i padrejtë nga operatori ekonomik “S. S.” SHPK.

-Nga auditimi i shtesës së kontratës nr. 8/1 prot, datë 04.01.2017 “Ruajtje e ambienteve të SPV”, rezultoi se pagesat e bëra nga AK në lidhje me këtë kontratë janë kryer vetëm në bazë të faturës tatimore dhe një situacioni të paraqitur nga OE, pa asnjë dokument tjetër vërtetues dhe mbështetës, dhe në ambientet e spitalit nuk vërtetohet fakti se ka patur dy vendroje dhe referuar kontratës së lidhur konstatohet se është paguar më tepër vlera **397,353 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit, si përfitim i padrejtë nga operatori ekonomik “S. S.” SHPK.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës shtesë me nr. 17/1prot me datë 05.01.2017, me vlerë 1,913,431, rezultoi se pagesat e bëra nga AK në lidhje me këtë kontratë janë kryer vetëm në bazë të faturës tatimore dhe një situacioni të paraqitur nga OE, pa asnjë dokument tjetër vërtetues dhe mbështetës, dhe në ambientet e spitalit nuk vërtetohet fakti se ka patur dy

vendroje dhe referuar kontratës së lidhur konstatohet se është paguar më tepër vlera **302,091 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit, si përfitim i padrejtë nga operatori ekonomik “S. S.” SHPK.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **5,457,007 lekë** nga operatori ekonomik “S. S.” shpk.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1218 prot., datë 14.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit, është bërë Ankim për zënie afati nr.779 prot.,datë 25.04.2018, deri sa të vihet në dispozicion vendimi i plotë i zbardhur. Ankim nr.1109/1 prot.,dt 24.06.2020. Vendimi nr.84,dt.18.02.2021 nga Gjyk. Adm. e Apelit. Rekurs nr.606 prot, dt.01.04.2021.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces.***

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratës shtesë me nr. 18/1 prot, me datë 05.01.2016, u konstatua se nga verifikimi i shpenzimit nr. 44 datë 16.03.2016 në shumën 306,240 lekë xhiruar për llogari të “Autosprint” Albania, u konstatua se shoferët bazuar në fletë-udhëtimet e tyre, kishin qenë në lëvizje pune së bashku me personat të cilët kishin firmosur fletë-udhëtimet e tyre, pra makinat nuk kishin qenë në servis në ato data sikurse kishin shkruar në procesverbalet e mbajtura. Gjithashtu nuk vërtetohet emergjenca dhe nevoja e lidhjes së kësaj kontrate dhe kryerjes së shërbimeve për mirëmbajtjen e automjeteve pasi nuk ka kërkesa pra veprimet e tyre janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI, neni 36 gërma ë), dhe nenin 55, gërma f), me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pra shuma e paguar për këtë shpenzim në vlerën **306,240 lekë** përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **306,240 lekë** nga K. Ll., V. N., P. L., Th. M., A. M. dhe K. H.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1261 prot., datë 21.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Kundër vendimit nr.432., datë.09.03.2018 e cila ka vendosur rrëzimin e Këkesë –Padisë është bërë Ankim-Civil nga pala e paditur.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces.***

8. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me furnizimin me karburant për nevoja të SPV, është lidhur kontrata me nr. 8/1 prot, me datë 05.01.2016, nga titullarit të SPV K. Ll. me OE “R. C.” SHPK. Vlorë me përfaqësues R. C. në shumën 179,820 lekë me tvsh, me çmim fiks 135 lekë/litër, dhe nuk është lidhur me operatorin ekonomik i cili është përcaktuar si kontraktues bazë për furnizimin me karburant por me një operator tjetër ekonomik, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu III, neni 33, pika 3, gërma b), dhe pika 5, gërma a),

si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 36, pika 2, gërma ë). Nga zbatimi i kontratës konstatohet se nga shpenzimet e kryera, duke mos u lidhur kontrata me OE “K.”, si furnizuesi i kontratës bazë, si dhe duke mos ju referuar çmimeve publikuara në buletin e APP-së, kanë paguar më tepër në vlerën **26,024 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **26,024 lekë** nga Drejtori i SPV K. Ll. dhe shefi i financës V. N.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1259 prot., datë 21.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Me Vendimin Nr.1990, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur rrëzimi i padisë, është bërë ankesë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces.***

9. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me shpenzimet e kryera për furnizimin me karburant për automjetet e SPV, nga auditimi i dokumentacionit të fletë-udhëtimeve të shoferëve u konstatua se kilometrat të cilat evidentoheshin në fletë-udhëtime nuk përputheshin me distancat reale të kryera për lëvizjet e automjeteve. Nga titullari i SPV dhe Shefi i Financës nuk është ushtruar kontrolli i duhur për dokumentacionin justifikues dhe verifikimin e fletë-udhëtimeve të distancave reale me konsumin e karburantit, në kundërshtim me *ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke sjellë një shpenzim të pajustificuar me dokumentacion në shumën prej 170,266 lekë për vitin 2014, në shumën 216,929 lekë për vitin 2015 dhe në shumën 284,944 lekë për vitin 2016 dhe në total në vlerën **672,139 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **672,139 lekë** nga Drejtori i SPV K. Ll., ish Drejtori Gj. A., Shefi i Financës V. N. dhe shoferët e automjeteve A. M., Th. M., K. H. dhe P. L.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1262 prot., datë 21.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për arkëtimin e shumës.

Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Me vendimin nr.405, datë 06.03.2018 është vendosur rrëzimi i padisë, është bërë Ankim-Civil në Gjykatën e Apelit Vlorë me nr.564 prot., datë 19.03.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces.***

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit për “Mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike për SPV”, me fond limit 375,000 lekë pa tvsh, u konstatua se është lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues “E. P.”, i cili është shpallur fitues, në shumën 345,000 lekë. Nga zbatimi i kontratës së lidhur pasi u krye verifikimi mbi likuidimin e kryer për këtë shërbim, u konstatua se ishin kryer disa punime në kompjuterët e administratës të cilët ishin paguar në vlerën

105,400 lekë, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit si përfitim i padrejtë nga ky OE. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 189-199, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **105,400 lekë** nga operatori ekonomik “E. P”.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1241 prot., datë 19.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Me vendimin nr.1072,datë.20.09.2018 është vendosur plotësisht për pranimin e Kërkesë-Padisë,është bërë Ankim nga ankues E. P. Disponojme vendim për pranim ankimi nr.regj.560.,nr.2249 prot., datë.14.12.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga operatori ekonomik.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

11. Gjetje nga auditimi:

Me urdhër shpenzimin nr. 93, datë 25.04.2014, është kryer pagesa ndaj Operatorit ekonomik “A. B. S.”, në shumën 127,080 lekë, për faturën nr. 179, datë 21.10.2013, për ndërtimin e faqes së internetit të SPV dhe mirëmbajtjen e saj. Nga verifikimi rezultoi se në dokumentacionin bashkangjitur kësaj pagese nuk ka akt për marrjen në dorëzim të këtij shërbimi, nga navigimi në internet nuk konstatohet ekzistenca e faqes së ueb-it të SPV, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Pagesa e kryer në vlerën **127,080 lekë** është përfituar padrejtësisht nga OE “A. B. S.” e si e tillë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **127,080 lekë** nga operatori ekonomik “A. B. S.”.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1216 prot., datë 14.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Me vendimin nr.175,datë 13.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është vendosë rrëzimi i Kërkesë-Padisë, është bërë Ankim me nr .698 prot., datë.11.04.2018. Vendim për pranim Ankimi nr.regj.2016/316., datë.07.06.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga operatori ekonomik.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezulton se Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë ka kryer në vitin 2016 procedurën e prokurimit “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” me vlerë 1,479,971.98 lekë me tvsh, me OE “D.” SHPK. Evadimi i mbetjeve urbane është një shërbim i cili mbulohet nga kontrata 5-vjeçare me nr. 4558 Prot., e lidhur më datë 31.10.2014, ndërmjet firmës së pastrimit “D.” SHPK dhe Bashkisë Vlorë. Gjithashtu ky shërbim mbulohet nga sanitaret e Spitalit Psikiatrik në mbështetje të Rregullores së Brendshme nr. 11, datë 10.10.2013, neni 31, pika 3, e cila përcakton se: “*Sanitarja grumbullon dhe largon plehrat nga reparti për në vendet e caktuara*”. Në të njëjtën kohë, kjo përgjegjësi mbulohet nga kontrata e shërbimit nr. 28, datë 08.04.2016 “*Për kryerjen e shërbimeve për pastrim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe mirëmbajtja e*

ambjenteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”, e specifikuar në nenin 7 “Detyrat e veçanta të Kontraktuesit”. Për pasojë shuma e kësaj procedure në vlerën **1,479,971.98 lekë**, përbën **dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit**.

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,479,971.98 lekë**, nga operatori ekonomik “D.” SHPK, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1215 prot., datë 14.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Me Vendimin Nr.61-2018-30, datë 23.01.2018 është vendosur rrezimi i padisë, do të bëhet ankesë në Gjykatën e Apelit Vlorë, është bërë Ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë nr.260 prot., datë.06.02.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga operatori ekonomik.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Ndërtimi i Spitalit të Ri Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”, u konstatua diferencë në volumet e punimeve të kryera në fakt, krahasuar me preventivin e objektit, si pasojë e të cilave është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve vlera prej **6,117,935.52 lekë** me tvsh, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të Buxhetit të Shtetit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-189, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **6,117,935.52 lekë**, të përfituara padrejtësisht nga operatori ekonomik “J.” SHPK, në zbatimin e punimeve në objektin “Ndërtimi i Spitalit të Ri Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1241 prot., datë 19.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Aktualisht SPV është në proces gjyqësor, sipas vendimit të gjykatës do të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit. Me vendimin nr.1072, datë.20.09.2018 është vendosur plotësisht për pranimin e Kërkesë-Padisë, është bërë Ankim nga ankues E. P. Disponohet vendim për pranim ankimi nr.regj. 560., nr.2249 prot., datë 14.12.2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk ka përgjigje për arkëtimin e shumës nga operatori ekonomik.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***.

14. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e kontratës së shërbimit nr. 568, datë 30.04.2013, me objekt “Shërbim cateringut”, për periudhën 01.01.2015-31.12.2016, nga krahasimi i numrit të pacientëve të shtruar sipas Degës Teknike dhe numrit të racioneve ushqimore ditore të furnizuara sipas Akt-Rakordimeve mujore u konstatuan diferenca, duke rezultuar në një faturim më të lartë për vitin 2015 me 355 racione dhe për vitin 2016 me 237 racione gjithsej, duke shkaktuar **dëm ekonomik** për llogari të Buxhetit të Shtetit në vlerën **375,963 lekë**.

Për sa më sipër rekomandoj:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **375,963 lekë**, nga operatori ekonomik “S. Al” SHPK, për diferencat shtrimeve të konstatuara në faturimin e kryer për shërbimin e cateringut.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1219 prot., datë 14.09.2017 është bërë padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për arkëtimin e shumës. Me Vendimin Nr.08, datë 09.01.2018 të Gj.Adm. Sh.I Vlorë, është vendosur rrëzimi i padisë, ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga operatori ekonomik është kthyer përgjigje negative.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *në proces*.

SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Gjatë auditimit janë konstatuar gjetje me impakt negativ në realizimin e të ardhurave të shoqërisë dhe të shtetit në vlerën **27,422,600 lekë**, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje objektsh ndërtimore, impjantistike, pajisje zyrash dhe hotelerie”, Prill 2016, me vlerë kontrate 2,776,457 lekë me tvsh, KVO ka skualifikuar OE me ofertën më të ulët, me argumentimin se: “*Nuk përmbush kriterin paraqitjen e certifikatës së pronësisë ose kontratën e qirasë për vendndodhjen në qytetin apo qarkun Vlorë*”. KVO ka skualifikuar këtë OE, sipas një kriteri diskriminues të vendosur pa të drejtë nga njësia e prokurimit, si dhe ka kualifikuar OE me ofertë më të lartë i cili nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentet e Tenderit. Për pasojë, **vlera 2,776,457 lekë**, e cila përbën vlerën totale të procedurës së zhvilluar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përbën **efekt financiar negativ** për llogari të Buxhetit të Shtetit. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20.

Për sa më sipër rekomandoj:

Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **2,776,457 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me skualifikimin e ofertës më të ulët të paraqitur, sipas një kriteri diskriminues të vendosur pa të drejtë nga njësia e prokurimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerrë urdhri nr.1306 prot., datë 27.09.2017 për analizimin e vlerës.

Grupi punës me shkresën nr.1584 prot., datë 20.11.2017, ka përgatitur relacionin dhe analizimin e komisionit të ngritur.

Komenti i grupit të Auditimit

Pas këtij urdhëri nuk ka veprime të tjera.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *i pazbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla për “Furnizimin me karburant për nevojat e SPV”, me fond limit 800,000 lekë dhe sasinë 5,570 litra u konstatua se përlllogaritja e fondit limit nuk është bazuar në kontratën bazë të lidhur me OE “K.” sha. Durrës. Kontrata është lidhur me nr. 1299/3 prot me datë 13.11.2015 me OE “R. C.” SHPK., Vlorë me vlerë kontrate 751,950 lekë me çmim 135 lekë/litër, dhe jo me marzh fitimi. Nga mos referimi ndaj kontratës bazë e cila ishte lidhur me një marzh fitimi prej 11.4%, rezulton se SPV ka paguar më tepër një shumë prej **57,382 lekë**, vlerë e cila është **efekt negativ financiar** për Buxhetin e Shtetit.

-Është kryer procedurë prokurimi “Me negociim pa shpallje”, për “Furnizim me karburant për nevojat e SPV” për vitin 2016, me fond limit në shumën 1,745,708 lekë pa tvsh. Është hartuar dhe lidhur kontrata midis titullarit të AK K. Ll. me përfaqësuesen e OE “R. C.”, në shumën 1,745,708 lekë pa tvsh, me marzh fitimi 15%. Referuar kontratës bazë me shoqërinë “K.” sha. Durrës, me të cili SPV ka lidhur kontratën me marzh fitimi prej 11.4%, konstatohet se nga

pagesat e kryera konstatohet një **efekt financiar negativ** në shumën **107,550 lekë** për Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **164,932 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me lidhjen e shtesave të kontratave të furnizimit me karburant me marzh të ndryshëm nga kontrata bazë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën **efekt financiar negativ**.

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerr urdhri nr.1307 prot., datë 27.09.2017 për analizimin e vlerës.

Komenti i grupit të Auditimit

Sipas grupit të punës procedura është e rregullt, por nga ana e titullarit nuk janë përcaktuar përgjegjësitë.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***i pazbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e automjeteve të SPV, janë kryer me anë të procedurave të prokurimit, por nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se këto shpenzime janë thuajse të njëjtat në preventivat që kryheshin çdo vit. Nuk ka një preventiv real në momentin që ndodh defekti i një automjeti, por preventivat për riparimin e tyre kryhen si parashikim për vitin në të cilin është hapur procedura, pa qenë realisht të dëmtuara, çka është konstatuar dhe në likuidimet pjesore përgjatë vitit. Spitali Vlorë disponon automjete të cilat vlera e shpenzimit të tyre tejkalon në rreth mbi 3-4 herë vlerën reale të tyre, pra nuk ka një monitorim dhe një menaxhim financiar të kontrolluar në lidhje me këto shpenzime për të cilat nuk konstatohet dokumentacion vërtetues e provues. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Për pasojë shuma e shpenzuar për këto automjete për vitet 2015 dhe 2016, në vlerën **3,015,804 lekë**, përbën **efekt financiar negativ** për Buxhetin e Shtetit

Për sa më sipër rekomandoj:

Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **3,015,804 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me riparimin e automjeteve të spitalit pa dokumentacionin përkatës. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerr urdhri nr.1038 prot., datë 27.09.2017 për analizimin e vlerës së mësipërme. Grupi i punës me shkresën nr.1541 prot., datë 10.11.2017 ka dorëzuar në drejtori relacionin përkatës.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***në proces***

4. Gjetje nga auditimi:

Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Psikiatrik Vlorë është paditur nga 22 persona, nga të cilat 12 janë në proces gjykimi për të cilët pretendohet një dëmshpërblim në vlerë **6,158,765 lekë** fituar në shkallën e parë të gjykimit, me një efekt negative financiar të pritshëm, ndërsa 10 çështje janë përfunduar duke e detyruar Spitali Psikiatrik Vlorë të paguajë vlerën **7,737,491 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit**

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit të merren masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën **7,737,491 lekë**, të ardhur si pasojë e mos ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangjen e kostove shtesë nga proceset gjyqësore në proces të cilat janë probabël për efekt negativ financiar në vlerën **6,158,765 lekë** për Spitalin Psikiatrik Vlorë.

Përgjigja e institucionit:

Për të gjithë proceset gjyqësore janë bërë ankimimet në të gjitha shkallët e gjykimit

Komenti i grupit të Auditimit

Nuk janë marrë masa për shqyrtimin e vlerës së mësipërme.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***i pazbatuar***.

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i gjendjeve kreditore, konstatohet se Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë gjatë periudhës së auditimit 2014-2016 ka shlyer detyrimet e prapambetur të energjisë elektrike si kamatëvonesat të llogaritura dhe gjeneruara nga sistemi i faturimit të OSHEE sh.a. Kamatëvonesat e akumuluar janë paguar në nëntor 2014 dhe mars 2015 shoqëruar me urdhër shpenzimit përkatës dhe kanë një vlerë prej **577,615 lekë** e cila përbën **efekt negativ financiar**. Janë hartuar dy Urdhra Prokurimi për prokurimin me vlera të vogla Nr. 1570 Prot., datë 25.11.2014 me vlerë 485,474 lekë si dhe Urdhri Nr. 630 Prot., datë 23.03.2015 me vlerë 180,026 lekë për pagesat e penalteteve dhe kamatëvonesave për energjinë elektrike. Këto fatura duhet të paguhet nga buxheti vjetor i miratuar i Ministrisë së Shëndetësisë për Spitalin Psikiatrik dhe pagesa e prokurimit me vlerë të vogël për likuidimin e faturave dhe kamatëvonesave të faturave të energjisë elektrike nuk është e rregullt. Gjithashtu, kjo procedurë prokurimi nuk figuron në sistemin e prokurimeve

Për sa më sipër rekomandoj:

Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **577,615 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me detyrimet e prapambetura të energjisë elektrike si kamatëvonesat të llogaritura dhe gjeneruara nga sistemi i faturimit të OSHEE. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerrë urdhri nr.1305 prot., datë 27.09.2017 për analizimin e vlerës, për të cilin është hartuar relacioni për evidentimin e shkaqeve.

Komenti i grupit të Auditimit

Pas këtij urdhëri nuk ka veprime të tjera.

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***i pazbatuar***.

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i gjendjeve kreditore, figuron se nuk është likuiduar fatura Nr. 617929636 e lëshuar nga OSHEE sh.a për detyrimin e muajit Tetor 2014, me një vlerë prej 2,246,995 lek për Spitalin Psikiatrik me Nr. Kontrate FIOA040014026593, me pretendimin se është faturuar gabim (mbifaturim) nga ana e OSHEE sha. Mos likuidimi në afat i kësaj fature ka gjeneruar një penaltet si kamatëvonesë i cili deri më 28.04.2017 kap vlerën e **1,957,045 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe shtuar me ligjin Nr. 10486, datë 26.11.2011 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Spitalit dhe Sektori i Financës të merren masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën **1,957,045 lekë**, të ardhur si pasojë e mos ndjekjes së procedurave ligjore në procesin e gjykimit, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës. Ndërkohë, Sektori Juridik

të marrë masa për rinisjen e procesit gjyqësorë për sistemimin e principalit të faturës dhe shmangien e këtij penaliteti i cili përbën efekt financiar negativ për shoqërinë.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1454 prot., datë 24.10.2017 është ngrit padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me V.K.M nr.126 datë 11.02.2015 është shlyer detyrimi ndaj OSHEE.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *i zbatuar*.

7. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi është konstatuar se në ofertën e shpallur fituese “J.” shpk për zbatimin e objektit “Ndërtimi i Spitalit të Ri Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”, zëri “Pajisje” është llogaritur në situacionin përfundimtar së bashku me tvsh, në vlerën 2,811,520 lekësi rrjedhë e përfshirjes së TVSH^{së}, së pajisjeve në preventivin e punimeve, vlerë kjo e cila efekt negativ financiar prej 2,811,520 lekë në buxhetin e shtetit. Gjithashtu në kontratën shtesë, si pasojë e përfshirjes në fondin limit të TVSH^{së} për pajisjet është rritur fiktivisht fondi limit në vlerën **815,200 lekë**.

-Nga auditimi i kontratës shtesë, rezulton të jenë vendosur zëra punimesh të panevojshëm në vlerë totale 6,358,035 lekë pa tvsh, si “F.V Mekanizëm me litar për hapjen të dritareve” me vlerë 748,200 lekë pa tvsh, “F.V. me alukobond e parapetit” me vlerë 838,035 pa tvsh dhe “F.V. Brisole linear (hije zues) për fasadë në dy kate” me vlerë 5,520,000 lekë pa tvsh. Si rezultat i nënshkrimit të kontratës shtesë, në kundërshtim me LPP dhe RPP, vendosja në preventivin e kontratës shtesë e zërave të punimeve të pa miratuara e që nuk ishin të nevojshme për përfundimin e kontratës bazë, shuma **7,629,642 lekë** me tvsh (6,358,035 lekë pa tvsh) është efekti ekonomik i shkaktuar nga shkeljet e konstatuara më sipër.

-Nga auditimi është konstatuar se në ofertën e shpallur fituese “J.” shpk për zbatimin e kontratës “Furnizim vendosje pajisje hotelerie dhe mobilimi i Spitalit Psikiatrik, Vlorë”, Faza I,” me fond limit 10,000,000 lekë, kur nuk i plotëson kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor e për pasojë nuk duhej të kualifikohet. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “J.” shpk, bie ndesh me nenet 1,2 e 20 të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Shuma 2,290,345 lekë pa tvsh (2,748,414 lekë me tvsh) që është diferenca midis ofertës të operatorit ekonomik “J.” shpk, shpallur padrejtësisht fitues me ofertën e operatorit ekonomik “R.-A.” shpk, shuma **2,748,414 lekë** me tvsh (2,290,345 lekë pa tvsh) është efekti ekonomik i shkaktuar nga shkeljet e konstatuara më sipër.

Për sa më sipër rekomandoj:

Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **11,193,256 lekë** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të kontratës së punimeve me objekt “Ndërtimi i Spitalit të Ri Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerrë urdhri nr.1309 prot., datë 27.09.2017 për analizimin e vlerës. Gjithashtu është bërë padi në Gjykatën e Rrethit Vlorë ndaj operatorit ekonomik i cili ka dalë fitues i procedurës së prokurimit për objektin e sipër cituar, për shkaktim dëmi ekonomik.

Komenti i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, *i zbatuar*.

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 14, pika d, i kërkojmë Ministrin të Shëndetësisë, që pasi të analizojë gjetjet e pasqyruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “*Largim nga puna*”, për:

1. Z. K. Ll. me detyrë drejtor i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën 24.11.2014 e në vazhdim;

Për arsye se:

-Nga auditimi u konstatua se për **39 procedura me negocim pa shpallje paraprake të kontratës**, në vlerën **36,487,705 lekë**, AK nuk ka vërtetuar, argumentuar dhe dokumentuar se nevoja ekstreme apo situata emergjente ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK, si dhe nuk ka vërtetuar nevojën e kryerjes së këtyre procedurave, e për pasojë këto procedura nuk duheshin zhvilluar me negocim por duhet të zhvilloheshin procedura të hapura në zbatim të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 5, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 36.

-Në 2 raste (“Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” dhe “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm” viti 2016), AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e materialeve dhe shërbimeve, të cilat janë objekt i prokurimit të përqendruar nga Ministria e Brendshme, pa marrë më parë miratimin e kësaj Ministrie, në kundërshtim me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, pika 1.

-Në 2 raste, AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e shërbimeve për një periudhë 4 vjeçare. Por nga Autoriteti Kontraktor nuk është argumentuar arsyeja e kryerjes së këtyre shërbimeve për periudhën 4 vjeçare, duke qenë se këto janë mallra dhe shërbime, për të cilat bëhen planifikime dhe përdorime vjetore, e që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratës”.

-Në 2 raste, është përcaktuar privatizimi i shërbimit të lavanderisë dhe pastrimit, por nga AK **nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e veçantë për trajtimin dhe marrjen në punë të punonjësve të SPV**, të cilët me Urdhrin e drejtorit të AK K. Ll. nr. 238, datë 29.04.2016, i janë ndërprerë në mënyrë kolektive marrëdhëniet e punës me SPV, në kundërshtim me Kodin e Punës. Konkretisht për këtë shërbim, u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve të lavanderisë dhe 28 punonjësve të pastrimit.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, Shkurt 2016, me vlerë kontrate 112,009,392 lekë me tvsh, me afat 4 vite (01.05.2016-30.04.2020), **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës, është në vlerën **3,999,199 lekë** për *vitin e parë të kontratës dhe dëmi ekonomik i mundshëm* të ardhmen për *3 vitet e tjera të kontratës* është në vlerën **11,755,860 lekë**.

-Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt “Shërbime për pastrim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik Vlorë”, **dëmi ekonomik** i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përllogaritja e gabuar e zbatimit të vlerës së kontratës, është në vlerën **5,131,297.25 lekë** me tvsh për 10 muaj të zbatimit të kontratës dhe **dëmi i mundshëm/pritshëm për 38 muajt e tjera të realizimit të kontratës është në vlerën 19,498,929 lekë me tvsh**.

-Për kontratën e Shërbimit nr. 927 prot., datë 11.05.2015, me objekt “Mirëmbajtje e lavanderisë”, me afat deri më 31.12.2015, nga auditimi i kryer, nuk konstatohet dokumentacion vërtetues e provues për funksionimin e lavatriçeve dhe tharëseve të vjetra, si dhe nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së shërbimit të riparimit, për arsye se SPV ka lidhur kontratën nr. 26, nr. 590 prot., datë 12.03.2015, me objekt “F.V. Pajisje teknologjike për spitalin e ri psikiatrik (Lavatriçe 20kg 2 copë dhe Tharëse 20kg 2 copë)”, pajisje të cila janë pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim më datë 04.05.2015. Për pasojë, pagesa e riparimit të lavatriçeve dhe tharëseve pas kësaj date, në vlerën **1,357,776 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të Buxhetit të Shtetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të

lartë”, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

D.2. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të spitalit, neni 4, si dhe kontratave individuale neni 8, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “*Largim nga puna*”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për:

1. z. V. N. me detyrë shef finance për periudhën objekt auditimi;

Për arsye se:

-Për kontratën e Shërbimit nr. 927 prot., datë 11.05.2015, me objekt “Mirëmbajtje e lavanderisë”, me afat deri më 31.12.2015, nga auditimi i kryer, nuk konstatohet dokumentacion vërtetues e provues për funksionimin e lavatriçeve dhe tharëseve të vjetra, si dhe nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së shërbimit të riparimit, për arsye se SPV ka lidhur kontratën nr. 26, nr. 590 prot., datë 12.03.2015, me objekt “F.V. Pajisje teknologjike për spitalin e ri psikiatrik (Lavatriçe 20kg 2 copë dhe Tharëse 20kg 2 copë)”, pajisje të cila janë pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim më datë 04.05.2015. Për pasojë, pagesa e riparimit të lavatriçeve dhe tharëseve pas kësaj date, në vlerën **1,357,776 lekë**, përbën **dëm ekonomik** për llogari të Buxhetit të Shtetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, germa a, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. -Vendosja e V. N. me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i SPV, si kryetari i KVO për të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 5.

-Në rastet e prokurimit të medikamenteve, konstatohet se kërkesat janë të miratuar nga komisioni mjekësor i SPV, pjesë e të cilit është dhe G. N. me detyrë mjekë psikiatre pranë SPV, e cila është bashkëshortja e V. N. me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i SPV, si dhe kryetari i KVO për të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, çka përbën një *konflikt të mundshëm interesi*. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 3 pika 1 dhe pika 4, germa c, si dhe neni 4.

-Në një rast, është vendosur V. N. kryetari i KVO, i cili në të njëjtën kohë ka marrë pjesë në grupin e punës për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58.

-Në 2 raste (“Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” dhe “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm” viti 2016), AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e materialeve dhe shërbimeve, të cilat janë objekt i prokurimit të përqendruar nga Ministria e Brendshme, pa marrë më parë miratimin e kësaj Ministrie, në kundërshtim me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, pika 1.

-Në 2 raste, AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e shërbimeve për një periudhë 4 vjeçare. Por nga Autoriteti Kontraktor nuk është argumentuar arsyeja e kryerjes së këtyre shërbimeve për periudhën 4 vjeçare, duke qenë se këto janë mallra dhe shërbime, për të cilat bëhen planifikime dhe përdorime vjetore, e që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratës”.

-Në 2 raste, është përcaktuar privatizimi i shërbimit të lavanderisë dhe pastrimit, por nga AK **nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e veçantë për trajtimin dhe marrjen në punë të punonjësve të SPV**, të cilët me Urdhrin e drejtorit të AK K. Ll. nr. 238, datë 29.04.2016, i janë

ndërprerë në mënyrë kolektive marrëdhëniet e punës me SPV, në kundërshtim me Kodin e Punës. Konkretisht për këtë shërbim, u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve të lavanderisë dhe 28 punonjësve të pastrimit.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, Shkurt 2016, me vlerë kontrate 112,009,392 lekë me tvsh, me afat 4 vite (01.05.2016-30.04.2020), **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përlllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës, është në vlerën **3,999,199 lekë** për *vitin e parë të kontratës* dhe **dëmi ekonomik i mundshëm** për *3 vitet e tjera të kontratës* është në vlerën **11,755,860 lekë**.

-Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar me objekt “Shërbime për pastrim të ambienteve të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik Vlorë”, **dëmi ekonomik** i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga përlllogaritja e gabuar e zbatimit të vlerës së kontratës, është në vlerën **5,131,297.25 lekë** me tvsh për 10 muaj të zbatimit të kontratës dhe **dëmi i mundshëm/pritshëm për 38 muajt e tjera të realizimit të kontratës është në vlerën 19,498,929 lekë me tvsh.**

D.3. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të spitalit, neni 4, si dhe kontratave individuale neni 8, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga puna”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për:

1.z. S. Xh. me detyrë jurist i spitalit për periudhën 29.01.2016 e në vazhdim, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,

2. znj. E. M. me detyrë shefe e hotelerisë për periudhën 20.04.2015 e në vazhdim, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit,

3. znj. K. Xh. me detyrë ekonomiste për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit

4. znj. K. Sh. me detyrë ekonomiste pagash për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit,

Për arsye se:

-Në 2 raste (“Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” dhe “Pastrim i brendshëm dhe pastrim gjelbërim i jashtëm” viti 2016), AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e materialeve dhe shërbimeve, të cilat janë objekt i prokurimit të përqendruar nga Ministria e Brendshme, pa marrë më parë miratimin e kësaj Ministrie, në kundërshtim me VKM nr. 28, datë 14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, pika 1.

-Në 2 raste, AK ka zhvilluar procedurat e prokurimit për prokurimin e shërbimeve për një periudhë 4 vjeçare. Por nga Autoriteti Kontraktor nuk është argumentuar arsyeja e kryerjes së këtyre shërbimeve për periudhën 4 vjeçare, duke qenë se këto janë mallra dhe shërbime, për të cilat bëhen planifikime dhe përdorime vjetore, e që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht me një procedurë të hapur ose kërkesë për propozim. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratës”.

-Në 2 raste, është përcaktuar privatizimi i shërbimit të lavanderisë dhe pastrimit, por nga AK **nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e veçantë për trajtimin dhe marrjen në punë të punonjësve të SPV**, të cilët me Urdhrin e drejtorit të AK K

. Ll. nr. 238, datë 29.04.2016, i janë ndërprerë në mënyrë kolektive marrëdhëniet e punës me SPV, në kundërshtim me Kodin e Punës. Konkretisht për këtë shërbim, u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve të lavanderisë dhe 28 punonjësve të pastrimit.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”, Shkurt 2016, me vlerë kontrate 112,009,392 lekë me tvsh, me afat 4 vite (01.05.2016-30.04.2020), **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit, nga

përlllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës, është në vlerën **3,999,199 lekë** për vitin e parë të kontratës dhe **dëmi ekonomik i mundshëm** për 3 vitet e tjera të kontratës është në vlerën **11,755,860 lekë**.

D.4. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: M. K., R. Sh., I. S., Sh. Z., A. T., R. H., të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Pretendimi i Subjektit:

Theksohet se me shkresën nr.1686 prot., datë 13.12.2017 është vendosur mos procedimi i dhënies së masës disiplinore, pasi për shkeljet e dispozitave ligjore të pretenduara janë ngritur padi pranë organeve gjyqësore për kërkimin e shumës së dëmit ekonomik të pretenduar.

Përsa më sipër disa padi të ngritura nga SPV, rezultojnë të jenë rrëzuar me vendim të formës së prerë.

-Vendim nr.405 datë 06.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzuar dhe lënë në fuqi me vendimin nr.809 datë 17.12.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për punonjësin Z. V. K., për D2.

-Vendim nr.2223 datë 27.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pranuar padinë, rrëzuar me vendimin nr.22 datë 22.01.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për punonjësin z. V. K., për D2.

-Vendim nr.71 datë 23.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzuar padia për punonjësin Z. V. K., për D2.

Qendrimi i grupit të auditimit:

Për D.1, Z.K. Ll., ka shkëputur marrëdhëniet me SPV, nuk është më drejtues i SPV si dhe grupit të auditimit nuk ju paraqit dokument i cili vertëton njoftimin e MSH në lidhje me rekomandimin e lënë .

Për D.2 merret parasysh përgjigja e institucionit. Mungon dokumentacioni lidhur me disa punonjës të përfshirë në rekomandimin **D. 3**. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të spitalit, neni 4, si dhe kontratave individuale neni 8, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri në “Largim nga puna”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për:

1. z. S. Xh. me detyrë jurist i spitalit për periudhën 29.01.2016 e në vazhdim, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit,
2. znj. E. M. me detyrë shefe e hotelerisë për periudhën 20.04.2015 e në vazhdim, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit,
3. znj. K. Xh. me detyrë ekonomiste për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit
4. znj. K. Sh. me detyrë ekonomiste pagash për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit

Grupi i auditimit konstatoi se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar, ***pjesërisht zbatuar***.

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet ne KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.

Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

1. Titulli i Gjetjes:**Situata:****Realizim i ulët i zbatimit të rekomandimeve**

Nga verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i mëparshëm i auditimit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është relativisht i ulët, tajtuar si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 masa organizative, të cilat, janë zbatuar 2 zbatuar pjesërisht 1, në proces 5 dhe janë pa zbatuar 1.
- Masa për shpërblim dëmi janë lënë 14 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2, në proces 12.
- Masa për eliminimin e efekteve negative 3E janë lënë 7 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2, në proces 1 dhe pazbatuar 4.
- Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;
- -4 masa disiplinore nuk janë zbatuar , 2 masë disiplinore janë zbatuar.
- -Sipas Statusit të Nëpunësit Civil janë lënë 0 masa disiplinore
- -Sipas Kodit të Punës, janë lënë 6 masa disiplinore e përkatësisht 4 'vërejtje me shkrim' deri në 'largim nga puna' dhe 2 masa 'largim nga puna'.

Kriteri:

Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

Shkaku:

Mos realizim i zbatimit të rekomandimeve

Rëndësia:

I Lartë

Rekomandimi:

Nga Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë rikërkojmë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara si dhe për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen të zbatuara pjesërisht ose në proces zbatimi, inkurajohet përshejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Afati i zbatimit:

Në vijimësi

2.2.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Emërimi i Drejtorit të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, është bërë nga MSHMS, me Urdhër nr.184, date 25.02.2019 për Emërim të Përkohshëm, në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4 e nenit 102, bazuar në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar .

Bazuar në Nenin nr.7 të Rregullores së Brendshme të SPV, detyrat dhe kompetencat e Drejtorit të SPV:

- 1.Drejtori i Spitalit Psikiatrik përfaqëson spitalin si person juridik.Ai është titullari ekzekutiv drejtues,organizues dhe kontrollues I gjithë aktivitetit të Spitalit Psikiatrik.
- 2.Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Spitalit bëhet nga Ministri i Shëndetësisë
- 3.Bën propozime dhe emërimet të Zv.Drejtorëve dhe shefave të shërbimit të pavioneve sektoreve,K/infermierit dhe për vende të reja pune për kuadrin e lartë.
- 4.Ka të drejtë të punësojë personelin e mesëm e të ulët mjekësor dhe jo mjekësore.
- 5.Bën planet e punës në fillim të vitit
- 6.Organizon dhe drejton mbledhjet e drejtorisë të spitalit në bazë të një tematike të caktuar.
- 7.Organizon,drejton dhe analizon gjithë problemet teknike dhe ekonomike-financiare të Spitalit Psikiatrik.
- 8.Organizon kontrolle vetë dhe me grupe pune për aktivitetin e shërbimeve mjekësore dhe jo mjekësore dhe merr vendime përkatëse për përmirësimin e gjendjes.
9. Ndjek realizimin e treguesve të efikasitetit të Spitalit Psikiatrik.
- 10.Merr vendime për largime nga puna për shkelje të Kodit të Punës,Kontratës dhe rregulloreve të shërbimit.
- 11.Drejtori i Spitalit nënshkruan të gjitha aktet që angazhojnë Spitalin Psikiatrik ndaj subjekteve ose personave të tjerë juridik.
12. Njihet me aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me detyrën e tij , organizon punën për njohjen me këto akte ligjore dhe nënligjore të të gjithë stafit të tij drejtues dhe kontrollon zbatimin e tyre .

13. Drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit ekonomik e financiar, miraton buxhetin e zbërthyer për çdo shërbim dhe repart, miraton programin e buxhetit në të gjitha zërat e tij, kontrollon punën dhe përgjigjet për plotësimin ritmikisht të hartimit të buxhetit në të gjithë zërat, kontrollon zbatimin e buxhetit në fushën e investimeve e të ndërtimeve, pezullon punimet në rastet kur vërtetohen shkelje të projektit të zbatimit të preventivit përfundimtar, merr masa që të mos krijohen mallra materiale dhe medikamente stoqe e me qarkullim të ngadalshëm, organizon dhe kontrollon zbatimin e planit financiar për përdorim me frytshmëri të mjeteve monetare dhe materiale; ndjek dhe organizon kontrollin e zbatimit e detyrave për mbrojtjen e pronës dhe mirëadministrimin e saj, miraton kontrollin e brendshëm të institucionit.

14. Ndjek dhe kërkon zbatimin për zgjidhjen, vendosjen kualifikimin e specializimin e kuadrit të lartë dhe të mesëm, drejton këshillin tekniko-administrativ.

15. Drejtori i Spitalit drejton punën për përmirësimin e kushteve të punonjësve dhe të pacienteve, kërkon zbatimin e rregullave për sigurimin teknik dhe higjeno-shëndetësor dhe mbrojtjen kundër zjarrit për çdo shërbim e repart.

16. Drejtori kërkon nga stafi drejtues tekniko-administrativ dhe gjithë personeli tjetër zbatimin me korrektësi të disiplinës në punë konform rregullores së institucionit si dhe respektimin dhe zbatimin e ligjeve në fuqi.

17. Drejtori organizon punën për shqyrtimin dhe zgjidhjen në kohë të kërkesave e ankesave të punonjësve.

18. Drejtori kur emërohet merr në dorëzim dhe kur largohet, dorëzon detyrën me proces verbal të rregullt në të njëjtën kohë që kjo detyrë të zbatohet rregullisht për të gjithë kuadrin e institucionit.

19. Përfaqëson institucionin para organeve shtetërore, ndërmarrjeve dhe institucioneve të tjera ose autorizon punonjësit e tjerë për ta përfaqësuar atë; miraton marrjen në punë të punonjësve sipas strukturës organizative, merr masa disiplinore të parashikuara nga kodi i punës për ata punonjës që ka në emërtesën e tij ose i propozon organit kompetent masa disiplinore për ata që nuk i ka në emërtesën e tij; miraton urdhër-cdëmtimi për punonjësit që detyrojnë pasurinë e institucionit, shkelin disiplinën financiare mbështetur në kompetencat që i janë lënë me dispozitat ligjore në fuqi, nxjerr urdhër dhe udhëzime me karakter të brendshëm për institucionin.

Nga grupi i auditimit u konstatua që Drejtori i SPV, i ka zbatuar detyrat e tij dhe i ka ushtruar kompetencat e tij për periudhën objekt auditimi.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit, lidhur me strukturën e SPV **Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë** është institucion publik, dytësor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor me synim promovimin, parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve me çrregullime mendore. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale përkrah aktivitetet dhe nismat kundër diskriminimit, stigmatizmit dhe përjashtimit të personave me çrregullime apo paafësi mendore dhe po ashtu kujdeset për respektimin e plotë të të drejtave të këtyre njerëzve. Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, në varësi të MSHMS, përkrah dhe zbaton gjithë nismat e ndërmara nga ky autoritet duke përfshirë këtu objektivin kryesor të saj për zhvillimin e reformës së shëndetit mendor.

1. Spitali Psikiatrik i Vlorës e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit të Shërbimit Shëndetësor, ligjit të Shërbimit Spitalor në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjit të Shëndetit Mendor (nr.44/2012). Infrastruktura fizike dhe pajisjet e këtij spitali janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Funkcionon në bazë të Këshillit Tekniko-Administrativ, i cili merr vendime të ndryshme në këtë institucion.

3. Spv është një institucion shtetëror me shtretër, kapaciteti i të cilit është deri në 200 dhe ofron shërbim për rrethet: Vlorë, Fier, Berat, Skrapar, Tepelene, Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë (Lushnje), zonë mbulimi kjo e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Ofron shërbim multi-disiplinor me këto pavione:

- a. Pavioni Pranim / Urgjencës
- b. Pavioni Akut / Sub-akut
- c. Pavioni kronik burra-gra

❖ **Këshilli Tekniko-Administrativ.**

Është organ konsultativ pranë drejtorisë së Spitalit, I cili përbëhet nga shefi I shërbimeve, drejtuesit e degëve të Administratës, kryeinfermieri i përgjithshëm dhe juristi. Kryetari i Këshillit Tekniko-Administrativ është Drejtori.

1. Këshilli bën rekomandimet e nevojshme për nrvojat në njerëz dhe materiale të shërbimeve përkatëse, shpërndarjen e shtretërvebrenda shërbimit dhe kërkesat eventuale për personel në kohë të plotë dhe të pjesshme të punës.
2. Gjithashtu merr dhe vendos për masa disiplinore si dhe për cdëmtimin në rast se ka shkelje në vlera materiale.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua që Këshilli Tekniko-Administrativ nuk ka funksionuar dhe ka përmbushur detyrat e tij, për cdo rast të audituar nga grupi i KLSH-së.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua që në SPV kanë shkëputur marrëdhëniet me punën 38 punonjës me arsye të ndryshme, nga ku 30 punonjës janë larguar me dëshirë, 4 punonjës kanë dalë në pension dhe 4 prej tyre janë larguar me masë disiplinore.

Për sa i përket punonjësve të larguar me masë disiplinore u auditua dosja e 4 punonjësve dhe procedura e ngritjes së Komisionit nga ana e Këshillit Tekniko-Administrativ. Konkretisht për punonjësit:

1. V. M., në pozicionin e punës ‘kujdestare’. Me urdhërin Nr.76, datë 14.09.2020 për ‘ Ngritjen e grupit të punës’, i përbërë nga 3 anëtar, ku urdhëron shqyrtimin e ankesës nga ana e punonjësës si dhe përgatitjen e një relacioni shpjegues mbi situatën dhe gjetjen. Me shkresën nr.1830 Prot, datë 16.10.2020 është bërë mbledhja Operatorit ne SPV, ku nga të dhënat dhe situatat e krijuara nga pjesëtarët Drejtori ka urdhëruar ngritjen e Këshillit Tekniko Administrativ për procedurat e largimit nga puna të znj.M. Është ngritur Këshillit Tekniko Administrativ ku ka theksuar që punonjësja ka thyer rëndë etikën në punë. Është në process gjyqësor.
2. M. Z., në pozicionin e punës ‘kujdestare’. Me shkresën nr.21/5 Prot, datë 02.06.2016, I është dhënë masa disiplinore zj. Z. ‘Vërejtje me paralajmërim largim nga puna.’ Me procesverbalin e mbajtur me datë në datë 03.03.2017, është ngritur Këshilli Tekniko Administrativ, i cili ka shqyrtuar situatën e kujdestares.
3. M. M., pozicionin e punës ‘kujdestar’. Me shkresën nr.156 Prot., datë 27.02.2017 z.Mane i është dhënë disiplinore ‘vretjtje’ si dhe me shkresën nr.623 Prot, datë 28.03.2018 i është dhënë masa disiplinore ‘këshillim’. *Nuk është mbledhur KTA për këtë rast, dhe në dosje ska të dhëna për ngritjen e grupit të punës si dhe mbledhjen e Operatorit.*
4. F. M., pozicioni i punës ‘mirëmbajtës elektrikist’. Në dosje ska të dhëna për ngritjen e grupit të punës si dhe mbledhjen e Operatorit.

2.3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.

Sistemi i programimit të projekt buxheteve të viteve 2017,2018,2019 dhe 2020

Hartimi i projekt buxheteve në total dhe i projekt buxheteve sipas zërave të strukturës buxhetore janë hartuar në zbatim të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave (MF) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH), të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Mbështetur në materialet e kërkuara nga grupi i auditimit dhe të vëna në dispozicion nga ana e stafit si dhe referuar fushave të përcaktuara në auditim, gjendja rezultoi si më poshtë:

Projekt buxhetet për vitet 2017,2018,2019 dhe 2020 janë përgatitur, miratuar dhe detajuar në referencë të: Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”; Ligjit nr. 7870, datë 21.07.1993 “Për Sigurimet Shëndetësore”; ligjit nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekut”; ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit të përhershëm të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012,

Ligjeve nr. 185/2013, nr. 160/2014 dhe nr. 147/2015, respektivisht: “Për Buxhetin e vitit 2017”, “Për Buxhetin e vitit 2018” Buxhetin e vitit 2019” dhe “Për Buxhetin e vitit 2020;

Për vlerësimin e procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi të Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlore (SPV), janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përbalimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së viteve të kaluara dhe nevojave reale si pasojë e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor. Në vijim janë analizuar të gjitha shkresat e miratimit të buxhetit vjetor së bashku me ndryshimet gjatë vitit në funksion të përcaktimit të planit përfundimtar dhe në kuadër të ndryshimeve të autorizuara nga nivelet përkatëse autorizuese. Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për secilin vit.

Auditimi i fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit është kryer në bazë të kërkesave të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për verifikimin e hartimit, planifikimit dhe realizimit të Buxhetit të institucionit janë marrë në shqyrtim planifikimi paraprak sipas kërkesave të PBA, planifikimin vjetor sipas detajimit nga MSH, planit përfundimtar pas ndryshimeve gjatë vitit të limiteve për llogaritë përkatëse dhe realizimin faktik.

Për vitin 2017

Me shkresën nr. 3338, datë 15.06.2016 ka dërguar udhëzimin për procedurat për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2017-2019 duke i shoqëruar edhe me anekse dhe pasqyrat përkatëse sipas (formularit të Aneksit 7.A dhe formulari Aneksi 5A).

Me shkresën nr. 315/1prot, me datë 26.07.2016, është hartuar dhe dërguar nga drejtori i Spitalit Psikiatrik Vlorë, dhe Kryetari i Degës së Financës projektbuxheti 2017-2019, i shoqëruar me relacionin përkatës si dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse shpjeguese për vitin 2017, të plotësuara e të nënshkruar nga drejtori i SPV dhe kryetari i degës së financës.

Nga SPV janë përgatitur pasqyrat përkatëse në ndihmë të projektbuxhetit, që do të punojnë personat përkatës, për mallra e shërbime (llogaria 602), ku pasqyrohen planet dhe projektbuxhetet nga viti 2017-2019, të shoqëruar secili vit, me vlerat përkatëse. Materialet e përgatitura janë finalizuar në pasqyrat përkatëse të cilat paraqiten në tabelën me poshtë së bashku me realizimet e tyre;

Ne 000/leke

Llog	Viti paraardhes	PBA 2017	Buxheti	Ndryshimet gjate vitit	Pl sipas thesar	Fakti	%
600	86,965.00	74,461	69,064	4,800	87,664	77,284.32	104
601	14,523	12,435	11,700	600	13,100	12,751.75	103
602	142,266.69	152,706	145,000	-	145,000	144,071.05	95
606	460,530		130,000	143,863	373,863	299,613	
230	-	-	-	-	-	-	
231	106,794	132,713			1,168	1,062	1.8

Nga të dhënat e mësipërme, vihet re një tejkallim në llog. 600 Paga të personelit të përhershëm, në masën 4%, e cila vjen si pasojë e një shtese fondi si rezultat i zbatimit të VKM nr.188 datë 15.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.155 datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të infermierisë në sistemin e MSH”. Në llogarin (601) Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, kemi një tejkallim në masën 3% të realizimit për arsyen e sipërpërmendur. Në llogarinë (606) Transferta për buxhetet familjare dhe Individë, me shkresën nr.651/3 datë 01.03.2017 miratuar nga Drejtori Ekonomik i Ministrisë së Shëndetësisë, kemi një akordim fondi për përdorimin e fondit të veçante në vlerën 143,863 lekë por e përdorur në 299.61 lekë.

Llogaria 602 Materiale & Shërbime te tjera	Viti 2017			
	Fakti paraardh	Parashikimi	Realizimi	%
Materiale dhe Shërbime të përgjithshme zyre	6,662	3,850	4,019	104.3

Materiale dhe Shërbime speciale	49,939	55,395	46,635	84.2
Shërbime nga te tretet	58,811	75,660	77,643	102.6
Shpenzime transporti	6,703	6,750	5,453	80.7
Shpenzime udhëtimi	757	700	807	115.2
Mirëmbajtje të zakonshme	7,348	8,050	6,437	79.9
Detyrime dhe kompensime legale	2,231	1,500	2,030	135.3
Shpenzime të tjera operative	817	800	1,144	143
<i>Total:</i>	<i>133,273</i>	<i>152,750</i>	<i>144,071</i>	

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se nga realizimi konstatohet një tejkallim në zërin ‘Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre’ me 4.3 %, më tepër në shumën 169,000 lekë, nga fondi i parashikuar. Gjithashtu në zërin “Shpenzime nga te tretet”, ka një tejkallim me 2.6 %, në shumën 1,983,000 lekë, në zërin “Shpenzime udhëtimi”, ka një tejkallim me 15.2 %, në shumën prej 107,000 lekë, në zërin “Detyrime dhe kompensime legale” ka një tejkallim me 35.5 % në shumën prej 530,000 lekë si dhe në zërin “Shpenzime të tjera operative me 43% në shumën 344,000 lekë.

Në Materiale dhe shërbime speciale , shpenzime transporti si dhe mirëmbajtje të zakonshme konstatohet se nuk ka tejkallim të fondit të parashikuar në lidhje me fondin e realizuar.

Në lidhje me tejkallimin e këtyre zërave u kërkuan shpjegimet përkatëse, por nuk u paraqit dokumentacion justifikues për të mundësuar një opinion me argumentet se përse janë tejkalluar këto zëra.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e llogarive paraqitur më sipër janë në tejkallim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. I njëjti fakt konstatohet edhe në shpenzimet e realizuara nën planifikimin fillestar, ku për disa llogari analitike të shpenzimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të vitit nuk janë realizuar tërësisht nga zërat e buxhetit.

Mosrealizimi më i madh për vitin 2017 është në llogarinë (231) Investime për të cilën është bërë detajimi si më poshtë:

Ne /000 lekë

<i>Investime nga buxheti</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>% realizimi</i>
<i>Rikonstruksion i pavionit 4 - 5</i>	<i>52,371</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Rikonstruksion i pavionit 1,2,3 - 6,7</i>	<i>73,729</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Blerje ECT (Elektroshock).</i>	<i>4,500</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Blerje pajisje elektronike</i>	<i>1,292</i>	<i>1,062</i>	<i>82</i>
<i>Blerje pajisje EKG</i>	<i>300</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Blerje pajisje mjekesore per mikrokirurgjine</i>	<i>281</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Blerje pajisje mobilimi (Karrige te thjeshta)</i>	<i>240</i>	<i>0</i>	<i>-</i>
<i>Totali</i>	<i>132,713</i>	<i>1,062</i>	<i>0.8</i>

Miratimi i buxhetit për SPV ka ardhur me shkresat nr. 6361/3 prot, me datë 16.01.2017, shkresën nr. 485 prot, me datë 30.01.2017, shkresën nr. 651/1, me datë 01.03.2017, shkresën nr.1689/5 me datë 15.05.2017 dhe shkresën nr. 1441/3 prot, me datë 20.02.2017, me tabelat dhe detajimet përkatëse të transferimit të fondeve për shtesat dhe pakësimet për buxhetin e investimeve dhe shpenzimet kapitale.

Nga auditimi i Planifikimit te buxhetiti afatmesen si dhe zbatimit të buxhetit duke rakorduar me situacionet vjetore, grupi i auditimit konstatoje se SPV nuk harton e për pasojë nuk dërgon raportet e monitorimit 4-mujore në Ministrinë e Shëndetësisë.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktit të performancës me ato të planifikuara. Monitorimi ka si qëllim të ndjek arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara të përcaktuara në deklaratën e politikës së programit për vitin e parë të pba nëpërmjet krahasimit të treguesve të performancës me treguesit faktit të tyre; të evidentojë nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo të propozojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve etj..

Pra, monitorimi i objektivave në sasi të treguesve të performancës dhe monitorimit të produkteve në sasi dhe në vlerë është një proces i cili lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritje të tyre.

SPV në kundërshtim nën 65 të ligjit nr.9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar i cili citon se “Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm” nuk ka hartuar raportet e monitorimit.

Referuar nenit 3, pika 43 të ligjit të sipërpërmendur “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues”. Nga auditimi u konstatua se këto raporte monitorimi nuk janë hartuar dhe nuk janë depozituar në MSH.

Për vitin 2018

Me urdhrin nr.168 datë 29.06.2017 miratuar nga titullari “Për hartimin e projekt buxhetit 2018-2020, është ngritur grupi i punës i përbërë nga sektorët e Financës, Hotelierisë, burimeve njerëzore, zyrës Teknike, shërbimi Kronim dhe Shërbimi akut-subakut.

Me shkresën nr. 633/1 datë 14.08.2017 është mbledhur këshilli Tekniko-Administrativ të cilët kanë mbajtur procesverbalin në lidhje me dakortësinë e miratimit të PBA 2018-2020

Me shkresën nr. 633/2, datë 14.08.2017 është hartuar dhe dërguar projekt buxheti afatmesëm për vitin 2018-2020 duke i shoqëruar edhe me anekse dhe pasqyrat përkatëse sipas (formularit të Aneksit 7.A dhe formulari Aneksi 5A), i shoqëruar me me relacionin përkatës si dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse shpjeguese për vitin 2017, të plotësuara e të nënshkruar nga drejtori i SPV dhe kryetari i degës së financës.

Me shkresën nr.954 datë 21.07.2017 janë hartuar dhe dërguar në MSH, kërkesat për medikamente dhe materiale mjekimi, firmosur nga titullari dhe nga kryeinfemirja e përgjithshme.

Nga SPV janë përgatitur pasqyrat përkatëse në ndihmë të projektbuxhetit, që do të punojnë personat përkatës, për mallra e shërbime (llogaria 602), ku pasqyrohen planet dhe projektbuxhetet nga viti 2017-2019, të shoqëruar secili vit, me vlerat përkatëse. Materialet e përgatitura janë finalizuar në pasqyrat përkatëse të cilat paraqiten në tabelën me poshtë së bashku me realizimet e tyre;

Në /000 lekë

Llog	Viti paraardhes	PBA 2018	Buxheti	Ndryshimet gjate vitit	PI sipas thesar	Fakti/ Realizimi	%
600	77,284	85,096	73,500	14,299	87,799	80,476	94.5
601	12,751	13,534	15,900	282	16,182	13,291	98.2
602	144,071	152,445	153,000	30,000	183,000	172,029	112.3
606	299	36	100	50	762	637	1769.4
230	-	-	-	-	-	-	-

231	1,062	127,336			-	-
-----	-------	---------	--	--	---	---

Me shkresën nr.5602/4 datë 22.01.2018, nga MSHMS është dërguar celja për buxhetin e vitit 2018.

Nga të dhënat e mësipërme, vihet re një tejkalim në llog. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe Individë” në masën 769.4 % ka ardhur për kërkesat për dhënie ndihme të menjëhershme, për rastet fatkeqësie në familje si dhe dalje në pension.

Për llog. 600 Paga të personelit të përhershëm dhe llog 601 Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, me shkresën nr.4773/4 datë 10.09.2018 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar detajimin e ndryshimeve të miratuara, referuar kërkesës së SPV si rezultat i ndryshimit të strukturës nga 123 punonjës në 128, me një shtesë në llog. 600 për vlerën 12,612,000 lekë.

Mosrealizimi më i madh për vitin 2018 është në llogarinë (231) Investime për të cilën është planifikuar ne PBA një fond prej 127,336,000 lekë por as nuk është miratuar e për pasojë as realizuar.

Me shkresën nr.12905/2 datë 19.07.2018 është miratuar shtesa prej 50,000 lekësh nga MSHMS për llogarinë 606 dhe me shkresën nr.6537 datë 14.11.2018 nga MSHMS është shtuar fondi për 30,000,000 lekë në llogarinë 602. Referuar zërave më lartpërmendur nuk kemi tejkalime në realizimet sipas parashikimeve të bëra ne Projekt Buxhetin Afatmesëm të SPV.

Llogaria 602 Materiale & Shërbime te tjera	Viti 2018			
	Fakti paraardh	Parashikimi	Realizimi	%
Materiale dhe Shërbime të përgjithshme zyre	4,019	4,529	4,360	96.3
Materiale dhe Shërbime speciale	46,635	51,480	57,826	112.3
Shërbime nga te tretet	77,643	83,239	92,558	111.2
Shpenzime transporti	5,453	5,908	6,775	114.6
Shpenzime udhëtimi	807	700	857	122.4
Mirëmbajtje të zakonshme	6,437	4,286	6,740	157.2
Detyrime dhe kompensime legale	2,030	1,500	2,194	146.3
Shpenzime të tjera operative	1,144	800	717	89.6
<i>Total:</i>	<i>144,071</i>	<i>152,442</i>	<i>172,027</i>	<i>112.8</i>

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se nga realizimi konstatohet një tejkalim në zërin ‘Materiale dhe shërbime speciale’ me 12.3 %, më tepër në shumën 6,346,000 lekë, nga fondi i parashikuar. Gjithashtu në zërin “Shpenzime nga te tretet”, ka një tejkalim me 11.2 %, në shumën 9,319,000 lekë, në zërin “Shpenzime udhëtimi”, ka një tejkalim me 22.4 %, në shumën prej 157,000 lekë, në zërin “Detyrime dhe kompesime legale” ka një tejkalim me 46.3 % në shumën prej 694,000 lekë, në zërin “shpenzime transporti ka një tejkalim” në masën 14.6 % në vlerën 867,000 lekë, në zërin “Mirëmbajtje të zakonshme” ka një tejkalim në masën 57.2 % në vlerën 2,454,000 lekë si dhe në zërin “Shpenzime të tjera operative me 43% në shumën 344,000 lekë.

Në zërin “materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre” si dhe në zërin “shpenzime të tjera operative” nuk kemi tejkalime të fondeve të parashikuara.

Në lidhje me tejkalimin e këtyre zërave u kërkuar shpjegimet përkatëse, por nuk u paraqit dokumentacion justifikues për të mundësuar një opinion me argumentet se përse janë tejkaluar këto zëra.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e llogarive paraqitur më sipër janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. I njëjti fakt konstatohet edhe në shpenzimet e realizuara nën planifikimin fillestar, ku për disa llogari analitike të shpenzimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të vitit nuk janë realizuar tërësisht nga zërat e buxhetit.

SPV në kundërshtim nenin 65 të ligjit nr.9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë ndryshuar i cili citon se “Nëpunësit autorizues të njësive

të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm” nuk ka hartuar raportet e monitorimit.

Referuar nenit 3, pika 43 të ligjit të sipërpërmendur “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues”. Nga auditimi u konstatua se këto raporte monitorimi nuk janë hartuar dhe nuk janë depozituar ne MSHMS.

Për vitin 2019

Me urdhrin nr.204 dhe nr.205 datë 12.06.2018 miratuar nga titullari “Për hartimin e projekt buxhetit 2019-2021, është ngritur grupi i punës i përbërë nga sektorët e Financës, Hotelerisë, Zyres Teknike, shërbimi Kronim dhe Shërbimi akut-subakut si dhe janë ndare detyrat dhe afatet respektive për përgatitjen e PBA 2019-2021.

Me shkresën nr. 1018/1, datë 26.07.2018 është hartuar dhe dërguar projekt buxheti afatmesëm për vitin 2019-2021 duke i shoqëruar edhe me anekse dhe pasqyrat përkatëse sipas (formularit të Aneksit 7.A dhe formulari Aneksi 5A), i shoqëruar me me relacionin përkatës si dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse shpjeguese për vitin 2019, të plotësuara e të nënshkruar nga drejtori i SPV dhe kryetari i degës së financës.

Janë hartuar kërkesat për medikamente dhe materiale mjekimi, firmosur nga titullari dhe nga kryeinfemirja e përgjithshme.

Nga SPV janë përgatitur pasqyrat përkatëse në ndihmë të projektbuxhetit, që do të punojnë personat përkatës, për mallra e shërbime (llogaria 602), ku pasqyrohen planet dhe projektbuxhetet nga viti 2019-2021, të shoqëruar secili vit, me vlerat përkatëse. Materialet e përgatitura janë finalizuar në pasqyrat përkatëse të cilat paraqiten në tabelën me poshtë së bashku me realizimet e tyre;

Në /000 lekë

Llog	Viti paraardhes	PBA 2019	Buxheti	Ndryshimet gjate vitit	Pl sipas thesar	Fakti Realizimi	%
600	80,476	90,114	79,000	5,400	84,400	83,623	92.7
601	13,291	14,332	16,500	400	16,901	13,816	96.4
602	172,029	158,886	155,994	30,000	155,994	155,991	98.1
606	637	42	40	200	373,863	226	538.1
230	-	-	-		-	-	
231	-	128,040			0	0	0

Me shkresën nr.5602/4 datë 22.01.2018, nga MSHMS është dërguar çelja për buxhetin e vitit 2019 për llogarite përkatëse në pasqyruara ne tabelën e mësipërme.

Nga të dhënat e mësipërme, vihet re një tejkallim në llog. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe Individë” në masën 438.1 %, në vlerën 126,978,000 lekë më shumë se planifikimi i buxhetit. Ky fond referuar kërkesave të SPV drejtuar MSHMS është përdorur për dhënie ndihme të menjëhershme, për raste fatkeqësie ne familje, sëmundje të rënda e dalje në pension të punonjësve të shëndetësisë.

Për të gjitha llogaritë si 600 Paga të personelit të përhershëm dhe llog. 601 Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, llog. 602 Mallra dhe Shërbime te tjera, llog. 230 dhe llog. 231 Investime, nuk ka tejkallim te fondit të parashikuar.

Me shkresën nr.5162/2 datë 14.11.2019 MSHMS ka dërguar referuar kërkesës së SPV, ka transferuar fondet për shpenzime operative për llog. 600 në vlerën 2,400,000 lekë dhe për llog. 601 në vlerën 400,000 lekë.

Llogaria 602 Materiale & Shërbime te tjera	Fakti paraardh	Viti 2019		
		Parashikimi	Realizimi	%
Materiale dhe Shërbime të përgjithshme zyre	4,360	3,136	3,015	96.1
Materiale dhe Shërbime speciale	57,826	56,497	51,425	91.2
Shërbime nga te tretet	92,558	81,778	78,552	96.1
Shpenzime transporti	6,775	6,735	8,023	119.1
Shpenzime udhëtimi	857	754	884	117.2
Mirëmbajtje të zakonshme	6,740	7,286	6,547	89.8
Detyrime dhe kompensime legale	2,194	2,000	6,804	340.2
Shpenzime të tjera operative	717	699	737	105.4
<i>Total:</i>	<i>172,027</i>	<i>158,885</i>	<i>155,987</i>	<i>98.2</i>

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se nga realizimi konstatohet një tejkalim në zërin “Shpenzime transporti” në masën 19.1% në shumën 1,288,000 lekë, në zërin “Shpenzime udhëtimi” ka një tejkalim me 17.2% në vlerën 130,000 lekë, në zërin “Detyrime dhe kompensime legale” në masën 34% në vlerën 4,804,000 lekë si dhe në zërin “Shpenzime të tjera operative” në masën 5% në vlerën 38,000 lekë.

‘Materiale dhe shërbime speciale’ me 12.3 %, më tepër në shumën 6,346,000 lekë, nga fondi i parashikuar. Gjithashtu në zërin “Shpenzime nga te tretet”, ka një tejkalim me 11.2 %, në shumën 9,319,000 lekë, në zërin “Shpenzime udhëtimi”, ka një tejkalim me 22.4 %, në shumën prej 157,000 lekë, në zërin “Detyrime dhe kompensime legale” ka një tejkalim me 46.3 % në shumën prej 694,000 lekë, në zërin “shpenzime transporti ka një tejkalim” në masën 14.6 % në vlerën 867,000 lekë, në zërin “Mirëmbajtje të zakonshme” ka një tejkalim në masën 57.2 % në vlerën 2,454,000 lekë si dhe në zërin “Shpenzime të tjera operative me 43% në shumën 344,000 lekë.

Në zërin “materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre” si dhe në zërin “Materiale dhe Shpenzime speciale”, “Shërbime nga te tretet”, “Mirëmbajtje të zakonshme” nuk kemi tejkalime të fondeve të parashikuara.

Në lidhje me tejkalimin e këtyre zërave u kërkuan shpjegimet përkatëse, por nuk u paraqit dokumentacion justifikues për të mundësuar një opinion me argumentet se përse janë tejkaluar këto zëra.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e llogarive paraqitur më sipër janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. I njëjti fakt konstatohet edhe në shpenzimet e realizuara nën planifikimin fillestar, ku për disa llogari analitike të shpenzimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të vitit nuk janë realizuar tërësisht nga zërat e buxhetit.

SPV në kundërshtim nenin 65 të ligjit nr.9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar i cili citon se “Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm” nuk ka hartuar raportet e monitorimit.

Referuar nenit 3, pika 43 të ligjit të sipërpërmendur “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues”. Nga auditimi u konstatua se këto raporte monitorimi nuk janë hartuar dhe nuk janë depozituar në MSHMS.

Per vitin 2020

Me urdhrin nr.151 dhe nr.155 datë 123.06.2019 miratuar nga titullari “Për hartimin e projekt buxhetit 2020-2022, është ngritur grupi i punës i përbërë nga sektorët e Finances, Hotelerisë, Zyres Teknike, shërbimi Kronim dhe Shërbimi akut-subakut si dhe janë ndare detyrat dhe afatet respektive për përgatitjen e PBA 2020-2022.

Me shkresën nr. 1064/1, datë 08.07.2019 është hartuar dhe dërguar projekt buxheti afatmesëm për vitin 2020-2022 duke i shoqëruar edhe me anekse dhe pasqyrat përkatëse sipas (formularit të Aneksit 7.A dhe formulari Aneksi 5A), i shoqëruar me me relacionin përkatës si dhe anekset dhe pasqyrat përkatëse shpjeguese për vitin 2020, të plotësuara e të nënshkruar nga drejtori i SPV dhe kryetari i degës së financës.

Janë hartuar kërkesat për medikamente dhe materiale mjekimi, firmosur nga titullari dhe nga kryeinfemirja e përgjithshme.

Nga SPV janë përgatitur pasqyrat përkatëse në ndihmë të projektbuxhetit, që do të punojnë personat përkatës, për mallra e shërbime (llogaria 602), ku pasqyrohen planet dhe projektbuxhetet nga viti 2020-2022, të shoqëruar secili vit, me vlerat përkatëse. Materialet e përgatitura janë finalizuar në pasqyrat përkatëse të cilat paraqiten në tabelën me poshtë së bashku me realizimet e tyre;

Në /000 lekë

Llog	Viti paraardhes	PBA 2020	Buxheti	Ndryshimet gjate vitit	Pl sipas thesar	Fakti	%
600	83,623	90,574	90,600	-3,000	87,600	85,190	94.1
601	13,816	15,126	15,200		15,200	14,087	93.1
602	155,991	162,286	151,500	15,500	167,000	147,434	90.8
606	226	500	40	200	373,863	1,000	200
230	0	-	-		-	-	
231	0	168,795		870	0	869	0.5

Me shkresën nr.247/2 datë 28.01.2020, nga MSHMS është dërguar çelja për buxhetin e vitit 2020 për llogaritë përkatëse në pasqyruara në tabelën e mësipërme.

Nga të dhenat e mësipërme, vihet re një tejkalim në llog. 606 “Transferata për buxhetet familjare dhe Individë” në masën 100 %, në vlerën 500,000 lekë më shumë se planifikimi i buxhetit. Ky fond referuar kërkesave të SPV drejtuar MSHMS është përdorur për dhënie ndihme të menjëhershme, për raste fatkeqësie në familje, sëmundje të rënda e dalje në pension të punonjësve të shëndetësisë.

Për të gjitha llogaritë si 600 Paga të personelit të përhershëm dhe llogarin 601 Kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, llog 602 Mallra dhe Shërbime të tjera, llog 230 dhe llog 231 Investime, nuk ka tejkalim të fondit të parashikuar.

Me shkresën nr.4419 datë 01.10.2020 MSHMS ka dërguar referuar kërkesës së SPV, ka transferuar fondet për shpenzime operative për llogarin 602 në vlerën 15,000,000 lekë dhe me shkresën nr.4419/1 datë 18.11.2020 nga MSHMS është zbritur fondi për llog.600 në vlerën 3,000,000 lekë.

Në 000/ lekë

Llogaria 602 Materiale & Shërbime të tjera	Viti 2020			
	Fakti paraardh	Parashikimi	Realizimi	%
Materiale dhe Shërbime të përgjithshme zyre	3,015	2,966	3,430	115.6
Materiale dhe Shërbime speciale	51,425	57,392	48,822	85.1
Shërbime nga të tretet	78,552	80,735	76,615	94.9
Shpenzime transporti	8,023	6,620	6,608	99.8
Shpenzime udhëtimi	884	840	1,122	133.6
Mirëmbajtje të zakonshme	6,547	6,544	5,131	78.4
Detyrime dhe kompensime legale	6,804	6,328	5,038	79.6
Shpenzime të tjera operative	737	859	665	77.4
Total:	155,987	162,284	147,431	90.8

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se nga realizimi konstatohet një tejkalim në zërin “Materiale dhe Shërbime të përgjithshme zyre” në masën 15.6% në shumën 464,000 lekë, dhe në zërin “Shpenzime udhëtimi” ka një tejkalim me 33.6 % në vlerën 280,000 lekë.

Në zërin “materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre” si dhe në zërin “Materiale dhe Shpenzime speciale”, “Shërbime nga të tretët”, “Mirëmbajtje të zakonshme” etj nuk kemi tejkalime të fondeve të parashikuara.

Në lidhje me tejkalimin e këtyre zërave u kërkuan shpjegimet përkatëse, por nuk u paraqit dokumentacion justifikues për të mundësuar një opinion me argumentet se përse janë tejkaluar këto zëra.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e llogarive paraqitur më sipër janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. I njëjti fakt konstatohet edhe në shpenzimet e realizuara nën planifikimin fillestar, ku për disa llogari analitike të shpenzimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të vitit nuk janë realizuar tërësisht nga zërat e buxhetit.

SPV në kundërshtim nën 65 të ligjit nr.9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar i cili citon se “Nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm” nuk ka hartuar raportet e monitorimit.

Referuar nenit 3, pika 43 të ligjit të sipërpërmendur “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë” është nëpunësi i administratës publike në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues”. Nga auditimi u konstatua se këto raporte monitorimi nuk janë hartuar dhe nuk janë depozituar në MSHMS.

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet në KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.

Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

Çëshja 1 – Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit.

Titulli i Gjetjes 1	Mos hartimi dhe dorezimi I raporteve të monitorimit për periudhën objekt auditimit (2017,2018,2019,2020)
Situata:	SPV nga auditimi u konstatua se, për asnjë nga vitet objekt auditimi nuk janë hartuar dhe dorezuar në MSHMS raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.
Kriteri:	Neni 65, i ligjit nr.57 datë 02.06.2016 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9936, Datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin E Sistemit Buxhetor Në Republikën E Shqipërisë”, Të Ndryshuar; Udhezimi nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
Ndikimi/Efekti	Mos paraqitja si dhe deklarimi i ndryshimeve brenda programeve në lidhje me realizimin apo jo të artikujve të parashikuara.

Rekomandimi

Nëpunësi autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të SPV të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues (MSHMS), deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat.

2.4.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit, lidhur me strukturën e SPV *Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë* është institucion publik, dytësor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor me synim promovimin, parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve me crregullime mendore. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale përkrah aktivitetet dhe nismat kundër diskriminimit, stigmatizmit dhe përjashtimit të personave me crregullime apo paafësi mendore dhe po ashtu kujdeset për respektimin e plotë të të drejtave të këtyre njerëzve. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në varësi të MSHMS, përkrah dhe zbaton gjithë nismat e ndërmara nga ky autoritet duke përfshirë këtu objektivin kryesor të saj për zhvillimin e reformës së shëndetit mendor.

5. Spitali Psikiatrik i Vlorës e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit të Shërbimit Shëndetësor, ligjit të Shërbimit Spitalor në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjit të Shëndetit Mendor (nr.44/2012). Infrastruktura fizike dhe pajisjet e këtij spitali janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Funkcionon në bazë të Këshillit Tekniko-Administrativ, i cili merr vendime të ndryshme në këtë institucion.

7. Spv është një institucion shtetëror me shtretër, kapaciteti i te cilit është deri në 200 dhe ofron shërbim për rrethet: Vlorë, Fier, Berat, Skrapar, Tepelene, Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë (Lushnje), zonë mbulimi kjo e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

8. Ofron shërbim multi-disiplinor me këto pavione:

- d. Pavioni Pranim / Urgjencës
- e. Pavioni Akut / Sub-akut
- f. Pavioni kronik burra-gra

❖ *Respektimi i strukturës organizative të miratuar.*

Rregullorja e SPV është miratuar nga Drejtori i Spitalit, ***në kundërshtim*** me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23, pika 2, e cila përcakton se: “2. *Ministri i Shëndetësisë përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloret e funksionimit të spitaleve publike*”. ***Rregullorja e brendshme nuk është e përditësuar me strukturën e vitit 2016 dhe asaj 2018.*** Si rrjedhojë rregullorja e brendshme e SPV vazhdon të jetë rregullorja me urdhër nr.11, datë 10.10.2013.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për vitet 2017 dhe 4-mujorin e parë të 2018-ës, SPV është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës me shkresën nr.2265/3, datë 09.11.2016, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, ku konstatohet se struktura organizative e SPV ka qënë me 123 pozicione pune të miratuara. Ndërsa për vazhdimin e vitit 2018, 2019, 2020 SPV është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës me shkresën nr.2269/1, datë 26.04.2018, miratuar nga MSHMS dhe ka 128 punonjës. Më konkretisht 7 mjek psikiatër, 42 infermier, 30 kujdestar, 17 punonjës administrate, 13 staf psiko-social si dhe pjesa tjetër staf mbështetës.

Përgjatë periudhës së auditimit institucioni nuk ka patur vende vakante të punonjësve pasi, pas liritimit nga detyra të punonjësve menjëherë është bërë emërimi i punonjësve të tjerë nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, duke vecuar rastin e një vendi vakant të njëkut-psikiatër, ku nga ana e SPV i është bërë kërkesë OSHKSH për plotësimin e këtij vendi vakant me datë 1.29.2021. Kjo si rrjedhojë, pasi emërimi i mjekëve, infermierve etj., kryhet nëpërmjet OSHKSH, bazuar në urdhrin nr.18, datë 17.01.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Operatorit të Shërbimeve Të Kujdesit Shëndetësor.

Emërimet e infermierëve bëhen nga Portali Infermierë për Shqipërinë, i mjekëve psikiatër bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si mjek specializant. Emërimi i punonjësve të administratës bëhet nga Operatori Qëndror i Kujdesit Shëndetësor Tiranë, si dhe emërimi i personelit mbështetës bëhet nga Spitali Psikiatrik me miratim nga OSHKSH-Vlorë.

-U verifikuan nga ana jonë të gjitha praktikat e kësaj procedure për vitet 2017, 2018, 2019 dhe dhe 2020. Situata për emërimet e punonjësve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.Viti	Me kontratë	Ngritje në detyrë
2017	7	
2018	13	1
2019	9	1
2020	6	
Total	35	2

-U verifikuan nga ana jonë të gjitha praktikat e kësaj procedure për vitet 2017, 2018, 2019 dhe dhe 2020. Situata për largimet paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.viti	Largim me dëshirë	Pension	Largim me masë disiplinore	Total
2017	4		1	5
2018	8	1		9
2019	11	2	1	14
2020	7	1	2	10
Totali	30	4	4	38

Nga auditimi rezulton se, në SPV për vitin 2017 fondi i pagave është realizuar në masën 88%, për vitin 2018 në masën 91%, për vitin 2019 në masën 99% dhe në vitin 2020 në masën 97% Institucioni për periudhën objekt auditimi nuk ka tejkalluar numrin e punonjësve të planifikuar për çdo vit kalendarik. Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërme për vitin 2018,2019 dhe 2020 ka ardhur si rezultat i lëvizjes së vazhdueshme të punonjësve (me kategori të ndryshme të pagave).

Më konkretisht, treguesi i realizimi të numrit të punonjësve dhe niveli i shpenzimit të fondit të pagave për periudhën e audituar paraqitet në tabelën e mëposhtme :

(të dhënat në mijë/lekë)

Pasqyra e realizimit të buxhetit për llogarinë 600 "Paga personeli" & llogarinë 601 "Kontribut për sigurimet shoqërore, shëndetësore"					
Nr	Periudha	Llogaria	Plani	Fakti	Realizimi në %
1	Viti 2017	600	87,664,000	77,284,316	88%
2		601	13,100,000	12,751,751	97%
1	Viti 2018	600	87,799,000	80,476,060	91%
2		601	16,182,000	13,291,415	82%
1	Viti 2019	600	84,400,000	83,623,942	99%
2		601	16,900,800	13,816,070	81%
1	Viti 2020	600	87,600,000	85,190,548	97%
2		601	15,200,000	14,087,043	92%

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë përpunuar nga audituesi nga specialisti i financës

Nga auditimi i dokumenteve për pagat e punonjësve të SPV, rezulton se përllogaritjet janë bërë në përputhje me bazën ligjore, VKM 555, datë 11.08.2011 për “Miratimin e strukturës dhe të

niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e MSH dhe një njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit të traumës si dhe për trajnimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura” (1, 2, 3, 4, 5, 6), lidhja 2, Kreu 2 dhe 3. ***Nga testet me zgjedhje në lidhje me llogaritjen e pagave dhe caktimin e kategorive të përfitimit, nuk u konstatuan parregullsi.*** Lidhur me zbatimin e bazës ligjore të pagave, u audituan borderotë e disa periudhave për administratën e SPV-së dhe u konstatua se përgatitja e borderove është mbështetur në listë prezencat mujore, të plotësuara nga çdo sektor. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj te paraqitur nga çdo sektor dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Listë pagesat dhe përmbledhëset e pagave janë nënshkruar, nga Shefja e Sektorit të Financës, nga Drejtori i institucionit si dhe Ekonomistja e Planit. Bashkëlidhur janë listë prezencat dhe urdhrat e brendshëm të drejtuesit të institucionit. Listë pagesat e punonjësve dhe ndarja e pagesave është bërë sipas bankave të nivelit të dytë. Çdo veprim u gjet i finalizuar me një pasqyrë përmbledhëse të pagave si dhe me numrin e punonjësve faktik mujor.

Libri i pagave, për periudhën objekt auditimi, është plotësuar për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, në të cilin janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave duke filluar nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.

❖ ***Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.***

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ligji nr. 8770, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të pagës bruto, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare, sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 97% për vitin 2017, 82% për vitin 2018, 81% për vitin 2019 dhe 92% për vitin 2020.

❖ ***Mbi rregullshmërinë në plotësimin e dosjeve të personelit.***

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuara me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si CV, diplomë, listë notash, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj. *Çdo punonjës në SPV ka dosje të veçantë të plotësuara me dokumentacionin e duhur sipas legjislacionit në fuqi. Në vend të certifikatës personale në çdo dosje është fotokopjo e kartës së identitetit të personit, që është dokument identifikues.*

Në Drejtorinë e SPV, për periudhën objekt auditimi, ***nuk janë kryer dhe nuk janë depozituar*** vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në MSHMS.

Në SPV, për periudhën objekt auditimi, nga auditimi i dosjeve u konstatua se në të gjitha dosjet e punonjësve të gjithë dokumentacionet ishin fotokopje të noterizuara.

Regjistri i personelit është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku të jenë pasqyruar regjistrimet për të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë.

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet në KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.
Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi rregullshmërinë e plotësisimit të dosjeve të personelit.</i>
Situata:	U konstatua që në dosjet e personelit mungojnë vlerësimet periodike të punonjësve, të cilat nuk i janë depozituar MSHMS.
Kriteri:	Vendim Nr. 109, datë 26.2.2014 për “Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë (ndryshuar me VKM nr. 252, datë 30.3.2016)”, Kreu IV
Ndikimi/Efekti:	Mos vlerësimi i punonjësve cënon ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.
Shkaku:	Mosrealizimi i detyrës nga hierarkia lidhur me vlerësimin e punonjësve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Spitali Psikiatrik, Vlorë në bashkëpunim me MSHMS, të kryejë vlerësimet periodike të punonjësve të SPV, me qëllim për të ndjekur angazhimin dhe performancën e punonjësve në punë.

2.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
- Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave
- Lista e debitorëve dhe kreditorëve në vite
- Regjistri i aktiveve të institucionit, si dhe dosjet e inventarizimit
- Regjistri i proceseve gjyqësore, regjistrimi dhe njohja e tyre në kontabilitet, si dhe urdhër shpenzimet për likuidimin e tyre.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve kontabël të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001. Auditimi vlerëson se, për periudhën objekt auditimi në përgjithësi veprimet dhe transaksionet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikues që mbështesin regjistrimet kontabël si në mënyrë kronologjike, ashtu dhe sistematike, konform përcaktimeve të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar/shfuqizuar.

- Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit *për vitin 2017* është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre*”, i ndryshuar.
- Për *vitin 2018 dhe vitin 2019*, hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën që auditohet 01.01.2017 deri 31.12.2019 është njësi shpenzuese më vete, dhe e tillë konsiderohet në pikëpamjen e buxhetimit dhe mbajtjes së veprimtarisë kontabile.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e

llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të llogarive për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstëve që varen prej tyre”, i ndryshuar (Viti 2017) dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8/ 2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Vlorë, si dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

Rezulton se, veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga SPV, situacione këto të rakorduar me degën e Thesarit. Kopje e bilancit dhe pasqyrave financiare janë dërguar në Degën e Thesarit, të cilat janë konfirmuar me vulosjen e tyre, Pasqyrat Financiare janë shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht, si më poshtë:

- për vitin 2017 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 20/1, datë 26.02.2018,
- për vitin 2018 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 59/1, datë 26.02.2019
- për vitin 2019 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 376, datë 20.02.2020

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

Viti 2017

Hartimi i llogarive vjetore dhe mbyllja e Pasqyrave Financiare të vitit 2017 është bërë në zbatim në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstëve që varen prej tyre”, i ndryshuar.

Pasqyrat financiare të vitit 2017, për SPV janë depozituar rregullisht dhe përfshijnë llogaritë e bilancin kontabël dhe të gjithë pasqyrat e anekset e tyre.

Gjatë përpilimit të bilancit janë ndjekur etapat dhe radha e veprimeve për mbylljen e llogarive, për nxjerrjen e bilancit kontabël përfundimtar të vitit 2017.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2017 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata ” në vlerën neto prej 305,060,155 lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ndërtesat dhe rikonstruksionet, instalime teknike, makineri e pajisje dhe inventar ekonomik.

Të dhënat në lekë

Nr.	llogaria	Zërat/ postet e bilancit	Viti 2017	Viti 2016
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	305,068,155	311,986,504
3	20, 230	I.Të pa trupëzuara	9,677,600	9,677,600
4	201	Prime te emisionit dherimbursimit te huave		
5	202	Studime dhe kërkime	9,677,600	9,677,600
9	21,23,24,28	II.Aktivet e Qëndrueshme te Trupëzuara	295,390,555	302,308,904
10	210	Toka,troje,Teren		
11	211	Pyje,Kullota Plantacione		
12	212	Ndërtime e Konstruksione	252,955,299	252,955,299
13	213	Rruge,rrjete,vepra ujore		
14	214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	30,329,352	29,874,352
15	215	Mjete transporti	11,978,024	11,928,024
16	216	Rezerva shtetërore		
17	217	Kafshe pune e prodhimi		
18	218	Inventar ekonomik	44,912,791	44,353,087
19	219	Amortizimi aktiveve të .Qëndrueshme të trupëzuara(-)	(44,784,911)	(36,801,858)
24	25.26	III.Aktive Financiare	0	0

Burimi: Sektori i Financës së SPV

- Grupi aktiveve afatgjata jo-materiale në fund të vitit 2017 rezultojnë në vlerën 9,677,600 lekë, i pandryshueshëm nga vitet paraardhëse.

- Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 252,955 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me vlerën e inventarit, ku nuk ka pësuar ndryshime nga viti i mëparshëm.

- Zëri “Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune” (llog. 214) për vlerën 30,329 mijë lekë, i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 6 “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën prej 168,000 lekë nga blerjet e realizuara gjatë vitit dhe me vlerën 323,000 lekë nga kalimet kapitale brenda sistemit. Llogaria 214 është pakësuar për vlerën prej 30,000 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi.

- Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 44,912 mijë lekë, i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 6 vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën prej 894,000 lekë nga blerjet e realizuar nga institucioni gjatë vitit 2017 dhe me vlerën 30,000 lekë nga transferimet kapitale brenda sistemit. Llogaria 218 është pakësuar për vlerën prej 43,188 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi dhe vlerën 321,108 lekë nga transferimet kapitale.

- Zëri “Mjete Transporti” (llog. 215) për vlerën 11,978 mijë lekë, i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 6 vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën 50,000 lekë nga transferimet kapitale brenda sistemit.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” (me koston historike) dhe të formatit nr. 7 “Pasqyra e amortizimeve” është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2017 me vlerën bruto prej 349,853 mijë dhe amortizimi i akumuluar në vlerën 44,784 mijëleke shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1 “Aktive afatgjata”si më poshtë:

Nr.llog.	EMERTIMI	Gjendje ne		Shtesa gjate vitit ushtrimor				Pakesime gjate vitit ushtrimor				Gjendja mbyllje te ushtrimit
		celje te ushtrimit	erje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Levizje brenda sistem	Gjithesej	Shitje	Nxjasht perdor.	Pakesime te tjera	Gjithesej	
				Jashte sistemi	renda aktiv.							
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	I. TE PA TRUPEZUARA	9,677,600	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9,677,600
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave											0
202	Studime dhe kerkime	9,677,600						0				9,677,600
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme							0				0
230	Shpenz.per ritijen e aktiv.qendr.patrupezuara							0				0
	II. TE TRUPEZUARA	339,110,762	1,062,000	0	403,000	0	1,465,000	0	79,188	321,108	400,296	340,175,466
210	Toka,troje,Terene	0						0				0
211	Pyje,Kullota Plantacione	0						0				0
212	Ndertime e Konstruksione	252,955,299	0		0			0	0		0	252,955,299
213	Rruge,rrije,vepra ujore	0						0				0
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	29,874,352	168,000		323,000	0	491,000		36,000	0	36,000	30,329,352
215	Mjete transporti	11,928,024	0		50,000		50,000					11,978,024
216	Rezerva shtetore	0						0				0
217	Kafshe pune e prodhimi	0						0				0
218	Inventar ekonomik	44,353,087	894,000	0	30,000	0	924,000		43,188	321,108	364,296	44,912,791
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0						0				0
28	Caktime (Punime ne proces 212) Ndertim i Spitalit te Ri	0	0					0				0
	TOTALI (I + II)	348,788,362	1,062,000	0	403,000	0	1,465,000	0	79,188	321,108	400,296	349,853,066

Analiza e debi-kredive:

Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.

Aktivt qarkulluese

Nga analiza e llogarive të aktiveve afatshkurtra rezulton se ato përputhen me te dhënat inventariale analitike. Për periudhën 2017 gjendja e këtyre llogarive paraqitet si vijon:

Të dhënat në lekë

27	B	AKTIVE QARKULLUESE	43,181,643	38,026,051
28	Klasa 3	I.Gjendja e Inventarit	19,219,250	22,402,083
29	31	Materiale	5,313,096	5,442,179
30	32	Objekte inventari	13,906,154	16959904
31	33	Prodhime, punime e shërbime ne proces		
38	Klasa 4	II.Kërkesaarkëtimi mbi Debitorët	23,593,464	14,808,039
39	409	Furnitorë(Debitorë),parapagime pagesa pjesore		
40	411-418	Klientë e llogari te ngjashme		
41	423.429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	738,365	660,163
42	431	Te drejta e taksa për t'u derdhur ne shtet		
43	432	Tatime mbledh nga shteti përlllog.Pushtetit Lokal		
44	433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti		
45	4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	22,855,099	14,147,876
46	435	Sigurime Shoqërore		
54	50.59	III.Llogarite financiare	368,929	815,929
57	512	Llogari ne banke		
58	520	Disponibilitetene thesar	368,929	815,929
59	531	Llogari ne arke		

Burimi: Sektori i Financës së SPV

a.Të drejtat e arkëtueshme:

Llogaria 423 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” për vitin 2017 janë në vlerën 738,365 lekë,ku detyrime te krijuara në vitin 2017 janë në shumën prej 125,037 lekë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 22,855,099 lekë përfaqëson detyrimet që ka SPV ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2017, përkatësisht për pagat në vlerën 5,448,981 lekë, për tatim taksa në vlerën 380,270 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,606,377 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 222,930 lekë, të cilat paguhen në Janar të vitit 2018, si dhe fatura të pa likuiduar ndaj të tretëve gjatë vitit 2017, pra janë shpenzime të konstatuara në vitin 2017, që do të paguhen në vitin 2018 në shumën prej 14,448,447 lekë. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435 ,436.,437 dhe llogarinë 467.Llogaria 4342 përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” nuk mbyllet për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme. Pasqyrimi në vlerën në vlerën 368,929 lekë përfaqëson të ardhura, që janë

trashëguar nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi në vlerën 273,973 lekë, si dhe gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) në vlerën 94,950 lekë.

b.Detyrimet e institucionit për periudhën ushtrimore 2017:

Nga analiza e llogarive të detyrimeve afatshkurtër rezulton se ato përputhen me të dhënat analitike. Për periudhën 2017 gjendja e këtyre llogarive paraqitet si vijon:

Të dhënat në lekë

20	Klasa 4	II.Detyrime afatshkurtra	23,688,414	15,349,989
21	419	Klientë(Kreditore), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	709,854	
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	5,448,981	5,098,302
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	380,270	309,468
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llogarit Pusht.Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	738,365	660,163
28	435	Sigurime shoqërore	1,606,377	1,480,583
29	436	Sigurime shëndetësore	222,930	205,467
30	437.438	Organizma te tjera shtetërore	38,240	
31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33	460	Huadhënie		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letra me vlere		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	94,950	541,950
36	467	Kreditore te ndryshëm	14,448,447	7,054,056

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Nga analiza e mësipërme konstatohet se në përgjithësi shumat e pasqyruara në bilanc në llogaritë sintetike janë kuadruar me të dhënat në mënyrë analitike të llogarisë së klasës 4.

Nga 15,349,989 lekë të paraqitura në vitin 2016, ato janë rritur për 8,338,425 lekë. Në këtë kuadër, peshën më të madhe e zë rritja e zërit 467 “Kreditore te ndryshëm”, që nga 7,054,056 lekë janë rritur në 14,448,447 lekë dhe llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” që nga 0 janë shtuar në 709,854 lekë.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 14,448,447 lekë përfaqëson detyrimet e prapambetura për energji elektrike, shpenzime telefon, detyrime për shpenzime ndaj furnitorëve për shërbime lavaxantërie, katering, pastrim gjelbërimi etj të cilat janë faturime të konstatuar në 2017 dhe që janë paguar në janar të vitit 2018 , pra kemi të bëjmë me detyrime të lindura apo të faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, të cilat janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, në periudhën pasardhëse të detajuar si më poshtë:

Të dhënat në lekë

Nr	Përshkrimi	Vlera	Likuidimi
	Llogaria 467		
1	Energji elektrike (Dhjetor 2017)	794,785	USH nr. 5, dt 26.01.2018
2	Ujë I pijshëm (Dhjetor 2017)	271,147	USH nr. 6, dt 26.01.2018
3	N. telefon fiks (Dhjetor 2017)	3,002	USH nr .12, dt 26.01.2018
4	N. shërbim interneti (Dhjetor 2017)	34,800	USH nr. 11, dt 26.01.2018
5	AGS shërbimlavaxantërie(Dhjetor 2017)	3,090,131	USH nr. 19, dt 30.01.2018
6	S. -AL,pastrimgjelbërimi (Dhjetor 2017)	1,964,751	USH nr. 20, dt 30.01.2018
7	S. - AL ushqimi katering(Nëntor-Dhjetor 2017)	7,139,654	USH nr. 18, dt 30.01.2018
8	D. mbetjet urbane (Dhjetor 2017)	127,831	USH nr. 21, dt 30.01.2018
9	Dieta dhjetor 2017	18,500	USH nr. 10, dt 26.01.2018
10	Shërbimi postar dhjetor 2017	4,356	USH nr. 17, dt 29.01.2018
11	A. Pol shërbim me roje private	999,490	USH nr. 30, dt 07.02.2018
	Shuma	14,448,447	
	Llogaria 401-408		
1	"A.3 " shpk blerje materiale pastrimi	709,854	USH nr. 22, dt 30.01.2018

	Shuma		
	Llogaria 437		
1	AMC dhjetor 2017	29,740	USH nr. 9, dt 26.01.2018
1	Urdhri I mjekut (Dhjetor 2017)	2,800	Likuiduar dhjetor 2018
3	Sindikate (Dhjetor 2017)	5,700	Likuiduar dhjetor 2018
	Shuma	38,240	

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Në llogarinë 466, “Kreditorë për mjete ne ruajtje”, gjendja më datën 31.12.2017 paraqitej për 94,950 lekë e pandryshuar nga vitet e mëparshme, e cila ka të bëjë vlerën 5% e garancisë së kontratës së realizuar për ndërtimin e një sere diellore për prodhim lulesh që në vitin 2011, e cila sot nuk është në gjendje funksionale për faktin se kjo serë është e djegur nga shkaqet natyrore.

Viti 2018-2019

Analiza e posteve kryesore te bilancit:

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018- 2019 të cilat janë hartuar në bazë të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 264,207,686 lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, ndërtesat dhe rikonstruksionet, instalime teknike, makineri e pajisje dhe inventar ekonomik. AA në vitin 2018 evidentoheshin në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar për vlerën e tyre neto prej 283,107,748 lekë.

Të dhënat në lekë

Nr.	Ilogaria	Zërat/ postet e bilancit	Viti 2019	Viti 2018
42		II.Aktivet Afatgjata	264,207,696	283,107,740
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	9,677,600	9,677,600
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kërkime	9,677,600	9,677,600
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	254,530,096	273,430,140
48	210	Toka, Troje, Teren		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	211,670,297	222,810,839
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	17,754,769	18,361,370
53	215	Mjete Transporti	1,689,941	2,112,426
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	23,415,089	30,145,505
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nen huadhënie		
61	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	0	0
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale		0

Burimi: Sektori i Financës se SPV

Grupi aktiveve afatgjata jo-materiale dhe fund të vitit 2018 - 2019 rezultojnë në vlerën 9,677,600 lekë.

**1. Titulli i Gjetjes:
Situata:**

Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"

Nga verifikimi analitikë i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se në zërin 202 "Studime dhe kërkime" në vlerën prej 9,677,600 lekë janë kontabilizuar shpenzimet për "Studime e projekte" të realizuara nga institucioni ndër vite (2007-2016). Vlera prej 9,677,600 lekë nuk ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale por janë "Studim e projekte", të cilat në momentin e konstatimit si investim nga SPV duhet të ishin regjistruar në zërin 230 "Investime për Aktive Afatgjata jo materiale" dhe pasi institucioni ka përfunduar dhe marrë në dorëzim godinat për të cilën janë realizuar "Studim projektimet" duhet të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit duke bërë veprimin kontabël: debituar llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione" dhe kredituar llogarinë 230. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale" në shumën 9,677,600 lekë.

Kriteri:

Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 6, 9 dhe 10; dhe konkretisht me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c".

Ndikimi/Efekti:

Mos pasqyrim i saktë i gjendjen e aktiveve, e cila ka çuar në mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e "Aktiveve Afatgjata Materiale" në shumën 9,677,600 lekë.

Shkaku:

Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël nga SPV të aktiveve.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Spektori i financës së SPV të marrë masa për sistemimin e shumës 9,677,600 lekë nga llogaria 202 "Studime dhe kërkime" në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", sipas zërave për të cilën janë realizuar "Studim e projekte".

Afati i zbatimit:

Menjëherë

**2. Titulli i Gjetjes:
Situata:**

Mos pasqyrimi në kontabilitet e institucionit "Toka, Troje, Terrene"

Nga auditimi i zërave të Pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se:

- Sipërfaqet e tokave dhe trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre për subjektin e audituar në vitin, 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë.


Nga ana e strukturave drejtuese për periudhën 2016, me kërkesën nr. 235/2, datë 14.06.2016 SVP i ka kërkuar ZRPP Vlorë informacion në lidhje me gjendjen juridike të pasurive që administron institucioni. Me shkresën nr. 16110/1, datë 22.06.2016 ZRPP Vlorë kthen përgjigje SPV për gjendjen juridike të pasurive si dhe sipërfaqen totale nën administrim prej **11620m²**.

Nga auditimi u konstatua se mbas kësaj korrespondence nuk ka pasur më komunikim me ZRPP Vlorë.

Në SPV nuk ekzistojnë dokumentacione dhe planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit dhe kjo sipërfaqe nuk është regjistruar në zyrat e kadastrës shtetërore dhe të hipotekës.

Sipërfaqet e tokave dhe trojeve në llogarinë 210, si dhe vlerat e tyre për subjektin e audituar në vitin 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës 11620m², që ka SPV në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 999), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Vlorës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet me çmimin prej **10,903 lekë/m² në zonën kadastrale ZK. 8602**.

Në referim të çmimit për m² për zonën kadastrale nr. 8602, sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016.



(Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 999)

Konstatohet se: Nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“62. Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata.....

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nen rubrikave që përfaqësojnë:

Kriteri:

- VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 3.3, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar Në evidentimin e saktë të vlerave të pasurisë shtetërore në kontabilitet.

Ndikimi/Efekti:

Shkaku:

Dobësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm para vitit 2015

Rëndësia:

I mesëm

Rekomandimi:

- Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

- Nga SPV të merren masa për përlogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Sektori i Financës të ndërmarr veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Afati i zbatimit:

Menjëherë e në vijimësi

- Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën neto 211,670,297 lekë për vitin 2019 dhe për vlerën neto 222,810,839 lekë për vitin 2018 është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me vlerën e inventarit, ku për të dy vitet nuk ka pësuar ndryshime. Ndryshimi i vlerës nga një vit në tjetrin është si rezultat i amortizimit pasqyruar në formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(vlera neto)”.

- Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218):

Për vitin 2018 është paraqitur në vlerën neto 18,361,370 lekë Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” vërehet se kjo llogari është pakësuar me vlerën bruto prej 1,320,000 lekë nga kalime kapitale pa pagesë.

Për vitin 2019 është paraqitur në vlerën neto 17,754,769 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën bruto prej 195,000 lekë nga kalime kapitale pa pagesë jashtë sistemit dhe është pakësuar me vlerën 30,000 nga nxjerrjet jashtë përdorimi të realizuara nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi në vitin 2019.

- Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218)

Për vitin 2018 është paraqitur në vlerën neto 30,145,505 lekë, i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën prej 15,000 lekë nga blerjet e realizuar nga institucioni gjatë vitit 2018 dhe është pakësuar për vlerën prej 293,450 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi dhe vlerën 18,000 lekë nga transferimet kapitale.

Për vitin 2019 është paraqitur në vlerën neto 23,415,089 lekë Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” vërehet se kjo llogari është rritur me vlerën prej 15,000 lekë nga kalim kapitale jashtësistemit dhe është pakësuar për vlerën prej 1,363,400 lekë nga nxjerrja jashtë përdorimi të realizuara nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi në vitin 2019

- Zëri “Mjete Transporti” (llog. 215) i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

- Për vitin 2018 është paraqitur në vlerën neto 2,112,426 lekë, zë i cili nuk ka pësuar ndryshime nga vitet e mëparshme

- Për vitin 2019 është në vlerën 1,689,941 lekë. Ndryshimi i vlerës së këtij zëri nga një vit në tjetrin është si rezultat i amortizimit pasqyruar në formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

3.Titulli i Gjetjes:
Situata:

Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuara në planin kontabël publik
Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitin 2017-2018-2019 u konstatua se, Një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes dhe transferimit të kapitalit pa pagesë nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se norma e amortizimit është llogaritur mbi bazën e llogarive kontabël, dhe jo mbi bazë grupimi, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se:

- një pjesë e pajisjeve elektronike (IT) janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, dhe jo në llogarinë 2186000 “Inventar ekonomik”, ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogaritur me normën 5% dhe jo me normën 25%.

- Një pjesë e aktiveve të tjera janë klasifikuar në llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, nga ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogaritur me normën 5% dhe jo me normën 20%.

Kriteri:

VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36;

Ndikimi/Efekti:

Mos evidentimi i saktë i vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni, e cila ndikon në mos Planifikimi e saktë të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

Shkaku:

Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Spektori i Financës së SPV të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” (me koston historike) dhe të formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2018 me vlerën bruto prej 348,236,616 dhe amortizimi i akumuluar në vlerën 65,128,876 leke dhe për vitin ushtrimor 2019 me vlerën bruto prej 347,033,116 lekë dhe amortizimi i akumuluar në vlerën 82,825,429 leke, shuma tënjëjta dhe të rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1 “Aktive afatgjata” si më poshtë:

Viti 2018

Nr.	Nr.	EMERTIMI	Teprica ne fillim 2018			Shtesat gjate vitit 2018		Paksimet gjate vitit 2018		Teprica ne Fund 2018		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
Rrjeshti	Reference	Llogarije	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
a	b	c										
1	20	L AAGJ/O MATERIALE	9,677,600	0	9,677,600	0	0	0	0	9,677,600	0	9,677,600
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	9,677,600	0	9,677,600					9,677,600	0	9,677,600
4	203	Koncione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	340,175,466	44,784,911	295,390,555	15,000	20,889,933	1,631,450	545,968	338,559,016	65,128,876	273,430,140
6	210	Toka,troje,Terene			0					0	0	0
7	211	Pysje,Kullota Plantacione			0					0	0	0
8	212	Ndertime e Konstruksione	252,955,299	18,417,574	234,537,725		11,726,886			252,955,299	30,144,460	222,810,839
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujqore			0					0	0	0
10	214	Instalime teknrike,makineri,paisje,vegla pune	30,329,352	10,106,778	20,222,574		992,383	1,320,000	451,179	29,009,352	10,647,982	18,361,370
11	215	Mjete transporti	11,978,024	9,337,491	2,640,533		528,107			11,978,024	9,865,598	2,112,426
12	216	Rezerva shtetore			0					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	44,912,791	6,923,068	37,989,723	15,000	7,642,557	311,450	94,789	44,616,341	14,470,836	30,145,505
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		TOTALI(I+II)	349,853,066	44,784,911	305,068,155	15,000	20,889,933	1,631,450	545,968	348,236,616	65,128,876	283,107,740

Viti 2019

Nr.	Reference	EMERTIMI	Teprica ne fillim 2019			Shtesat gjate vitit 2019			Paksimet gjate vitit 2019			Teprica ne Fund 2019		
			Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica		
Rrjeshti	Llogarije		Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto		
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
1	20	I. AAGJ/O MATERIALE	9,677,600	0	9,677,600	0	0	0	0	9,677,600	0	9,677,600		
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			-					0	0	0		
3	202	Studime dhe kerkime	9,677,600		9,677,600					9,677,600	0	9,677,600		
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme			-					0	0	0		
5	21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	338,559,016	65,128,876	273,430,140	210,000	18,285,485	1,413,500	588,941	337,355,516	82,825,420	254,530,096		
6	210	Toka, troje, Terene			-					0	0	0		
7	211	Pyje, Kullota Plantacione			-					0	0	0		
8	212	Ndertime e Konstruksione	252,955,299	30,144,460	222,810,839		11,140,542			252,955,299	41,285,002	211,670,297		
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0		-					0	0	0		
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	29,009,352	10,647,982	18,361,370	195,000	785,030	30,100	13,529	29,174,252	11,419,483	17,754,769		
11	215	Mjete transporti	11,978,024	9,865,598	2,112,426		422,485			11,978,024	10,288,083	1,689,941		
12	216	Rezerva shtetore			-					0	0	0		
13	217	Kafshe pune e prodhimi			-					0	0	0		
14	218	Inventar ekonomik	44,616,341	14,470,836	30,145,505	15,000	5,937,428	1,383,400	575,412	43,247,941	19,832,852	23,415,089		
15	24	Aktive te Qend. te trupezuara te demtuara			-					0	0	0		
16	28	Caktime			-					0	0	0		
17		TOTALI (I + II)	348,236,616	65,128,876	283,107,740	210,000	18,285,485	1,413,500	588,941	347,033,116	82,825,420	264,207,696		

4. Titulli i Gjetjes:
Situata:

Lëvizja e aktiveve kapitale të aktiveve pa pagesë

- Në vitin 2017 është bërë hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi (dhurim) të një automjeti Mercedes Benz si ndihmë nga UNOPS. Dhurimi në natyrë të automjetit nga donatori është dhënë vetëm në sasi pa çmim apo kosto, e cila është pranuar nga njësia SPV, ku është bërë vlerësimi i tij në vlerën prej 50,000 lekë. Fletëhyrja në magazinë në SPV është bërë më datën 07.11.2017.

Kalim kapitali pa pagesë i makinës vlerësuar me vlerën 50,000 lekë nuk është shoqëruar me aktin e dhurimit, Nuk është mbajtur proces-verbal për marrjen në dorëzim dhe kalim kapitali në prani të marrësi (përfaqësues të SPV) dhe në dorëzim përfaqësues UNOPS. Mungon autorizimi i personit për tërheqjen e mjetit, sikundër kërkohet në Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre"

- Në vitin 2017 është bërë hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi të një kompjuteri në vlerën 15,000 lekë, Skaneri në vlerën 8,000 lekë dhe të një printeri në vlerën 7,500 lekë. Shuma e hyrjes së këtyre aktiveve u konstatua nga pasqyra nr. 6 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) 2017". Nga auditimi u konstatua se për hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi të këtyre aktiveve mungon i gjithë dokumentacioni sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre". Hyrja dhe kontabilizimi i tyre në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" është mbështetur vetëm në fletë hyrjen në magazinë me nr. 2, datë 03.07.2017.

- Me Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.1589, datë 28.02.2017 "Kalim kapitali të aktiveve pa pagesë", nga SPV në Shërbimin Spitalor Gramsh urdhëron :

- Kalimin Kapital pa pagesë nga SPV në Shërbimin Spitalor Gramsh, të një sobe gatimi, aspiratori dhe inventar ekonomik.

Kalim kapitali pa pagesë nga SPV në Shërbimin Spitalor Gramsh, në shumën totale 1,338,000 lekë. konkretisht llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 1,320,000 lekë dhe llogaria 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 18,000 lekë është realizuar me 08.05.2018, një vit mbas urdhrin të MSHMS. Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi të aseteve nga SPV në Shërbimin Spitalor Gramsh nuk ka të bashkëngjitur proces-verbal marrjes në dorëzim midis përfaqësuesve të SPV dhe Shërbimit Spitalor Gramsh, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga SPV deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon fletë hyrja e asetve dhe Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve, si dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit Shërbimit Spitalor Gramsh.

- Në vitin 2018 është bërë hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi (dhurim) të një dollapi nga "A.". Kalim kapitali pa pagesë në shumën totale 15,000 lekë është shoqëruar me aktin e dhurimit, ku është përcaktuar dhe vlera aktivitetit të dhuruar. Bashkëngjitur është fletë hyrja në magazinë të aktivitetit me nr. 1 datë 21.05.2018. Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi të aktivitetit nga Donatori tek SPV nuk ka të bashkëngjitur Procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve.

- Në vitin 2019 është bërë hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi (dhurim) të një aparati Diasorin Liason nga shoqëria "S. C.&L."

Kalim kapitali pa pagesë në shumën totale 190,000 lekë është shoqëruar me aktin e dhurimit,

Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre, si dhe fletë hyrjen në magazinë të mallit me nr. 2 datë 29.10.2019.

Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi të aparaturës nga Donatori tek SPV nuk ka të bashkëngjitur Procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve.

- Në vitin 2019 është bërë hyrje kapital pa pagesë jashtë sistemi (dhurim) të një kompjuter desktop dhe të një skaneri nga shoqëria "ACT Albania Co" në SPV.

Kalim kapitali pa pagesë në shumën totale 20,000 lekë është shoqëruar me aktin e dhurimit, ku është përcaktuar vlera e tyre nga dhuruesi. Bashkëngjitur është fletë hyrja në magazinë të mallit me nr. 1, datë 05.06.2019.

Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi të aparaturës nga Donatori tek SPV nuk ka të bashkëngjitur procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve.

Kriteri: Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" në kapitullin III të udhëzimit "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre"

Ndikimi/Efekti: Mos llogaritje e vlerës së mbetur të aktivitetit, çon në regjistrimin e vlerës jo reale të aktivitetit. Mos paraqitja e flete hyrjeve ose fletë daljeve si dhe aktit të konfirmimit, lë të hapur ciklin e transferimit të kapitali.

Shkaku: Mos plotësimi i dokumentacionit shoqëruar sipas përcaktimeve ligjore.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Sektori i Financës të marri masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi.

Afati i zbatimit: Në vijimësi

Aktivitet qarkulluese

Nga analiza e llogarive të aktiveve afatshkurtra rezulton se ato përputhen me të dhënat analitike. Për periudhën 2018 dhe 2019 gjendja e këtyre llogarive paraqitet si vijon:

Të dhënat në lekë

Llogaria	Zërat/ postet e bilancit	Viti 2019	Viti 2018
A	A K T I V E T	31,202,938	31,711,298
	I.Aktivitet Afat shkurtra	31,202,938	31,711,298
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	368,929	368,929
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke		
520	Disponibilitete ne Thesar	368,929	368,929
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provizionezhvlerësimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	17,599,006	19,988,555
31	Materiale	3,638,378	4,233,271
32	Inventar I imët	13,960,628	15,755,284
33	Prodhim ne proces		
34	Produkte		
39	Provizioneperzhvlerësimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arkëtushme	13,235,003	11,353,814
411	Klientë e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	711,226	714,764
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqësi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqërore		
436	Sigurime Shëndetësore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitorë te ndryshëm		
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	12,523,777	10,639,050
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara perzhvlerësim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes të marrëdhënies me thesarin		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49...

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 368,929 lekë përfaqëson të ardhura, që janë trashëguar nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi në vlerën 273,979 lekë, si dhe gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) në vlerën 94,950 lekë.

Pika 50 e udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2019:

Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore.

Në akt rakordimin, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2018-2019 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2018 dhe 31.12.2019 reflekton vlerën 368,929lekë.

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” përbëhet nga detyrime të pambyllura nga viti 1998-2012 në vlerën 548,656 lekë dhe nga detyrime të krijuara në vitin 2016 në vlerën 56,169 lekë.

Për të gjitha këto detyrime të njohura dhe regjistruara në kontabilitet SPV ka dërguar njoftimet përkatëse pranë subjekteve/individëve në vitin 2016.

Spektori Juridik po në këtë vit ka bërë një analizë të debitorëve, ku ka përgatitur një relacionin përmbledhës mbi evidentimin, verifikim historik të lindjes së detyrimeve për çdo debitor mbështetur në dokumentacionet dhe informacionet që disponon SPV. Në relacionin e përpiluar nga sektori juridik është shprehur se SPV nuk mund të procedojë në rrugë gjyqësore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, për faktin se do të rëndohet Buxheti i shtetit me kosto, duke bërë të pamundur arkëtimin e shumës si rezultat i parashkrimit të afateve për të kërkuar të drejtën, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “ Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “ Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

Në vitet në vazhdim nga SPV nuk ka vazhduar më procesi i mbledhjes së këtyre të drejtave **Nga SPV** nuk është bërë një ndarje e debitorëve se sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa nuk janë likuiduar apo arkëtuar për faj të strukturave që duhet të merren me arkëtimin e tyre.

- Nga institucioni për vlerat mbi një vit drejtimi nuk është bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 8 “Ruajtja e dokumenteve kontabël”.

**5.Titulli i Gjetjes:
Situata:**

Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”

Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” janë kontabilizuar dhe detyrimet e krijuara:

- Për vitin 2018 në shumën prej 109,939 lekë, të cilat janë arkëtuar në vitin pasardhës.

- Për vitin 2019 në shumën prej 106,401 lekë, të cilat janë arkëtuar në vitin pasardhës.

Vlerat e pasqyruara për vitin 2018 dhe 2019 në llogarinë 429 ka të bëjë më të ardhura të konstatuara në bazë të kontratave për qiratë e ambienteve.

Shumat prej 109,939 lekë për vitin 2018 dhe shuma prej 106,401 lekë në vitin 2019 duhet të ishin kontabilizuar në momentin që janë konstatuar, duke debituar llogarinë 411 ose 468 dhe duke kredituar klasën 7. Këto të ardhura në fund te periudhës ushtrimore nuk janë arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet

detyrimi: duke Debituar llogarinë 8424 "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm" dhe duke kredituar llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".

Në momentin kur këto të ardhura arkëtohen nga subjektet bëhet veprimi kontabël duke Debituar llogarinë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe duke kredituar llogaritë 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm.

Në momentin që institucioni i kalon këto të ardhura në buxhetin bëhet veprimi kontabël duke Debituar llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" dhe duke Kredituar llogarinë 520 "Disponibilitete në thesar".

Kriteri:

Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*".

Ndikimi/Efekti:

Keq klasifikim të llogarive kontabël, por pa ndikim material në rezultatin financiar të institucionit.

Shkaku:

Mos kontabilizimi i saktë i të drejtave të konstatuara.

Rëndësia:

E ulët

Rekomandimi:

Spektori i financës të marrë masa në vijimësi, që për të ardhurat e konstatuara në bazë të akteve ligjore dhe të pa arkëtuara në fund të periudhës ushtrimore, të kontabilizohen duke debituar llogarinë 411 ose 468, dhe duke kredituar llogarinë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".

Afati i zbatimit:

Në vijimësi

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetit debitor" përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.

Për vitin 2018 në shumën 10,639,050 lekë përfaqëson detyrimet që SPV ka ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2018 përkatësisht për pagat në vlerën 5,579,816 lekë, për tatim taksa në vlerën 387,404 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,649,323 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 228,884 lekë, të cilat paguhen në Janar të vitit 2019. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 dhe 436. Si dhe fatura të pa likuiduar ndaj të tretëve gjatë vitit 2018, pra janë shpenzime të konstatuara në vitin 2018, që do të paguhen në vitin 2019, ku si kundërparti ka llogarinë 401 në shumën prej 211,314 lekë, 467 në shumën prej 2,527,463 lekë dhe llogarinë 437 në shumën prej 54,824 lekë.

Për vitin 2019 në shumën 12,523,777 lekë përfaqëson detyrimet që SPV ka ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2019 përkatësisht për pagat në vlerën 5,817,511 lekë, për tatim taksa në vlerën 425,559 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,723,036 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 239,115 lekë, të cilat paguhen në Janar të vitit 2019. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 dhe 436. Si dhe fatura të pa likuiduar ndaj të tretëve gjatë vitit 2019, pra janë shpenzime të konstatuara në vitin 2019, që janë paguar në vitin 2020 ku si kundërparti ka llogarinë 467 në shumën prej 4,286,796 lekë dhe llogarinë 437 në shumën prej 52,760 lekë.

6.Titulli i Gjetjes:

Situata:

Njohja dhe kontabilizimi i vendimet e proceseve gjyqësore

Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se, shuma totale e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë:

- në vitin 2017 në shumën prej 973,643 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2018

- në vitin 2018 në shumën prej 1,139,216 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2019 dhe 2020

- në vitin 2019 në shumën prej 1,324,270 lekë dhe janë likuiduar në vitin 2020

nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t'u shlyer.

1. Si pasojë, llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Konkretisht për vitit 2017-2020, ky zë reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare për secilin nga vitet.

2. Gjithashtu shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat në

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

3. Duke ju referuar pagesave të kryera nga SPV për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Kriteri:	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
Shkaku:	Mungesë bashkëpunimi të sektorit të financës me sektorin juridik.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me sektorin e çështjeve juridike, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit. - Sektori i Financës në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura. - Sektori juridik, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Afati i zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

b. Detyrimet e institucionit për periudhën ushtrimore 2018-2019:

Nga analiza e mësipërme konstatohet se në përgjithësi shumat e pasqyruara në bilanc në llogaritë sintetike janë kuadruar me të dhënat në mënyrë analitike të llogarisë së klasës 4. Nga 11,448,764 lekë të paraqitura në vitin 2018, ato janë rritur për 1,881,189 lekë, për vitin 2019. Në këtë kuadër, peshën më të madhe e kanë shtesat në llogarinë 467 “Kreditor të ndryshëm” që nga 2,527,483 lekë janë rritur në 4,265,796 lekë.

Të dhënat në lekë

Ilogaria	Zërat/ postet e bilancit	Viti 2019	Viti 2018
	I.Pasivët Afat shkurtër	13,329,953	11,448,764
	1. Llogari të Pagueshme	13,329,953	11,448,764
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	211,314
42	Detyrime ndaj personelit	5,817,511	5,579,818
16,17,18	Hua Afat shkurtër		
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	425,559	387,404
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime Shoqërore	1,723,036	1,649,323
436	Sigurime Shëndetësore	239,115	228,884
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	52,760	54,824
44	Institucione të tjera publike		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike		
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	94,950	94,950
467	Kreditorë të ndryshëm	4,265,796	2,527,483
4341	Operacione me shtetin(detyrime	711,226	714,764
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës. Vlera e detyrimit të mbetura pa u likuiduar është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të

drejtave dhe detyrimeve të kontatuara. Vlerat e këtyre faturave janë likuiduar me urdhër shpenzimet përkatëse, duke i kontabilizuar dhe paraqitur si detyrim dhe në të njëjtën kohë edhe si likuidim i këtij detyrimeve në llogarinë 467 “Kreditor të ndryshëm”.

Bazuar në të dhënat e kontabilitetit, janë kryer pagesat nëpërmjet thesarit, për furnitorë për blerjen e konstatuar, duke kryer veprimet kontabël: Debituar llogaria 401 “Furnitorë” dhe 467 “Kreditor të ndryshëm”, duke kredituar llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Më datën 31.12.2018, Inventari i llogarisë 401-408, llogarisë 467 “Kreditor të ndryshëm” dhe llogarisë 437 “Organizma te tjera shtetërore” në vlerën prej 2,793,621 lekë përbëhet nga subjektet furnitorë, të krijuar gjatë vitit, të cilat janë likuiduar në janar të vitit 2019, të detajuara si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera	Likuidimi
	Llogaria 467		
1	Energji elektrike (Dhjetor 2018)	677,676	USH nr 19, dt 23.01.2019
2	Ujë I pijshëm (Dhjetor 2018)	292,171	USH nr 18, dt 23.01.2019
3	N. telefon fiks (Dhjetor 2018)	3,027	USH nr 11, dt 22.01.2019
4	N. shërbim interneti (Dhjetor 2018)	30,000	USH nr 12, dt 22.01.2019
5	AGS shërbim lavanterie(Dhjetor 2018	416,085	USH nr 9, dt 22.01.2019
6	S.-Al.pastrim gjelbërimi (Dhjetor 2018)	258,543	USH nr 8, dt 22.01.2019
7	S. - AL ushqimi catering (Dhjetor 2018)	688,861	USH nr 10, dt 22.01.2019
8	D. mbetjet urbane (Dhjetor 2018)	124,975	USH nr 7, dt 22.01.2019
9	Dieta dhjetor 2018	29,500	USH nr 21, dt 24.01.2019
10	Dieta dhjetor 2018		USH nr 22, dt 24.01.2019
11	Shërbimi postar dhjetor 2018	6,645	USH nr 6, dt 22.01.2019
	Shuma	2,527,483	
	Llogaria 401-408		
1	"M" shpk medikamente	17,350	USH nr 14, dt 23.01.2019
2	"T." shpk medikamente	17,388	USH nr 15, dt 23.01.2019
3	"A." shpk medikamente	175,986	USH nr 23, dt 24.01.2019
4	"R." shpk medikamente	590	USH nr 16, dt 23.01.2019
	Shuma	211,314	
	Llogaria 437		
1	AMC dhjetor 2018	43,324	USH nr 13, dt 22.01.2019
2	Urdhri I mjekut (Dhjetor 2018)	2,800	USH nr 274, dt 5.12.2019
3	Sindikate (Dhjetor 2018)	4,300	USH nr 107, dt 16.5.2019
4	Urdhër infermieri dhjetor 2018	4,400	USH nr 273, dt 5.12.2019
	Shuma	54,824	

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Më datën 31.12.2019, Inventari i llogarisë 401-408, llogarisë 467 “Kreditor të ndryshëm” dhe llogarisë 437 “Organizma te tjerë shtetërore” në vlerën prej 4,318,556 lekë përbëhet nga subjektet furnitorë, të krijuar gjatë vitit, të cilat janë likuiduar në vitit 2020, të detajuara si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera	Likuidimi
	Llogaria 467		
1	Ujë I pijshëm (Dhjetor 2019)	1,391,310	USH nr 6, dt 22.01.2020
2	Sori -Al.pastrimgjelbërimi (Dhjetor 2019)	590,122	USH nr 7, dt 22.01.2020
3	Sori - AL ushqimi catering(Dhjetor 2019)	1,016,330	USH nr 8, dt 22.01.2020
4	Dieta dhjetor 2019	79,500	USH nr 18, dt 12.02.2020
5	Dieta dhjetor 2019		USH nr 21, dt 12.02.2020
6	Dieta dhjetor 2019		USH nr 23, dt 14.2.2020
7	Shërbimi I ruajtjes me roje private	1,188,534	USH nr 4, dt 22.01.2020
	Shuma	4,265,796	USH nr 5, dt 22.01.2020
	Llogaria 437		
1	AMC	42,460	USH nr 9, dt 22.01.2020
2	Urdhri I mjekut (Dhjetor 2019)	2,000	USH nr 322, dt 11.12.2020
3	Sindikate (Dhjetor 2019)	4,000	USH nr 88, dt 11.05.2020

4	Urdhër infermieri dhjetor 2019	4,300	USH nr 323, dt 11.12.2020
	Shuma	52,760	

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Në llogarinë 466, “Kreditorë për mjete ne ruajtje”, gjendja më datën 31.12.2018 dhe me 31.12.2019 paraqitej për 95,950 lekë, e pandryshuar nga vitet e mëparshme, e cila ka të bëjë vlerën 5 % e garancisë së kontratës së realizuar për ndërtimin e një sere diellore për prodhim lulesh që në vitin 2011, e cila sot nuk është në gjendje funksionale për faktin se kjo serë është e djegur nga shkaqet natyrore.

7. Titulli i Gjetjes:

Situata:

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”

Fondi neto në vlerën 282,080,681 lekë përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 281,806,702 lekë dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 273,979 lekë që përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës, Nga analiza e pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto rezulton një keq klasifikim të llogarive, e cilat nuk ka efekt material në pasqyrën financiar.

Në fund të periudhës ushtrimore bëhet mbyllja e gjitha llogarive e klasës 7 “Të ardhura”, duke kredituar llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 7 dhe

- mbylljen e të gjitha llogarive të klasës 6 “Shpenzime”, nëpërmjet regjistrimit me artikullin kontabël duke debituar llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, dhe kredituar llogaritë përkatëse të klasës 6.

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme, llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson tepricë kreditore, rezultatin financiar nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten, për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës, e cila në vitet 2017-2018-2019 duhet të ishte e barabartë me zero.

Shuma e mbetur prej 273,979 lekë e kontabilizuar në llogarinë 85 është e mbartur dhe e pa sistemuar që nga viti 2010 e cila ka të bëjë me një sponsorizim, të cilën institucioni e ka gjendje në Llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”. Në mbylljen e pasqyrave financiare nga institucioni në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” në zërin 7207 “Sponsorizime te brendshme (nga te trete)” vendose shumën prej 273,979 lekë si sponsorizim të periudhës ushtrimore, ku kjo shumë është konstatuar një herë si e ardhur që në vitin 2010.

Në “Pasqyrën e performancës financiare” në zërin “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” nga SPV është debituar dhe kredituar njëkohësisht.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në fund të vitit ushtrimor duhet të paraqitej me vlerën e ndryshimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, ku për vitin 2018 duhet të reflektohej në vlerën 706,305 lekë dhe për vitin 2019 duhet të reflektohej në vlerën (2,389,549) lekë.

Llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë. Për vitin 2019 duhej të paraqitej për vlerën (706,305) lekë. Në fillim të vitit ushtrimor institucioni duhet të saktësonte pozicionin e çeljes së llogarive nga vitet e mëparshme dhe të realizonte transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”.

Paraqitja e saktë e “Fondit të konsoliduar” duhet të ishte:

Llogaria	Zërat/ postet e bilancit	Viti 2019	Viti 2018
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	282,080,681	303,370,274
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	283,700,925	302,600,969
12	Rezultatet e mbartura	769,305	
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	-2,389,549	769,305
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme		

Kriteri:

UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre”, i ndryshuar dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”

Ndikimi/Efekti:	Keq klasifikim të llogarive, e cilat nuk ka efekt material në pasqyrën financiare.
Shkaku:	Ne pasqyrat financiare ndër vite është vendosur shuma prej 273,979 lekë si sponsorizim të periudhës ushtrimore në zërin 7207 “Sponsorizime te brendshme (nga te trete)”, ku kjo shumë është konstatuar një herë si e ardhur që në vitin 2010, si dhe në “Pasqyrën e performancës financiare” në zërin “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” nga SPV është debituar dhe kredituar njëkohësisht.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.
Afati i zbatimit:	Menjëherë

Inventarizimi i pronës shtetërore:

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2017-2020.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2017– 2020, çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të **paktën një herë në vit** ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

Procesi i inventarizimit të aktiveve, **për vitin 2017-2020** është kryer nga disa komisioni të ngritur sipas urdhrat të Titullarit të Institutit “Për krijimin e komisionit të inventarizimit” të ndarë në pavijone si me poshtë vijon:

Për vitin 2017

Urdhëri nr. 254, datë 06.11.2017; Urdhëri nr. 258, datë 06.11.2017; Urdhëri nr. 256, datë 06.11.2017; Urdhëri nr. 265, datë 09.11.2017

Për vitin 2018

Urdhëri nr. 310, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 311, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 312, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 313, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 314, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 315, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 316, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 318, datë 27.11.2018; Urdhëri nr. 317, datë 27.11.2018

Viti 2019

Urdhëri me nr. 239 datë 13.11.2019

Viti 2020

Urdhëri me nr. 202 datë 24.11.2020

Me Urdhër të Titullarit është ngritur “**Komisioni I Vlerësimit**” për vitet objekt auditimi si më poshtë: Urdhëri me nr. 282 datë 12.12.2017; Urdhëri me nr. 330 datë 12.12.2018; Urdhëri me nr. 257 datë 23.12.2019; Urdhëri me nr. 207 datë 22.12.2020.

Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/ përdorim, të hartojë procesverbalin përkatës, të bëjë krahasimet me librat e kontabilitetit dhe të japë mendim për diferencat që mund të lindin.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:

“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

8. Titulli i Gjetjes:

Inventarizimi i aktiveve

Situata:

Nga auditimi i dosjeve të inventarizimit rezulton se mungon procesverbali që mbahet midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, ku duhet të fiksohet numri rendor i flete hyrjes dhe flete daljeve. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material, veprime në mospërputhje me paragrafin 82 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

- Mungon një raport mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave të dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës.), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit duhet t'ia dorëzohet tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në mospërputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Titullari i institucionit, pas realizimit të procesit të inventarizimit ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se komisioni i vlerësimit pasi ka vlerësuar materialet dhe aktivet që disponon institucionit ka hartuar një procesverbal me listë bashkëngjitur, me materiale dhe aktivet, të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorim.

Konstatohet se, komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit, të cilat i ka vlerësuar për jashtë përdorim nuk ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorim, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorim të këtyre aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në kundërshtim me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Kriteri:

Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafin 82; 85/c; 102-105.

Ndikimi/Efekti:

Në evidentimin e saktë të vlerave të aktiveve dhe administrimin e tyre në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Shkaku:

Neglizhence, nga komisioni i inventarizimit të pikave të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Rëndësia:

E ulët

Rekomandimi:

- Komisioni i inventarizimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të SPV-së të marrë masa në vazhdimësi, që në fund të procesit të inventarizimit, të përpilojë një relacionin, me komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit.

- Komisioni i vlerësimit të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktive të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorim, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorim të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

Në lidhje me inventarizimin e medikamenteve të farmacisë së SPV rezultoi se ishte e përcaktuar gjendja e medikamenteve që disponon farmacia bashkëlidhur me informacionin në lidhje me skadencën.

Në lidhje me hyrjet e medikamentet në farmaci mbahej fletë hyrja e mallrave dhe Akt kolaudimi i sasive së medikamenteve të bëra hyrje, ku specifikohet dhe data e skadencës.

Për daljen e medikamenteve nga farmacia bëhej në baze të kërkesave të bëra nga Kryeinfermierët, e cila është sigluar nga Shefi i Shërbimit dhe Kryeinfermieri.

Medikamentet janë marrë sipas fletë-daljeve dhe janë regjistruar në regjistrin e barnave, gjithashtu janë regjistruar edhe shkarkimet e tyre sipas përdorimit.

Nga verifikimi i medikamenteve të cilat ishin inventar në dollapin e medikamenteve të farmacisë së SPV, rezultoi se ishin të rregullta, të gjithë medikamentet kishin etiketë, si dhe afatin e skadencës.

Nga farmacia është ndjekur praktika që bari që ka skadencën më të afërt del i pari (FEFO) dhe/ose bari i parë që ka hyrë në ambientet e ruajtjes është i pari që del jashtë (FIFO).

Pothuajse çdo muaj nga farmacisti i SPV bëhej një përmbledhëse në lidhje me medikamentet të cilat janë gjendje në magazinë dhe që kanë një qarkullim më të ngadaltë përdorimi dhe afat të afërt kadence, e cila raportohet në regjistrin e përgjithshëm kombëtar.

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet ne KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.

Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

2.6.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve).

Në zbatim të pikës 6 të Programit “Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve”, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion si më poshtë:

- 1- Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.0.2017-31.01.2021;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuar për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuar për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marre nga APP si Auditues;
- 5- Urdhër pagesat e likuidimit të kontratave të lidhura (me zgjedhje);
- 6- Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/ dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, SPV për vitin **2018** ka realizuar 18 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), nga keto janë audituar 4 procedura. Ndërkohe për procedurat e prokurimit (Mbi 800,000 lekë) SPV ka realizuar 8 procedura dhe nga këto 4 janë audituar.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, SPV për vitin **2019** ka realizuar 16 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), nga keto janë audituar 6 procedura. Ndërkohe për procedurat e prokurimit (Mbi 800,000 lekë) spv ka realizuar 5 procedura dhe nga këto 4 janë audituar.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, SPV për vitin **2020** ka realizuar 35 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), nga keto janë audituar 8 procedura. Ndërkohe për procedurat e prokurimit (Mbi 800,000 lekë) spv ka realizuar 4 procedura dhe nga këto 3 janë audituar.

Në të gjithë rastet, dosjet nuk janë të inventarizuara dhe nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e specialistes se prokurimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 83, pika 2.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit dhe sistemit elektronik të APP, SPV për vitin **2017** ka realizuar 10 procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël (ftesë për ofertë dhe blerje me vlerë nën 100,000 lekë), nga keto janë audituar 3 procedura. Ndërkohe për procedurat e prokurimit (Mbi 800,000 lekë) spv ka realizuar 6 procedura dhe nga këto 4 janë audituar.

Procedurat e audituara si me poshtë vijon:

1-Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Kite dhe Reagent”, për vitin 2017 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Kite dhe reagent”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.170 Datë30.06.2017.	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr. 132 dt. 02.06.2017 1.S. Xh. 2.R. Sh. 3.E. H.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.133. Dt02.06.2017 1.K. P. 2.K. Sh. 3.E. M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 2,148,190 lekë Loti I. 1,809,190 lekë Loti II. 339,000 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 2,124,370 lekë Loti I. 1,785,370 lekë Loti II. 339,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Loti I. 23,280 Lekë Loti II. 0
8. Data e hapjes së tenderit Loti I. 01.08.2017 Loti II. 15.06.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Loti I. 2 OE, Loti II. 2 OE b) S’kualifikuar Loti I. 1 OE, Loti II. 1 OE c) Kualifikuar Loti I. 1 OE; Loti II. 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka;	12. Përgjigje Ankesës AK ndryshuar DST për Lotin I.	13.Përgjigje S’ka
b. Zbatimi i Kontratës së Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Loti I, Nr. Nr.38 me Nr. 779/1 Prot. datë 16.08.2017 Loti II, Nr.34 me Nr. 603/12 Prot. datë 25.07.2017	15. Vlera e kontratës (me TVSH). Loti I. 2,142,444 lekë Loti II. 406,800 lekë	16. Likuiduar deri më datën 31.12.2017 Loti I. 2,142,444 lekë Loti II. 406,800 lekë
17. Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi	18.Afati i kontratës: Loti I. 31.12.2017 Loti II. 31.12.2017	19.Zgjatja e kontratës S’ka

1. Llogaritja e fondit limit është hartuar në bazë të Urdhrit Nr.115 datë 18.05.2017 me përbërje K. Xh., R. Sh. dhe E. B., dhe me Proces Verbalin nr.579 prot. datë 30.05.2017 i cili është në shumën 2,148,190 lekë pa TVSH nga këto, Loti I. 1,809,190 lekë pa TVSH dhe Loti II. 339,000 lekë pa TVSH.
2. Procesverbali i hartimit të kritereve të veçanta nr.779/1 datë 30.06.2017, nga anëtarët e NJHD.
3. Formulari i njoftimit të kontratës me shkresën nr.603/2 prot, datë 202.06.2017.

4. Formular ankese nr.2 prot. datë 02.03.2020.
5. Njoftim për anulimin e tenderit Loti 1 nr.603/9 prot, datë 28.06.2017 se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhen me kriteret e përcaktuara në DST.
6. Urdhër Nr. 176 datë 06.07.2017 për pezullimin e procedurës së prokurimit.
7. Urdhër Nr. 186 datë 25.07.2017 për c pezullimin e procedurës së prokurimit Loti I.
8. Raport përmbledhës nr.779/3 prot. datë14.08.2020 për Lotin I dhe nr.603/7 prot. datë 27.06.2017 për Lotin II.
9. Formular i njoftim fituesi me nr. 603/8 datë28.06.2017 për Lotin II dhe nr.779/4 datë 14.08.2017.
10. Kontrata me OE fitues “G.” shpk Nr.34. datë25.07.2017 me vlerë 339,000lekë pa TVSH dhe vlera 406,800 lekë me TVSH.
11. Kontrata me OE fitues “B. A. D.” me Nr.38 datë 16.08.2017 me vlerë 1,785,370 lekë pa TVSH dhe vlera 2,142,444 lekë me TVSH.

Zhvillimi i procedurës.

Me Urdhër nr.176, datë06.07.2017, procedura e prokurimit është pezulluar dhe shtyrë afati i dorëzimit të ofertave deri në ndryshimin e DST pasi një nga OE ka bërë ankesë se certifikatat ISO të kërkuara në DST nuk janë në fuqi.

Me procesverbalin datë 01.08.2017 për Lotin I, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Me procesverbalin nr.603/6 datë15.06.2017 për Lotin II, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Vlerësimi dhe klasifikimi i ofertave ekonomike, për të dy lotët si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
Loti I			
1	“B. A. D.”	1,785,370	Kualifikuar.
2	“K.” shpk		S’Kualifikuar pasi ka patur mangësi në DST dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
Loti II			
1	“G.”	339,000	Kualifikuar.
2	“K.” shpk		S’Kualifikuar pasi ka patur mangësi në DST dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Për Lotin I, KVO ka hartuar Raportin përmbledhës nr.779/3 prot. Datë 14.08.202, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Titullari i AK për Lotin I, më datë 14.08.2017 ka shpallur fituese ofertën e OE “B. A. D.” me të cilën është lidhur kontrata Nr.38 datë 16.08.2017 me vlerë 1,785,370 lekë pa TVSH dhe vlera 2,142,444 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes deri 31.12.2017. Për Lotin II, KVO ka hartuar Raportin përmbledhës, nr.603/7 prot. datë 27.06.2017, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Titullari i AK për Lotin II, më datë28.08.2017 ka shpallur fituese ofertën e OE “G.” Shpk me të cilën është lidhur kontrata Nr.34. datë 25.07.2017 me vlerë 339,000 lekë pa TVSH dhe vlera 406,800 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes deri 31.12.2017.

Konkluzion

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e tenderimit, kërkesë për propozim, me objekt “*Kite dhe Reagent*” me fond limit 2,148,190lekë pa TVSH e ndarënë dy Lote, dhe kontrata të lidhura, Loti I: Kontrata Nr.38 datë 16.08.2017 me vlerë1,785,370 lekë pa TVSH me OE “B. A. D.” dhe Loti II: Kontrata Nr.34. datë 25.07.2017

me vlerë 339,000 lekë pa TVSH me OE "G." ku afati i zbatimit të kontratave është 31.12.2017konstatohet se:

- Në urdhrin Nr.133 datë 02.06.2017për ngritjen e KVO nuk ështëpërcaktuar kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58 ku thuhet:

Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit

- Llogaritja e fondit limit është argumentuar me proces verbalin Nr.579prot. datë 30.5.2017 ku janë marrë tre oferta nga tregu dhe është përzgjedhur oferta më e vogël. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se objekti i aktivitetit të operatorëve ekonomik "TISA Albania" me NIPT L52206079Q dhe "TIS Solution" me NIPT L11815023N nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Për sa më sipër ështënë kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku thuhet:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) K. Ll. me detyrë, ish-Drejtor i në cilësinë e Titullarit të Autoriteti Kontraktor.
- 2) K. Xh. në cilësinë e anëtares të komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.115,datë18.05.2017.
- 3) R. Sh. në cilësinë e anëtares tëkomisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.115, datë 18.05.2017.
- 4) E. B. në cilësinë e anëtarit tëkomisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.115, datë 18.05.2017.

2-Procedurës së prokurimit "E hapur"me objekt: "Rojet Private", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rojet Private"		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1770 Dt 28.12.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.1746 , dt. 22.12.2017 1.Z. S. Xh. 2.Znj. R. B. 3.Znj. E. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.1772 Dt. 28.12.2017 1.Znj.M. C. 2. znj.Sh. Z. 3.znj.K. Xh.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit E hapur.		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 32,299.978 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 32,296.631 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3.347 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 22/01/2018	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 2 OE b) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqeria "J. Z." shpk

11.Ankimime AK -Nr.340/1 prot 29.12.2017, Nr.2 prot date 03.1.2018, nr.3 prot date 03.01.2018, nr.4 prot date 03.01.2018. APP-ska; KPP - Nr.74 prot date 11.01.2018	12. Përgjigje Ankesës Nr.45 prot date 08.01.2018. Nr.46 prot date 08.01.2018. Nr.47 prot date 08.01.2018.	13.Përgjigje
--	---	---------------------

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit" me urdhër Nr.1754 prot. datë 26.12.2017.

Me shkresë nr.1764 prot datë 27.12.2017 është argumentuar fondi limit dhe cmimet janë marë në baze të ligjit nr.75/2014 "Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike", me vendimin nr.399 date 03.05.2017 për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi. Komisioni për nevojat e SPV ka llogaritur që i nevojiten 3 vend roje 24 orë sherbim dhe një vend roje me sherbim turnin e dyte dhe të tretë. Në bazë të rekomandimeve të APP me nr.15166 prot dhe nga KPP me nr.1858 prot date 20.12.2017 ku një vend roje llogaritet me koeficient zëvendësimi 1.66 punonjes për turn dhe rezulton se për sherbim 3 turne nevoiten 4.98 roje. 3 vend roje * 4.98 roje = 14.94, ndërsa 1 vend roje (po me 2 turne) * 1.6 = 3.2 roje. Në total SPV i duhen 14.94+3.2=18.18 roje. Fondi limit i llogaritur për një vit është 10,766.659 leke pa tvsh. Ndërsa për marveshjen kuader 36 muaj është 32,299.978 leke pa tvsh.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST:

Me nr.1770/1 prot datë 28.12.2017 është bërë argumentimi i kriterëve të vecanta. Ndërsa me nr.1770/2 prot date 28.12.2017 është formulari i njoftimit të kontratës.

Pas publikuar në SPE me nr.1770/2 date 28.12.2017, pranë AK kanë ardhur disa ankesa nga OE lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT.

AK ka pezulluar procedurën dhe me datë 08.01.2018 i ka kthyer përgjigje OE, ku disa nga ankesat e tyre do të meren në konsiderat dhe do të reflektohen në DT.

Me date 12.01.2018 pranë KPP kanë ardhur 2 ankesa të bëra nga 2 OE dhe KPP vendosi të pezullohet procedura deri në shqyrtimin e ankesave.

Në datë 14.02.2018 pranë AK ka ardhur vendimi i marë nga KPP në lidhje me ankesat e ardhura nga OE, disa nga ankesat i ka marë në konsiderat dhe i drejtohet AK të ndyshojë ato në DST.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.319/7 prot datë 05.03.2018 është mbajtur procesverbali i hapjes së procedurës ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"A. S."	32,299.631	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit. Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit sipas DST dhe konkretisht: A. & B. 1-Sipas kapacitetit ekonomik ,pika V, Bashkimi i OE nuk plotëson nr e rojeve që ofrojnë sherbimin sipas përqindjes në kontratën e bashkëpunimit.OE "A. S." ka vetëm pesë roje sipas kriterit(gjashtë roje duhet sipas kontratës së bashkëpunimit).OE "B. -KO" ka vetëm tetë punonjes sipas kriterit (11 roje duhet sipas kontratës së bashkëpunimit).
2	"M. S. "	32,299.620	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit sipas DST dhe konkretisht: 1-Sipas kapacitetit teknik , pika V .OE ka vetëm 10 roje sipas kriterit(nga 18 që kërkohen). 2-Sipas kapacitetit teknik ,pika kater OE nuk ka të specifikuar në performancën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë përgjegjësin e sherbimit dhe grupin e gatshëm 3-Sipas kapacitetit teknik,pika 2, për vërtetimin e qendrës së kontrollit nuk ka dokument pronesie /qeraje të vendit /selise ku ushtron aktivitetin OE.
3	"N. 2000"	32,299.620	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit sipas DST dhe konkretisht: 1-Sipas kapacitetit teknik ,pika V .OE " ka vetëm 7 roje sipas kriterit(nga 18 që kërkohen).

4	“S. S.”	32,298.173	Kualifikuar.
5	“S. S. S.”	32,296.631	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Me nr.516 prot datë 09.03.2018 KVO i drejtohet NJHDT për sqarim, në dt në piken 3.3/4 Vërtetim/Preformance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlore, leshuar ne vitin 2017, ku te sqarohen te dhenat e meposhtme.

Me nr.516/1 NHDT sqaron se duke qenë se DST janë hedhur në SPE në dhjetor të vitit 2017, vërtetimi i përformacës të marët në fillim të vitit 2018, për të pasur informacion sa më të mirë. Me date 10.04.2018 pranë KPP ka ardhur një ankesa e bërë nga OE dhe KPP vendosi te pezulloj proceduren deri ne shqyrtimin e ankesave.

Me date 11.06.2018 pranë AK ka ardhur vendimi i mare nga KPP në lidhje me ankesën e ardhura, dhe ankesa nuk eshte mare në konsiderate nga KPP, ku i drejtohet AK të vashdojë procedurën.

Me nr 319/10 date 25.06.2018 është mbajtur raporti përmbledhës drejtuar titullarit të AK dhe nga ku njoftohet së kualifikim i 2 OE, dhe skualifikimite I 3 OE me arsyet perkatese.

Me nr.319/11 eshte bere njoftimi i OE fitues me oferte më të ulet.

Nderkohë me nr.319/14 datë 09.07.2018 është lidhur marveshja kuader për 36 muaj midis BOE ”S. S.” dhe ”A.-Pol-1” dhe titullarit te AK.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës së sipër përmëndur konstatohet se procedura është ne përputhje me kuadrin ligjor.

3-Procedurës së prokurimit “Kerkes per propozim” me objekt: ”Evadimi i mbetjeve urbane”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ”Evadimi i mbetjeve urbane ”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.130. Dt. 17.02.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.82, dt. 30.01.2017	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.84. Dt. 30.01.2017
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkes per propozim	1. Z.S. Xh. 2. Znj.R. Sh. 3. Znj.E. M.	1.Z.V. N. 2.Z. E. B. 3.Znj.E. P.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 981,611 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 970,601 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 11,010 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 02/03/2017	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës ne tender I OE b) Shpallur Fitues Firma “D.” shpk
11.Ankimime AK-ska; APP-ska; KPP-ska	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundesuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit me urdhër datë Nr.83 prot, date 30.01.2017.

Me shkresë date 14.02.2018 komisioni i argumentimit të fondit limit shprehet: për cmimet është bazuar nga kontrata e ngjashme e vitit 2016.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST:

Me shkres nr.130/1 prot datë 17.02.2017 është bërë argumentimi i kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Zhvillimi i Procedures.

Komisioni i vlersimit te ofertave pasi ka shqyrtuar dokumentat e sjell nga OE ”D.” vendosi ta shpall fitues.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	“D.” shpk	970,601	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje te parashikuara	kg	14,259.6	54.5	777148
2	Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m ²)	m ²	12,240	8.1	99144
3	Disifektim per 2 pika (1*2)	dite	122.4	154.1	94304
Totali pa TVSH					970,601

Me nr.130/3 prot datë 15.03.2017 është mbajtur Raporti Permbledhes ku tregohet procedura e kryer nga anetarët e njhdt dhe kvo.

Me nr.130/6 datë 17.03.2017 është firmosur kontrata midis OE “D.” shpk dhe AK.

Komisioni i mbikqyrjes se kontrates eshte ngritur me nr.225 prot date 21.03.2017.

Konkluzionet Nga auditimi i procedurës për pikën 2 “Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilen operon Operatori Ekonomik “S. Al”, me kontrat shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brëndshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit spikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithë siperfaqen e rrugeve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugeve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.*

Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me cfare do te kryet disifektimi (lende, produkti ose solucioni).

Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjme me një **dëm ekonomik me vlerë 232,143.60** me tvsh.

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre janë: ish-Titullari i AK, z. K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projket-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: bazuar pretendimit tuaj se Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata 5 vjecare me nr.4558 prot., e lidhur me date 31.10.2014 e firmes se pastrimit “D.” Shpk me Bashkine Vlore, Spitali Psikiatrik i eshte drejtuar Bashkise Vlore me kerkesen nr.577 Prot., date 30.05.2017 dhe me shkresa në vazhdimësi me shkresën nr.742 prot., datë 15.04.2020 ku i është kthyer përgjigje me shkresën nr.741/1 prot., datë 29.04.2020, per te sqaruar përsëri nese Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata nr.4558 prot., date 31.10.2014. Nga pergjigjjet e kthjera sqarojme se kjo kontrate nuk e mbulon Evadimin e mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik te Vlores.

Vërtetë bashkia Vlorë në kontratën e saj ka mbulimin e rrugës “Ibrahim Avdullhu”, rrugë në të cilën është vendndodhja e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë por Bashkia nuk ka kontratë për heqjen e mbetjeve urbane brenda teritorit të SPV.

Për këtë rekomandim është njoftuar Operatori Ekonomik “D.” shpk me shkresën me nr.1505 prot., datë 20.09.2021 në lidhje me kontratën me objekt “Evadimi mbetjeve urbane”, i cili i është përgjigjur Autoriteti Kontraktor mbi rekomandimet e lëna, me shkresën e ardhur në institucion me nr.1505/1., datë 06.10.2021. *(Bashkëlidhur kthim përgjigje)*

Gjithashtu sqarojmë se në kontratën e shërbimit të pastrimit të brendshëm detyrimet e shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm janë heqja e mbetjeve nga pavionet apo ambienti i jashtëm dhe grumbullimi nëpër vendet përkatëse, por nuk ka për detyrë heqjen e mbetjeve nga territori SPV.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Argumentimet tuaja qëndrojnë pjesërisht për pikën e parë (mbetje te parashikuara) e për pasojë merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Ndërsa per pikën e 2 Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m²) dhe pikën 3 Disifektim per 2 pika (1*2) nuk meret parasysh pasi janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në

Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik "S.AL", me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016.

Për sa i përket fshirjes ku gjenden koshat OE "S. Al" ka për detyrë në bazë të kontratës të pastrojnë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlore ku citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përçarkë godinave (Objekt ndërtimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë.*

Për sa i përket grumbullimit të heqjes së mbetjeve nga firma e pastrimit "S. Al" në kontratë citohet: *Grumbullimi i mbeturinave behet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimit e plehrave behet çdo ditë, transporti behet me kosha të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapak.*

Për dezinfektimin të pikave ku grumbullohen mbetjet urbane theksojmë se tek specifikimet nuk është përcaktuar se me çfarë do të dizinfektohet (lënd, produkt etj) dhe OE "S. AL" në bazë kontratës kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00.

Obesvacioni merit pjeserisht në konsiderat.

4-Procedurës së prokurimit "Kerkese për propozim" me objekt: "Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave"		
1.Urdhër Prokurimi Nr.594. Dt 01.06.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.602, dt. 02.06.2017	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.653. Dt. 08.06.2017
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese për propozim.	1. Z.S. Xh. 2. Znj.R. Sh. 3. Znj.E. M.	1.Znj. S. N. (kryetare) 2.Znj. Sh. Z. (anetare) 3.Z. E. B. (anetare)
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,530.400 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 1,440.100lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 90.30 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 22/06/2017	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S'kualifikuar 2 OE c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues Firma "J. Z." shpk
11.Ankimime AK-ska; APP-ska; KPP-ska	12. Përgjigje e Ankesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit me urdhër nr.473 prot datë 17.05.2017.

Me shkresën nr.513 prot datë 23.05.2017 komisioni për argumentimit e fondit limit për çmimet ka marrë 3 oferta në treg dhe duke u bazuar tek çmimi më i ulët ka llogaritur fondin limit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST:

Me shkresën nr.594/1 datë 09.06.2017 është bërë argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Nga NjHD në DST "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2. Kapaciteti teknik: Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar si më poshtë. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e kërkuar për:

c.Certifikatë ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

ç.Certifikatë ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit të mjedisit.

d.Certifikatë OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të cilësisë në punë.

e.Certifikatë PAS 99:2012 për sistemin e integruar.

Konkluzionet: Sqarojmë se certifikata ISO 9001-2008, e cila gjë referim në llojin e objektit të prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit të mjedisit,

18001:2007 për sistemin e menaxhimit të cilësisë në punë dhe PAS 99:2012 për sistemin e integruar, nuk gjejnë aspak referim, për sa kohe që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, por i shërben vetë subjektit ofertues, për vet OE për realizimin sa më të mirë të proceseve të tij të punës. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet ligjore nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punëpublike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktore":

Gjithashtu në përbërje të komisionit nuk ka person përgjegjës grupi dhe veprimet janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre anetaret e NJHDT z.S. Xh., Znj.R. Sh., Znj.E. M. dhe ish Titullari i AK z.K. Ll.

Zhvillimi i Procedurës.

Me nr.594/6 prot date 22.06.2017 është mbajtur proces verbali i hapjes së ofertave ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"C. C"	1,377.660	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit. Nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit sipa DST dhe konkretisht: 1-Vertetimi i realizimit të kontratës si dhe faturat tatimore të shitjes janë fotokopje e pa noterizuar.
2	"C."	1,448.100	Kualifikuar.
3	"J. Z."	1,440.100	Kualifikuar dhe spallur fitues.
4	"S. C."	1,244.000	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit sipa DST dhe konkretisht: 1-Tek deklarata e konfliktit të interesit data e zhvillimit të tenderit nuk është në përputhje me DST. 2-Sherbimet e ngjashme nuk përputhen me objektin që prokurohet. 3-Mungojnë listet pagesat e sig -shoqerore për muajt janar 2016-mars 2017.

Me shkresën nr.594/7 date 06.07.2017 është mbajtur raporti përfundimtar nga ku komisioni shprehet se mbas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitura nga 4 OE vendosi të skualifikojë 2 OE.

Me nr.594/8 date 26.07.2017 është bërë njoftimi i fituesit i cili është OE "J. Z. " me ofertë me të ulët. Ndërkohe me nr.594/11 date 31.07.2017 është lidhur kontrate midis OE "J. Z. " dhe AK.

Me urdhër nr.1004 prot datë 31.07.2017 është ngritur komisioni i mbikëqyrjes së kontratës.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës konstatojmë se KVO ka skualifikuar OE "C. C." me arsye se nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit sipas DST dhe konkretisht: (Vërtetimi i realizimit të kontratës si dhe faturat tatimore të shitjes janë fotokopje e pa noterizuar.)

Nga dokumentat e hedhura në sistemin e APP nga OE "C." konstatohet se faturat tatimore janë fotokopje dhe Vertetimi i realizimit të kontratës me një ent publik është origjinal. OE ka paraqitur një kontratë punë e lidhur me nr.2738 prot date 20.12.2016 midis BOE "C." SHPK dhe Ministria e Integritimit Europian. Faturat tatimore që janë hedhur në sistemin janë punimet e

realizuara nga OE "C. C." me "Ministria e Integrimit European". Kvo nuk duhet të skualifikonte OE pasi ai ka pariqitur vertetim të realizimit nga nje ent publik. Por duhet të kërkonte sqarimi OE ne lidhje me vertetimin e kontrate dhe faturat tatimore te hedhura ne sistem nga OE "C." Gjithashtu duhet të kërkonte informacion OE mbi ndarjen e punimeve në kontratën e paraqitur me një ent publik Ministria e Integrimit European pasi është bashkim OE dhe sasia e punimeve do të vertetonte shërbimet e ngjashme dhe kapacitetet e tij. *Veprimet janë ne kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3. Ku citohet: "Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal". Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 53 pika 1 ku citon: "Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme".*

Referuar me siper OE "J. Z." ofertuesi i shpallur fituese dhe skualifikimi i OE "C.C." me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 74,928 leke me tvsh**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimr pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55.

Ngarkohet me përgjegjësi anetare e KVO: Znj.S. N., z. E. B. dhe ish titullari i AK z.K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: *Ne lidhje me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST :kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2 sqarojme duke mos patur nje specialist te mirefillt ne NJHDT kemi menduar se Certifikatat ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit të mjedisit ,18001:2007 për sistemin e menaxhimit të cilësisë në punë dhe Pass 99:2012 për sistemin e integruar i menduam si shume të domosdoshme për shërbimin që OE do të kryente në AK. Këto certifikata vertetojne se OE do të ishte me i kualifikuar dhe shërbimi do të ishte me efektive .*

Kurse pjëstari i KVO për vitin 2017 Sh. Z. sqaron si me poshte:

Zhvillimi i procedures. Bazuar raportit permbledhes me nr 594/7dt 06.07.2017 si anetare e KVO ne ndryshim nga dy anetaret e tjere kam skualifikuar te gjithe operatoret pjesemarres ne kete procedure .Per sa i perket skualifikimit te OE "C."shpk ne kontraten e paraqitur si BOE "C."shpk dhe Ministria e Integrimit European "nuk percaktohet sasia e punimeve te kryera nga OE "C."shpk operator pjesemares ne konkurim. Kjo sasi punimesh do te vertetonte shërbimet e ngjashme te ketij OE duke dhene siguri per kapacitetet e tij. Ne keto kushte kam s'kualifikuar OE.

Vleresimi im per moskualifikimin e OE "C."shpk nuk ndikon ne kualifikimin perfundimtar te fituesit ne sistem.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Sqarojmë se certifikatat ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit të mjedisit, 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të cilësisë ne pune dhe PAS 99:2012 për sistemin e integruar, nuk gjejnë aspak referim, për sa kohe që nuk i shërben AK përshërbimin që kërkon të marrë, por i shërbejnë vete subjektit ofertues, për vetë OE për realizimin sa me mire te proceseve te tij te punës.*

Ne rastin kur KVO nuk ka pasur informacion lidhur me sasin e puneve te kryera nga OE "C."shpk ne kontrate e hedhur ne sistem nga OE, KVO duhet ti kerkonte sqarim OE sipas Vendim Nr.914, datë 29.12.2014, I Ndryshuar neni 66 pika 3 citon: Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Obesvacioni juaj meret në konsiderat pjesërisht.

5-Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: " Blerje Kite dhe Reagent", për vitin 2018 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “ BlerjeKite dhe reagent”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.12 Datë 29.03.2018.	3.Hartuesit e Dokumente vetë Tenderit Urdhër Nr. 97, dt. 29.03.2018. 1. S. Xh. 2. R. B. 3. E. H.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.98. Dt 29.03.2018 1. E. B. 2. L. M. 3. K. Sh.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 925,100 lekë Loti I. 758,300 lekë Loti II. 166,800 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) Loti I. 753,900 lekë Loti II. 166,720 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Loti I. 4,400 Lekë Loti II. 80 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Loti I. 11.04.2018 Loti II. 10.04.2028	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Loti I. 2 OE, Loti II. 2 OE b)S’kualifikuar Loti I. 1 OE, c) Kualifikuar Loti I. 1 OE Loti II. 2 OE b)S’kualifikuar Loti I. 1 OE, c) Kualifikuar Loti I. 1 OE
11.Ankimime AK-ka; për DST Loti I , para hapjes së tenderit. APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës AK ndryshuar DST për Lotin I.	13.Përgjigje S’ka
b. Zbatimi i Kontratës së Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Loti I, Nr. Nr.11 me Nr. 632/21Prot. datë 16.05.2018 Loti II, Nr.10 me Nr. 632/20 Prot. datë 16.05.2018	15. Vlera e kontratës (me TVSH). Loti I. 904,680 lekë Loti II. 200,064 lekë	16. Likuiduar deri: Loti I+II më datën 31.12 2018 1,104,400 lekë
17. Situacioni Përfundimtar/FaturëMalli/Shërbimi datë 06.11.2018 Vlera me tvsh 1,104,400 lekë	18.Afati i kontratës: Loti I. 31.12.2018 Loti II. 31.12.2018	19.Zgjatja e kontratës S’ka

- 1.Llogaritja e fondit limit është hartuar në bazë të Urdhrit Nr.94 datë 28.03.2018 me përbërje E. M., R. B. dhe K. P., sipas kërkesës të Degës së Hotelerisë nr.610prot. datë 27.03.2018. Vlera e fondit limit është sipas procesverbalit nr. 620 prot. datë 28.03.2018 është në shumën 925,100 lekë pa TVSH nga këto, Loti I. 758,300 lekë pa TVSH dhe Loti II. 166,800 lekë pa TVSH.
- 2.Procesverbali i hartimit të kriterëve të veçantanr.632/1prot, datë 29.03.2018, nga anëtarët e NJHD.
3. Formular i njoftimit të kontratës me shkresën nr.632/2prot, datë 29.03.2018 për Lotin I dhe II.
4. Formular ankese nr.673 prot. datë 06.04.2018.
5. Urdhër nr.106 me nr.674prot. datë 06.04.2018 për modifikimin e kriterëve të veçanta për Lotin I.
6. Shkresë për ndryshimin e DST, nr.632/3prot, datë 06.04.2018
7. Procesverbali i KVO nr.632/11 prot, datë 11.04.2018 i hapjes së procedurës për Lotin I nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 2 OE.
8. Raport përmbledhës nr.632/14 prot, datë 25.04.2018 për Lotin I.
9. Formular i njoftim fituesi me nr.632/15 prot, datë 25.04.2018 për Lotin I.
10. Kontrata me OE fitues “B. A. D.” shpk, Nr.11 me nr.632/21prot. datë 16.05.2018 me vlerë 753,900 lekë pa TVSH dhe vlerë904,680 lekë me TVSH.

11. Procesverbali i KVO nr.632/7 prot, datë 10.04.2018 i hapjes së procedurës për Lotin II nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 2 OE.
12. Raporti përmbledhës nr.632/12 datë19.04.2018, për Lotin II.
13. Formular i njoftim fituesi me nr.632/13 datë19.04.2018, për Lotin II.
14. Kontrata me OE fitues “G.” shpk, Nr.10 me nr.632/20 prot. datë 16.05.2018 me vlerë 166,720 lekë pa TVSH dhe vlerë 200,064 lekë me TVSH.

Zhvillimi i procedurës.

Sipas urdhrin nr.106, datë 06.04.2018, data e hapjes së ofertave për Lot I është ndryshuar dhe është vendosur data 11.04.2018 me arsyen se një OE ka kërkuar ndryshimine DST konkretishtcertifikate konformiteti CE sipas direktivës 93/42/EEC nuk është për produktet e listuara në DST. Me procesverbalin nr.632/7 datë10.04.2018 për Lotin II, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Me procesverbalin nr.632/11 datë11.04.2018 për Lotin I, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Vlerësimi dhe klasifikimi i ofertave ekonomike, për të dy lotët si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
Loti I			
1	“B. A. D.”	753,900	Kualifikuar.
2	“K.” shpk	370,670	S’Kualifikuar pasi produkti DG-38876 SP Boitecuvettes 150x4 mungon në katalogët ë paraqitur dhe certifikata përkatëse dhe oferta e operatorit është minimalisht e ulët.
Loti II			
1	“G.”	166,720	Kualifikuar.
2	“K.” shpk	Pa ofertë	S’kualifikohet pasi ka mungesë të theksuar dokumentacioni sipas DST dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Për Lotin I, KVO ka hartuar Raportin përmbledhës Nr.632/14 datë 25.04.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar 1 OE.

Për Lotin II, KVO ka hartuar Raporti përmbledhës Nr.632/12 datë 19.04.2018, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s’kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar 1 OE.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK për Lotin I, më datë 25.04.2018 ka shpallur fituese ofertën e OE “B. A. D.” me të cilën është lidhur kontrata Nr. 11 datë 16.05.2018 me vlerë 753,900 lekë pa TVSH dhe vlera 904,680 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes së kontratës deri 31.12.2018.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK për Lotin II, më datë 25.04.2018 ka shpallur fituese ofertën e OE “G.” shpk me të cilën është lidhur kontrata Nr. 10 datë 16.05.2018 me vlerë 166,720 lekë pa TVSH dhe vlera 204,064 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes së kontratës deri 31.12.2018.

Konkluzion

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e tenderimit, kërkesa për propozim, me objekt “Kite dhe Reagent” me fond limit 925,100 lekë pa TVSH e ndarë në dy Lote, dhe kontrata të lidhura, Loti I: Kontrata Nr.11, datë16.05.2018 me vlerë753,900 lekë pa TVSH ose 904,680 lekë me TVSH me OE “B. A. D.” dhe Loti II: Kontrata Nr. 10 datë16.05.2018 me vlerë166,720 lekë pa TVSH ose 200,064 lekë me TVSH, me OE “G.” ku afati i zbatimit të kontratave janë nga data e lidhjes deri më 31.12.2020 konstatohet se:
 - Në urdhrin nr.98 datë29.03.2018 për ngritjen e KVO nuk është përcaktuar kryetari i komisionit kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58 ku thuhet:

Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit

- Llogaritja e fondit limit është argumentuar me proces verbalin Nr.290prot. datë 11.02.2020 ku janë marrë tre oferta nga tregu dhe është përzgjedhur oferta më e vogël. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se objekti i aktivitetit të operatorëve ekonomik “TISA Albania” me NIPT L52206079Q dhe “TIS Solucion” me NIPT L11815023N nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku thuhet:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënljore të bëra në:

- 15. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,
- 16. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 5) K. Ll. me detyrë, ish Drejtor në cilësinë e Titullarit të AK.
- 6) E. M. në cilësinë e anëtares së komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.94,datë 28.03.2018.
- 7) R. B. në cilësinë e anëtares së komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.94, datë 28.03.2018.
- 8) K. P., në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.94, datë 28.03.2018.

6.-Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “Mbetjet Urbane”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Mbetjet Urbane”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.377 Datë 22.02.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per propozim.	Urdhër Nr.375 , dt. 21.02.2018 1.Z. S. Xh. 2.Znj. R. B. 3.Znj. E. M.	Urdhër Nr.378 Dt. 22.02.2018 1.Z.A. L. 2. znj.K. Xh. 3.znj.M. C.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 987,278 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 976,262 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 11,016 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.02.2018	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 1 OE b) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqeria “D.” shpk
11.Ankimime AK-ska;APP-ska; KPP-ska	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit" me procesverbal date nr.357 prot datë 20.02.2018.

Me shkresë nr.374 prot datë 21.02.2018 është argumentuar fondi limit dhe cmimi është marë nga kontrata e ngjashme që ka patur vitin e shkuar, ndersa për mbetjet e parashikuara kanë marë për baze si me posht:

1. "Mbetjet të parashikuara" nga realizimi i kontrates se vitit 2017 (17,000kg mbetje ne vit / 365 dite = 47.6 kg mbetje ne dite)
2. " Siperfaqe fshirese per 2 pika nga 20m (2*20m²)"
3. " Disinfektim per 2 pika (1*2) "

Për pikën 2 dhe 3 është llogaritur sipas siperfaqeve në funksion për mbajtjen e konteinerve të mbetjeve urbane të cilat janë 20m ne nje pik dhe do te pastrohen 2 herë në ditë dhe do të dizinfektohet 1 herë në ditë.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST:

Me nr.377/2 prot datë 22.02.2018 është bërë argumentimi i vendosjes se kriterëve te vecanta te kualifikimit.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.377/6 prot datë 05.03.2018 është mbajtur procesverbal i hapjes së procedurës, ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"D." shpk	976,262	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Me nr.377/7 prot datë 15.03.2018 është mbajtur raporti përmbledhës dhe KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "D."

Me nr.377/8 prot është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit i cili është OE "D." me vlerë oferte 976,262 lekë pa tvsh.

Me nr.377/11 prot datë 19.03.2018 është lidhur kontrata midis OE "D." dhe AK me afat deri nga nënshkrimi i kësaj kontrate dhe me 31.12.2018.

Me urdhër nr.562 prot date 19.03.2018 është ngritur komisioni i mbikëqyrjes se kontratës.

Shtojca 1 formulari i ofertës ekonomike

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje te parashikuara	kg	14,565.60	54	786,542
2	Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m ²)	m ²	12,240	8	97,920
3	Disinfektim per 2 pika (1*2)	dite	612	154	97,800
Totali pa TVSH					976,262

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës për pikën 2 "Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)" dhe pikën 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik "S. Al", me kontrat shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit spikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithë siperfaqen e rrugëve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.*

Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me çfare do te kryet disinfektimi (lende, produkti ose solucioni).

Për mbivendosjet e mësipërme kemi të bëjme me një **dëm ekonomik me vlerë 234,864** me tvsh.

Personat pergjegjes per veprimet ose mos veprimet e tyre: Ish titullari i AK z.K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projeket-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: bazuar pretendimit tuaj se Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata 5 vjecare me nr.4558 prot., e lidhur me date 31.10.2014 e firmes se pastrimit “D.” Shpk me Bashkine Vlore, Spitali Psikiatrik i eshte drejtuar Bashkise Vlore me kerkesen nr.577 Prot., date 30.05.2017 dhe me shkresa në vazhdimësi me shkresën nr.742 prot., datë 15.04.2020 ku i është kthyer përgjigje me shkresën nr.741/1 prot., datë 29.04.2020, per te sqaruar përsëri nese Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata nr.4558 prot., date 31.10.2014. Nga pergjigjet e kthjera sqarojme se kjo kontrate nuk e mbulon Evadimin e mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik te Vlores.

Vërtetë bashkia Vlorë në kontratën e saj ka mbulimin e rrugës “Ibrahim Avdullhu”, rrugë në të cilën është vendndodhja e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë por Bashkia nuk ka kontratë për heqjen e mbetjeve urbane brenda teritorit të SPV.

Për këtë rekomandim është njoftuar Operatori Ekonomik “D.” shpk me shkresën me nr.1505 prot., datë 20.09.2021 në lidhje me kontratën me objekt “Evadimi mbetjeve urbane”, i cili i është përgjigjur Autoriteti Kontraktor mbi rekomandimet e lëna, me shkresën e ardhur në institucion me nr.1505/1., datë 06.10.2021 (Bashkëlidhur kthim përgjigje)

Gjithashtu sqarojmë se në kontratën e shërbimit të pastrimit të brendshëm detyrimet e shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm janë heqja e mbetjeve nga pavionet apo ambienti i jashtëm dhe grumbullimi nëpër vendet përkatëse, por nuk ka për detyrë heqjen e mbetjeve nga territori SPV.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Argumentimet tuaja qëndrojnë pjesërisht për piken e parë (mbetje te parashikuara) e për pasojë merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Ndërsa per pikën e 2 Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m²) dhe pikën 3 Disifektim per 2 pika (1*2) nuk meret parasysh pasi janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S.AL”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016.

Për sa i përket fshirjes ku gjenden koshat OE “S. AL” ka për detyrë në bazë të kontratës të pastrojnë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlore ku citohet: Me pastrim te jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te kuptojmë te gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e për qark godinave (Objekt ndërtimi) qe aktualisht janë ne funksion te këtij spitali. O.E do te pastroj çdo dite gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here ne dite.

Për sa i përket grumbullimit të heqjes së mbetjeve nga firma e pastrimit “S. AL” ne kontrate citohet: Grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne çdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për ne vend grumbullimin e plehrave behet çdo dite, transporti behet me kosha te mëdhenj, te posaçëm, te mbyllur me kapak.

Për dezinfektimin të pikave ku grumbullohen mbetjet urbane theksojm se tek specifikimet nuk është përcaktuar se me çfarë do të dizinfektohet (lend, produkt etj) dhe OE “S. AL” në bazë kontratës kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para orës 7:00.

Obesvacioni meret pjeserisht ne konsiderat.

7.- Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.539 Dt 15.03.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.484 , dt. 07.03.2018	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.561 Dt. 19.03.2018
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per propozim.	1.Z. S. Xh. 2.Znj. R. B. 3.Z. A. L.	1.Znj.S. N. 2. znj.E. B. 3.znj.M. C.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,285,300 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 11,269,500 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 15,800 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30/03/2018	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 2 OE b) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqëria “J. Z.” shpk
11.Ankimime AK-ka nr.539/7 date 12.04.2018	12. Përgjigje Ankesës Nr.539/8 date 16.04.2018	13.Përgjigje Nr.851 date 17.07.2018

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit" me urdher datë nr.496 prot datë 08.03.2018.

Me shkresë nr.534 prot datë 13.03.2018 është argumentuar fondi limit dhe cmimi është bazuar në realizimin e kontrates se vitit 2017.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST:

Me nr.539/1 prot datë 19.03.2018 është bërë argumentimi i kriterëve të vecanta të kualifikimit. Nga Njhd në DST "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2.3 Kapaciteti teknik: Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar si me poshte. Për plotesimin e kesaj kerkese ofertuesi duhet të paraqesë certifikaten e kerkuar për:

c.Certifikatë ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit te cilësisë.

ç.Certifikatë ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit te mjedisit.

d.Certifikatë OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit te cilësisë ne pune.

e.Certifikatë PAS 99:2012 për sistemin e integruar.

Konkluzionet: Sqarojmë se certifikata ISO 9001-2008, e cila gjen referim në llojin e objektit te prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit te mjedisit, 18001:2007 për sistemin e menaxhimit te cilësisë ne pune dhe PAS 99:2012 për sistemin e integruar, nuk gjejnë aspak referim, për sa kohe që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, por i shërben vetë subjektit ofertues, për vetë OE për realizimin sa me të mire të proceseve të tij të punës. Kriteret e mësipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur ne prokurimin publik. Mos argumentimi i kerkesave per kualifikim, jane veprime ne mosperputhje me percaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punëpublike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione te veçanta", ne te cilen percaktohet se: "Kontratat per pune, ne te cilen eshte percaktuar se: "Ne cdo rast kerkesat e mesiperme duhet te jene te argumentuara nga autoriteti kontraktore":

Gjithashtu në përbërje të komisionit nuk ka person përgjegjës grupi dhe veprimet janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre anetaret e NJHDT z.S. Xh., Znj.R. Sh., Znj.A. L. dhe ish Titullari i AK z.K. Ll.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.539/6 prot datë 03.04.2018 është mbajtur procesverbal i hapjes së procedures, ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"C." shpk	1,247,000	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit -Eshte hedh kontrate e ngjashme per vitin 2014, kur nga AK eshte kerkuar per vitet 2015-2016-2017. -Kontrata e ngjashme per vitin 2015 eshte Bashkim Operatoresh Ekonomik, nuk eshte percaktuar shperndarja e puneve dhe sherbimeve per cdo operator. -Lista bashkengjitur faturave tatimore dhe procesverbali per evidentimin e sherbimeve nuk eshte firmosur nga te dy palet por vetem nga O.E, mungon firma e AK. -Faturat tatimore jane te korigjuara.
2	"J. Z."shpk	1,269,500	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me nr.539/7 datë 12.04.2018 OE "C." shpk ka paraqitur pranë AK një ankese për arsyet e s'kualifikimit dhe me nr.539/8 date 16.04.2018 AK i ka kthyer përgjigje OE ku nuk marrë për baze arsyet e s'kualifikimit.

Me nr.539/9 datë 27.04.2018 është mbajtur raporti përmbledhës nga anëtarët e KVO ne prani te NjHD ku është shpallur fitues OE "J. Z."shpk.

Me nr.539/10 prot datë 27.04.2018 formuari i njoftimit te fituesit.

Me nr.851 prot datë 03.02.2018 është urdhëruar pezullimi i procedurës pasi ankimimit të berë nga OE "C." pranë KPP.

Me nr.1467 prot datë 19.07.2018 ka ardhur shkresa e KPP ku njofton AK se ankimimi nuk është marë parasysh pasi ka kaluar afatet e anikimit pranë KPP. Në të tilla kushte AK lejohet të vashdoje ne hapat e metejshem mbi procedure e prokurimit publik.

Me nr.539/14 datë 26.07.2018 është lidhur kontrata midis titullarit të AK dhe OE fituese "J. Z." shpk.

Mbikqyrja e kontates është ngritur me nr.1506 prot date 26.07.2018.

Konkluzionet : Nga auditimi i procedurës konstatojmë se skualifikimi i OE "C." shpk nga Kvo per pikat:

2.3. Për kapacitetin teknik:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë viteve 2015, 2016, 2017 të aktivitetit financiar shërbime të ngjashme me objektin e ketij prokurimi në vleren 40% të vlerës së fondit limit.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, kontraten me entin publik.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi i kvo mbi skualifikimin:

-Eshte hedh kontrate e ngjashme per vitin 2014, kur nga AK eshte kerkuar per vitet 2015-2016-2017.

-Kontrata e ngjashme per vitin 2015 eshte Bashkim Operatoresh Ekonomik, nuk eshte percaktuar shperndarja e puneve dhe sherbimeve per cdo operator.

-Lista bashkengjitur faturave tatimore dhe procesverbali per evidentimin e sherbimeve nuk eshte firmosur nga te dy palet por vetem nga OE, mungon firma e AK.

-Faturat tatimore jane te korigjuara.

Konkluzionet: Në përbërje të grupi të kvo nuk ka person përgjegjës grupi në kundësttim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 58.

Nga shqyrtimi i dokumentave në SPE konstatohet se OE "C." ka paraqitur një kontratë shërbimi të lidhur midis Qendren Spitalore "Nënë Tereza" dhe BOE "C." shpk dhe "A. K.". Në kontratë citohet së 95% të shërbimit do ta kryej "C." shpk ndërsa 5% "A. K.". Ndërkohë me shkresë nr.2720/1 prot datë 20.05.2016 ku citohet: *Vertetim per ralizimin e kontrates, Kontrata eshte realizuar ne vleren 1,018.850 lek pa tvsh dhe 1,222.620 lek me tvsh*, shkresa është firmosur nga titullari i QSUT me kërkesë të OE "C.". Sasia e punimesh prej 95% të kryera nga OE vërteton shërbimet e ngjashme të ketij OE në vlerën 40% të fondit limit.

Referuar më siper Operatori Ekonomik "J. Z." i shpallur fitues dhe skualifikimi i OE "C." me ofertë më të ulët kemi të bëjmë me **dem ekonomik ne vlerën 27,000 leke me TVSH, në kundësttim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimr pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55.**

Personat përgjegjës për veprimet ose mos veprimet e tyre: znj.S. N., z. E. B., znj. M. C. dhe ish titullari i AK, z. K. Ll.

Me shkresën nr.1457/1 datë 07.10.2021 me objekt "Kthim përgjigje të Projekt-Raportit,janë paraqitur observacionet nga SPV, protokolluar në KLSH me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021 në kuadër të auditimit të

ushtruar në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në bazë të programit të auditimit nr.149/1 datë 28.01.2021 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Nga shqyrtimi i observacionit, pretendimet e ngritura nga Insitucioni nuk sjellin asnjë arsytim/apo fakt shtese, ndryshe nga trajtimi i bere nga grupi i auditmit ne projekt raport.
Për sa trajtuar me sipër, observacioni nuk merret parasysh

8.-Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “ Mirmbajte e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise””, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “ Mirmbajte e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1019 Dt 23.05.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.1017 , dt. 23.05.2018 1.Z. S. Xh. 2.Znj. R. B. 3.Z. A. L.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.561 Dt. 19.03.2018 1.Znj.K. Xh. 2. znj.E. M. 3.znj.K. T.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per propozim.		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 2,573.764 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 2,268.650 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 305,114 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30/06/2018	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 6 OE b) Skualifikuar 4 OE c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues Firma “L. 2002” shpk
11.Ankimime AK-ka nr1187 date 14.06.2018 APP-ska; KPP-ska	12. PërgjigjeAnkesës Nr.1187/1 date 19.06.2018	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit" me urdher nr.642 prot datë 30.03.2018. Komisioni është ngritur pas kërkesës pa nr.prot e bera nga shefi i zyrës teknike z.A. L. dhe me pas me shkresë nr.641 prot., datë 30.03.2018 bërë nga shefe hotelerise znj.E. M. kërkohet që nga titullari të miratohet ky sherbim.

Me shkrese nr.796 prot datë 26.04.2018 është argumentuar fondi limit dhe për përlllogaritjen e cmimeve janë marë cmimet bazë të VKM nr.629 datë 15.07.2015 bazuar në manualet që janë postuar në fleteron zyrtare. Ndersa për cmimet e “Riparim Ashensori” është ndjekur procedura duke marë 3 oferta ne treg.

Konkluzioni: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së kësaj procedure, për arsye se:

- nuk ka akt-konstatime për gjëndjen aktuale të këtyre godinave.
- nuk ka akt-konstatim mbi gjëndjen dhe pse duhet të riparohet ashensori.
- nuk ka akt-konstatim ku të kerkohet riparimi i ashensorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”.*

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST:

Me shkres 1019/1 date 23.05.2018 është bërë argumentimi i kriterëve të vecanta te kualifikimit.

Nga NJHDT ne DST tek shtojca 1 formulari I ofertes ekonomike qe duhet te plotesohet nga OE, disa nga zera e specifikimeve teknike si me posht:

Shtojca 1 formulari i ofertes ekonomike

10	2.503	F.V ĖC allafrenga importi	cope	4
11	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	5
12	2.506	F.V bide importi porcelani	cope	3
13	an-m9	lavaman xingato me nje grope	cope	2
16	2.508	F.V bolier 80 liter importi	cope	10
18	an-m13	F.V. rubinet cezme (cilesore italiane)	cope	50
		shuma VIII		
	IX	Punime Elektrike		
8	2.485/g	F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Gevis"	cope	30
9	2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis"	cope	10
10	2.487/d	F.V kuti suport pllaket 4 modular Gevis	cope	10

Nga NJHDT ne DST eshte kerkuar ne kriteret e vecanta per Kapaciteti teknik 3.2 pika e):

Mjetet	Sasia	Gjendja
1.Betoniere kantieri	1 cope	Pronesi ose me qera
2.Matrapyke	1 cope	Pronesi ose me qera
3.Makine shkarkuese inerte	1 cope	Pronesi ose me qera
4.Kamioncin trasporti	1 cope	Pronesi ose me qera
5.Vinç	1 cope	Pronesi ose me qera
6.Pompe uji	1 cope	Pronesi ose me qera

Konkluzioni: Në dokumentet e tenderit të hartuara nga NJhdt, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe tek tabela me sipër nuk është argumentuar se perse duhet të disponojn keto mjete, si dhe specifikimet për këto mjete. Kjo është pasojë e mospasjes në përbërje të asnjë specialisti të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, neni 61 “Hartimi i dokumentave të tenderit” pika 2, ku citohet se: “Në rastet kur njësisia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentojë dhe të dokumentojë në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Nderkohë në “shtojcen 1” formulari i ofertes në disa zëra është përdorur fjala Importi, cilësore Italiane dhe emri i markes "Gevis" përmendja e këtyre fjalëve dhe i markës është një kriter diskriminues, për arsye se nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”, neni 23, pika 5, e cila përcakton se: “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

ne kundërshtim me Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 Neni 23 pika 5 ku citon: Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Gjithashtu në përbërje të grupi nuk ka përgjegjës grupi dhe specialist të fushes, anetari z. A. L. është teknik i mesëm dhe nuk është me arsim të lartë. Veprimet e mësipërme janë në

kushdeshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATË 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATË 23.11.2016 DHE ME VENDIMIN NR. 797, DATË 29.12.2017, NENI 57 Pika 2 ku citon: Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoriteti kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbër nga z. S. Xh., znj. R. B. dhe z.A. L. dhe ish titullari i AK z.K. Ll..

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.1019/6 prot date 04.06.2018 është mbajtur procesverbal i hapjes së procedurës ku është bërë evidentimi i operatoreve pjësemarrës në procedurë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	“Z K.”	2,548.900	Kualifikuar.
2	“D.-G ”	1,984.840	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Ka munges dokumentacioni dhe konkretisht : 1.Deklarata per drejtuesin teknik te punimeve nuk i perket AK (i perket AK Bashkia Shijak) . 2.Vertetimi per xhiron vjetore te realizuar ne tre vitet e fundit nuk i perket AK (i perket AK Shtepise se pushimit se Ministrise se Brendshme) . 3.Nuk ka vinc.
3	“L. 2002”	2,268.650	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
4	“M.”	2,502.000	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit dhe konkretisht per piken (d) per drejtuesit teknik nuk ka dokumentacionin e kerkuar .
5	“V.K.”	2,097.950	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Ka munges dokumentacioni dhe konkretisht : 1.Vertetim i tatimeve per xhiron e tre viteve te fundit nuk perkon me objektin e prokurimit . 2.Mungon listepagesa e muajit Prill e vitit 2018. 3.Per mjetet vinc, pompe uji, matrapyk nuk shoqerohen me fatura tatimore .
6	“S.”	2,097.950	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Ka munges dokumentacioni dhe konkretisht : 1.Formulari i ofertes sipas shtojces 1. nuk permban emertimin e punimeve , sipas dhe DST-ve .

Me nr.1187 prot datë 14.06.2018 OE “S.” ka bere ankese pranë AK për arsyen e skualifikimit si me posht:

1. Formulari i ofertes sipas shtojces 1 nuk përmban emërtimin e punimeve, sipas DST-ve.
- 2.Kontrata për drejtuesin teknik i ka mbaruar afati.

Me nr.1187/1 prot datë 19.06.2018 është pezulluar procedura. Njesia e prokurimit i ka kthyer përgjigje OE “S.”, për ankesen e pikës së 1 nuk merit parasysh sepse OE nuk e ka plotësuar shtojcen 1 sipas DT për më tepër e ka ndryshuar ate.

Ndersa per piken e 2 merit parasysh ankimi juaj.

Me nr.1019/7 date 02.07.2018 është mbajtur raporti përmbledhës nga anetarët e kvo ku është shpallur fitues OE “L. 2002” shpk me ofertë më të ulet nga 2 OE e kualifikuara.

Me nr.1019/11 datë 05.07.2018 është lidhur kontrata midis OE dhe titullarit të AK dhe afatit i kësaj kontrate është nga momenti i firmosjes deri me datë 31.12.2018.

Me nr.1362 prot 05.07.2018 eshte ngritur komisioni imbikqyrjes se kontrates.

Zbatimi i kontrates: Me nr.1362 prot datë 05.07.2018 është ngritur komisioni i mbikqyrjes së kontratës. Komisioni perbehet nga anetarët: z. E. B., znj.O. M.dhe z. F. M. Komisioni i mbikqyrjes së kontratës ka mbajtur raport paraprak të punimeve me nr.1372 prot datë 03.10.2018, sipas komisionit OE “L. 2002” ka realizur punime në vlerën 1.494.628 leke me tvsh sipas situacionit nr.1. Me urdher shpenzimi nr.231 date 04.10.2018 eshte kryer likujdimi me vlere 1,494.628 leke. Gjithashtu me nr.2272 prot datë 18.12.2018 nga komisioni i mbikqyrjes se kontrates ka mbajtur mbajtur raport paraprak mbi pjesën e mbetur të punimeve. Sipas komisionit kontrata është realizur plotesisht. Me urdher shpenzimi nr.302 date 19.12.2018 eshte likujduar ne vleren 1,227.750 leke. Vlera totale e 2 situaceneve eshte 2,722.380 lek me tvsh.

9- Procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt: ”Evadimi i mbetjeve urbane”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : ”Evadimi i mbetjeve urbane ”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.504. Dt 05.03.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.503, dt. 05.03.2019	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.505. Dt. 05.03.2019
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per propozim.	1. Znj.R. B. 2. Znj.K. Xh. 3. Znj.E. M.	1.Z.A. L. 2.Znj.K. Sh. 3.Znj.K. T.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,164.496 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 1,156.086 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8.410 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 18/03/2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës ne tender 1 OE b) Shpallur Fitues Firma “D.” shpk
11.Ankimime AK-ska; APP-ska; KPP-ska	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit përpërlllogaritjen e vlerës se fondit limit" me urdhër date Nr.2311 prot, date 26.12.2018.

Komisioni është ngritur pas kërkesës nga Krye/infermieri i përgjithshëm me shkresë nr.2307 prot date 26.12.2018.

Me shkresën nr.2324 prot date 26.12.2018 komisioni i argumentimit te fondit limit përçmimetështë bazuar nga kontratën e ngjashme te vitit 2018.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST:

Me shkresë 504/1 date 05.03.2019 është bere argumentimi i kriterëve te veçanta te kualifikimit. Vendosja e kriterëve konstatohet se është ne përputhje me llojin e objektit e shërbimit te kërkuar, janë te argumentuara dhe nuk cenojnëpjesëmarrjen e OE te interesuara.

Zhvillimi i Procedurës.

Me nr.504/4 prot date 18.03.2019 është mbajtur procesverbal i hapjes se procedurës ku është bere evidentimi i operatoreve pjesëmarrës ne procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	“D.” shpk	1,156.086	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Me nr.504/7 date 28.03.2019 është mbajtur raporti përmbledhësanëtarët e KVO. Komisioni pasi evidentoj dokumentet e OE vlerësojë se janë ne përputhje me DST.

Me nr.504/14 me date 04.04.2019 është firmosur kontrata midis OE ”D.” shpk dhe AK.

Mbikëqyrja e kontratës është realizuar sipas urdhër nr.668 prot date 04.04.2019.

Shtojca 1

formulari i ofertës ekonomike

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje te parashikuara	kg	17.347	53.6	931,246
2	Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m ²)	m ²	14,600	7.9	115,340
3	Disifektim per 2 pika (1*2)	dite	730	150	109,500
Totali pa TVSH					1.156,086

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës për pikën 2 “Siperfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik ”S. Al”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapsirës rreth e për qark godinave (Objekt ndertimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë, OE kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimit e për të bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të medhej, të posaçem, të mbyllur me kapak.*

Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me çfarë do të kryet disinfektimi (lende, produkti ose solucion).

Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjmë me një **dëm ekonomik me vlerë 269,808** me tvsh.

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre : Ish Titullari i AK z. K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: bazuar pretendimit tuaj se Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata 5 vjecare me nr.4558 prot., e lidhur me date 31.10.2014 e firmes se pastrimit “D.” Shpk me Bashkine Vlore, Spitali Psikiatrik i eshte drejtuar Bashkise Vlore me kerkesen nr.577 Prot., date 30.05.2017 dhe me shkresa në vazhdimësi me shkresën nr.742 prot., datë 15.04.2020 ku i është kthyer përgjigje me shkresën nr.741/1 prot., datë 29.04.2020, për të sqaruar përsëri nese Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata nr.4558 prot., date 31.10.2014. Nga pergjigjet e kthjera sqarojme se kjo kontrate nuk e mbulon Evadimin e mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik te Vlores.

Vërtetë bashkia Vlorë në kontratën e saj ka mbulimin e rrugës “Ibrahim Avdullhu”, rrugë në të cilën është vendndodhja e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë por Bashkia nuk ka kontratë për heqjen e mbetjeve urbane brenda territorit të SPV.

Për këtë rekomandim është njoftuar Operatori Ekonomik “D. sh.p.k me shkresën me nr.1505 prot., datë 20.09.2021 në lidhje me kontratën me objekt “Evadimi mbetjeve urbane”, i cili i është përgjigjur Autoriteti Kontraktor mbi rekomandimet e lëna, me shkresën e ardhur në institucion me nr.1505/1., datë 06.10.2021 (*Bashkëlidhur kthim përgjigje*)

Gjithashtu sqarojmë se në kontratën e shërbimit të pastrimit të brendshëm detyrimet e shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm janë heqja e mbetjeve nga pavionet apo ambienti i jashtëm dhe grumbullimi nëpër vendet përkatëse, por nuk ka për detyrë heqjen e mbetjeve nga territori SPV.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Argumentimet tuaja qëndrojnë pjesërisht për pikën e parë (mbetje te parashikuara) e për pasojë merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Ndërsa për pikën 2 Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m²) dhe pikën 3 Disifektim per 2 pika (1*2) nuk meret parasysh pasi janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik ”S. AL”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016.

Për sa i përketë fshirjes ku gjenden koshat OE ”S.-AL” ka për detyrë në bazë të kontratës të pastrojë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlore ku citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapësirës*

rrerth e përqark godinave (Objekt ndërtimi) qe aktualisht janë ne funksion te këtij spitali. O.E do te pastroj çdo dite gjithësipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here ne dite.

Për sa i përketë grumbullimit të heqjes së mbetjeve nga firma e pastrimit "S. Al" ne kontrate citohet: *Grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne çdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për ne vend grumbullimin e plehrave behet çdo dite, transporti behet me kosha te mëdhenj, te posaçëm, te mbyllur me kapak.*

Për dezinfektimin të pikave ku grumbullohen mbetjet urbane theksojm se tek specififikimet nuk është përcaktuar se me cfarë do të dizinfektohet (lënd, produkt etj) dhe OE "S. AL" në bazë kontratës kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para orës 7:00.

Obsvacioni meret pjeserisht ne konsiderat.

10- Procedurës së prokurimit "Kërkese per propozim" me objekt: " Mirëmbajtje e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave"		
1.Urdhër Prokurimi Nr.302 Dt 08.02.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.301 , dt. 08.02.2018	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.303 Dt. 08.02.2019
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per propozim.	1.Z. S. Xh. 2.Znj. R. B. 3.Z. A. L	1.Znj.S. N. 2. znj.O. M. 3.znj.K. Xh.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,642.800 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 1,591.300 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 51.500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 21/02/2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 2 OE b) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqeria "J. Z."shpk
11.Ankimime AK-ska; APP-ska; KPP-ka	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit per përlllogaritjen e vlerës se fondit limit" me urdhër date Nr.169 prot. date 23.01.2019.

Me shkresë nr.177 prot date 25.01.2019 është argumentuar fondi limit dhe çmimetjanë mare nga 3 oferta ne treg dhe nga këto është zgjedhur çmimi me i ulet.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT ne DST:

Me nr.302/1 prot date 08.02.2019 është bere argumentimi i kriterëve te veçanta.

Nga NjHD ne DST ështëkërkuar "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 2.3 Kapaciteti teknik:

b. Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë te punësuar mesatarisht 5 (pese) punonjës për periudhën Nëntor 2018- Janar 2019.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

a. Vertetim nga Administrata Tatimore ose Dega e Sigurimeve Shoqerore per numrin e punonjesve te siguruar per periudhënNëntor 2018-Janar 2019.

b. Liste pagesat përkatësepër muajt Nëntor 2018- Janar 2019 te konfirmuar nga Administrata Tatimore.

c. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar ne stafin e tij te paktën 2 (dy) punonjes me certifikate profesionale per instalimin e sistemeve termohidraulike, vertetuar me kontrate pune dhe certifikatën përkatëse.

ç. Certifikatë ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit te cilësisë.

d. Certifikatë ISO 14001:2004 për sistemin e menaxhimit te mjedisit.

e. Certifikatë OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit te cilësisë ne pune.

f. Certifikatë PAS 99:2012 për sistemin e integruar.

Konkluzionet: Nuk argumentohetse perse OE duhet te ketë te paktën 2 punonjës me certifikatë profesionale per instalimin e sistemeve termohidraulike. Gjithashtu sqarojmë se certifikata ISO

9001-2008, e cila gjen referim ne llojin e objektit te prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 per sistemin e menaxhimit te mjedisit, 18001:2007 per sistemin e menaxhimit te cilesise ne pune dhe PAS 99:2012 per sistemin e integruar, nuk gjejne aspak referim, per sa kohe qe nuk i sherben AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, por vet OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes. Kriteret e mesiperme, nuk nxisin pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencen ndermjet tyre, por krijojne diskriminim te tyre dhe sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik.

Mos argumentimi i kerkesave per kualifikim, jane veprime ne mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punëpublike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione te veçanta", ne te cilen percaktohet se: "Kontratat per pune, ne te cilen eshte percaktuar se: "Ne cdo rast kerkesat e mesiperme duhet te jene te argumentuara nga autoriteti kontraktore":

Gjithashtu ne përbërje te komisionit nuk ka person përgjegjës grupi dhe veprimet jane ne kushdeshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2.

Mbajne pergjegjesi per veprimet dhe mos veprimet e tyre anetaret e NJHDT Z.S. Xh., Znj.R. Sh., Z.A. L. dhe ish Titullari i AK, z.K. Ll.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.302/6 prot date 21.02.2019 eshte mbajtur procesverbal i hapjes se procedures ku eshte bere evidentimi i operatoreve pjesemarres ne procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"A." shpk	1,396.380	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Me ane te rubrikes mesazhe njoftuar AK per terheqje nga procedura e prokurimit ne fjale.
2	"J. Z."shpk	1,591.300	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Me nr.302/7 date 11.03.2019 është mbajtur raporti përmbledhës nga anëtarët e KVO ne prani te NjHD ku është shpallur fitues OE "J. Z." shpk.

Me nr.302/9 prot date 13.03.2019 formuari i njoftimit te fituesit.

Me nr.302/12 date 26/03.2018 eshte lidhur kontrata midis titullarit te AK dhe OE fituese "J. Z."shpk.

Mbikëqyrja e kontratës është realizuar sipas urdhrin nr.608 prot date 26.03.2019.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

II-Procudurës së prokurimit "E hapur" me objekt: " Shërbimi i lavaxerise dhe zëvendësimi me inventar te imët", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procudurës së Prokurimit me objekt : "Shërbimi i lavaxerise dhe zëvendësimi me inventar te imet per nevoja te SPV"		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1589, datë 23.08.2019	3.Hartuesit DokumentevetëTenderit Urdhër Nr.1588 , dt. 23.08.2019 1.Znj. P. M.- (Juriste sektori burimeve njerëzorë) 2.Znj. R. B.- (Jursite Specialiste prokurimesh) 3.Z. E. B.- (K/ infermier ipërgjithshëm)	4.Komisioni iVlerësimittëOfertave. Urdhër Nr.1590 Dt. 23.08.2019 1.Znj.M. C.- (Juriste sektori burimeve njerëzore) 2.Znj. K. T. (llogaritare e I Sektori financës) 3.Znj.K. Sh.- (Ekonomiste sektori financës)
2. Lloji i Procudurës së Prokurimit E HAPUR		

5.Fondi Limit (pa TVSh) 108,365,662 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 106.187.633 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,178,029 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.09.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S'kualifikuar 3 OE c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqëria "A G S" shpk
11.Ankimime AK-ka: Nr.1589/16 prot date 28.10.2019 APP-ka;- rekomandime KPP-ka: Nr.1589/18 prot date 13.11.2019	12. PërgjigjeAnkesës AK ndryshuar DST. Nr.1589/17 prot dt 04.11.2019	13.Përgjigje KPP shkres nr792/1. prot, date 19/12/2019

Hartim i fondit limit:

Me urdhër nr.1047, datë 10.06.2019 është ngritur Komisioni i përllogaritjes së vlerës limit, me anëtarë znj.K. Xh., znj.R. B., znj.E. M., znj.O. M. dhe z.E. B. Komisioni ka testuar çmimin e këtij shërbimi me kontrata të institucioneve të ngjashme të AK për te pasur një objektiv sa me real për koston e çmimit të këtijshërbimi.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST:

Procesverbali me nr.1589/1 prot, datë 23.08.2019 i hartimit dhe argumentimit të vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Procesverbal përgatitur nga grupi i punës nr.1589/4 prot datë 03.09.2019 mbi ndryshimin e kriterëve (bërë sipas rekomandimit të APP.)

Procesverbal mbi ndryshimin e kriterëve përgatitura nga grupi i punës nr.1589/7 prot date 26.09.2019 (bere sipas rekomandimeve të një kërkesë nga OE.)

Rezulton se pas hedhjes në SEP ato janë ndryshuar, duke ju referuar rekomandimeve të APP-se dhe kërkesës së bërë nga OE "A G S".

Pavarësisht rekomandimeve për ndryshime nga APP-ja, vendosja e kriterëve përsëri konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cenon pjesëmarrjen e OE-ve të interesuar, konkretisht:

Nga NJHDT në DST është kërkuar në kriteret e veçanta për Kapacitetin teknik 3.2:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2015. (Ekuivalent). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformiteti i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
2. Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformiteti i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (Ekuivalent) - Sisteme të menaxhimit të mjedisit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2004 (Ekuivalent). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformiteti i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
7. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë :
 - Të shoqëruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor për aktivitetin në lavanderi lëshuar nga autoriteti përkatës;
 - Të shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit.

Konkluzioni: Kriteret 2, 3 dhe 7 rezultojnë të paargumentuara, për sa kohë që nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, por i shërben vetë subjektit ofertues, pra OE për

realizimin sa më mirë të proceseve të tij të punës dhe sistemeve të menaxhimit të mjedisit dhe masave të mbrojtjes ndaj zjarrit. Kriteret e mesipërm, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencen ndërmjet tyre, por krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Nga NJHDT në DST është kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2 :

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*


b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

d. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Konkluzionet: Në kriteret që janë kërkuar nga NJHDT konstatojmë së pavarësisht së është kërkuar kriteri në pikën **b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1** ky kriter dhe kjo shtojcë nuk gjëndet në DT dhe në **KREUN nr.III të DT** nuk është cituar si pjesë përbërëse kjo shtojcë si më poshtë:



Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23, neni 41 pika 1, Neni 42 pika 2 si dhe neni 46 pika (1, 3), Neni 55 pika (2), pika si dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratave për punëpublike pika 3 " Kreu III, neni 10 "Dokumentet e tenderit".

Gjithashtu në përbërje të komisionit nuk ka person përgjegjës grupi dhe veprimet janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2.

Për sa më sipër për veprimet dhe mos veprimet e tyre mbajnë përgjegjësi anetarët e NJHDT i përbërë nga znj. P. M., znj. R. B., Z. E. B., dhe titullari i AK znj.O. G.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.1589/12 datë 07.10.2019 është mbajtur procesverbal i hapjes së procedurës ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"A G S" shpk	106,187,633	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
2	"E.- S."	0	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Munges te theksuar ne dokumentacion, ka paraqitur vetem ekstraktin historik.
3	"S. C."	103,608,445	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk kishte paguar taksat vendore ne qytetin e duresit ku kishte paraqitur dhe kontrata te ngjashme.
4	"U. S."	93,700,000	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk ka paraqitur deklaraten e pavarur sipas shtojcës 1/1. Certifikatat iso te pa perkthyer ne gjuhen shqipe. Mjeti me targe AA992NR ne certifikaten e pronesisë shkruhet se është kamion frigorifer.

Me procesverbalin nr.1589/13 datë 17.10.2019 anëtarët e KVO i janë drejtuar njësisë së hartimit të dokumentave të tenderit dhe kërkojnë informacion pasi në kriteret e kualifikimit pika 1/B shtojca 1/1, konstatohet së në DST nuk është paraqitur formati tip i shtojca 1/1 *"Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur"* dhe nuk ka asnjë të dhënë mbi përmbajtjen e këtij dokumenti dhe kriteri.

Me procesverbalin nr.1589/14 datë 21.10.2019 njësia e prokurimit ka marrë në shqyrtim kërkesën e bërë nga anëtarët e KVO dhe shprehet se shtojca 1/1 *"deklaratë për paraqitjen e ofertës së pavarur"* është pjesë e dokumentave standarte bazuar në vendimin nr.2 me nr.2233 prot datë 08.03.2019 të APP "Për miratimin e disa shtesave në dokumentat standarte të tenderit". Ndërsa për piken "Te vertetohet me dokumentacion përkates të pronesisë apo në rastin e marrjes me qera të vërtetuara me kontratë përkatese" sipas NJHD mjafton të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.

Me njoftimin nr.1589/15 datë 22.10.2019 KVO ka përfunduar vlerësimet dhe anëtarja e KVO-së znj. K. Sh. ka votuar për të kualifikuar OE "A G S" shpk dhe OE "U. S.". Ndërsa dy anëtarët e tjerë kanë votuar për të kualifikuar vetëm një OE përkatesisht "A G S" shpk.

Me nr.1589/16 prot datë 28.10.2019 OE "U. S." ka bërë ankese pranë AK dhe arsyet e ankesës janë si me poshtë vijon:

1. Mungese deklarate për paraqitjen e ofertës së pavarur, sipas shtojcës 1/1.
2. Ofertuesi ka paraqitur çertifikata ISO në gjuhë të huaj, të pa perkthyer në gjuhën shqipe.
3. Në certifikaten e pronesisë së mjetit rezulton se mjeti eshte kamion frigoriferik.

Eshte pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e ankesës së OE "U. S." me urdher nr.1942 prot nr.235 datë 30.10.2019 me antare znj. K. Xh., znj. K. Xh, znj. O. M..

Me nr.1589/17 prot grupi i punës mbas shqyrtimit të ankesës i ka kthyer pergjigje OE "U. S." ku ka pranuar ankimin për piken e 3 certifikatën e pronesisë së mjetit ku rezulton së mjeti është kamion frigoriferik. Ndërsa për piken e 1 dhe të 2 nuk i ka pranuar ankimimin.

Me nr.1589/18 prot datë 13.11.2019 OE "U. S." ka paraqitur ankesë pranë Komisionit Prokurimit Publik.

Me nr.792/1 prot date 19.12.2019 Komisioni Prokurimit Publik ka venë në dijeni SPV, OE "U. S." dhe APP lidhur me ankimimin e bërë nga OE. KPP pas shqyrtimit të dokumentacionit nuk e ka pranuar ankesën e bërë nga OE "U. S." dhe njofton AK që të vijoj me hapat e më tejshëm të procedurës së prokurimit të sipërpërmendur.

Me nr.2177 prot datë 23.12.2019 është urdhëruar c'pezullimi i procedures, ndërsa me nr.1589/28 datë 23.12.2019 është mbajtur raporti permbledhës.

Nderkohë me shkres nr.713 prot date 22.01.2020 Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë ka kerkuar të dhena për procedurën e sipër përmendur për interes të hetimit, pas kallzimit penal të bërë me datë 17.12.2019.

Me nr.1589/36 prot datë 31.01.2020 është lidhur kontrata midis AK dhe OE fitues "A G S" shpk.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës përsa i përket skualifikimit të OE "U. S." për 2 pikat si më posht:

1. Mungesë deklarate për paraqitjen e ofertës së pavarur, sipas shtojces 1/1.

2. Ofertuesi ka paraqitur çertifikata ISO në gjuhë të huaj, të pa përkthyer në gjuhën shqipe. Konsatojmë së kjo e ka skulifikuar pa të drejtë OE "U. S." me ofertë me të ulet për pikat me siper. Përkatesisht për pikën e parë AK nuk ka përdorur dokumentat standarte të tenderit, pasi në dokumenta e procedures nuk është përfshirë shtojces 1/1 (deklaratë për paraqitjen e ofertës së pavarur). Sic u shprehëm dhe më sipër pavarësisht së nga NJHDT është kërkuar të kriteret e veçanta Shtojca 1/1, në dokumentat e tenderit nuk gjëndet e bashkangjitur kjo shtojce, ndërsa tek dokumentat standarte të tenderit nuk gjëndet kjo shtojcë si pjesë e dokumentave standarte. Veprimet janë në kundësthim me ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 41 pika 1 citon: Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, të përcaktuara në rregullat e prokurimit,, Neni 42 pika 2, Neni 55 pika 2 citon: Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit dhe Vendim Nr. 914, datë 29.12.2014, I Ndryshuar, Kreu III neni 10 citon: APP-ja përgatit formatin e dokumentave standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumenta japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës. Ndërkohë për pikën e dytë konsatojmë se ISOT nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, por këto dokumenta janë hedhur dhe paraqitur në SPE, perseri ky është një devijim i vogël dhe nuk prek themelin e procedures sipas ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 53 pika 4 citon se: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Gjithashtu OE "A G S" në dokumentat e paraqitura për pikën "Te vërtetohet me dokumentacion përkatës të pronesisë apo në rastin e marrjes me qera të vërtetuara me kontratë përkatëse" ka paraqitur kontratën e qerasë lidhur me SPV me nr.218 prot datë 19.04.2016 dhe afati i kohëzgjatjes sipas neni 3 të kësaj kontrate qeraje ka qenë e lidhur me kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit të lavanderisë me nr. 26 datë 29.03.2016 deri në mbarimin e saj.

Ndërkohe në përbërje të grupit të kvo nuk ka person përgjegjës grupi në kundësthim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 58.

Gjithashtu, kundrejt këtyre konstatimeve, bie ndesh edhe vendimi nr.792/2019 i marrë nga KPP për mos pranimin e ankimimit të OE.

Referuar më sipër Operatori Ekonomik "A G S" shpk i shpallur fitues dhe skualifikimi i OE "U. S." me oferte më të ulet kemi të bejm me **dem ekonomik në vlerën 14,985,160 lekë me tvsh, në kundësthim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimr pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55.**

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre anëtarët e KVO dhe anëtarët e grupit të punës: Znj. M. C., znj. K. T., znj. K. Xh., znj. K. Xh., znj. O. M., dhe **Titullari i AK,** znj. O. G.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021

Pretendimi i Subjektit: Për procedurën e prokurimit E hapur – Marrëveshje Kuadër me objekt "Shërbimi i lavanderisë dhe zvendësimi me inventar të imët", me Ref-45935-12-10-2019, si dhe për negociim me të njëjtin objekt me Ref-34183-08-23-2019 janë procedura në shqyrtim nga Prokuroria e Vlorës me shkresë nr.905 prot./A.M datë 28.01.2020 ardhur në institucion nr.183 prot, datë 29.01.2020, gjithashtu dhe nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit Dhe Krimin të Organizuar me Vendim "Për kqyrje marrje dokumentacioni" ardhur në institucion nr.1580/1 prot., 06.10.2021 dhe në këto kushte ju si institucion nuk mund të na rekomandoni për shpërblim dëmi në këto procedura duke qenë se po presim një përgjigje nga këto organe kompetente për këto

çeshtje, bazuar kjo në në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi I Proçedurës civile I Republikës së Shqipërisë” I përditësuar me nr.38/2017, datë 30.03.2017, kreu II, neni 36 citon se “.....Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.....” pra ndalohe marrja në shqyrtim të çdo lloji shkele/marrëveshje nga palë të tjera (qoftë dhe KLSH), duke ju përmbytur ligjit të më sipërm kërkojmë nga ana juaj si institucion të respektoni hierarkin ligjore.

Gjithashtu për proçedurën me Ref- 45935-12-10-2019 ndodhemi në faktin se OE i skualifikuar në këtë proçedurë nga dy komisione ngritur nga AK dhe të mirë argumentuar këto skualifikime edhe nga KPP.

Për sa më sipër këto vendime të Ak janë shfuqizuar nga KPP e cila është organi më i lartë gjykimin në ligjin e prokurimit publik Kreu II “Organizimi i prokurimit public” neni 19/1 për Komisionin e Prokurimit Publik. Vendimi I KPP për proçedurën e sipërciatuar ka vendosur të mos e pranojë ankesën e OE të skualifikuar dhe e lejon AK me hapat e mëtejshme të proçedurës.

Konkretisht AK^{se} i janë shfuqizuar vendimet e komisioneve përkatëse ngritur në institucion nga KPP^{ja} dhe ka vazhduar me hapat e proçedurës për lidhjen e kontratës me vendimin e KPP^{se}.

Për këtë proçedurë është njoftuar znj.K. Xh. me shkresën me nr.1503 prot, dt.20.09.2021, ku si pjesë e komisionit të proçedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i lavanderisë dhe zvendësimi me inventar të imët” ka detyrim për shpërbllim dëmi ekonomik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit, pretendimet e ngritura nga Insitucioni nuk sjellin asnjë arsytim/apo fakt shtese, ndryshe nga trajtimi i bere nga grupi i auditmit ne projekt raport. Me email me datë 13.10.2021 u dërgua shkresa nga SPV me nr.1580 prot. Datë 06.10.2021 nga Prokuroria e Posacme kundër korrupsionit dhe krimin te organizuar drejtuar Spitalit Psikiatrik, Vlorë për “Kqyrje marrje dokumentacioni”.

Obesvacioni nuk meret ne konsiderat.

12-Procudurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake te kontrates.

” me objekt: “Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imet”,me këto të dhëna:

Zhvillimi i Proçedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imet per nevoja te SPV”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.2071 Datë 03.12.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave.
2. Lloji I Proçedurës së Prokurimit Me negociim pa shpallje paraprake te kontrates.	Urdhër Nr.2070 , dt. 03.12.2019 1.Znj. P. M.- (Juriste sektori burimeve njerzore) 2.Znj. R. B.- (Jursite Specialiste prokurimesh) 3.Znj.K. Sh.- (Ekonomiste plani sektori finances).	Urdhër Nr.2109 Dt. 10.12.2019 1.Znj.M. C.- (Juriste sektori burimeve njerzore) 2.Znj. O. M. 3.Znj.L.B. (Nen/drejtoresh ekonomike)
5.Fondi Limit (pa TVSh) 4,482,345 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 4,470,515 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 11,830 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.12.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues Shoqeria “A G S”shpk
11.Ankimime AK-ska; APP-ska; KPP-ska	12. PërgjigjeAnkesës	13.Përgjigje

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundesuar, nga Komisioni "Mbi ngritjen e komisionit per përlllogaritjen e vlerës së fondit limit" me procesverbal Nr.2060 prot., datë 02.12.2019 me anetar: znj.R. B., znj.E. M., znj.K. Xh.

Lidhur me mënyrën e përlllogaritjes se fondit te prokuruar:

Me shkres nr.2066, datë 03.12.2019 komisioni sqaron së situata është emergjente për këtë shërbim pasi vlera e mbetur e kontrates nr.26 me nr.75/6 prot date 29.04.2016 nuk e mbulon muajn dhjetor 2019 dhe procedura e hedhur “E Hapur” e hedhur ne SPE është e pezulluar për momentin, për këtë arsye Spv nuk mund të rrije zbuluar për këtë shërbim dhe në të tilla kushte

kerkohet vazhdimi për periudhen dhjetor 2019 dhe janar 2020. Për ciminin dhe kilet komisioni është referuar kontratës së ngjashme e cila është rivlersuar në vite.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST:

Rezultoni se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Nga NJHDT në DST është kërkuar në kriteret e vecanta për Kapaciteti teknik 2.3:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2015. (Ekuivalent) Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
2. Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001-2018 (ekuivalente me 18001:2007). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. (ISO 45001 janë standarde Niderkombetare, të cilat parashtrijne kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë)
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (Ekuivalent) - Sisteme të menaxhimit të mjedisit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit SSH EN 14065:2016. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
5. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambjentin ku ushtron veprimtari në e shërbimit të lavandërisë :
 - Të shoqëruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor për aktivitetin në lavandëri lëshuar nga autoriteti përkatës;
 - Të shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit.

Konkluzionet: Kriteret e pikës 2, 3 dhe 5 të DST rezultojnë të paargumentuara, përse nuk i shërben AK për shërbimin që kërkon të marrë, por i shërben vetë subjektit ofertues pra OE, për realizimin sa më mirë të proceseve të tij të punës dhe sisteme të menaxhimit të mjedisit dhe masave të mbrojtjes së zjarrit. Kriteret e mesipër, nuk nxit pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre dhe shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Vendosja e kriterëve jo në përputhje me objektin e prokurimit, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), Neni 55 pika (2), pika si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punëpublike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mesipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktore": për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbëhet nga Znj.P. M., Znj. R. B. dhe Znj.K. Sh.

Zhvillimi i Procedures.

Me nr.2071/3 Njesia e prokurimi i ka derguar ftesë për oferte 5 OE si më poshtë:

1. "U. S."
2. "S. C."
3. "A G S shpk"
4. "Ë.C"
5. "D. shpk"

Me nr.2071/4 prot datë 12.12.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"A G S" shpk	4,470,551	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
2	"U. S."	4,021,000	Skualifikuar arsyeja e skualifikimit Nuk ploteson kriterin e vecant sipas DST pika 2.3 (noterizimi nuk eshte konform ligjit 110/2018 "per noterin" Neni 135

Me nr.2071/7 prot datë 13.12.2019 është mbajtur raporti përmbledhës dhe KVO ka s'kualifikuar OE "U. S." me arsyen se certifikatat ISO të perkthyer dhe te noterizuara nuk jane konform ligjit 110/2018 "Per noterin" Neni 135, ndërkohe qe OE "A G S" shpk është kualifikuar.

Me nr.2071/6 date 13.12.2019 është njoftuar OE "A G S" shpk si oferta fituese të paraqes sigurimin e kontratës pranë AK.

Me nr.2071/9 nr.37 datë 16.12.2019 është lidhur kontrata midis OE "A G S" shpk dhe AK me kohë zgjatje 54 dite.

Me nr.2071/12 prot datë 17.12.2019 OE "U. S." ka bërë ankesë pranë APP.

Me nr.2071/15 prot datë 26.12.2019 APP i ka kthyer pergjigje OE "U. U" dhe per dijeni SPV, në të cilën sqaron së detyrat dhe kompetencat e saji i ushtron në bazë të zbatimit të ligjit nr.9643 neni 13 dhe app nuk ka kompetenca ligjore te shqyrtoj ankesa e OE për procedura prokurimi në të cilat parashikohet së "Për procedura e prokurimi, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e akimimit admisistrativ". Megjithatë veprimtaria e AK është subjekt monitorimi "ex post" nga APP apo instuticionet e tjera audituese.

Me nr.183 prot datë 29.01.2020 pranë SPV ka ardhur një shkresë nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlore me të cilen kerkon të dhena me interes për hetimin për dosjen e sipercituar.

Konkluzionet.

Nga auditimi i procedurës konstatojmë se skualifimi i OE "U. S." për arsye se, dokumentat e dorezuar nga OE nuk janë në përputhje me DST. Konkretisht mos plotesimi i kriterëve te veçanta 2.3 (jo korrekt noterizimi i perkthimit te certifikatave ISO sipas ligjit "Per noterin", nr110/2018) neni 135.

Skualifikimi i OE "U. S." është i pa drejtë pasi KVO duhet të kërkonë informcion për Çertifikatat iso që ka dorezuar OE të cilat janë në gjuhe të huaj dhe janë përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtesis, të cilat mbajnë vulën dhe firmën e përkthueses në cdo faqe të dokumentacionit si dhe gjithashtu janë të noterizuara me vertetim noterial te perkthimit te certifikatave ISO.

Në dokumentin e noterizuar nuk rezulton të jetë të shkruara të dhënat e noterit por këto dokumente permbajn pullën, firmen dhe vulën e tij si dhe numrin e repertorit dhe koleksionit.

Skualifikimi i OE "U. S." është në kundërshtim me *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3 citon: Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal". LIGJI Nr.9643, datë 20.11.2006, Për prokurimin publik" Neni 53 pika 3: vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit" pika 5 dhe neni 55 pika 2.*

Referuar me siper OE "A G S" ofertuesi i shpallur fituese dhe skualifikimi i OE "U. S." me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit në vleren 539,461 leke mne tvsh, né kundërshtim me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimr pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55.**

Ngarkohet me pergjegjesi anetare e KVO: Znj. L. B., znj. M. C. dhe znj. O. M. si dhe titullari i AK, znj. O. G.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Referuar observacioneve të ardhura nga SPV si dhe referuar bashkëbisedimit i cili u zhvilluan me datë 11.10.2021 në takimin ballafaques të zhvilluar në ambietet të KLSH me përfaqësuesit e SPV, grupi i auditimit pasi rishqyrtoj dokumentacionin gjykoj se vlerësimi i KVO ka cuar në një shpenzim pa eficence, efikasitet dhe ekonomikitet, pasi duhet të kërkonte informacion shtesë në lidhje paqartësisë e dokumentacionit të noterizuar të dorëzuar nga OE. *Observacioni meret pjesërisht parasysh dhe u reflektua në Raportin Perfundimtar*

13- Procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt: “Blerje medikamente”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje medikamente”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.569 prot Nr.12 Datë 12.03.2020.	3.Hartuesit Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr. 66, dt. 11.03.2020	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.67 Dt12.03.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	1.Znj. R. B. 2.Znj. P. M. 3.Znj. O. M.	1.Znj.L. B. 2.Z. E. B. 3.Znj.L. M.
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,148,474 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 1,109,374 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 39,100 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 23.03.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike “C. P.”
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje Ankesës S’ka	13.Përgjigje S’ka

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është hartuar në bazë të Urdhrit Nr.62 datë 10.03.2020 me përbërje znj. K. Xh., znj, L. B. dhe z. M. S.. Argumetimi i fondit limit me nr.547 prot datë 10.03.2020 cilëson se cmimet e medikamenteve janë marë dhe janë miratuar nga Ministria e Shëndetsise dhe e Mbrojtjes Sociale.

Argumentimi i kriterëve të veçanta.

Argumentimi i vendosjes së kriterëve të veçanta nr.569/2 datë 13.03.2020, nga anëtarët e NJHD. Vendosja e kriterëve konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit të kërkuar, janë të argumentuara dhe nuk cenojnë pjesëmarrjen e OE të interesuara.

Konkluzionet: Në përbërje të grupi nuk ka person përgjegjes grupi dhe specialist të fushës veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 Pika 2 ku citon: Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushë në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. O. G.

Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin nr.569/6 prot datë 24.03.2020, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës, ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’Kualifikuar
1	“C. P.”	1,109,347	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me datë 06.04.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe

formularit të njoftimit të fituesit i mbajtur me nr.569/7 date 01.04.2020, rezulton se ka marë pjese vetëm 1 (një) operator pjesëmarrës, dhe shpallur fitues OE “C. P.”.

Ne përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës me nr.569/7 prot datë 06.04.2020 titullari AK ka shpallur fituese ofertën e OE “C. P.”, me vlerë oferte prej 1,109,347 leke pa TVSH dhe vlera 1,331,216l eke me TVSH. Kontrata është lidhur me nr. 569/11 port, date 08.04.2020, me afat 12 muaj nga moment i nënshkrimit te marrëveshjes.

Konkluzion: Në përbërje të grupi të KVO nuk ka person përgjegjes grupi në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 58 ku citon : “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave”.

Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. O. G.

14-Procudurës së prokurimit “Me negociim ,pa shpallje Paraprake” me objekt: “Shërbimi pastrimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procudurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi pastrimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.549 prot Nr.11 Dt 10.03.2020.	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.548, dt. 10.03.2020 1.Znj. R.B. 2.Znj. P. M. 3.Znj. E. M.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.550 prot Dt 10.03.2020 1.Znj. K. Xh. 2.Znj. M. C. 3.Znj. O. M.
2. Lloji i Procudurës së Prokurimit Me negociim, pa shpallje Paraprake		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 6,411,655 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 6,406,235 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 5,420 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.03.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesmarres ne tender 1 OE b) Shpallur Fitues “S.-AL”
11.Ankimime S’ka	12. PërgjigjeAnkesës S’ka	13.Përgjigje S’ka

Hartim i fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është hartuar në bazë të Urdhrit Nr.414 prot datë 25.02.2020 dhe përbëhet nga znj. E. M., znj. R. B., z. A. L., z. E. B. dhe znj. K. Xh.. Me shkresë nr.415 prot datë 25.02.2020 është argumentuar fondi limit dhe çmimet janë marë nga OE me kontrate te ngjashme i është dërguar kërkesë për informacion OE “D. AL”, “Ë-C.” dhe “KLP” dhe nga kontrata e mëparshme qe ka pasur vete AK me OE “S.-AL” dhe çmimi me kontratën e rivlerësuar nga AK është 5.63 leke per njesi.

Konkluzionet: Në përbërje të grupi nuk ka përgjegjes grupi si dhe anetari z. A. L. eshte teknik i mesem dhe nuk është me arsim të lartë por me arsim të mesem. Veprimet e mesiperme jane ne kushdeshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2 ku citon:Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoriteti

kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. O. G.

Argumentimi i kritereve te vecanta.

Me nr.549/1 date 10.03.2020 është bërë argumentimi i kritereve të vecanta nga anëtarët e NJHD.

Nga Njhd në DST "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", pika 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë I certifikuar si me poshte. Për plotesimin e kesaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqese certifikaten e kerkuar per:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 18001 ose ISO 45001. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Konkluzinet: Në përbërje të komisionit nuk ka person përgjegjës veprime janë në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2 ku citon: *Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.*

Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: Znj. O. G.

Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin nr.549/5 datë 12.03.2020, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës, ku është bërë evidentimi i operatoreve pjesëmarrës në procedure:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	"S. AL"	6,406,235	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr.549/9 prot datë 13.03.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 (nje) operator, dhe shpallur fitues OE "S. AL".

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës titullari i AK ka lidhur kontrata me nr.549/10 prot datë 13.03.2020, me afat 122 ditë nga moment i nënshkrimit të marrëveshjes, me të drejtë zgjidhje përpara përfundimit të kontratës, me lidhjen e kontratës së procedurës "E hapur – Marrëveshje kuadër" nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Konkluzionet: Në përbërje të grupi te KVO nuk ka person përgjegjës grupi kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i

ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 58 ku citon : “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës” 65 . Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: znj. O. G.

15-Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Kite dhe Reagent”, për vitin 2020 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Kite dhe reagent”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.10 Datë 25.02.2020.	3.Hartuesit e Dokumente vetë Tenderit Urdhër Nr. 41, dt. 19.02.2020 1.Znj. R. B. 2.Znj.P. M. 3.Znj. E. H.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Urdhër Nr.42. Dt 10.02.2020 1.Znj.K. T. 2.Znj. O. M. 3.Znj.L. M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 1,267,200 lekë Loti I. 1,000,000 lekë Loti II. 267,000 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 1,259,200 lekë Loti I. 992,000 lekë Loti II. 267,200 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Loti I. 8,000 Lekë Loti II. 0
8. Data e hapjes së tenderit Loti I. 27.03.2020 Loti II. 09.03.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Loti I. 2 OE, Loti II. 1 OE b)S’kualifikuar Loti I. 1 OE, c) Kualifikuar Loti I. 1 OE Loti II. 1 OE
11.Ankimime AK-ka; për DST Loti I , para hapjes së tenderit. APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës AK ndryshuar DST për Lotin I.	13.Përgjigje S’ka
b. Zbatimi i Kontratës së Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Loti I, Nr. Nr.12/1 me Nr. 405/21Prot. datë 27.03.2020 Loti II, Nr.12 me Nr. 405/15 Prot. datë 19.03.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSH). Loti I. 1,190,400 lekë Loti II. 320,640 lekë	16. Likuiduar deri: më datën 31.12.2020 Loti I. 1,190,400 lekë Loti II. 320,640 lekë
17. Situacioni Përfundimtar/FaturëMalli/Shërbimi Vlera me tvsh 1,511,040lekë	18.Afati i kontratës: Loti I. 31.12.2020 Loti II. 31.12.2020	19.Zgjatja e kontratës

1. Llogaritja e fondit limit është hartuar në bazë të Urdhrit Nr.28 datë 04.02.2020 me përbërje K. Xh., K. T. dhe E. B., dhe me Proces Verbalin nr 290 prot. datë 11.02.2020 është në shumën 1,267,200 lekë pa TVSH nga këto, Loti I. 1,000,000 lekë pa TVSH dhe Loti II. 267,200 lekë pa TVSH.

12. Procesverbali i hartimit të kriterëve të veçanta datë 25.02.2020, nga anëtarët e NJHD.

13. Njoftimi i kontratës me shkresën nr.405/2prot, datë 25.02.2020 për Lotin I dhe me shkresën nr 405/3 datë 25.02.2020 për Lotin II, publikuar në buletin e APP.

14. Formular ankese nr.2 prot. datë 02.03.2020.

15. Urdhër pezullimi nr.448 prot. datë 02.03.2020.

16. Urdhër grup pune nr.449 prot datë 02.03.2020 për sqarimin e ankesës.

17. Proces verbal nr. 464 prot. datë 03.03.2020 për argumentimin e ndryshimeve në DST.

18. Shkresë për ndryshimin e DST, nr.405/4 datë 03.03.2020

19. Procesverbali i KVO nr.405/5, datë 09.03.2020 i hapjes së procedurës për Lotin II nga ku rezulton se ka marrë pjesë 1 OE.

20. Raport përmbledhës nr.405/6 prot. datë 17.03.2020 për Lotin II.

21. Formular i njoftim fituesi me nr.405/7 datë 17.03.2020 për Lotin II.
22. Kontrata me OE fitues "G." shpk nr.405/15prot. datë 19.03.2020 me vlerë 267,200 lekë pa TVSH dhe vlera 320,640 lekë me TVSH.
23. Raporti përmbledhës nr.405/20 datë 27.03.2020, për Lotin I
24. Formular i njoftim fituesi me nr.405/18 datë 25.03.2020 për Lotin I.
25. Kontrata me OE fitues "B. A. D." me Nr.12/1, datë 27.03.2020 me vlerë 992,000 lekë pa TVSH dhe vlera 1,190,400 lekë me TVSH.

Zhvillimi i procedurës.

Me Urdhër nr.448, datë 02.03.2020, procedura e prokurimit është pezulluar dhe shtyrë afati i dorëzimit të ofertave deri në ndryshimin e DST pasi një nga OE ka bërë ankesë se certifikatat ISO të kërkuara në DST nuk janë në fuqi.

Me procesverbalin nr.405/5 datë09.03.2020 për Lotin II, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Me procesverbalin nr.405/14 datë19.03.2020 për Lotin I, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.

Vlerësimi dhe klasifikimi i ofertave ekonomike, për të dy lotët si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'Kualifikuar
Loti I			
1	"B. A. D."	992,000	Kualifikuar.
2	"K." shpk		S'Kualifikuar pasi ka patur mangësi në DST dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
Loti II			
1	"G."	267,200	Kualifikuar.

Për Lotin I, KVO ka hartuar Raportin përmbledhës nr.405/14 datë 19.03.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 OE dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Titullari i AK për Lotin I, më datë 26.12.2019 ka shpallur fituese ofertën e OE "B. A. D." me të cilën është lidhur kontrata Nr. 12/1 datë 27.03.2020 me vlerë 992,000 lekë pa TVSH dhe vlera 1,190,400 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes deri 31.12.2020.

Për Lotin II, KVO ka hartuar Raporti përmbledhës, nr.405/6 datë 17.03.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti Përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit ka patur një operatorë pjesëmarrës i cili është kualifikuar.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Titullari i AK për Lotin II, më datë 17.03.2020 ka shpallur fituese ofertën e OE "G." shpk me të cilën është lidhur kontrata Nr. 12 datë 19.03.2020 me vlerë 267,200 lekë pa TVSH dhe vlera 320,640 lekë me TVSH, me afat zbatimi nga data e lidhjes deri 31.12.2020.

Konkluzion

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për procedurën e tenderimit, kërkesa për propozim, me objekt "Kite dhe Reagent" me fond limit 1,267,200 lekë pa TVSH e ndarë në dy Lote, dhe kontrata të lidhura, Loti I: Kontrata Nr.12/1, datë 27.03.2020 me vlerë 992,000 lekë pa TVSH me OE "B. A. D." dhe Loti II: Kontrata Nr. 12 datë17.03.2020 me vlerë 267,200 lekë pa TVSH me OE "G." ku afati i zbatimit të kontratës është 31.12.2020 konstatohet se:

- Në urdhrin nr.42 datë 19.02.2020 për ngritjen e KVO nuk është përcaktuar kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58 ku thuhet:

Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit

- Llogaritja e fondit limit është argumentuar me proces verbalin Nr.290prot. datë 11.02.2020. Nga auditimi i dokumentacionit nuk gjenden gjurmë që vërtetojnë se si është llogaritur fondi limit, kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku thuhet:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë :çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

17. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,

18. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

9) O. G. me detyrë, Drejtor në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

10) K. Xh. në cilësinë e anëtares të komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.28,datë 04.02.2020

11) K. T. në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.28, datë 04.02.2020

12) E. B. në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit sipas urdhër nr.28, datë 04.02.2020

Për kontratën **“Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

• *Kontrata e zbatimit Nr.34 me objekt “Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019”.*

• *Korrespondenca me Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme.*

• *Dokumentacioni teknik, situacionet pjesore dhe librezat e realizimit të punimeve.*

• *Urdhrat e Brendshëm.*

Titullari i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me shkresën Nr.351 Prot. datë 15.02.2019 i është dërguar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme për nevojat e parashikuara për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, impjantistikës, pajisjeve të zyrave dhe hotelerisë për një periudhë 24 muaj me situacionin përkatës. Situacioni përkatës është hartuar dhe firmosur nga punonjësi A. L. me profesion teknik i mesëm. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, kërkesa e dërguar për mirëmbajtjen nuk është e argumentuar, për arsye se:-nuk konstatohet se në cilat godina do kryhet riparimi si dhe gjendja aktuale e këtyre godinave (volumet e punimeve të shoqëruara me vizatimet dhe planimetritë e tyre, fotografi, etj.).-nuk konstatohet kërkuesi dhe miratuesi i kryerjes së këtyre punimeve,-nuk konstatohet urdhri për caktimin e z. A.L. ose të një grupi pune për hartimin preventiv.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se:

“Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt

të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Për nisjen e procedurës pa dokumentacionin e mësipërm, mban përgjegjësi ish titullari i AK, z. K. Ll.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme me shkresën Nr.56/6 datë 07.10.2019 ka autorizuar Spitalin Psikiatrik “AliMihali” Vlorë për lidhjen e kontratës me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Psikiatrik ‘AliMihali’ Vlorë*” sipas marrëveshjes kuadër me afat 24 muaj Nr.56/5 datë 04.10.2019 me BOE “E. B&B” shpk dhe “A.” shpk, ofertë fituese me vlerë 5,256,000 lekë me TVSH, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” me REF-35054-09-04-2019. Për sa më sipër është lidhur kontrata e zbatimit Nr.34 me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” me Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 midis Spitalit Psikiatrik “AliMihali” Vlorë dhe BOE “E. B&B” shpk dhe “A.” shpk. Afati i zbatimit të kontratës është 24 muaj nga data e lidhjes së saj, kjo sipas marrëveshjes kuadër dhe nenit 4, “Afatet e shërbimeve”. Me Urdhër Nr. 233, nr.1884prot. datë 18.01.2019 është krijuar komisioni për mbikëqyrjen e kontratës, “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave Nr.34 me Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019*”, me përbërje O. M. në pozicionin e magazinieres, ekonomiste, A. L. shef i sektorit teknik, teknik i mesëm, F. M. mirëmbajtës, marangoz.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se asnjë nga punonjësit e komisionit të mbikëqyrjes nuk është i pajisur me licencën përkatëse të mbikëqyrjes së punimeve, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, i cili përcakton se:

Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi ipunimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik osejuridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjëmënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë.

Për ngarkimin e komisionit për mbikëqyrjen e punimeve i cili nuk është i pajisur me licencën përkatëse, mban përgjegjësi titullari i znj. O. G.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për kontratën e zbatimit Nr.34 me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” me Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 konstatohet se Formulari i Garancisë së Kontratës nr. 0002494 datë 15.10.2019 lëshuar nga kompania e sigurimit “S. International” ka afat deri më datë 15.10.2020. Afati i përfundimit të kontratës është 24 muaj, datë përfundimi 15.10.2021. Për sa më sipër kontrata e zbatimit të punimeve nuk është e mbuluar me garanci gjatë gjithë kohës së zbatimit të saj. Kjo në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 24, pika 1 dhe 2 ku thuhet:

1. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

2. Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25% të vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Znj. O. G. në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në terren në prezencë të audituesve shtetërorë të KLSH dhe dy pjesëtareve të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës u konstatuan diferenca në volume të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **191,280 lekë me TVSH**, të argumentuara këto si më poshtë:

Në kategorinë, Punime Hidroizolim, zëri Hidroizolim emulsion bitumi dhe 1 shtrese k-katrama në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 200 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, është likuiduar në situacionet pjesore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga vizita në terren konstatohet se në godinën Ego-terapi hidroizolimi në një sipërfaqe prej 60 m² (12mx5m) mungon dhe nuk ka gjurmë që tarraca të jetë e lyer me emulsion bitumi. Gjithashtu në godinën ish pavijoni nr.5 konstatohet se shtresa k-katrama nuk është e lidhur me tarracën dhe nuk ka gjurmë të lyerjes së saj me emulsion bitumi në një sipërfaqe prej 24 m² (2mx12m). Hidroizolimi i tarracës nuk është realizuar sipas specifikimeve teknike ku mungon lyerja e saj me emulsion bitumi dhe volumi i punimeve për këtë zë nuk do të merret në konsideratë si punë e kryer. Sa më sipër sipërfaqja prej 200 m² nuk është realizuar sipas standardeve dhe për këtë sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 200 m² të zërit Hidroizolim emulsion bitumi dhe 1 shtrese k-katrama në vlerën **90,000 lekë pa TVSH** (200 m²*450 lekë/m²).

Në kategorinë, Punime Hidroizolim, zëri Shtrese llustërçimento 1:2, t = 20 mm në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 200 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, është likuiduar në situacionet pjesore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga vizita në terren konstatohet se shtresa llustër çimento nuk është e realizuar për të gjithë volumin e punimeve të likuiduar. Për sa më sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 200 m² të zërit Shtrese llustërçimento 1:2, t = 20 mm në vlerën **40,000 lekë pa TVSH** (200 m²*200 lekë/m²).

Në kategorinë, Punime Hidroizolim, zëri Kasete shkarkimi me llamarine xingat në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 4 copë dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, është likuiduar në situacionet pjesore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga vizita në terren konstatohet se kasetat e shkarkimit nuk janë realizuar përtë gjithë sasinë e likuiduar. Për sa më sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 4 copë të zërit Kasete shkarkimi me llamarine xingat në vlerën **4,000 lekë pa TVSH** (4 copë*1,000 lekë/copa).

Në kategorinë, Punime Hidroizolim, zëri Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm 731 në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 2 copë dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, është likuiduar në situacionet pjesore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga vizita në terren konstatohet se ulluku i shkarkimit nuk është e realizuar për të gjithë sasinë e likuiduar. Për sa më sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 2 copë të zërit Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm 731 në vlerën **2,400 lekë pa TVSH** (2 copë*1,200 lekë/copa).

Në kategorinë, Punime Hidroizolim, zëri Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 90-120 mm në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 40 ml dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, është likuiduar në situacionet pjesore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga vizita në terren konstatohet se ulluku i shkarkimit nuk është e realizuar për të gjithë sasinë e likuiduar. Për sa më sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 40 ml të zërit Ulluk shkarkimi vertikal PVC Ø 90-120 mm në vlerën **14,000 lekë pa TVSH** (40m*350 lekë/m).

Në kategorinë Punime Dyer Dritare zëri i punimeve Riparim dery duralumin (element dural, brava, mentesha, doreza, llastik, etj), në librezën e masave pasqyrohet 60 copë të riparuar dhe po e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar. Nga verifikimi në terren u konstatua se 10 copë të situacionuara dhe të likuiduara në situacionet pjesore, nuk janë riparuar. Për sa më sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 10 copë të zërit Riparim dery duralumin (element dural, brava, mentesha, doreza, llastik, etj) në vlerën **9,000 lekë pa TVSH** (10 copë*900 lekë/copa).

Veprimet e komisionit të mbikëqyrjes të kontratës janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III neni 7, ku përcaktohet se:

Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:Pika 8.1:

Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

3.2 *Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

3.3 *Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*

Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi Komisioni i Mbikëqyrjes së kontratës z. A. L., z. F. M. dhe znj. O. M.

Për sa më sipër është paraqitur observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit, me shkresën nr.149/8 datë 12.10.2021, nga OE BOE “E. B&B shpk dhe “A.” shpk:

Pretendimet e subjektit të audituar:

Kontraktori pranon që ka qënë një lapsus nga ana e stafit të tij në llogaritjen e volumeve të punimeve dhe hartimin e situacionit pjesor. Duke qene se objekti është në përfundim të afateve te kontates, do merren masa në riparimin dhe kryerjen me sukses të këtyre zërave të punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

Observacioni merret pjesërisht parasysht dhe u reflektua në Raport.

1. Titulli i gjetjes:

Mangësi në dokumentacion për fillimin e procedurës së prokurimit.

- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se Spitali Psikiatrik Vlore ka dërguar shkresën Nr.351 Prot. datë 15.02.2019 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, kjo për nevojat e parashikuara, për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, impjantistikës, pajisjeve të zyrave dhe hotelerisë për një periudhë 24 muaj me situacionin përkatës. Situacioni përkatës për punimet e nevojshme është hartuar dhe firmosur nga punonjësi A. L. me profesion teknik i mesëm. Nga auditimi konstatohet se kërkesa e dërguar për mirëmbajtjen nuk është e argumentuar, konkretisht: -nuk përcaktohet se në cilat godina do kryhet riparimi si dhe gjendja aktuale e këtyre godinave (volumet e punimeve të shoqëruara me vizatimet dhe planimetritë e tyre, fotografi, etj.). - nuk ka gjurmë që vërteton kërkuetin dhe miratuesin për nevojën e kryerjes së këtyre punimeve; mungon urdhri për caktimin e z. A. L. ose të një grupi pune për hartimin preventiv.

Situata:

- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “ Mirmbajte e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise ”,me këto të dhëna:**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet arsyeja e kryerjes së kësaj procedure, për arsye se:

- nuk ka akt-konstatime për gjëndjen aktuale të këtyre godinave.
- nuk ka akt-konstatim mbi gjëndjen dhe pse duhet të riparohet ashensori.
- nuk ka akt-konstatim ku të kerkohet riparimi i ashensorit.

Situacioni përkatës për punimet e nevojshme është hartuar dhe firmosur nga punonjësi A. L. me profesion teknik i mesëm. Nga auditimi konstatohet se kërkesa e dërguar për mirëmbajtjen nuk është e argumentuar, konkretisht: -nuk përcaktohet se në cilat godina do kryhet riparimi si dhe gjendja aktuale e këtyre godinave (volumet e punimeve të shoqëruara me vizatimet dhe planimetritë e tyre, fotografi, etj.). - nuk ka gjurmë që vërteton kërkuetin dhe miratuesin për

nevojën e kryerjes së këtyre punimeve;- mungon urdhri për caktimin e z. A. L. ose të një grupi pune për hartimin preventiv.

Kriteri:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se: “*Dokument financiar*” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative

Ndikimi/Efekti:

Kryerje punimesh mirëmbajtjeje të pa nevojshme si dhe mosplotësim i dokumenteve justifikues

Shkaku:

Mosnjohje e legjislacionit në fuqi.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

SPV të marrë masa, që në të ardhmen, për parashikimin e punimeve të nevojshme në mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore të kryej një vlerësim dhe dokumentim real të tyre, nisur nga fakti i amortizimit të madh të këtyre objekteve.

2. Titulli i gjetjes:

Sigurimi i kontratës jashtë afateve të zbatimit.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për kontratën e zbatimit Nr.34 me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” me Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 konstatohet se Formulari i Garancisë së Kontratës nr. 0002494 datë 15.10.2019 lëshuar nga kompania e sigurimit “S. International” ka afat deri më datë 15.10.2020. Afati i përfundimit të kontratës është 24 muaj, datë përfundimi 15.10.2021. Kontrata me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” nuk është e mbuluar me garanci gjatë gjithë kohës së zbatimit të saj e cila e krijon risk për AK në rast të mosplotësimit të detyrimeve kontraktuale nga sipërmarrësi.

Kriteri:

VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 24, pika 1 dhe 2 ku thuhet:

1. *Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.*
2. *Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25% të vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës*

Ndikimi/Efekti:

Risk për AK në rast mosplotësimi të detyrimeve kontraktuale nga sipërmarrësi.

Shkaku:

Sigurimit i kontratës jo në përputhje me afatet e zbatimit të saj.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

SPV të kërkoj që sipërmarrësi i punimeve BOE “E. B&B” shpk dhe “A.” Shpk të paraqesin një sigurim kontrate deri në afatin përfundimtar të saj.

3. Titulli i gjetjes:

Punime të situacionuara por të pakryera si dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për kontratën me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Psikiatrik ‘AliMihali’ Vlorë*”, të lidhur midis Spitalit Psikiatrik Vlorë dhe BOE “E. B&B” dhe “A.” shpk, Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 me vlerë **4,380,000 lekë pa TVSH** ose **5,256,000 lekë me TVSH**, me afat përfundimi të punimeve 24 muaj, konkretisht:

- *Kontrata e zbatimit.*
 - *Dokumentacioni teknik, situacionet pjesore dhe librezat e realizimit të punimeve.*
- si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt si dhe të kryera jo sipas specifikimeve teknike. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Punime Hidroizolim	Hidroizolim emulsion bitumi dhe 1 shtrese k-katrama	90,000
2		Shtrese llustërcimento 1:2, t = 20 mm	40,000
3		Kasete shkarkimi me llamarine xingat	4,000

4		Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm 731	2,400
5		Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 90-120 mm	14,000
6	Punime Dyer Dritare	Riparim dere duralumin (element dural, brava, mentesha, doreza, llastik, etj	9,000
SHUMA			159,400

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

Kriteri: neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën **191,280 lekë me TVSH.**

Shkaku: Certifikimi nga ana e Komisionit të Mbikëqyrjes së kontratës volumeve të punimeve të pakryera në fakt si dhe jashtë kushteve teknike.

Rëndësia: E Lartë

SPV të marrë masa për kryerjen e punime brenda afatit të kontratës dhe garancisë së tyre në shumën **159,400 lekë pa TVSH**, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE “E. B&B” dhe “A.” shpk me Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.

4. Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve jo ne përputhje me objektin e prokurimit.

Situata:

Nga auditimi I dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në hartimin e dokumentave të tenderit janë vendosur kriterë jo ne përputhje me objektin e prokurimit dhe disa kriterë nuk janë argumentuar, konkretisht:

- **Procedura ë prokurimit “Kërkese per propozim” me objekt: ” Mirëmbajtje e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 22/06/2017.**

Certifikata ISO 9001-2008, e cila gjen referim ne llojin e objektit te prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 per sistemin e menaxhimit te mjedisit, 18001:2007 per sistemin e menaxhimit te cilesise ne pune dhe PAS 99:2012 per sistemin e integruar, nuk gjejne aspak referim, per sa kohe qe nuk i sherben AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, por vet OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes.

- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim”me objekt: “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 30/03/2018.**

Certifikata ISO 9001-2008, e cila gjen referim ne llojin e objektit te prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 per sistemin e menaxhimit te mjedisit, 18001:2007 per sistemin e menaxhimit te cilesise ne pune dhe PAS 99:2012 per sistemin e integruar, nuk gjejne aspak referim, per sa kohe qe nuk i sherben AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, por vet OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes.

- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “ Mirmbajte e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise ””,me hapur me date 30.06.2018.**

Ne formularin e ofertës në disa zëra është përdorur fjala Importi, cilësore Italiane dhe emri i markes "Gevis" përmendja e këtyre fjalëve dhe i markës është një kriter diskriminues, për arsye së nuk janë përdorur fjalët “ose ekuivalent”.

- **Procedura ë prokurimit “Kërkese per propozim” me objekt: ” Mirëmbajtje e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 21.02.2019.**

Nuk argumentohetse perse OE duhet te ketë te paktën 2 punonjës me certifikatë profesionale per instalimin e sistemeve termohidraulike.

Certifikata ISO 9001-2008, e cila gjen referim ne llojin e objektit te prokurimit, certifikatat e tjera si ISO 14001:2004 per sistemin e menaxhimit te mjedisit, 18001:2007 per sistemin e menaxhimit te cilesise ne pune dhe PAS 99:2012 per sistemin e integruar, nuk gjejne aspak referim, per sa kohe qe nuk i sherben AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, por vet OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes.

- **Procedura ë prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lavanterise dhe zëvendësimi me inventar te imët”, e hapur me date 26.09.2019.**
Kriteret per te pasur certifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë ne pune ISO 18001:2007, ISO 14001:2015 (Ekuivalent) - Sisteme të menaxhimit të mjedisit si dhe Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë :shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit. Kriteret e siperpermendur rezultojne te paargumentuara, per sa kohe qe nuk i sherbejne AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, pra OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes dhe sistemeve te menaxhimit te mjedisit dhe masave te mbrojtjes ndaj zjarrit.
- **Procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake te kontrates.” me objekt: “ Shërbimi i lavanterise dhe zëvendësimi me inventar te imet”, e hapur me date 12.12.2019.**
Kriteret per te pasur certifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë ne pune ISO 18001:2007, ISO 14001:2015 (Ekuivalent) - Sisteme të menaxhimit të mjedisit si dhe Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë :shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit. Kriteret e siperpermendur rezultojne te paargumentuara, per sa kohe qe nuk i sherbejn AK per sherbimin qe kerkon te marre, por i sherben vete subjektit ofertues, pra OE per realizimin sa me mire te proceseve te tij te punes dhe sistemeve te menaxhimit te mjedisit dhe masave te mbrojtjes ndaj zjarrit.

Kriteri:	Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punë publike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Kërkesat për kualifikim nuk jane hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e Operatorve ekonomik dhe nuk nxisin pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik,
Shkaku:	Mos njohja e mire e ligjit te prokurimve publike dhe vkm nr.914 per miratimin e rregullave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E larte
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit të marrë masa ku kriteret e vendosura për plotësimin e dokumentave standard të tendrit, të hartohen ne menyre jo diskriminuese apo orinetuese në mënyrë që tësigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të OE duke nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencës ndërmjet tyre . AK duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj OE.

5. Titulli i gjetjes: *Nuk ka personi pergjegjes grupi ne komisionet e Procedurava te prokurimeve publik.*

Situata: Iga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në hartimin e dokumentave të tenderit në urdhrin e ngritjes së njësisë së prokurimit dhe KVO u konstatua se nuk ka të përcaktuar person përgjegjës (Kryetar) i cili ështëpërgjegjës për organizimin e punës dhe mirëfunksionimin e komisioneve, nga ku konkretisht:

- **Procedurës së prokurimit me objekt: “Kite dhe Reagent”,për vitin 2017.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim”me objekt: “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 30/03/2018.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “ Blerje Kite dhe Reagent”,për vitin 2018.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “ Mirmbajtje e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise” e hapur me date 30/06/2018**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Procedura ë prokurimit “Kërkese per propozim” me objekt: ” Mirëmbajtje e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 21.02.2019.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.

- **Procedura ë prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lavanterise dhe zëvendësimi me inventar te imët”, e hapur me date 26.09.2019.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake te kontrates ” me objekt: “ Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imet”, e hapur me date 12.12.2019.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.
- **Procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt: “ Blerje medikamente”, e hapur me date 23.03.2020.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka kryetar person përgjegjës grupi.
- **Procedurës së prokurimit “Me negociim ,pa shpallje Paraprake” me objekt: “Shërbimi pastrimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme”, e hapur me date 12.03.2020.**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka kryetar person përgjegjës grupi.
- **Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Kite dhe Reagent”, për vitin 2020 .**
Ne komisionet e ngritura per kete procedure nuk ka person përgjegjës grupi.

Kriteri:	Vendim Nr 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, Neni 57: Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit.
Ndikimi/Efekti:	Kryetari i grupit eshte pergjegjes per organizimin e punes dhe mirefunksionimin e komisioneve.
Shkaku:	Mos njohja e mire e ligjit te prokurimve publike dhe vkm nr.914 per miratimin e rregullave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E larte.
Rekomandimi:	Nga Titullari i SPV ose personi i autorizuar prej tij te merren masa ku, për çdo procedurë prokurimi në përbërjen të njësisë së prokurimit apo Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit të përcaktojë personi përgjegjës të grupit (Kryetar grupi).

**6. Titulli i gjetjes:
Situata:**

Skualifikimi i padrejt i Operatorve ekonomik me oferte me te ulet.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se KVO ka skualifikuar ne menyre te padrejte OE me oferte me te ulet, konkretisht:

- **Procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” e hapur me date 30/03/2018.**
Nga shqyrtimi i dokumentave ne SPE konstatohet se OE ka paraqitur nje kontrate sherbimi te lidhur me nje ent publik, kontrata eshte lidhur me nr.3476/1 prot date 14.08.2015 midis Qendren Spitalore ”Nene Tereza” dhe BOE “C.” shpk dhe “A. K.”. Ne kontrate citohet se 95% te sherbimit do ta kryej “C.” shpk ndersa 5% “A. K”. Nderkohe me shkrese nr.2720/1 prot date 20.05.2016 ku citohet Vertetim per realizimin e kontrates: Kontrata eshte realizuar ne vleren 1,018.850 lek pa tvsh dhe 1,222.620 lek me tvsh shkresa eshte firmosur nga titullari i qsut me kerskese te OE. Tek specifikimet teknike citohet: Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate viteve 2015, 2016, 2017 te aktivitetit financiar sherbime te ngjashme me objektin e ketij prokurimi ne vleren 40% të vlerës së fondit limit. Sasai e punimesh perez 95% te kryera nga Oe vertetonte sherbimet e ngjashme te ketij OE ne vleren 40% të vlerës së fondit limit.
- **Procedura ë prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lavanterise dhe zëvendësimi me inventar te imët”, e hapur me date 26.09.2019.**
Komisioni i vlersimit te ofertave e ka skulifikuar pa te drejte OE ”U. S.” me oferte me te ulet per pikat .

1.Mungese deklarate per paraqitjen e ofertës se pavarur, sipas shtojcës 1/1.

2. Ofertuesi ka paraqitur çertifikata ISO ne gjuhe te huaj, te pa perkthyer ne gjuhen shqipe.

Përkatesisht për piken e parë AK nuk ka përdorur dokumentat standarte të tenderit, pasi në dokumenta e procedures nuk është përfshirë shtojces 1/1 (deklaratë për paraqitjen e ofertës së pavarur). Sic u shprehëm dhe më sipër pavarësisht së nga NJHDT është kërkuar tëk kriteret e veçanta Shtojca 1/1, në dokumentat e tenderit nuk gjëndet e

bashkangjitur kjo shtojce, ndërsa tek domomentat standarte të tenderit nuk gjendet kjo shtojcë si pjesë e dokumentave standate. Nderkohe per piken e dyte konstatojm se ISOT jane hedhur ne spe por nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, por theksojme se ISOT jane çertifikata nderkombetare dhe ne to mund te perkthehet vete nr i isos dhe perseri ky eshte nje devijim i vogel dhe nuk prek themelin e procedures.

Kriteri: *ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 1 "Objekti dhe qëllimr pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), neni 41 pika 1, Neni 46, Neni 53 pika 4, Neni 55 pika 2. Vendim Nr. 914, datë 29.12.2014, I Ndryshuar, Kreu III neni 10 si dhe neni 66 pika 3.*

Ndikimi/Efekti: *Dem ekonomik ne buxhetin e shtetit ne vleren 15,551,621 leke me tvsh.*

Shkaku: *Diskriminim dhe favorizim i Opertatorve ekonomik.*

Rëndësia: *E larte*

Rekomandimi: *Nga SPVtë kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 15,012,160 lekë, nga Komisionet e Vlersimit si dhe grupi i punës, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulet të përcaktuar si më poshtë vijon:*

1.Procedurës së prokurimit "Kërkesepër propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe çillerave" arkëtimi i vlerës 27,000 lekë nga Znj.S.N., Znj.M. C., Z. E. B. dhe ish titullari i AK z.K. Ll.

2.Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt: "Shërbimi i lavanderise dhe zëvendësimi me inventar te imët" arkëtimi i vlerës 14,985,160 lekë nga Znj. M. C., znj. K. T., znj. K. Xh., znj. K. Xh. Znj. O. M. dhe Titullari i AK znj. O. G.

7. Titulli i gjetjes:

Mbivendosje kontrate Shërbimi Evadim i mbetjeve urbane & Sherbim pastrim gjelberimi

- **Procedurës së prokurimit "Kerkes per propozim" me objekt: "Evadimi i mbetjeve urbane", e hapur me datë 02/03/2017.**

*Nga auditimi i procedurës për pikën 2 "Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)" dhe pikën 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilen operon Operatori Ekonomik "S.AI", me kontrat sherbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brëndshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithe siperfaqen e rrugeve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugeve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.**

Situata:

Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjme me një dëm ekonomik me vlerë 232,143.60 me tvsh.

- **Procedurës së prokurimit "Kerkes per propozim" me objekt: "Evadimi i mbetjeve urbane", e hapur me datë 23.02.2018.**

*Nga auditimi i procedurës për pikën 2 "Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)" dhe pikën 3 "Disinfektim për 2 pika (1*2)", të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilen operon Operatori Ekonomik "S. AI", me kontrat sherbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brëndshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithe siperfaqen e rrugeve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugeve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur**

me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.

Për mbivendosjet e mësipërme kemi të bëjme me një **dëm ekonomik me vlerë 234,864** me tvsh.

- **Procedurës së prokurimit “Kerkes per propozim” me objekt: “Evadimi i mbetjeve urbane”, e hapur me datë 18/03/2019.**

Nga auditimi i procedurës për pikën 2 “Siperfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilen operon Operatori Ekonomik “S. AL”, me kontrat shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithë siperfaqen e rrugeve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugeve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.*

Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me çfare do te kryet disinfektimi (lende, produkti ose solucioni).

Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjme me një **dëm ekonomik me vlerë 269,808** me tvsh.

Kriteri:

Kontrata nr.4558 datë 31.10.2014 “Pastrimi i Qytetit” e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe OE “D.” SHPK si dhe kontrata nr.77/13 datë 08.04.2016 e lidhur midis SPV dhe “S. AL” shpk

Ndikimi/Efekti:

Dem ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën **736,815.60** leke me tvsh

Shkaku:

Lidhje si dhe likuidim për dy kontrata te ndyshme per nje shërbim

Rëndësia:

E larte

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **736,815.60 lekë**, nga ish-titullari z.K. Ll., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”Vlorë”.

8. Titulli i gjetjes:

Mos Inventarizim i Dosjeve te Prokurimit per vitn 2017,2018,2019,2020

Situata:

Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve te auditimit për periudhën objekt auditimit në të gjithë rastet, dosjet nuk janë te inventarizuara dhe nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e specialistes se prokurimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13

Kriteri:

Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13

Ndikimi/Efekti:

Mos dokumentim fizik i procedurave te prokurimit.

Shkaku:

Mos inventarizim i dosjeve te prokurimit.

Rëndësia:

E Mesme.

Rekomandimi:

Nga njësia e prokurimit te merren masa të menjehershme, ku te inventarizohen dhe arkivohet te gjitha dosjet e prokurimeve publike te perfunduara për vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 si dhe per procedurat ne vijimësi.

9. Titulli i Gjetjes :

Shpenzim te kryera pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficence

Situata:

1.Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt: “Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” grupi i auditimi nga dokumentat e hedhura ne SPE nga OE “C.” konstatohet se Vertetimi i realizimit te kontrates me nje ent publik eshte origjinal. OE ka paraqitur nje kontrate pune e lidhur me nr.2738 prot date 20.12.2016 midis BOE “C.” SHPK dhe Ministria e Integritimit Europian. KVO nuk duhet te skualifikonte OE pasi ai ka pariqitur vertetim te realizimit nga nje ent publik, por duhet ti kerkonte informacion në lidhje me kontraten mbi ndarjen e punimeve dhe do të vërtetonte shërbimet e ngjashme dhe kapacitetet e tij. Referuar me siper diferenca midis OE “J. Z.” ofertuesi i shpallur fituese dhe skualifikimi i OE ” C.” me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 74,928 leke me tvsh**

2. Nga auditimit i procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake te kontrates me objekt: “Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imet”, Skualifikimi i OE ”U. S.” me ofertë me të ulët është i pa drejtë pasi KVO duhet të kërkonë informacion për Çertifikatat iso që ka dorezuar OE të cilat janë në gjuhe të huaj dhe janë përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtesis, të cilat mbajnë vulën dhe firmën e përkthyeses në cdo faqe të dokumentacionit si dhe gjithashtu janë të noterizuara me vertetim noterial te perkthimit te certifikatave ISO por në dokumentin e noterizuar nuk rezulton të jetë të shkruara të dhënat e noterit por këto dokumente permbajn pullën, firmen dhe vulën e tij si dhe numrin e repertorit dhe koleksionit. Referuar me siper OE ”A G S” difrenca midis ofertuesit të shpallur fituese dhe skualifikimi i OE ”U. S.” me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vleren 539,461 leke me tvsh.**

Kriteri:

Pika 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3.*

Ndikimi/Efekti:

Shpenzim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet ne vlerën 614,389 leke.

Shkaku:

Mos argumentim i kërkesave dhe shpenzimeve te kryera

Rëndësia:

I Lartë

Rekomandimi:

Titullari i AK të shqyrtojë **vlerën 614,389 lekë**(me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, gjatë 2 procedurave të prokurimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

- **Zbatimi i kontratave të lidhura midis AK dhe OE për “Shërbim Katering”, “Pastrim dhe Gjelberim i Ambjenteve te Brendshme dhe të Jashtme” si dhe “Sherbim Lavanderie” per vitin 2017,2018,2019,2020.**

Kontrata “Shërbim Kateringu”

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit u shqyrta dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratat e lidhura midis AK dhe OE
- Raportet e monitorimeve ditore dhe mujore për ndjekjen e zbatimit të kontratave
- Regjistrat e hyrjes dhe daljes së pacientëve, të cilët mbaheshin nga mjekët dhe raportoheshin nga hoteleria
- Urdhër shpenzimet mbi zbatimin e kontratës së kateringut

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve rezultoi:

Për vitin 2017- 2019, SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 568, datë 30.04.2013, me objekt “Shërbim kateringut”, për periudhën 01.05.2013-31.12.2019, me vlerë 363,777,750.3 lekë me TVSh, e nënshkruar nga operatorin ekonomik “S. Al” SHPK dhe Titullarin e Institucionit SPV. Sipas kësaj kontrate çmimi për dietë ushqimore për pacient është në vlerën 517.17 lekë pa TVSh dhe për dietë ushqimore për mjek roje është në vlerën 375.35 lekë pa TVSh. Sipas kontratës, çmimi do rivlerësohet çdo vit sipas normës së inflacionit të publikuar nga INSTAT. Realizimi i kësaj kontrate për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, sipas situacioneve mujore të paraqitura, është në vlerën 136,042,786 lekë.

Nga grupi i auditimit për periudhën 01.05.2017-31.12.2019, u realizua një krahasim i numrit të pacientëve të shtruar sipas Sektorit të Degës së Hotelarisë, Bllokut të dorëzimit të turnit dhe numrit të racioneve ushqimore ditore të furnizuara sipas Akt-Rakordimeve mujore, për të cilat nuk u konstatua diferenca.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës nr. 568, datë 30.04.2013, u konstatua se për vitet për 2017-2019, nga SPV është bërë rivlerësimi i çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke marre si reference inflacionin e publikuar nga INSTAT. Rivlerësimi është bërë duke lidhur kontrata midis OE dhe AK me objekt “Rivlerësim kontrate”, detajuar si më poshtë:

Kontrata	Periudha	Dieta ushqimore		Totali
		Për pacient	Për mjekun e rojës	
nr. 632/1, datë 21.08.2017	01.05.2016/30.04.2017	549.1	398.76	947.86
nr. 1050/1, datë 27.07.2018	01.05.2017/30.04.2018	560.95	407.13	968.08
nr. 1474, datë 05.08.2019	01.05.2018/30.04.2019	569.36	413.24	982.6

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë **me efekt prapa veprues**, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit.

SPV bazuar në këto kontrata rivlerësimi ka përllogaritur ndryshimet e çmimeve bazuar në inflacionin e publikuar nga INSTAT dhe :

- Me urdhër shpenzimin nr. 179, datë 05.09.2017 është paguar vlera prej 1,154,431 lekë subjektit “S. Al” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 568, datë 30.04.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot nr. 632/1, datë 21.08.2017 për shërbimin katering të realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2016-Maj 2017.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përllogaritur për periudhën 01.05.2016-31.08.2017.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas kësaj periudhe e deri në Tetor 2018 çmimi është indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për dietën ushqimore për pacient ka qenë në vlerën 549.41 leke dhe për dieta ushqimore për mjekun e rojës në vlerën 398.76 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 238, datë 08.10.2018 është paguar vlera prej 1,150,818 lekë subjektit “S. Al” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 568, datë 30.04.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1050/1, datë 27.07.2018 për shërbimin katering të realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2017-Maj 2018.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përllogaritur për periudhën 01.05.2017-31.07.2018.

Për të gjithë shërbimin e realizuar në periudhën në vazhdimësi çmimi është indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për dietën ushqimore për pacient ka qenë në vlerën 560.95 leke dhe për dieta ushqimore për mjekun e rojës në vlerën 407.13 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 197, datë 04.09.2019 është paguar vlera prej 910,931 lekë në favor të subjektit “S. Al”, për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 568, datë 30.04.2016. Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1494, datë 05.08.2019 për shërbimin katering të realizuar dhe të likuiduar nga SPV për periudhën Maj 2018-Maj 2019.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është bërë për periudhën 01.05.2018-31.08.2019.

Për të gjithë shërbimin e realizuar në periudhën Tetor 2019 e në vazhdimësi çmimi është indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për dietën ushqimore për pacient ka qenë në vlerën 569.36 lekë dhe për dieta ushqimore për mjekun e rojës në vlerën 413.24 lekë.

Konstatimi:

Nga sa më sipër konstatohet se për:

- Periudha Maj 2017 - Korrik 2017 ne vlerën 291,813 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin me nr. 179, datë 05.09.2017 dhe më pas me urdhër shpenzimin me nr. 238, datë 08.10.2018.

- Periudha Maj 2018 - Korrik 2018 ne vlerën 236,195 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin nr. 238, datë 08.10.2018 dhe më pas me urdhër shpenzimin nr. 197, datë 04.09.2019.

Në kontratën nr. 568, datë 30.04.2013 e lidhur mes AK dhe OE në nenin 4 pika 4.3 dhe 4.6 citohet se çmimet duhet të rivlerësohen në mënyrë progresive çdo vit.

Indeksimi i çmimeve realizohet për mallrat dhe shërbimet për periudhat e ardhshme dhe jo për mallrat dhe shërbimet të periudhave të mëparshme.

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga sa cituam më sipër gjithashtu konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim i periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

SPV e keq interpreton pikat 4.3 dhe 4.6 të kontratës së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese. Pikat 4.3 dhe 4.6 të kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 4.3 dhe 4.6* i Kontratës Tip dhe as ndonjë *dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit.

Kontrata me nr. 568, datë 30.04.2013 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar, kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi *ripërtëritjeje*, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për *rishikimin e*

vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën **1,154,431 lekë**

- për vitin 2018 në shumën **1,150,818 lekë**

- për vitin 2019 në shumën **910,931 lekë**, në total në shumën prej **3,216,180 lekë** përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.**

Me datë 31.12.2019 është lidhur amendamenti kontrata shërbimi “Shërbim cateringu për SPV, Vlorë protokolluar me nr. 2202 datë 31.12.2019 miratuar nga AK dhe OE “S. AL”, për periudhën 01.01.2020 me të drejtë shkëputje me lidhjen e kontratës pas shpalljes së procedurës së hapur me të njëjtin objekt prokurimi, me një fond limit 9,094,444 lekë pa TVSh dhe në vlerën 10,913,328 me TVSH.

Realizimi i amendamentit të sipërpërmendur është likuiduar në vlerën 10,312,053 me TVSH.

Për vitin 2020, me autorizimin nr. 80/9 prot. datë 27.03.2020, nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si Organ Qendror Blerës, pas përfundimit të procedurës së prokurimit “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, ka autorizuar SPV të lidhi kontratën me OE të shpallur fitues “S. AL” me ofertë ekonomike **166.021.272 lek** pa TVSH.

SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4 lekë** pa TVSh, me operatorin ekonomik “S. AL” SHPK.

Nga auditimi u konstatua se fondi limit i autorizuar sipas ABP, në të cilin ka shpallur fitues OE “S. AL” shpk për periudhën 4 vjeçare nuk është i njëjtë me fondi limit të caktuar në kontratën që SPV me OE kanë lidhur, me një diferencë **prej 835,178.40 lekë.**

Vlera e kontrate për periudhën 8-mujore 03.04.2020 – 31.12.2020 është 30,929,990.40 lekë pa TVSH dhe 37,115,988.48 me TVSH.

Sipas kësaj kontrate çmimi për dietë ushqimore për pacient është në vlerën **566.51 lekë** pa TVSh dhe për dietë ushqimore për mjek roje është në vlerën **411.20 lekë** pa TVSh.

Sipas pikës nr. 3.6 së kontratës citohet se *“Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në fuqi të MK nr. 80/8 Prot, datë 27.03.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakort që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”*.

Realizimi i kësaj kontrate për periudhën 8- mujore deri me 30.12.2020, sipas situacioneve mujore të paraqitura, është në vlerën **33,783,584 me TVSH.**

Me kontratën nr. 44 datë 30.12.2020 është rilidhur kontrata midis OE dhe AK referuar Marrëveshjes Kuadër për periudhën një vjeçare 01.01.2021-31.12.2021 në shumën 41,505,318 lekë pa TVSH me çmimet për njësi të pandryshuara si në kontratën sipërpërmendur.

Realizimi i kësaj kontrate për periudhën 03.04.2020 – 31.01.2021, sipas situacioneve mujore të paraqitura, është në vlerën 34,215,151 lekë.

Në shkresën nr. 80/8, datë 27.03.2020 të marrëveshjes kuadër midis Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara dhe Operatorit Ekonomik fitues të tenderit catering në piken 1.4 citohet se *“..... kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do të lejohet të beje ndryshime të çmimit të njësisë.....”*.

Gjithashtu edhe në kundërshtim me nenin 60 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili citon qartësisht në paragrafin “Rregullat që zbatohen për kontratën” se..... *“Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të parashikuara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”*.

Pra dhe në kontratën e lidhur midis AK dhe OE me nr. 13 datë 03.04.2020 në nenin 3 “Vlera e Kontratës” pika 3.6 ku citohet *“Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në*

fuqi të MK nr. 80/8 Prot, datë 27.03.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”, **SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese**, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4.

Observacion i subjektit mbi Projekt raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit me shkresën nr.149/7, datë 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: Parashikimi i rivlerësimit të çmimeve është mbështetur në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Pika 2, e Nenit 9 ku parashikohet se: “Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar”.

Kontrata bazë e nënshkruar përcakton indeksimin e çmimeve në mënyrë progresive vit pas viti. Amendimi i Kontratës (kontrata e rivlerësimit) që zbatohet për indeksimin e çmimeve zbaton kushtet e kontratës/marrëveshjes bazë duke e mbajtur indeksin e çmimeve të azhurnuar në mënyrë progresive (rivlerësuar).

Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit (norma e inflacionit e shprehur në përqindje), publikohen nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe gjithmonë i referohen periudhës paraardhëse.

Një vit pas nënshkrimit të kontratës bëhet rivlerësimi i Kontratës së Shërbimit sipas ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT. Në këtë rast me nënshkrimin e amendimit për rivlerësimin e kontratës, Kontraktorit i lind e drejta të llogaris rivlerësimin si më poshtë:

- Llogarit rivlerësimin e çmimit për periudhën vjetore paraardhëse. Pra për periudhën paraardhëse (përfshirë edhe vitin e parë të kontratës) kemi një rritje të çmimit të shërbimit sipas indeksit të inflacionit të publikuar për periudhën përkatëse dhe Kontraktuesit i lind e drejta të marrë diferencën e çmimit të papaguar **ashtu sikundër në rast deflacioni porositesit i lind e drejta që të merrte mbrapsht diferencën e shumës “tepër” të paguar më parë për shërbimin e kryer gjatë kësaj periudhe dhe**

- Llogarit rivlerësimin e çmimit në mënyrë progresive për vitin në vijim sipas Indeksit të inflacionit në të cilën përcaktohet, çmimi i ri i indeksuar për shërbimin që do të ofrohet nga Kontraktuesi në vijim po për një periudhë një vjeçare.

- Nuk ka dublim të pagesës për te tre vitet objekt auditimi, për arsye se pagesa e kryer me urdhër shpenzimin nr. 179, datë 05.09.2017; me nr. 238, datë 08.10.2018 dhe me nr. 197, datë 04.09.2019 janë **diferenca e indeksimit të çmimit për periudhën** e aplikuar në faturën e muajit vijues.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Inflacioni nuk ka kuptimin e indeksimit dhe vlerësimit të çmimeve të periudhave paraardhëse. Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

Kontrata me nr. 26, datë 29.03.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për

mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Nga auditimi i pagesave të realizuar nëpërmjet nga SPV në favor të subjektit konstatohet se çmimet për këto mallra dhe shërbime janë indeksuar nga dy e më shumë herë, të analizuar sipas urdher shpenzimeve, ku është publikuar pagesat pasi është aplikuar indeksi i çmimit të periudhës dhe më pas është aplikuar përsëri indeksi i periudhës pasardhëse kur është bërë rivlerësimi i çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të realizuara në periudhat paraardhëse. Muajt e konstatuar janë për të treguar se si nga AK/SPV ka indeksuar nga dy e më shumë herë çmimet për këto mallra dhe shërbime. Vlera totale e dëmit i përlogarit nga grupi i auditimit është për të gjithë indeksimin e çmimeve për periudhën vjetore paraardhëse.

Për sa më sipër trajtuar Observacioni nuk merret në konsideratë.

Verifikimi në terren mbi zbatimin e kushteve të kontratës:

Referuar kushteve të kontratës së lidhur midis AK dhe OE, grupi i auditimit me datë 30.03.2021 gjatë fazës në terren, ka kryer verifikimin e plotësisht të këtyre kushteve, nga ku ka mbajtur dhe Akt Verifikimit nr. 600 datë 31.03.2021, nga ku rezultoi se:

Gatimi i ushqimit bëhet me sistem gazi GLN, ku cisterna ishte e instaluar nën tokë, me kapacitet 1750 litra.

Pas gatimit të ushqimit sipas dietave përkatëse si dhe numrit të të shtruarve të marre nga Hotelaria, punonjësit e kompanisë shpërndanin ushqimet në një ambient mence për *pavijonin akut dhe pranim*. Pas shpërndarjes së ushqimit për secilin pacientet, bëhet mbledhja e enëve, të cilat lahen në ambientet e mences në lavamanët përkatës (bashkëlidhur ndodhen fotot e ambienteve të sipërpërmendur).

Për QKSHM, godine e cila ndodhet disa metra më larg nga Spitali, ushqimet për pacientet e shtruar në QKSHM në ambientet e kuzhinës ishin përgatitur të mbledhura në vasketa si dhe në enët metalike. Këto ushqime transportohen me makine në mini kuzhinën e QKSHM, ku nga aty bëhet ndarja për secilin nga pacientet në mence të QKSH. Pas ngrënies së ushqimit, enët lahen nga punonjësit e OE, në mini kuzhinën e QKSHM. (bashkëlidhur ndodhen fotot e ushqimit). Në QKSHM ndodhet dhe një ambient i cili mban çarçafët, batanijet si dhe ndërresat e pacienteve.

Për pavijonin kronik- Gra, godine e cila ndodhet në një gjendje të mjerueshme (bashkëlidhur fotot), kryhet e njëjta procedure, ku ushqimi dërgohej në mini kuzhinën e pavijonit dhe pas vendosjes në mini kuzhinë shpërndahet nëpër racione në mence të pavijonit. Pas përfundimit të vakteve nga pacientët, punonjësit e OE në mini kuzhinën e pavijonit bënte larjen e enëve (bashkëlidhur fotot).

Për pavijonin kronik-Burra, gjatë vëzhgimit nga grupi i auditimit si dhe kalimit në ambientet e kuzhinës, u pa se transportimi i ushqimit të pacienteve bëhet nga vet pacientet. (bashkëlidhur fotot).

Në pavijon ndodhet një mini kuzhinë në të cilën bëhet vendosja e ushqimit dhe nga mini kuzhina, në ambientin e mences, nëpër tavolinat përkatëse. Pas përfundimit të vakteve nga pacientët,

punonjësit e OE në mini kuzhinën e pavijonit bënte larjen e enëve (bashkëlidhur fotot) dhe vendosja e tyre në një dollap po në këtë ambient. (bashkëlidhur fotot).

Konstatimi:

Referua konstatimeve të sipërpërmendur, grupi i auditimit konkludoi se një pjesë e kushteve të kontratës nuk janë zbatuar, kushte të cilat nën gjykimin tonë përbejnë themelin e krijimit të kësaj kontrate:

1. Shërbimi i ushqimit, referuar kontratës nën nr. 12 të kontratës duhet të sigurojë “një higjienë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit.....”, nga auditimi u konstatua se ambientet e mini kuzhinave, enët të cilat OE përdorte për shërbimin e ushqimit, si dhe mënyra e transportimit të ushqimit deri tek pacientët, ishte në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së lidhur (prova materiale foto e realizuara gjatë verifikimit në terren). Vetëm ambienti i kuzhinës ku gatuhet ushqimi, plotëson kushtet

e kontratës, ndërsa të gjitha mini kuzhinat e tjera nuk përmbushnin asnjë nga kusht higjienosanitarë.

2. Nga auditimi i materialeve të imta, të cilat duhet ti sigurojë kontraktuesi si, luge pirunj, thika, tabaka referuar nenit nr. 13 “Përgatitja e pjatave, lugëve, pirunjve dhe tabakave, etj., si dhe pastrimi i mëtejshëm i tyre, është detyrë e Kontraktuesit, u konstatua se përveç mbajtjes dhe ruajtjes së tyre në një ambient si dhe në një tip dollap, i cili nuk siguronte **asnjë kusht higjienosanitar** dhe ku materialet e imta ishin në një gjendje total të amortizuar, nga ku referuar nenit 12.4 të kontratës është detyrë e OE të sigurojë një higjienë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave.

3. Grupi i auditimit referuar nenit nr. 9 të kontratës *transporti i ushqimit te përgatitur nga kuzhina e shërbimit te ushqimit social për grupet e veçanta deri te pacienti, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet si dhe për te ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit te produktit)*, konstatoi se ushqimi deri në shërbimin tek pacienti nuk shpërndahej me enë termues për ruajtjen e ngrohtësisë së ushqimit, por me tip tenxhere gatimi.

Gjithashtu, u konstatua se, në disa raste mbajtja e enëve të ushqimit deri në mençat e pavijoneve bëhej nga vetë pacientët.

4. Grupi i auditimit, konstatoi se enët, te cilat shpërndaheshin neper mini kuzhinat e pavijoneve, laheshin dhe mbaheshin po ne këto mini kuzhina. Nga verifikimi dhe auditimi u konstatua se OE për këto ambiente nuk ka lidhur asnjë kontrate ose marrëveshje me AK, për të paguar detyrimet utilitare, të cilat lindin nga përdorimi i ambienteve për nevojat e OE. OE ka lidhur kontrate për energjisë elektrike dhe ujit vetëm për ambiente marrë me qira, të cilin e përdor për gatimin e ushqimit, por jo për mini kuzhinat e pavijoneve.

5. Nga auditimi u konstatua se nëpër disa pavijone ushqimi, ambalazhohet neper vasketa, ku ushqimi ndahej neper porcione të vogla dhe te ambalazhuara në vasketa, ne kundërshtim te plote me kontratën e lidhur. Nga auditimi u konstatua se ushqimi doktorëve roje, u shërbehej jo nëpër materialeve, pjata, pirunj, luge, por nëpër vasketa.

Kontratat e Rivlerësimit për kontratën bazë nr. 568, datë 30.04.2013 “Shërbim cateringu për “Spitalit Psikiatrik” Vlorë.

1.Titulli i Gjetjes: Situata 1:

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE për kontratën baze nr. nr. 568, datë 30.04.2013 “Shërbim cateringu për “Spitalit Psikiatrik”.Vlorë.” rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga auditimi konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim te periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike. Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese.

Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105“Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

- a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;
- b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;
- c) organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE. SPV e keq interpreton pikat 4.3 dhe 4.6 të kontratës nr. 568, datë 30.04.2013 së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese.

Pikat 4.6 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 4.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. Kontrata me nr. 568, datë 30.04.2013 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi *ripërtëritjeje*, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për *rishikimin e vlerës*, në përputhje me inflacionin e publikuar...” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën **1,154,431 lekë**

- për vitin 2018 në shumën **1,150,818 lekë**

- për vitin 2019 në shumën **910,931 lekë**, në total në shumën prej **3,216,180 lekë** përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.**

Kriteri:

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105, VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9.

Ndikimi/Efekti:

Rivlerësimi i çmimeve ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit

Shkaku:

Keq interpretim i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerës **3,216,180 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit të periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2.Titulli i Gjetjes:

Përcaktimi jo i saktë i vlerës së kontratës së lidhur me OE

Situata 2:

SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4 lekë** pa TVSh, me operatorin ekonomik “S. AL” SHPK.

Nga auditimi u konstatua se fondi limit i autorizuar sipas ABP, për ofertën ekonomike të shpallur fituese OE “S. AL” shpk për periudhën 4 vjeçare nuk është i njëjtë me fondi limit të caktuar në kontratën që SPV me OE kanë lidhur, me një diferencë prej **835,178.40 lekë**.

Kriteri:

VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 47, pika 2 Në kushtet e kontratës të lidhur jo në vlerën ekonomik të OE të shpallur fitues, kontrata ka risk të likuidohet jo në vlerën e fituar.

Ndikimi/Efekti:

Shkaku:

Lidhje kontrartes midis AK dhe OE jo në vlerën e përcaktuar nga organi qendror blerës.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi:

Nga Titullari i Institucionit të merren masa urgjente në ri-ndryshimin e vlerës së lidhur të kontratës për shërbimin e Kateringut me OE, ku në zbatim të procedurës së kryer nga organit qendror Blerës për këtë shërbim, të lidhet nënkontrata në vlerën 166.021.272 lekë e cila është oferta ekonomike e shpallur fitues dhe jo në vlerën 166,854,450.4 lekë, e cila përfaqëson fondin e përgjithshëm.

3.Titulli i Gjetjes:

Mos plotësimi i disa prej Kushteve të Kontratës

Situata 3:

Referuar konstatimeve mbi zbatimin e kontratës së lidhur midis AK dhe OË për “Shërbimin Katering”, grupi i auditimi konstatoi se një pjesë e kushteve të kontratës nuk janë zbatuar, kushte të cilat nën gjykimin tonë përbejnë themelin e krijimit të kësaj kontrate si dhe ofrimi i një shërbimi, i cili është jetik për pacientët. Nga grupi i auditimit u konstatua se grupi i monitorimit, mbante proces verbale në forme tabelare vetëm në lidhje me numrin e pacineteve dhe numrin e ofrimit të rracioneve ditore.

Kriteri:

Kontrata nr.13 prot me nr.692 datë 03.04.2020 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Spitalin Psikiatrik, Vlorë

Ndikimi/Efekti:

Mos ofrimi i shërbimit të duhura për pacientet, bazuar në kushtet e kontratës së lidhur midis SPV dhe OE.

Shkaku:

Mos plotësimi i kushteve të kontratës të lidhur midis OE dhe SPV.

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Titullari i Institucionit të SPV si dhe nga grupet e mgritura nga Titullari për monitorimin e kontratës “Shërbimit Katering”, të merren masa të menjëhershme dhe në vazhdimësi, ku ofrimi i shërbimit të ushqimit, si një shërbim jetik për pacientët të kryhet në standardet dhe kushtet e përcaktuara në kontratë. Grupi i monitorimit të marrë masa të realizojë kontrolle të herpashershme, në lidhje me cilësinë e ushqimit si dhe shërbimit duke mbajtur proces verbale të trajtuara në mënyrë narrative në lidhje me konstatimet apo jo të tij.

Në zbatim të kontratës së “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratat e lidhura midis AK dhe OE.
- Raportet e monitorimeve mujore për ndjekjen e zbatimit të kontratave.
- Dokumentacion mbi sipërfaqen që administrojnë SPV, dhe të ambienteve të cilat janë dhënë me qira nga SPV.
- Urdhër shpenzimet mbi likuidimin e shërbimit të pastrimit.
- Kontratat e lidhura midis AK dhe OE
- Raportet e monitorimeve ditore dhe mujore për ndjekjen e zbatimit të kontratave
- Urdhër shpenzimet mbi likuidimet mujore të zbatimit të kontratës

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve rezultoi:

Kontrata e Shërbimit nr. 26, nr. 75/6 prot., datë 29.03.2016, me afat 4 vite (**01.05.2016-30.04.2020**), me vlerë **112,009,392 lekë** me TVSh(**93,341,160** lekë pa TVSh), është nënshkruar nga z. K. Ll. për SPV dhe znj. A. T. për shoqërinë AGS SHPK.

Në nenin 2, pika 2.2 të kontratës është cituar se, çmimi që është fiksuar më përpara, do të rishikohet 1 herë në vit në bazë të indeksit që tregon inflacionin, i cili llogaritet nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

Referuar kontratës së sipërpërmendur sasia për çdo vit është parashikuar në masën 96.228 kg, me një çmim për njësi 242.5 dhe në vlerën 23.335.290 lekë pa TVSh dhe 28,002,348 lek me TVSH.

Me kontratën nr. 631/1 prot. datë 21.08.2017 “Rivlerësim Kontrate”, firmosur nga OE dhe AK, është kryer rivlerësimi i kontratës për periudhën 30.04.2017/01.05.2016.

Me kontratën nr. 1050/1 prot. datë 27.07.2018 “Rivlerësim Kontrate”, firmosur nga OE dhe AK është kryer rivlerësimi i kontratës për periudhën 30.4.2018/01.05.2017.

Me kontratën nr. 1472 Datë 05.08.2019 “Rivlerësim Kontrate”, firmosur nga OE dhe AK është kryer rivlerësimi i kontratës për periudhën 30.04.2017/01.05.2019.

E përmbledhur në mënyrë tabelore, referuar kontratave të lidhura, ndryshimi i çmimeve sipas INSTAT është si më poshtë vijon:

<i>Periudha</i>	<i>Çmimi për njësi (pa TVSH)</i>	<i>Vlera shtesë sipas inflacionit</i>	<i>Totali</i>
01.05.2016/30.04.2017	242.5	4.85	247.35
01.05.2017/30.04.2018	247.35	5.19	252.54
01.05.2018/30.04.2019	252.54	3.79	256.33

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës nr. 26, nr. 75/6 prot., datë 29.03.2016 u konstatua se për vitet objekt auditimi nga SPV është bërë rivlerësimi i çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke marrë si reference inflacionin e publikuar nga INSTAT.

Me urdhër shpenzimit nr. 180, datë 05.09.2017 është paguar vlera prej 749,072 lekë subjektivit “AGS” shpk për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 26, datë 29.06.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot nr. 631/1, datë 21.08.2017 për “Shërbimin Lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik të SPV” të realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2016-Maj 2017.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përlogaritur për periudhën 01.05.2016-31.08.2017.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas periudhës Gusht 2017 çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për kg është bërë 247.35 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 175, datë 06.08.2018 është paguar vlera prej 885,249 lekë subjektit “AGS shpk” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 26, datë 29.06.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1050/1, datë 27.07.2018, për shërbimin e realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2017-Maj 2018.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përlogaritur për periudhën 01.05.2017-31.07.2018.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas periudhës Gusht 2018 çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për kg është bërë 252.54 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 198, datë 04.09.2019 është paguar vlera prej 611,390 lekë në favor të subjektit “AGS shpk” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 26, datë 29.06.2016. Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1472, datë 05.08.2019 për shërbimin e realizuar dhe të likuiduar nga SPV për periudhën Maj 2018-Maj 2019.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është bërë për periudhën 01.05.2018-31.08.2019.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas periudhës Gusht 2019 çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të inflacionit, ku çmimi për kg është bërë 256.33 lekë.

Konstatimi:

Nga sa më sipër konstatohet se për:

- Periudha Maj 2017 - Gusht 2017 në vlerën 156,862 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin me nr. 180, datë 05.09.2017 dhe më pas me urdhër shpenzimin me nr. 175, datë 06.08.2018.

- Periudha Maj 2018 - Korrik 2018 në vlerën 191,548 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin me nr. 175, datë 06.08.2018 dhe më pas me urdhër shpenzimin nr. 198, datë 04.09.2019.

Në kontratën nr. 26, datë 29.03.2016 e lidhur mes AK dhe OE në nenin 2, pika 2.2 citohet se çmimet duhet të rivlerësohen në mënyrë progresive çdo vit.

Indeksi i çmimeve realizohet për mallrat dhe shërbimet për periudhat e ardhshme dhe jo për mallrat dhe shërbimet të periudhave të mëparshme.

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga sa cituam më sipër gjithashtu konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim te periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

SPV e keq interpreton nenin 2 pikat 2.2 të kontratës së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit.

Kontrata me nr. 26, datë 29.03.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi *ripërtëritjeje*, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për *rishikimin e vlerës*, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën 749,072 lekë

- për vitin 2018 në shumën 885,249 lekë

- për vitin 2019 në shumën 611,390 lekë, në total në shumën prej 2,245,711 lekë përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.**

Nga grupi i auditimi u bë krahasimi i të dhënave mujore dhe ditore të sasive të lara gjatë periudhave objekt auditimi.

Nga verifikimi u konstatua se:

Çdo ditë nga subjekti “AGS” shpk bëhet fletë daljet për sasinë e artikujve të larë, ku në to është shënuar sasia dhe pesha për secilin artikull të ndarë sipas pavijoneve të SPV.

Ndërsa në urdhër shpenzimeve ***konstatohet*** se proces verbalët e mbajtura nga komisioni i monitorimit të kontratës dhe subjektit, artikujt janë të shënuar në copë pa peshën specifike të secilit artikull, çka sjell mos evidentim të peshave përkatëse për secilën nga produktet me totalin e shënuar në procesverbalin e likuidimit të shërbimit, firmosur nga OE dhe AK.

Realizimi në vlerë i kontratës për periudhën e mbulimit të saj referuar dokumentacionit të sektorit të financës, për periudhën nga lidhja e saj deri më 16.12.2019 është sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Vlera e parashikuar		Vlera e realizuar		% Realizimi Shuma/lekë	% realizimi Sasia/kg
	Shuma/lekë	Sasia/kg	Shuma/lekë	Sasia/kg		
2017	28,002,348	96,228	29,331,149	102,034	104.70%	106%
2018	28,002,348	96,228	36,284,083	118,409	129.58%	123,1%
2019	28,002,348	96,228	23,316,506	91,626.79	83.27%	95.2%

Nga auditimi ***u konstatua*** se referuar kontratës së lidhur nr. 26 datë 29.03.2016 është përcaktuar që vlera e kësaj kontrate për çdo vit deri në realizim është 28,002,348 lekë si dhe pesha referuar kontratës do të jetë 96,228 kg për vit.

Grupi i auditimit nga shqyrtimi i situacioneve të likuidimit në vite të zbatimit të kontratës konstatoj se kjo kontratë është realizuar:

- për vitin 2017 në vlerën 29,331,149 lekë ose në masën 104.7%, dhe me një tejkalim në masën 106% për sa i përket sasisë,

- për vitin 2018 në vlerën 36,284,083 lekë ose në masën 126.58% dhe në një tejkalim në masën 123,1% për sa i përket sasisë dhe

- për vitin 2019 në vlerën 23,316,506 ose në masën 83.27%,

Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 26, nr. 75/6 prot., datë 29.03.2016, neni 19 “Ndryshimi i porosisë”.

Në nëntor të vitit 2019, fondi i parashikuar në kontratë ka përfunduar, ku si pasoje, SPV me shkresën 2071/1, datë 05.12.2019 i është drejtuar APP me kërkesë për miratimin e procedurës negociim pa shpallje, me kohë zgjatje deri në përfundimin e procedurës së prokurimi të hapur, për një periudhë 54 ditore, për shkak të situatës pa shërbim në të cilën ndodhej institucioni.

Arsyet e realizimit të fondit të kësaj kontratë 5 muaj përpara afatit të nënshkruar në kontratë, sipas AK është si më poshtë vijon:

“Duke qenë se janë pacient të shëndetit mendor nuk mund të bëjmë një planifikim konkret për larjen e përditshme të përcaktuar si në kontratën nr. 26, pasi pacientët rezidentët me probleme trupore të pavetëdijshme defektojnë përditë në shtratë...si dhe për arsye të kushteve të vështira në të cilën mungon ngrohja ku bëjnë që gjatë sezonit të dimrit të përdorin më shumë tesha.....si dhe inflacioni i cili ka ardhur në rritje”.

Grupi i auditimit, pas rakordimit të totalit të numrit të pacientëve të shtruar, për te 4 vitet (marre nga sektori i hotelerisë), me urdhër shpenzimet mbi likuidimin për shërbimin e lavanderisë për të njëjtën periudhë konstatoi se:

	viti 2017		viti 2018		viti 2019		viti 2020	
	Nr. pacientëve	Likuidimi/ lavanderi	Nr. pacientësh	Likuidimi/ lavanderi	nr pacientësh	Likuidimi/ lavanderi	Nr. pacientësh	Likuidimi/ lavanderi
tetor	5,535	2,774,873	5,628	2,633,402	5,409	2,185,410	5,366	2,509,555
nëntor	5,179	3,001,073	5,439	2,534,672	2,060	2,145,245	4,724	2,384,019
dhjetor	5,606	3,090,131	5,411	2,649,703	5,293	2,511,584	4,785	2,654,403
janar	5,477	2,535,428	5,421	3,337,325	5,613	3,093,475	5,218	2,324,162
shkurt	5,219	2,859,174	5,082	2,990,325	5,093	2,728,044	4,867	2,209,168
mars	5,576	2,224,375	5,624	3,819,501	5,572	2,780,423	4,942	2,759,074
prill	5,426	2,080,280	5,507	3,846,490	5,607	2,528,829	4,745	2,672,655

Referuar statistikave në tabelën e mësipërme si dhe arsyetimit nga SPV për mbarimin e fondit limit 5- muaj përpara përfundimit të kontratës, grupi i auditimit zgjodhi 7 muajt më të ftohtë të vitit e nga ku rezultoi se numri i pacientëve **nuk justifikon dhe as nuk argumenton arsyen** e mbarimit të fondit në një kohë më të afërt sesa ajo e parashikuar.

Grupi i auditimit konstatoi se për të njëjtën periudhë për shembull

Në janar të vitit 2017 janar janë kryer larje në vlerën 2,535,528 lekë, për një numër prej 5,477 paciente.

Për vitin 2018 në të njëjtin muaj, janar, edhe pse kemi një rënie të numrit të pacientëve vlera e paguar për lavanderinë është 3,337,322 lekë, me një diferencë 801,897 lekë më shumë sesa për vitin 2017.

Për vitin 2019 janë kryer larje në vlerën 3,093,475 lekë, për një numër prej 5613 paciente, me një diferencë në rritje prej 192 krahasuar me vitin 2018, dhe ku vlera e lavanderinë për këtë muaj është ulur në shumën prej 243,850 lekë

Në mars të vitit 2017, janar janë kryer larje në vlerën 2,224,375 lekë, për një numër prej 5576 paciente.

Për vitin 2018 në të njëjtin muaj, Mars, kemi një rënie të numrit prej 48 pacientë, vlera e paguar për lavanderinë është 3,337,322 lekë, me një diferencë 1,595,126 lekë më shumë se vitin 2017.

Për vitin 2019 janë kryer larje në vlerën 2,780,423 lekë, për një numër prej 5572 paciente, me një diferencë në ulje prej 52 pacientë krahasuar me vitin 2018, dhe ku vlera e lavanderinë për këtë muaj është 1,039,078 lekë më pak.

Pra, grupi i auditimit **konstatoi** se argumentimi i SPV mbi përfundimin e parakohshëm të fondit të kontratës së lavanderisë, për arsyet e sipërpërmendura, **nuk qëndron**, pasi numri i pacientëve në muaj të njëjtë për periudha të ndryshme është pothuajse i pandryshuar, ndërsa sasi e artikujve në kg për këto muaj në vite të ndryshme ka diferencë të konsiderueshme midis tyre. Si rrjedhojë dhe vlera e shërbimit të lavanderisë së paguar është tejkaluar mbi vlerën e parashikuar të kontratës së lidhur midis OE dhe AK për periudhën **01.05.2016-05.12.2019**, në kundërshtim dhe me nenin 19 “Ndryshimi i porosisë” të kontratës nr.36/ datë 29.03.2016 lidhur midis SPV dhe OE.

Gjithashtu arsyeja e dytë e trajtuar nga SPV mbi përfundimin e parakohshëm të fondit të konstantës së shërbimit të lavanderisë, trajtohej se për shkak të ndryshimit të çmimit për arsye të inflacionit.

Grupi i auditimit referuar likuidimit të SPV për inflacionin, referuar vlerave të INSTAT-it ka konstatuar se çmimet e mallrave dhe shërbimeve *janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit*. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim te periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit mbi çmimet e periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, trajtuar me hollësishtme në kontratat e rivlerësimit.

Për vitin 2020 me kontratën nr. 37 protokolluar me nr. 2071/9, datë 16.12.2019 firmosur nga OE “AGS” dhe AK është lidhur kontrata e shërbimit të lavanderisë dhe zëvendësimi me inventar të imët në SPV, Vlorë për **54 dite** me fond limit **4,470,551.55** lekë pa TVSH dhe **5,364,661.86** me TVSH, nga data e nënshkrimit, si dhe me kusht ndërprerje me shpalljen e fituesit nga procedura me të njëjtin objekt auditimi zhvilluar nga SPV.

Me kontratën nr. 1 protokolluar me shkresën nr. 1589/32, datë 27.01.2020 “Draft marrëveshja kuadër, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për “Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV” është lidhur kontrata midis AK dhe OE për një periudhë 48 Muaj (4 vjeçare), me një fond limit në vlerë **106,187,633.96 lekë pa TVSH** dhe në vlerën **127,425,160.76 lekë me TVSH**.

Me kontratën nr. 3 protokolluar me shkresën nr. 1589/36, datë 31.01.2020 “Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV” është lidhur kontrata e firmosur prej AK dhe AGS, për periudhën 01.02.2020 – 31.12.2020 me fond limit në vlerën **24,334,665.11 leka pa TVSH** dhe në vlerë **29,201,598.13 lekë me TVSH**

Me kontratën nr. 43 protokolluar me shkresën nr. 2303 datë 30.12.2020 “Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV” është lidhur kontrata e firmosur prej AK dhe AGS, për periudhën 01.01.2021- 31.12.2021 me fond limit në vlerën **26,546,722.85 lekë pa TVSH** dhe në vlerën **31,856,073.42 lekë me TVSH**

Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE me nr. 3, datë 31.01.2020 në nenin 2, pika 2.6 ku citohet se: *“Palë bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruaj në amendim kontrate ku të për caktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”*.

SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2.

Observacion i subjektit mbi Projetrabortin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit me shkresën nr.149/7, datë 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: Kontrata bazë e nënshkruar përcakton indeksimin e çmimeve në mënyrë progresive vit pas viti. Amendimi i Kontratës (kontrata e rivlerësimit) që zbatohet për indeksimin e çmimeve zbaton kushtet e kontratës/marrëveshjes bazë duke e mbajtur indeksin e çmimeve të azhurnuar në mënyrë progresive (rivlerësuar). Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit (norma e inflacionit e shprehur në përqindje), publikohen nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe gjithmonë i referohen periudhës paraardhëse.

Parashikimi i rivlerësimit të çmimeve është mbështetur në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Pika 2, e Nenit 9 ku parashikohet se: “Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar”.

Një vit pas nënshkrimit të kontratës bëhet rivlerësimi i Kontratës së Shërbimit sipas ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT. Në këtë rast me nënshkrimin e amendimit për rivlerësimin e kontratës, Kontraktorit i lind e drejta të llogaris rivlerësimin si më poshtë:

- Llogarit rivlerësimin e çmimit për periudhën vjetore paraardhëse. Pra për periudhën paraardhëse (përfshirë edhe vitin e parë të kontratës) kemi një rritje të çmimit të shërbimit sipas indeksit të inflacionit të publikuar për periudhën përkatëse dhe Kontraktuesit i lind e drejta të marrë diferencën e çmimit të papaguar **ashtu sikundër në rast deflacioni porositisit i lind e drejta që të merrte mbrapsht diferencën e shumës “tepër” të paguar më parë për shërbimin e kryer gjatë kësaj periudhe dhe**

- Llogarit rivlerësimin e çmimit në mënyrë progresive për vitin në vijim sipas Indeksit të inflacionit në të cilën përcaktohet, çmimi i ri i indeksuar për shërbimin që do të ofrohet nga Kontraktuesi në vijim po për një periudhë një vjeçare.

në kushtet kur norma e inflacionit që merret për bazë në cdo rivlerësim, çmimi është ajo i një viti më parë (pra jo norma e vitit koherent për të cilin po lidhet kontrata e eivlerësimit). është e detyrueshme që në momentin e publikimit të normës të bëhet rivlerësimi i çmimit në lje ose rritje.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Inflacioni nuk ka kuptimin e indeksimit dhe vlerësimin të çmimeve të periudhave paraardhëse. Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

- kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;
- kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;
- organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

Kontrata me nr. 26, datë 29.03.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i Subjektit: Nuk ka dublim të pagesës për te tre vitet objekt auditimi, për arsye se pagesa e kryer me urdhër shpenzimit nr. 180, datë 05.09.2017; me nr. 175, datë 06.08.2018 dhe me nr. 198, datë 04.09.2019 janë **diferenca e indeksimit të çmimit për periudhën** e aplikuar në faturën e muajit vijues.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pagesave të realizuar nëpërmjet nga SPV në favor të subjektit konstatohet se çmimet për këto mallra dhe shërbime janë indeksuar nga dy e më shumë herë, analizuar në tabelën si mëposhtëm:

Periusha	rivlerësim 2017		rivlerësim 2018		rivlerësim 2019			
	242.5	rivlerësimi 2.1%		rivlerësimi 2.1%		rivlerësimi 1.5%		
Maj 2016	242.5	247.35	Maj 2017	242.5	247.59	Maj 2018	247.35	251.06
Gershor 2016	242.5	247.35	Gershor 2017	242.5	247.59	Gershor 2018	247.35	251.06
Korrik 2016	242.5	247.35	Korrik 2017	242.5	247.59	Korrik 2018	247.35	251.06
Gusht 2016	242.5	247.35	Gusht 2017	242.5	247.59	Gusht 2018	252.54	256.33
Shtator 2016	242.5	247.35	Shtator 2017	247.35	252.54	Shtator 2018	252.54	256.33
Tetor 2016	242.5	247.35	Tetor 2017	247.35	252.54	Tetor 2018	252.54	256.33
Nentor 2016	242.5	247.35	Nentor 2018	247.35	252.54	Nentor 2018	252.54	256.33
Dhjetor 2016	242.5	247.35	Dhjetor 2017	247.35	252.54	Dhjetor 2018	252.54	256.33
Janar 2017	242.5	247.35	Janar 2018	247.35	252.54	Janar 2019	252.54	256.33
Shkurt 2017	242.5	247.35	Shkurt 2018	247.35	252.54	Shkurt 2019	252.54	256.33
Mars 2017	242.5	247.35	Mars 2018	247.35	252.54	Mars 2019	252.54	256.33
Prill 2017	242.5	247.35	Prill 2018	247.35	252.54	Prill 2019	252.54	256.33
Maj 2017	242.5	247.35	Maj 2018	247.35	252.54	Maj 2019	252.54	256.33
Gershor 2017	242.5	247.35	Gershor 2018	247.35	252.54	Gershor 2019	252.54	256.33
Korrik 2017	242.5	247.35	Korrik 2018	247.35	252.54	Korrik 2019	252.54	256.33
Gusht 2017	242.5	247.35	Gusht 2018	247.35	252.54	Gusht 2019	252.54	256.33

Pra siç është paraqitur në tabelle periudhat për të cilët janë publikuar pagesat pasi është aplikuar indeksi i çmimit të periudhës dhe më pas është aplikuar përsëri indeksi i periudhës pasardhëse kur është bërë rivlerësimi i çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të realizuara në periudhat paraardhëse. Muajt e konstatuar janë për të treguar se si nga AK/SPV ka indeksuar nga dy e më shumë herë çmimet për këto mallra dhe shërbime. Vlera totale e dëmit i përlllogarit nga grupi i auditimit është për të gjithë indeksimin e çmimeve për periudhën vjetore paraardhëse.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

Verifikimi në terren mbi zbatimin e kushteve të kontratës:

Referuar kushteve te kontratës së lidhur midis AK dhe OE, grupi i auditimit me datë 30.03.2021 gjatë fazës në terren, ka kryer verifikimin e plotësimit të këtyre kushteve, nga ku ka mbajtur dhe Akt Verifikimit nr. 600 datë 31.03.2021, nga ku rezultoi se:

Ne pavijonin kronik-Gra, u kontrolluan dhomat e pacienteve, nga ku u konstatua se çarçafët dhe jastiqet e shtretërve te pacienteve ishin te pandërruar (bashkëlidhur fotot). Ne pavijon ndodhej dhe një ambient ne te çilen mbaheshin çarçafët, batanijet si dhe te gjitha rrobat e pacienteve (bashkëlidhur fotot).

Për pavijonin kronik-Burra, grupi i auditimit, vëzhgoi ambientin, i cili ishte ne një gjendje te mjerueshme (bashkëlidhur fotot). Ne pavijonin akut-burra ndodhej dhe një ambient në te cilin mbanin çarçafët, jastiqet, batanijet si dhe veshjet e pacientëve.

Referuar kontratës nr. 3 protokolluar me nr. 1589/36, datë 31.01.2020 “Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV” është lidhur kontrata e firmosur prej AK dhe AGS, për periudhën 01.02.2020 – 31.12.2020 me fond limit në vlerën **24,334,665.11 leka pa TVSH** dhe në vlerë **29,201,598.13 lekë me TVSH**

Konstatimi:

Referua konstatimeve të sipërpërmendur, grupi i auditimit konkludoi se një pjesë e kushteve të kontratës nuk janë zbatuar, kushte te cilat nen gjykimin ton ëpërbejnë themelin e krijimit të kësaj kontrate:

Shërbimi i Lavandërisë, referuar kontratës së sipërpërmendur, si dhe Specifikimet teknike te menaxhimit te procesit te lavanderise, ku citohet se “**Larja e inventarit te materialit te bute, do te behet me këto afate:**

- Çarçafët, kellefet e jastekut, kellefet e dyshekut, pizhamet e pacientit, peshqirët e pacientit, do te lahen sa here te jete e nevojshme dhe për çdo shtrim.
- Batanijet, jasteket do te lahen sa here te jete e nevojshme.
- Rrobat e brendshme dhe rrobat e tjera te pacienteve do te lahen çdo dite dhe sa here është e nevojshme.
- Përparëset e mjekut, kostumet e personelit infermieror, personelit ndihmes, do te lahen 1 (një) here ne jave.
- Pandoflat e pacientit do te lahen 1(një) here ne muaj.

Ndërrimi i materialit te bute te shtratit, do te behet me këto afate:

- Çarçaf e shtrati i sipërm dhe i poshtëm, këllëf jastëku, këllëf dysheku, peshqir e pacienti, robdishan pacienti, pizhame pacienti, ku materiali i bute i shtratit te pacientit do te ndërrohet çdo dite, për çdo shtrim te ri, si dhe sa here kërkohet nga shërbimi për shkak te specialitetit qe ato trajtojnë.

Nga grupi i auditimit **u konstatua** se gjatë vëzhgimit në terren nëpër pavijonet e spitalit, pavijoni kronik-Gra, ishte ne një gjendje të mjerueshme, ku çarçafë e pacienteve ishin të konsumuara deri ne masën 80%, ashtu si dhe jastëkët dhe batanije e pacienteve. Gjendja e çarçafëve te shtruar në shtretërit e pacienteve ishte e papastër, edhe pse detyrimi i punonjësve referuar kontratës së sipërpërmendur është ti ndërroj çarçafët e pacienteve për çdo shtrim te ri, dhe sa herë të jetë e nevojshme.

Ne momentin kur është kryer verifikimi, te gjithë pacientet ishin ne ambientet e jashtme te pavijonit, çka nuk gjen justifikim mos ndërrimi i çarçafëve dhe jastekeve të pacienteve apo zëvendësimi i tyre me materiale te reja.

Ne mini-magazinën e pavijoneve, u konstatua se ishin gjendje te gjitha materialet e buta, çka ne asnjë moment nuk ka mungesa të materialeve për të bere ri ndërrimin apo zëvendësimin e materialeve te konsumuara me materiale të reja.

4.Titulli i Gjetjes:

Kontratat e Rivlerësimit për kontratën bazë nr. 26, datë 29.03.2016 “Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik”.

Situata:

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “AGS” shpk për kontratën bazë nr. 26, datë 29.03.2016 rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga sa cituam më sipër gjithashtu konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim te periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme. *Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.*

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

SPV e keq interpreton nenin 2 pikat 2.2 të kontratës së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit.

Kontrata me nr. 26, datë 29.03.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar...” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave te kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën 749,072 lekë

- për vitin 2018 në shumën 885,249 lekë

- për vitin 2019 në shumën 611,390 lekë, në total në shumën prej 2,245,711 lekë përbën

dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Kriteri:

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105, VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9.

Ndikimi/Efekti:

Rivlerësimi i çmimeve ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit

Shkaku:

Keq interpretim i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerën prej **2,245,711 lekë me TVSH**, nga sipërmarrësit “AGS” shpk, për vlerën e përfutur padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Afati i zbatimit:

Menjëherë.

5.Titulli i Gjetjes:

Zbatimi i kontratës “Shërbim Lavanderie”

Situata:	Nga auditimit ne terren i zbatimit të kontratës së shërbimit të lavdërisë u konstatua se, ndërrimi si dhe ripërtëritja e materialeve të buta për nevojë të pacienteve të SPV nuk kryhej në kohë ashtu si dhe shume materiale të buta si, çarçafë, jastëk, kuverta te cilat janë domosdoshmëri e përditshme e pacienteve, si dhe detyrim nga OE për furnizimin e tyre referuar kontratës, ishin në gjendje të konsumuar.
Kriteri:	Kontrata nr. 1 protokolluar me shkresën nr. 1589/32, datë 27.01.2020 “Draft marrëveshja kuadër, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për “ <i>Shërbim Lavanderise dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV</i> ”
Ndikimi/Efekti:	Mos plotësim i kushteve të pacientëve, si pjesë e veprimtarisë së SPV
Shkaku:	Mos plotësim i kushteve të kontratës te lidhur midis OE dhe SPV
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi:	Nga ana e përgjegjësve mbi ndërrimin dhe ripërtëritjen e materialeve, të kushtohet një vëmendje e veçantë mbi ndërrimin dhe shërbimin në kohë ndaj pacientëve, të cilët në mungesë të aftësive për ti kërkuar këto kushte, tu plotësohen nga punonjësit përgjegjës për kryerjen e shërbimit. Grupi i monitorimit ngritur nga titullari i institucionit të marrë masa për realizimin e kontrolleve sistematike dhe në mënyrë vigjilente, me qëllim minimizimin e rasteve të cilat sjellin ndikim tek cilësia e shërbimit ndaj pacientit.
Afati i zbatimit:	Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.Titulli i Gjetjes: **Plotësim i parregullt i proces verbaleve ditore dhe mujore te mbajtura për shërbimin e Lavanderisë**

Situata:	Në urdhër shpenzimet mbi likuidimin e shërbimit të kontratës “Shërbim Lavanderië” konstatohet se proces verbalet e mbajtura nga komisioni i monitorimit të kontratës dhe subjektit, artikujt janë të shënuar në copë pa peshën specifike të secilit artikull, çka sjell mos evidentim të peshave përkatëse për secilën nga produktet me totalin e shënuar në procesverbalin e likuidimit të shërbimit, firmosur nga OE dhe AK.
Kriteri:	<i>Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik” i ndryshuar</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos rakordim i sasisë dhe vlerës në proces verbaleve bashkëngjitur likuidimit të faturave.
Shkaku:	Mos plotësim i saktë, për të pasqyruar peshat specifike ditore për secilin nga artikujt dhe jo vetëm sasi të.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi:	Nga ana e përgjegjësve të materialit për secilin pavijon si dhe shefit të hotelerisë, të merren masa që ne procesverbalin ditor si dhe në përmbledhjen mujore, të shkruhet sasia dhe pesha përkatëse për çdo artikull, pas peshimit te secilit nga produktet e tërhequra nga lavanderia, me qëllim përcaktimin e saktë mbi vërtetësisë dhe rakordimin me tabelën përmbledhëse mujore, si dokument justifikues dhe argumentues për likuidimin e shërbimit. Struktura përgjegjëse për financat përpara se të kryej likuidimin duhet të kontrollojë dokumentet shoqërues justifikues në lidhje me produktin apo shërbimin e kryer.
Afati i zbatimit:	Menjëherë dhe në vazhdimësi

Në zbatim të kontratës së “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratat e lidhura midis AK dhe OE.
- Raportet e monitorimeve mujore për ndjekjen e zbatimit të kontratave.
- Dokumentacion mbi sipërfaqen që administron SPV, dhe të ambienteve të cilat janë dhënë me qira nga SPV.
- Urdhër shpenzimet mbi likuidimin e shërbimit të pastrimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve rezultoi:

Në datë 08.04.2016 është lidhur kontrata e shërbimit nr. 28 prot., me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”, përfaqësuar nga z. K. Ll., Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe operatori ekonomik “S. AL” shpk, përfaqësuar nga znj. A. T., me vlerë të kontratës **75,721,348.20** lekë pa t.v.sh (shtatëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e një mijë e treqind e dyzetë e tetë pikë njëzetë) dhe në vlerën **90,865,617,84** lekë me TVSH, me afat shërbimi 4 vjet nga data e lidhjes së kontratës, me të drejtë rivlerësimi çdo vit në mënyrë progresive sipas inflacionit zyrtar të publikuar në INSTAT. Kontratat hyn në fuqi më datë më datë 01.05.2016 dhe përfundon më datë 30.04.2020.

Baza ligjore e kontratës është dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Kreu V, neni 58, pika 3; VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, neni 21, dhe Kreu VII, neni 70.

Me datë 21.08.2017 protokolluar me nr.1128, prot datë 21.08.2017 është lidhur kontrata e rivlerësimit për “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” për SPV midis OE dhe AK, për rivlerësimin e çmimeve për periudhën 01.05.2016-30.04.2017.

Me datë 27.07.2018 protokolluar me nr.1050/2, datë 27.07.2018 është lidhur kontrata e rivlerësimit për “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik” “Ali Mihali” për SPV midis OE dhe AK, për rivlerësimin e çmimeve për periudhën 01.05.2017-30.04.2018.

Me datë 05.08.2019 protokolluar me nr.1473, datë 05.08.2019 është lidhur kontrata e rivlerësimit për “Shërbim pastrimi” për SPV midis OE dhe AK, për rivlerësimin e çmimeve për periudhën 01.05.2018-30.04.2019.

Përmbledhur në mënyrë tabelore vlerën e ndryshuar si dhe llojin e shërbimit si më poshtë vijon:

Në lekë

Shërbimi	Kontrata bazë	Rivlerësim 01.05.2016\03.04.2017	Rivlerësim 01.05.2017\30.04.2018	Rivlerësim 01.05.2018\30.04.2019
Pastrim I Brendshëm	5.33	5.44	5.55	5.63
Pastrim I Jashtëm	2.66	2.71	2.76	2.8
Gjelbërimi	16786.86	17,122.60	17,482.17	17,774.40
Total	16,794.85	17,130.75	17,490.48	17,782.83

Realizimi i kësaj kontrate për periudhën 01.01.2017-30.02.2020, sipas situacioneve mujore të paraqitura, është në vlerën 71,013,297 lekë.

Përmbledhur në mënyrë tabelore parashikimi dhe realizimi i kontratës së “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë është si më poshtë vijon:

viti	parashikuar	realizuar	% realizimi
2017	22,716,404	23,436,549	103.2%
2018	22,716,404	23,933,840	105.4%
2019	22,716,404	24,206,161	106.6%

Nga auditimi me përzgjedhje i disa likuidimeve mbi tejkalimin e fondit të parashikuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, me fondin e realizuar u konstatua se diferenca vjen si pasojë e kontratave të rivlerësimit, ku për shkak të inflacionit janë rritur çmimet, rikthimit në periudhë të mëparshme për rivlerësimin e tyre si dhe mbivendosja e likuidimit për disa muaj (trajtuar me hollësisht si më poshtë vijon).

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës 77/13, prot. datë 08.04.2016 **u konstatua** se për vitet objekt auditimi nga SPV është bërë rivlerësimi i çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke marrë si reference inflacionin e publikuar nga INSTAT.

Me urdhër shpenzimin nr. 181, datë 05.09.2017 është paguar vlera prej 608,250 lekë subjektit “S. AL” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 28, datë 08.04.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot nr. 1128, datë 21.08.2017 për “Shërbimin për pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe mirëmbajtjen e ambienteve të gjelbërimit të SPV” të realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2016-Maj 2017.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përlogaritur për periudhën 01.05.2016-31.08.2017

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas kësaj periudhe çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të këtij inflacioni.

Me urdhër shpenzimin nr. 232, datë 04.10.2018 është paguar vlera prej 608,215 lekë subjektit “S. Al” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 28, datë 08.04.2016.

Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1050/2, datë 27.07.2018, për shërbimin të realizuar dhe të likuiduar nga SPV Maj 2017-Maj 2018.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është përlogaritur për periudhën 01.05.2017-31.07.2018.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas kësaj periudhe çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të këtij inflacioni.

Me urdhër shpenzimin nr. 199, datë 04.09.2019 është paguar vlera prej 473,236 lekë në favor të subjektit “S. Al” për rivlerësimin e kontratës bazë nr. 28, datë 08.04.2016. Rivlerësimi është bërë në bazë të kontratës prot. nr. 1473, datë 05.08.2019 për shërbimin e realizuar dhe të likuiduar nga SPV për periudhën Maj 2018-Maj 2019.

Në pasqyrën përmbledhëse bashkëngjitur urdhër shpenzimin rivlerësimi është bërë për periudhën 01.05.2018-31.08.2019.

Për të gjithë shërbimin e realizuar pas kësaj periudhe çmimet e shërbimit janë indeksuar në bazë të këtij inflacioni.

Konstatimi:

Nga sa më sipër konstatohet se për:

- Periudha Maj 2017 - Gusht 2017 në vlerën 152,824 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin me nr181, datë 05.09.2017 dhe më pas me urdhër shpenzimin me nr. 232, datë 04.10.2018.

- Periudha Maj 2018 - Korrik 2018 në vlerën 122,448 lekë me TVSh ka mbivendosje në situacionet e rivlerësimit. Kjo vlerë është paguar një herë me urdhër shpenzimin me nr. 232, datë 04.10.2018 dhe më pas me urdhër shpenzimin nr. 199, datë 04.09.2019.

Në kontratën nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 e lidhur mes AK dhe OE në nenin 2 pika 2.2 citohet se çmimi i përcaktuar në fillim do të rishikohet një herë në vit, në bazë të indeksit të inflacionit publikuar nga INSTAT.

Indeksi i çmimeve realizohet për mallrat dhe shërbimet për periudhat e ardhshme dhe jo për mallrat dhe shërbimet të periudhave të mëparshme.

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga sa cituam më sipër gjithashtu konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim te periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105“Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

SPV e keq interpreton pikën 2.2 të kontratës së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit.

Kontrata me 77/13, prot. datë 08.04.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përllogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi *ripërtëritjeje*, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për *rishikimin e vlerës*, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën **608,250** lekë

- për vitin 2018 në shumën **608,215**lekë

- për vitin 2019 në shumën **473,236** lekë, në total në shumën prej **1,686,701** lekë përbën **dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.**

Ne muajin Mars të vitin 2020, ka përfunduar fondi mbi realizimin e kontratës së “*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta*”, e ku si rezultat është lidhur kontrata shtesë nr.11 protokolluar me nr.549/10 datë 13.03.2020 midis OE “S. Al” dhe AK për një periudhë 122 ditore me të drejt zgjidhjeje deri në përfundimin e afatit, me lidhjen e kontratës së procedurës “E hapur- Marrëveshje kuadër” në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara me fond limit **6,406,235.92** lekë pa TVSH dhe në vlerën **7,687,486.10** lekë.

Realizimi i kontratës së sipërpërmendur për 122 dite nga akt rakordimet me thesarin është në vlerën **7,685,296** lekë.

Nga auditimi i zërave të situacioneve të shërbimit të “Pastrim i brendshëm” grupi i auditimit konstatoi se për sipërfaqe të dhëna me qira:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë janë likuiduar për zërin e shërbimit “Pastrim i brendshëm”, sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m² që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qera.

Nga periudha 01.03.2017 deri me 13.07.2020 në lidhje me zbatimin e kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” konstatohet se SPV ka paguar OE “S. AL” shpk për “Pastrim i brendshëm” të ambienteve të dhëna me qira, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në vlerën prej **1,767,275** lekë me TVSh duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.**

a. Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m².

Kontrata e parë e qerasë nr. 218 prot., datë 19.04.2016, është nënshkruar midis qiradhënësin SPV dhe qiramarrësin shoqërinë “AGS” SHPK. Sipas kësaj kontrate janë dhënë me qira: “Ambienti i lavanderisë 70.5 m² + ambient ndihmës me sipërfaqe 18 m².”

Kohëzgjatja e qiradhënies ishte e parashikuar nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës së shërbimit të lavanderisë nr. 26, datë 29.03.2016 deri në përfundim të saj dhe/ose shtesave eventuale.

Midis SPV dhe qeramarrësin shoqërinë “AGS” SHPK është lidhur kontrata e re e qerasë nr. 5, datë 03.02.2020 me kohëzgjatja nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës së shërbimit të lavanderisë nr. 3, datë 31.01.2020 dhe deri në përfundim të saj dhe/ose kontrata të tjera shërbimi me po të njëjtin objekt.

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 01 mars 2017 deri më 13.07.2020 (1238 ditë kalendarike) për pastrimin e lavanterisë dhe ambientit ndihmës shuma 596,506 lekë pa TVSh.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	88.5	144,342
2018	365	5.44	88.5	175,726
2019	365	5.55	88.5	179,279
13.07.2020	195	5.63	88.5	97,160
Totali	1238			596,506

Siç konstatohet sa më sipër shoqëria “S. AL” sh.p.k deri me datën 13.07.2020 është paguar më tepër, për zërin “Pastrim i brendshëm”, gjatë zbatimit të kontratës me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.”, për sipërfaqen e lavanderisë dhënë me qera, duke shkaktuar **dëm ekonomik 596,506 lekë pa TVSh (715,807 lekë me TVSh)**.

b. Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m².

Kontrata e qerasë nr. 219 prot. datë 19.04.2016 është nënshkruar midis qiradhënësin SPV dhe qiramarrësin shoqërinë “S. AL” SHPK. Sipas kësaj kontrate janë dhënë me qira: “Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m².” Kohëzgjatja e qiradhënies ishte nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës së shërbimit të catering deri në përfundim të saj me datën 31.12.2019 dhe/ose shtesave eventuale.

Midis SPV dhe qiramarrësin shoqërisë “S. AL” SHPK është lidhur kontrata e qerasë nr. 16, prot., datë 07.01.2020, ku kohëzgjatja e qiradhënies do jetë nga momenti i hyrjes në fuqi të amendamentit të kontratës nr. 38, datë 31.12.2019.

Me datën 03.04.2020 është rilidhur kontratë e re me shoqërisë “S. AL” SHPK me nr. 969, prot. me kohëzgjatje deri në datë 03.04.2021, me të drejtë rinovimi me të njëjtat kushte, me që ambienti i dhënë me qira është i lidhur ngushtësisht me kontratën e shërbimit të marrëveshjes kuadër nr. 80/8, datë 27.03.2020.

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 01 mars 2017 deri më 13.07.2020 (1231 ditë kalendarike) për pastrimin e ambientit të gatimit shuma 876,223 lekë pa TVSh.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	130	212,027
2018	365	5.44	130	258,128
2019	365	5.55	130	263,348
20.07.2020	195	5.63	130	142,721
Totali	1231			876,223

Siç konstatohet sa më sipër shoqëria “S. AL” shpk deri me datën 13.07.2020 është paguar më tepër, për zërin “Pastrim i brendshëm”, gjatë zbatimit të kontratës me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.”, për sipërfaqen e gatimit dhënë me qira, duke shkaktuar **dëm ekonomik 876,223 lekë pa TVSH (1,051,469 lekë me TVSh)**.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë konstatohet se për zërin “Pastrim i brendshëm” çdo muaj nga periudha 01 Mars 2017 deri më

20.07.2020 është paguar për sipërfaqen 7354 m2. Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, si dhe në DT është përcaktuar se sipërfaqja “Pastrim i brendshëm” është në sasinë 7,347 m2, çka rezulton me një tejkalim të kontratës prej 7m2.

Nga SPV për këtë periudhë ka paguar OE “S. AL” shpk më tepër për vlerën **47,181** lekë pa TVSh (**56,618** lekë me TVSH) duke shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit**.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	7	11,417
2018	365	5.44	7	13,899
2019	365	5.55	7	14,180
13.07.2020	195	5.63	7	7,685
Totali	1238			47,181

Veprimet e përshkruara më sipër, janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës”, i cili përcakton se: “1. Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

si dhe neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

Lidhja e kontratës për vitin 2020

Me shkresën nr.25/8 datë 20.07.2020 ABP ka dërguar njoftimin për lidhje kontrate “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë”, me operatorin e shpallur fitues “C. F.” shpk, me vlerë të ofertuar 59,103,548 lekë pa TVSH me afat 48 muaj, dhe ku me shkresën nr.25/7 datë 20.01.2020 midis ABP dhe OE “C. F.” është lidhur Marrëveshja kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara) ku në nenin 2 pika 2.2 citohet se “Çmimet e njërive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër” si dhe neni 1 pika 1.4 ku citohet se “Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.....”.

Me kontratën nr.24 protokolluar me nr.1360 datë 20.07.2020, firmosur nga titullari i AK dh OE është lidhur kontrata “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë” me afat 20.07.2020-31.12.2020 në vlerën 6,394,248.2 lekë pa TVSH dhe në vlerën 7,673,097.84 lekë më TVSH.

Me kontratën nr.48 protokolluar me nr.2316 datë 30.12.2020, firmosur nga titullari i AK dh OE është lidhur kontrata “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë” me afat 30.12.2020-31.12.2021 në vlerën **14,775,887** lekë pa TVSH dhe në vlerën **17,731,064.40** lekë më TVSH.

Realizimi i kontratës së sipërpërmendur nga data e lidhjes së marrëveshjes deri me datë 31.01.2021 është në vlerën 6,213,336 lekë.

Në kontratat e sipërpërmendura ku janë lidhur midis SPV dhe OE, në pikën 2.5, citohet se “Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në fuqi të MK nr. 25/7 Prot, datë 20.07.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”

Pra dhe në kontratat e sipërpërmendura të lidhur midis AK dhe OE “C. F.” pika 2.4 ku citohet “Çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit do të rivlerësohet në përputhje me inflacionin e publikuar, referuar parashikimeve ligjore të pikës 2 të nenit 9 të VKM 914/2014” si dhe pika 2.5 e kontratës “Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në fuqi të MK nr. 25/7 Prot, datë 20.07.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”, **SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave**

administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4.

Nga auditimi i zërave të situacioneve të shërbimit të “Pastrim i brendshëm” grupi i auditimit konstatoi se për sipërfaqe të dhëna me qira:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë për vitin 2020-2021 është lidhur kontratë e re me OE “C. E.” shpk me nr 24, prot. nr 1360 datë 20.07.2020 dhe kontratës nr. 48, prot. 2318, datë 30.12.2020 me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.”,

Nga SPV janë likuiduar për zërin e shërbimit “Pastrim i brendshëm”, sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m² që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qera.

Nga SPV për periudhën 20.07.2020 deri me 31.01.2021 në lidhje me zbatimin e kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” konstatohet se ka paguar OE “C. E.” shpk për “Pastrim i brendshëm” të ambienteve të dhëna me qera, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në vlerën prej **201,894 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit**.

a. Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m².

Midis SPV dhe qeramarrësin shoqërinë “AGS” SHPK është lidhur kontrata e qerasë nr. 5, datë 03.02.2020 me kohëzgjatja nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës së shërbimit të lavanderisë nr. 3, datë 31.01.2020 dhe deri në përfundim të saj dhe/ose kontrata të tjera shërbimi me po të njëjtin objekt.

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 20.07.2020 deri me 31.01.2021 (175 ditë kalendarike) për pastrimin e lavanterisë dhe ambientit ndihmës shuma 68,145 lekë pa TVSh.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/përnjësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
20.07.2020-31-12.2020	144	4.4	88.5	56,074
31.01.2021	31	4.4	88.5	12,071
Totali	175			68,145

Siç konstatohet sa më sipër shoqëria “C. E.” shpk deri me datën 31.01.2021 është paguar më tepër, për zërin “Pastrim i brendshëm”, gjatë zbatimit të kontratës nr 24, prot. nr 1360 datë 20.07.2020 dhe kontratës nr. 48, prot. 2318, datë 30.12.2020 me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.”, për sipërfaqen e lavanderisë dhënë me qera, duke shkaktuar **dëm ekonomik 68,145 lekë pa TVSH (81,774 lekë me TVSh)**.

b. Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m².

Midis SPV dhe qiramarrësin shoqërisë “S. AL” SHPK është lidhur kontrata me nr. 969, prot. datë 03.04.2020, me kohëzgjatje deri në datë 03.04.2021, me të drejtë rinovimi me të njëjtit kushte, meqë ambienti i dhënë me qira është i lidhur ngushtësisht me kontratën e shërbimit të marrëveshjes kuadër nr. 80/8, datë 27.03.2020.

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 20.07.2020 deri me 31.01.2021 (175 ditë kalendarike) për pastrimin e ambientit të gatimit shuma 100,100 lekë pa TVSh.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/përnjësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
20.07.2020-31-12.2020	144	4.4	130	82,368
31.01.2021	31	4.4	130	17,732
Totali	175			100,100

Siç konstatohet sa më sipër shoqëria “C. E.” shpk deri me datën 31.01.2021 është paguar më tepër, për zërin “Pastrim i brendshëm”, gjatë zbatimit të kontratës nr. 24, prot. nr.1360 datë 20.07.2020 dhe kontratës nr. 48, prot. 2318, datë 30.12.2020 me objekt: “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.”, për sipërfaqen e gatimit dhënë me qira, duke shkaktuar **dëm ekonomik 100,100 lekë pa TVSH (120,120 lekë me TVSh).**

Observacion i subjektit mbi Projekt raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit me shkresën nr.149/7, datë 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me pretendimin për se është paguar shërbimi i pastrimit për ambientet që janë dhënë me qera. Në Proces-Verbalin datë 29.04.2016 nënshkruar mes Institucionit tonë dhe “S. Al” Sh.p.k, nuk rezultoi që shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme të jetë kryer edhe në ambientet e dhëna me qira. Zërat e përshkruar në procesverbalin e nënshkruar mes palëve nuk përfshijnë ambientin e gatimit dhe të lavanderisë. Në asnjë rast, OE “S. Al” Sh.p.k nuk ka faturuar kryerjen e shërbimit të pastrimit për këto sipërfaqe dhe SPV-ja nuk ka paguar për pastrimin e tyre jashtë sipërfaqes së dorëzuar me Proces Verbalin datë 29.04.2016 .

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sipërfaqja totale e Spitalit te ri kati i bodrumit ku është dhe ambienti i gatimit dhe i lavanderise i përfshirë është në total 872m², sipërfaqe e cila është paguar e plotë në çdo situacion, në çdo muaj pa zbritur sipërfaqet, të cilat janë dhënë me qira. Vlera e plotë e sipërfaqes prej 872 m² është vlerë e cila është e përcaktuar dhe në projekt preventivin e rikonstruksionit të godinës. Në të është e përcaktuarës vlera e plotë e ambientit të bodrumit është 872m².

Në shumën totale prej 5,677.00 m² të sipërfaqeve (të brendshme) të matura në SPV janë sipërfaqet e Spitalit të Ri, pra nuk është hequr asnjë metër katror për sipërfaqet e dhëna me qira në podrum dhe në katin përdhe.(kjo kuptohet sepse sipërfaqet e kateve të matura në Spitalin e sipas kateve janë 872, 875 e 874 m²)

Observacioni nuk merret ne konsideratë.

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me pretendimin për tejkalimin e sipërfaqes së kontratës me (7 m²). Theksojmë se përllogaritja e fondit limit si dhe përcaktimi i modaliteteve të kryerjes së shërbimit janë parashikime, të cilat mund të pësojnë ndryshime gjatë zbatimit të kontratës. Nisur nga ky fakt SPV-ja së bashku me OE “S. Al” Sh.p.k, në Aneksin Nr. 1 bashkëlidhur Kontratës së Shërbimit Nr. 28, datë 08.04.2016 kanë parashikuar që: “Sasia e përcaktuar në tabelat e mësipërme shërben si tabelë orientuese por që në varësi të nevojave Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë kërkesat e AK, kërkesa të cilat duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës pa dëmtuar volumin e punimeve dhe grafikun e ekzekutimit të tyre.”. SPV-së, sa herë që konstaton domosdoshmërinë e rehabilitimit dhe përshtatjes së ambienteve në përputhje me nevojat e pacientëve, mjekëve të SPV-së, rrit kërkesën, duke kërkuar frekuencë larje më intensive. Kjo, vlerësohet rast pas rasti, në varësi të shumë faktorëve që ndikojnë në një strukturë spitalore, aq më tepër kur pacientët kërkojnë një përkujdesje edhe më të veçantë se në spitale të tjerë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Veprimet e përshkruara më sipër, janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 neni 59 “Kushtet për zbatimin e kontratës”, i cili përcakton se: “1. Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit. si dhe neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese””.

Observacioni nuk merret ne konsideratë.

Pretendimi i Subjektit: Kontrata bazë e nënshkruar përcakton indeksimin e çmimeve në mënyrë progresive vit pas viti. Amendimi i Kontratës (kontrata e rivlerësimit) që zbatohet për indeksimin e çmimeve zbaton kushtet e kontratës/marrëveshjes bazë duke e mbajtur indeksin e çmimeve të azhurnuar në mënyrë progresive (rivlerësuar). Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit (norma e inflacionit e shprehur në përqindje), publikohen nga Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe gjithmonë i referohen periudhës paraardhëse.

Një vit pas nënshkrimit të kontratës bëhet rivlerësimi i Kontratës së Shërbimit sipas ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga INSTAT. Në këtë rast me nënshkrimin e amendimit për rivlerësimin e kontratës, Kontraktorit i lind e drejta të llogaris rivlerësimin si më poshtë:

Llogarit rivlerësimin e çmimit për periudhën vjetore paraardhëse. Pra për periudhën paraardhëse (përfshirë edhe vitin e parë të kontratës) kemi një rritje të çmimit të shërbimit sipas indeksit të inflacionit të publikuar për periudhën përkatëse dhe Kontraktuesit i lind e drejta të marrë diferencën e çmimit të papaguar ashtu sikundër në rast deflacioni porositesit i lind e drejta që të merrte mbrapsht diferencën e shumës “tepër” të paguar më parë për shërbimin e kryer gjatë kësaj periudhe dhe

Llogarit rivlerësimin e çmimit në mënyrë progressive për vitin në vijim sipas Indeksit të inflacionit në të cilën përcaktohet, çmimi i ri i indeksuar për shërbimin që do të ofrohet nga Kontraktuesi në vijim po për një periudhë një vjeçare

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Inflacioni nuk ka kuptimin e indeksimit dhe vlerësimit të çmimeve të periudhave paraardhëse. Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezultoi se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike.

Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese. Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105“Efektet prapavepruese” citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

Kontrata me nr. 26, datë 29.03.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" në nenin 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës" pika 2, citohet se....."Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar...." pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i Subjektit: Nuk ka dublim të pagesës për tre vitet objekt auditimi, për arsye se pagesa e kryer me urdhër shpenzimit nr. 181, datë 05.09.2017; nr. 232, datë 04.10.2018 dhe nr. 199, datë 04.09.2019 janë diferenca e indeksimit të çmimit për periudhën e aplikuar në faturën e muajit vijues.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pagesave të realizuar nëpërmjet nga SPV në favor të subjektit konstatohet se çmimet për këto mallra dhe shërbime janë indeksuar nga dy e më shumë herë, analizuar në tabelën si mëposhtëm:

Rivlerësimi 2017		Rivlerësim 2018		Rivlerësim 2018		Rivlerësuar 2019	
31.05.2017	1,925,834	31.05.2017	1,925,834	31.05.2018	1,964,751	31.05.2018	1,964,751
30.06.2017	1,863,710	30.06.2017	1,863,710	30.06.2018	1,901,372	30.06.2018	1,901,372
31.07.2017	1,925,834	31.07.2017	1,925,834	31.07.2018	1,964,751	31.07.2018	1,964,751
31.08.2017	1,925,834	31.08.2017	1,925,834		5,830,874		5,830,874
	7,641,212		7,641,212				
Indeksuar 2%	152,824	Indeksuar 2.1%	160,465	Indeksuar 2.1%	122,448	Indeksuar 1.5%	87,463

Pra siç është paraqitur në tabele periudhat për të cilët janë dublikuar pagesat pasi është aplikuar indeksi i çmimit të periudhës dhe më pas është aplikuar përsëri indeksi i periudhës pasardhëse kur është bërë rivlerësimi i çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të realizuara në periudhat paraardhëse. Muajt e konstatuar janë për të treguar se si nga AK/SPV ka indeksuar nga dy e më shumë herë çmimet për këto mallra dhe shërbime. Vlera totale e dëmit i përlogarit nga grupi i auditimit është për të gjithë indeksimin e çmimeve për periudhën vjetore paraardhëse.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

7.Titulli i Gjetjes:

Kontratat e Rivlerësimit për kontratën bazë nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik".

Situata 1:

Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE për kontratën baze nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik" rezulton se rivlerësimi i çmimeve është bërë me efekt prapaveprues, duke aplikuar çmime të ndryshëm nga ato të përcaktuar në kontratë në momentin e realizimit të shërbimit. Nga auditimi konstatohet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve janë indeksuar dy herë me normën e inflacionit. Në momentin që është lidhur kontratë rivlerësimi është bërë rivlerësim të periudhave paraardhëse, për të cilën është aplikuar norma e inflacionit të periudhës së mëparshme.

Pra siç vërehet, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, nga ku rezulton se nga SPV është cenuar parimi i sigurisë juridike. Në përputhje me këtë parim kushtetues, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mungesën e fuqisë prapavepruese.

Me konkretisht në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë" në neni 105 "Efektet prapavepruese" citohet se:

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur **kjo lejohet nga ligji** dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Ky vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese.

Çmimi i aplikueshëm në momentin e realizimit të shërbimit janë çmimet e përcaktuar në kontratën e lidhur midis AK dhe OE.

SPV e keq interpreton nenin 2 pika 2.2 të kontratës nr. 77/13, datë 08.04.2016 së lidhur midis SPV dhe OE, pasi kjo pikë e kontratës nuk mund të interpretohet vetëm, por e lidhur me dispozitat e sipër cituara, të cilat nuk lejojnë aplikimin e fuqisë prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit.

Kontrata me 77/13, prot. datë 08.04.2016 nuk i japin AK të drejtë të ndryshojnë çmimin pasi ka ndodhur transaksioni, pra pasi shërbimi është marrë dhe është likuiduar.

Kjo jo vetëm që bie ndesh me nenin 105 “Kodi i procedurave administrative të republikës së Shqipërisë”, por cenon parimet themelore të sigurisë juridike.

Vlerësimi i çmimeve për mallra/shërbimet e përlogaritura nga SPV është në kundërshtim dhe me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, citohet se.....“Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar....” pra në asnjë rast nuk përcaktojnë dhe nuk citohet, që të behët rivlerësim të çmimeve për mallra/shërbime, të cilat janë blerë dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, por rishikim i vlerave të kontratës për në vazhdimësi.

Për pasojë vlera e rivlerësimit

- për vitin 2017 në shumën **608,250** lekë

- për vitin 2018 në shumën **608,215** lekë

- për vitin 2019 në shumën **473,236** lekë, në total në shumën prej **1,686,701** lekë përbën

dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Kriteri:

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” në neni 105, VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 9.

Ndikimi/Efekti:

Rivlerësimi i çmimeve ka shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit

Shkaku:

Keq interpretim i aplikimit të inflacionit dhe vlerësimit të çmimeve për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Nga ana e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbllimin e dëmit në vlerën prej **1,686,701 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S.-AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit të periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Afati i zbatimit:

Menjëherë.

8.Titulli i Gjetjes:

Zbatimi i kontratës nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik”.

Situata 1:

Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë janë likuiduar për zërin e shërbimit “Pastrim i brendshëm”, sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m² që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qira.

Nga periudha 01.03.2017 deri me 13.07.2020 në lidhje me zbatimin e kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë konstatohet se SPV ka paguar OE “S. Al” shpk për “Pastrim i brendshëm” të ambienteve të dhëna me qera, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në vlerën prej **1,767,275 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin:

a. Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m²

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 01 mars 2017 deri më 13.07.2020 (1238 ditë kalendarike) për pastrimin e lavanderisë dhe ambientit ndihmës shuma 596,506 lekë pa TVSh (715,807 lekë me TVSh).

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	88.5	144,342
2018	365	5.44	88.5	175,726
2019	365	5.55	88.5	179,279
13.07.2020	195	5.63	88.5	97,160
Totali	1238			596,506

b. Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m².

Nga SPV janë paguar për periudhën kohore 01 mars 2017 deri më 13.07.2020 (1231 ditë kalendarike) për pastrimin e ambientit të gatimit shuma **876,223** lekë pa TVSh (1,051,469 lekë me TVSh).

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	130	212,027
2018	365	5.44	130	258,128
2019	365	5.55	130	263,348
20.07.2020	195	5.63	130	142,721
Totali	1231			876,223

Situata 2:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë konstatohet se për zërin “Pastrim i brendshëm ” çdo muaj nga periudha 01 Mars 2017 deri më 20.07.2020 është paguar për sipërfaqen 7354 m2. Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, si dhe në DT është përcaktuar se sipërfaqja “Pastrim i brendshëm” është në sasinë 7,347 m2, çka rezulton me një tejkalim të kontratës prej 7m2.

Nga SPV për këtë periudhë ka paguar OE “S. A” shpk më tepër për vlerën 47,181 lekë pa TVSh (56,618 lekë me TVSH). duke shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit**.

Viti	Ditë/Kalendarike	Çmimi/për njësi	Sipërfaqe	Vlera Totale pa TVSH
Mars 2017	306	5.33	7	11,417
2018	365	5.44	7	13,899
2019	365	5.55	7	14,180
13.07.2020	195	5.63	7	7,685
Totali	1238			47,181

Situata 3

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë për periudhën 20.07.2020 deri me 31.01.2021 në lidhje me zbatimin e kontratës “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë konstatohet se ka paguar OE “C. E.” shpk për “Pastrim i brendshëm” të ambienteve të dhëna me qera, prej 218.5 m², ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në **vlerën prej 201,894 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin a. *Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m².* në vlerën **81,774 lekë me TVSh** dhe b. *Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m²* në vlerën **120,120 lekë me TVSh**.

Kriteri:

Shkelje e kushteve të kontratës së lidhur midis OE dhe AK, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike” i ndryshuar, neni 59 dhe neni 6060, pika 1, e cila përcakton se: “Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

Ndikimi/Efekti:

Shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Shkaku:

Mos përlllogaritja e saktë e sipërfaqeve të ambientit, për të cilën realizohet “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme”, si dhe mos zbritja e sipërfaqeve të ambienteve të dhëna me qera në procesverbalet e monitorimit si dhe në situacionet e realizimit të shërbimit.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerën prej **1,823,892 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfutur padrejtësisht për “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme” të cilat janë dhanë me qira.

Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit në vlerën **201,894 lekë me TVSH** ndaj sipërmarrësit “C. E.” shpk, për vlerën e përfutur padrejtësisht për “Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme” të cilat janë dhanë me qira.

Afati i zbatimit:

Menjëherë.

9.Titulli i Gjetjes:

Në kontratat e shërbimit të lidhra midis SPV dhe OE, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese.

Situata 1:

Nga titullari i AK dh OE “C. F.” shpk është lidhur kontrata nr. 24, datë 20.07.2020 “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë” me afat 20.07.2020-31.12.2020 në vlerën 6,394,248.2 lekë pa TVSH (7,673,097.84 lekë me TVSH), si dhe kontratën nr.48, datë 30.12.2020, me afat 30.12.2020-31.12.2021 ne vlerën 14,775,887 lekë pa TVSH (17,731,064.40 lekë me TVSH).

Në kontratat e sipërpërmendura ne pikën 2.4 dhe 2.5, citohet se “Çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit do të rivlerësohet në përputhje më inflacionin e publikuar, referuar

parashikimeve ligjore të pikës 2 të nenit 9 të VKM 914/2014” si dhe pika 2.5 e kontratës “Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në fuqi të MK nr. 25/7 Prot, datë 20.07.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të **periudhës së mëparshme** dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”,

Në bazë të këtij neni të kontratës së pranuar mes palëve, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, duke cënuar parimin e sigurisë juridik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4, ku citohet se “Kontraktuesi nuk do të ketë të drejt kompensimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.....”.

Situata 2:

Për vitin 2020, me autorizimin nr. 80/9 prot. datë 27.03.2020, nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si Organ Qendror Blerës, pas përfundimit të procedurës së prokurimit “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, ka autorizuar SPV të lidhi kontratën me OE “shpallur fitues “S. AL” me ofertë ekonomike **166.021.272** lek pa TVSH. SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4** lekë pa TVSh, me operatorin ekonomik “S.AL” SHPK.

Në pikën nr. 3.6 së kontratës citohet se “Rivlerësimi i çmimit do të ketë efekt ligjor nga data e hyrjes në fuqi të MK nr. 80/8 Prot, datë 27.03.2020 deri në përfundim të vlerës së saj. Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të **periudhës së mëparshme** dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”.

Në bazë të këtij neni të kontratës së pranuar mes palëve, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, duke cënuar parimin e sigurisë juridik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4, ku citohet se “Kontraktuesi nuk do të ketë të drejt kompensimi dhe nuk do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.....”.

Situata 3:

Nga titullari i AK dh OE “AGS” shpk është lidhur kontrata me nr. 43, datë 30.12.2020 “Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV” për periudhën 01.01.2021- 31.12.2021 me fond limit në vlerën 26,546,722.85 lekë pa TVSH. Në kontratat e sipërpërmendura në nenin 2, pika 2.6 citohet se “Palë bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruaj në amendimkontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të **periudhës së mëparshme** dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”. Në bazë të këtij neni të kontratës së pranuar mes palëve, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, duke cënuar parimin e sigurisë juridik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” pika 2.

Kriteri:

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”, si dhe me Marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE, pika 1.4,

Ndikimi/Efekt:

Krijimi t dëmeve ekonomike të mundshme në të ardhmen.

Shkaku:

Keq interpretim i konceptit dhe aplikimit të inflacionit, duke vlerësuar çmimet për mallrat e shërbime të realizuara në periudhat paraardhëse, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

SPV të marrë masa të menjehershme për ndryshimin e nenit në të cilën citohet “.....të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të **periudhës së mëparshme** dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen”, duke hequr togëfjalëshin “të **periudhës së mëparshme**”, me qëllim shmangien e krijimeve të dëmeve ekonomike të mundshme në të ardhmen.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

2.7.Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e krverjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

Ne zbatim te pikes 7 te programit te auditimit u shqyrtuan dokumentacionet si me poshtë:

- ❖ Urdher shpenzimet e realizuar, per vitet objekt auditim.
- ❖ Procedurat e auditimit per blerje te vogla.
- ❖ Shpenzimet per udhetime dhe djeta.
- ❖ Shpenzimet per karburantin.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, te Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësitet e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura nga grupi i auditimit në bazë risku u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

- Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, te Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësitet e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i Avokaturës së Shtetit, në përputhje konform pikës 42, 43, 44, te Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësitet e Sektorit Publik"

1. Me urdhërin nr.757 prot me datë 28.06.2017, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se fondit limit për blerje me vlera të vogla për "Riparim dhe mirmbajtje automjetesh". Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimit me te ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlera e përlllogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr.760 prot me datë 28.06.2017 është **777,818** lek pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.762 prot date 28.06.2017 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. Kvo me nr.762/10 datë 07.07.2017 ka shpallur fitues ofertuesin i renditur i pesti , pasi OE e tj nuk ja paraqitur prane AK ne afatat e percaktuara ose kane njoftuar terheqe nga gara ne sistemin e app. Me nr.762/11 date 10.07.2017 eshte lidhur kontrata midis O.E "S.GJ." dhe AK me vlerën **749,900** lekë pa tvsh. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me urdher nr.863 prot date 10.07.2017 dhe përbëhet nga z.E. B., z.F. M. dhe F. M.. Komisioni i mbikqyrjes me proces verbal pa nr prot datë 22.08.2017 ka mbajtur raport paraprak për mbikqyrjen e kontrates së shërbimit. Sipas komisionit, shërbimet (pjesor nr.1) jane kryer konform kriterëve dhe specifikimeve të vendosura në kontratë dhe shuma është likujduar me urdher shpenzimi nr.166 date 24.08.2017. Vlera e pjeshme e punimeve është **702,360** lek me tvsh. Gjithashtu me raportin perfundimtare datë 22.12.2017 komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur raportin

përfundimtar për mbikqyrjen e kontrates. Sipas komisionit kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe është likuajduar me urdhër shpenzimi nr.268 datë 27.12.2017. Vlera e punimeve është **196,800** lek me tvsh. Në total të dy situacionet janë në vlerën **899,160 me tvsh.**

Nga auditimi i procedurës konstatohet se nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet, nuk ka kërkesa nga shoferët, gjithashtu nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e difekteve të këtyre automjeteve, nuk ka urdhër nga titullari që automjetet të shkojnë për diagnostimin e difekteve. Gjithashtu konstatohet se nevoja për kryerjen e shërbimeve të automjeteve nuk është reale pasi nuk është kryer diagnostikimi i pjesëve të dëmtuara por është kryer një parashikim i cili mund të ndodhë për ndërrimin e pjesëve dhe dëmtimin e tyre.

Ne shkresen date 22.12.2017 “Raport përfundimtar i mbikqyrjes së kontratës” shprehen se kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike. Nderkohe nga situacioni i punimeve 1 dhe 2 (përfundimtare) konstatohet se është kryer mirembajtja e automjeteve dhe e gjeneratorve, por jo sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK, pavaresisht se vlera totale është pak me e vogël. Në kundërshtim Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu konstatohet se për shpenzimet e mësipërme për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti.

Përcaktimi i preventivit është shpenzimi jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit.

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre: Z. E. B., z.F. M. dhe F. M. dhe ish titullari i AK, z.K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

2. Me urdhërin nr.694 prot datë 15.06.2017, është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Blerje Goma, bateri për automjete”. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg, konkretisht nga O.E S., G. dhe A. S, dhe në bazë të cmimit më të ulët ka bërë përlogaritjen e fondit limit. Vlera e llogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr 697 prot date 15.06.2017 është **646,482** leke me tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.874 prot datë 12.07.2017 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Komisioni i vlersimit të ofertave me proces verbal nr 878/1 prot date 13.07.2017, njofton se si pasojë e mosrealizimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël në SPE, për mungesë konkurrence, dy here konkretisht. Kjo vendosi të realizoj këto procedurë prokurimi me rruge shkrese. Nga testimi i tregut duke u bazuar në cmimin me të ulët vendosi të përcaktoj si fitues OE “G.” me vlerë 627,940 pa tvsh dhe 753,528 me tvsh.

Komisioni i mbikqyrjes së kontratës është ngritur me nr.900 prot date 14.07.2017 Komisioni i mbikqyrjes me proces verbal datë 14.07.2017 ka mbajtur raport-mbikqyrjen për kontratën dhe sipas komisionit materialet kanë ardhur sipas specifikimeve dhe sasive të përcaktuara në procedurë. Shuma është likuajduar me urdhër shpenzimi nr.145 date 17.07.2017 dhe vlera është **753,528** leke me tvsh.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës së sipër përmëndur konstatohet se procedura është në përputhje me kuadrin ligjor.

3. Me urdhërin nr.864 prot datë 04.05.2018, është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Mirëmbajtje automjeteve dhe gjeneratorësh”. Komisioni

për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkreses nr.633 prot datë 29.03.2018 e cila përmban kërkesat e bëra nga shefe e zyres se hoteleris per mirmbajtjen e automjeteve. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimi me ulët ka bërë përllogaritjen e fondit limit, vlera e përllogarit nga komisioni për fondin limit me shkres nr.882 prot me datë 08.05.2020 është **758,000** leke pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.894 prot nr.22 date 09.05.2018 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. Kvo me nr.894/10 datë 23.05.2018 ka shpallur fitues ofertuesin e renditur i 7 O.E “S.GJ.”, me nipt L36308201D pasi OE e tj ose jane terhequr ose nuk jan paraqitur prane AK. Me nr.894/11 prot date 24.05.2018 eshte lidhur kontata midis OE “SALATAJ GJ” dhe AK dhe cmimi eshte 729,00 lek pa tvsh dhe 874,800 me tvsh. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me nr.1035 prot nr.173 date 24.05.2028 dhe përbëhet nga z.E. B., z.F. M. dhe z.F. M.. Komisioni i mbikqyrjes me shkresë nr.1475 prot datë 20.07.2018 ka mbajtur raport paraprak për mbikqyrjen e kontrates së shërbimit dhe sipas komisionit shërbimet (situacion i pjeshem) është kryer konform kriterëve të vendosura në kontratë dhe është likujduar me urdher shpenzimi nr.170 date 02.08.2018 dhe vlere e pjeshme e punimeve është **579,840** leke me tvsh, gjithashtu me shkresë nr.2302 datë 26.12.2018 komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur raportin përfundimtar për mbikqyrjen e kontrates dhe sipas komisionit kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike, dhe është likujduar me urdher shpenzimi nr.310 datë 26.12.2020, vlera e punimeve është **290,880** leke me tvsh. Në total të dy situacionet janë në vlerën **870,720 me tvsh.**

Nga auditimi i procedurës konstatojm se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara dhe për zërin si Xham i parem, thekësojm se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fatke se përse duhet të ndrohen ky ze specifikisht. Me shkresen nr.2302 datë 26.12.2018 “raport përfundimtar i mbikqyrjes së kontratës” citohet: *se kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike.* Nderkohe nga situacioni i punimeve 1 dhe 2 (përfundimtare) konstatojm se është kryer mirmbajtja e automjeteve dhe e gjeneratorve por jo sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga AK, pavarsisht se vlera totale e punimeve eshte me e vogel se Vlera e shpallur fituese. Perkatesisht OE eshte shpallur fitues me vleren 874,800 me tvsh nderkohe vlera totale e punimeve te kryera eshte **870,720 me tvsh** . Në kundërshtim Nr. 914, datë 29.12.2014 per miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, DATË 29.12.2017 Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu konstatojm se shpenzimet e mësipërme për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi, kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivin përpara se të ndodhë një difekt ose avari, apo nevojë për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh difekti. Përcaktimi i preventivit është shpenzimi jo i drejtë, dhe në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit.**

Personat pergjegjes per veprimet dhe mos veprimet e tyre. Ish titullari i Ak, z. K. Ll., z.V. N., z.E. B., z.F. M. dhe z.F. M.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

4.Me nr.1787 date 29.12.2017 me urdher prokurime per shtese kontrate te mbejtjeve urbane, kerkoher kjo procedur nga kry/inf/pergjithshem z. E. B. me shkrese pa nr prot me date 29.12.2017, pasi ne fund te vitit mbaron kontrata dhe per fillim te vitit 2018 eshte I nevojshem evadimi i mbetje urbane. Kontrata eshte firmosur me nr.1787/1 prot me date 29.12.2019 dhe afati i kontrates eshte nga data 1.01.2018 deri me 27.02.2018.

Komisioni I mbikqyrjes eshte ngritur me nr.1789 date 29.12.2017.

Vlere e llogaritur e 20% të kontratës së fundit të lidhur eshte si me posht:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje te parashikuara	kg	2851.9	54.5	155428.55
2	Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m ²)	m ²	24488.1	19828.8	
3	Disifektim per 2 pika (1*2)	dite	122.4	154.1	18861.84
Totali pa TVSH				194119.19	

Nga auditimi i procedurës "Evadimi i mbetjeve urbane" konstatohet se procedura e prokurimit është e pa nevojshme pasi ky shërbim mbulohet nga kontrata 5 vjecare me Nr.4558 Prot, datë 31.10.2014 e lidhur më midis firmes se pastrimit "D." shpk dhe Bashkinë Vlorë. Gjithashtu është mbivendosje kontrate me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik "S.AL", me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016 dhe OE ka për detyrë në baze të kontratës të pastrojnë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlore si citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përreth godinave (Objekt ndërtimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë, OE kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimi e plerave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të medhej, të posacem, të mbyllur me kapak.* Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjmë me dëm ekonomik në vlerë **46,428.77** me tvsh. **Personat përgjegjes për veprimet ose mos veprimet e tyre: Z.K. Ll.**

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: bazuar pretendimit tuaj se Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata 5 vjecare me nr.4558 prot., e lidhur me date 31.10.2014 e firmes se pastrimit "D" Shpk me Bashkinë Vlore, Spitali Psikiatrik i është drejtuar Bashkisë Vlore me kërkesën nr.577 Prot., date 30.05.2017 dhe me shkresë në vazhdimësi me shkresën nr.742 prot., datë 15.04.2020 ku i është kthyer përgjigje me shkresën nr.741/1 prot., datë 29.04.2020, për të sqaruar përsëri nëse Evadimi i mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata nr.4558 prot., date 31.10.2014. Nga përgjigjet e kthyera sqarohet se kjo kontratë nuk e mbulon Evadimin e mbetjeve urbane te Spitalit Psikiatrik te Vlores.

Vërtetë bashkia Vlorë në kontratën e saj ka mbulimin e rrugës "Ibrahim Avdullhu", rrugë në të cilën është vendndodhja e Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë por Bashkia nuk ka kontratë për heqjen e mbetjeve urbane brenda territorit të SPV.

Për këtë rekomandim është njoftuar Operatori Ekonomik "D." shpk me shkresën me nr.1505 prot., datë 20.09.2021 në lidhje me kontratën me objekt "Evadimi i mbetjeve urbane", i cili i është përgjigjur Autoriteti Kontraktor mbi rekomandimet e lëna, me shkresën e ardhur në institucion me nr.1505/1., datë 06.10.2021 (Bashkëlidhur kthim përgjigje)

Gjithashtu sqarohet se në kontratën e shërbimit të pastrimit të brendshëm detyrimet e shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm janë heqja e mbetjeve nga pavionet apo ambienti i jashtëm dhe grumbullimi nëpër vendet përkatëse, por nuk ka për detyrë heqjen e mbetjeve nga territori SPV.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Argumentimet tuaja qëndrojnë pjesërisht për pikën e parë (mbetje të parashikuara) e për pasojë merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Ndërsa për pikën e 2 Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m²) dhe pikën 3 Disifektim per 2 pika (1*2) nuk merret parasysh pasi janë mbivendosje e kontratës me objekt "Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm" në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik "S. Al", me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016.

Për sa i përket fshirjes ku gjenden koshat OE "S. Al" ka për detyrë në bazë të kontratës të pastrojnë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlore ku citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përreth godinave (Objekt ndërtimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë.*

Për sa i përket grumbullimit të heqjes së mbetjeve nga firma e pastrimit "S. Al" në kontratë citohet: *Grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si*

rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për ne vend grumbullimin e plehrave behet çdo dite, transporti behet me kosha te mëdhenj, te posaçëm, te mbyllur me kapak.

Për dezinfektimin të pikave ku grumbullohen mbetjet urbane theksojm se tek specifikimet nuk është përcaktuar se me çfarë do të dizinfektohet (lënd, produkt etj) dhe OE “S. AL” në bazë kontratës kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para orës 7:00.

Obesvacioni meret pjeserisht ne konsiderat.

5. Me nr.118 date 17.01.2018 urdher prokurime per shtese kontrate te “Mirmbajtja e kondisionerve, kaldajave dhe cillrave, kerkohet kjo procedur nga pergjegjsi i zyres teknike z.A. L. me shkrese pa numer protokolli me date 15.01.2018, pasi mbeshetur ne kerkesat e pavioneve dhe nga verifikimi i bere nga zyra teknike per sisitemin e ngrohesh-tohes. Mbeshtetur ne kontraten e lidhur vitin e kaluar me nr.3594/11 date 31.07.2017. Kontrata eshte lidhur me nr.118/1 prot me date 17.01.2018.

Komisioni i mbikqyrjes eshte ngritur me nr.132 date 17.01.2018 dhe ka mbajtur raport permbledhes me date 16.03.2018 ne te cilen shprehet se punimet jane kryer konform kriterëve dhe kushte te vendosura ne kontrate. Ndersa me urdher shpenzimi nr.64 date 19.03.2018 me vlere 345,600 me tvsh.

Nga auditimi i procedures nuk vërtetohet emergjenca dhe nevoja e lidhjes së kësaj kontrate dhe kryerjes së shërbimeve për mirëmbajtjen e kondisionerve, kaldajave dhe cillareve. Pasi me process verbal te mbajtur me date 10.11.2017 dhe 18.12.2017 nga komisioni i mbikqyrjes se kontrates eshte bere mirmbajta dhe riparimi e tyre nga kontrate e lidhur me nr.594/11 date 31.07.2017 eshte midis OE ”J. Z.” dhe AK. Gjithashtu ne procesverbalet e mbajtura nuk jane shprehur se kane nevoja te metejshme emergjente per mirmbajtjen e tyre.

Përcaktimi i preventivit është shpenzimi jo i drejtë, dhe në mos përputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.**

Personat pergjejes per veprimet ose mos veprimet e tyre: Z.K. Ll.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

6. Me urdhërin nr.2003 prot datë 26.10.2018, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se vleres limit” për blerje Emergjente për “Riparimin e motorrit te automjetit tip mercedes”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkreses nr.1997 prot datë 26.10.2018 e cila përmban kerkesen e bëre nga shoferi I ambulances i cili ka konstatuar difektin ne motorr, bazur kjo ne verifikimi dhe akt-konstatimi nr.1192 prot date 25.10.2018 nga shoferi i ambulances dhe se bashku me administratorin e servisit. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimi me ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, vlere e përlllogarit nga komisioni për fondin limit me shkres nr.2019 prot me datë 30.10.2018 është**98,800** lek pa tvsh. Me nr.2043 prot date 02.11.2018 komisioni i prokurimeve me vlere te vogel ka mbajtur procesverbali per rastet emergjenten, i cili ka sqaruar se kjo ngjarje eshte emergjente dhe nuk mund te parashikohej me pare. Me nr.2045 prot date 02.11.2018 eshte ngritur komisioni I marrjes ne dorezim. Komisioni me nr.2064 prot date 07.11.2018 ka mbajtur procesverbal per marrjen ne dorezim dhe sipas komisionit mjete eshte mar dhe eshte ne gjendje te mire pune dhe me garanci pune prej 6 muajsh. Eshte bere pagesa me urdher shpenzimi nr.264 date 07.11.2018 me vlere 117,840 me tvsh.

7. Me urdhërin nr.517 prot datë 09.03.2018, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se vleres limit” për blerje me vlere te vogel “Monitorim dhe ekspertize mjedisore, sipas lejes mjedisore tipi B” per nevoja te SPV. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkreses nr.510 prot datë 09.03.2018 e cila përmban kerkesen per monitorimin e shkarkimeve dhe ndotjeve ne mjedis. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimit me te ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlere e përlllogaritur nga komisioni për fondin limit me shkrese nr.519 prot me datë 09.03.2018 është **600,000** lek pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.547 prot nr.11 date 16.03.2018 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. KVO me proces-verbal nr.547/2 date 21.02.2018 pasi ka shqyrtuar oferten e OE se

rendiur ne vend e pare me cmim me te ulet, ka vendosur ta skualifikoj pasi nuk permbush nje nga kushtet e AK si: *Ne perberje te stafit te kete nje veterine me tituj shkencor per monitorimin e mjedisit, dhe nje bioteknolog te vertetuar me diplom perkatese.*

Ne dokumentacioni e sjell nga OE nga kvo konstatohet se se ne listpagesat e paraqitura nuk figurojn emrat e personave specialist qe kane dorezuar diplomat universitare perkatese.

Me proces-verbal nr547/4 date 23.03.2018 KVO pasi shqyrtoj oferten e OE "S. E.-K." shpk vendsoi ta shpall fitues. Kontrata eshte lldhur me nr.600 prot date 26.03.2018 me vlere 589.900 pa tvsh dhe me vlere 707,880 me tvsh.

Me nr.601 prot date 26.03.2018 eshte ngritur komisioni i mbikqyrjes se kontrates. Komisioni pa nr prot me date 06.04.2018 ka mbajtur raportin e zbatimit te kontrates dhe kontrata eshte realizuar brenada standarteve dhe kriterëve te percaktuara eshte bere likuajdimi me urdher shpenzim nr.84 date 16.04.2018 ne vleren 281,940 me tvsh. Me nr.2268 prot date 18.12.2018 komisioni ka mbajtur raport mbi zbatimit e kontrates dhe eshte realizuar brenada standarteve dhe kriterëve te percaktuara eshte bere likuajdimi me urdher shpenzim nr.303 date 19.12.2018 ne vleren 281,940 me tvsh.

Nga auditimi i procedures konstatojm se specifikimit teknike e bere nga AK nuk jane te argumentuar dhe tek kriteri 2. *Ne perberje te stafit te kete nje veterine me tituj shkencor per monitorimin e mjedisit, dhe nje bioteknolog te vertetuar me diplome perkatese.*

Nuk argumentohet se perse duhet nje veteriner per ekspertizen mjedisore. Kriteri i mesiperm, nuk nxit pjesemarrjen e OE ne procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencen ndermjet tyre, krijojne diskriminim te tyre, sherben si penges per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. Kriteri i mesiperm nuk eshte hartuar ne menyre te tille qe te stimulojne pjesemarrjen, ishte i paargumentuara dhe jo ne perpjesetim me natyren e kontrates.

Mos argumentimi i kerkesave per kualifikim, jane veprime ne mosperpethje me percaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punëpublike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione te veçanta", ne te cilen percaktohet se: "Kontratat per pune, ne te cilen eshte percaktuar se: "Ne cdo rast kerkesat e mesiperme duhet te jene te argumentuara nga autoriteti kontraktore":

Gjithashtu ne perberje te komisionit nuk ka person pergjegjes grupi dhe veprimet jane ne kushdeshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 57 pika 2.

Personat pergjegjes per veprimet dhe mos veprimet e tyre: Z.S. Xh., znj.K. Xh., znj. R. B.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

8. Me urdhërin nr.1083 prot nr.154 datë 13.06.2019, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit për blerje me vlere të vogël për "Blerje Goma, bateri per automjete". Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në bazë të shkreses nr.1040 prot datë 10.06.2019 e cila përmban kerkesat e bera nga shoferat e automjeteve. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg, konkretisht nga O.E Autorunaj, Andi Hamo dhe Shkelzen Abazaj. Në bazë të cmimit më të ulet ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlora e llogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr 1115 prot date 14.06.2019 është **607,500** leke pa tvsh.

Me urdher prokurimi nr.1226 prot nr.28 datë 03.07.2019 është ngritur prokurimi me vlere te vogel. Komisioni i vlersimit te ofertave ka publikuar ne sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit i cili është renditur në vend të parë me oferte me te ulet O.E "A. K.". Operatori Ekonomik "A. K." nuk eshte paraqitur prane AK brenda afateve te percaktura dhe si pasoj AK e ka skualifikuar. Komisioni i vleresimit të ofertave ne kushtet e skualifikimit nga gara te O.E-se te renditur ne vendin e pare, ka kaluar në O.E e renditur në vendin e 2 deri tek OE I renditur ne vendin e 5 OE "K.". Me Proces-verbal nr 1126/8 date 16.07.2019

Komisioni i blerjeve te vogla njofton se OE "K." skualifikohet pasi nje nga dokumentat eshte paraqitu fotokopje.

Me nr.1226/14 prot date 19.07.2020 eshte shapllur fitues O.E "G." me vlere 549,900 leke pa tvsh.

Komisioni i mbikqyrjes se kontrates eshte ngritur me urdher nr.1407 prot nr date 24.07.2019. Komisioni i mbikqyrjes me shkrese nr.1436 prot datë 30.07.2019 ka mbajtur raport mbikqyrjen për kontraten dhe sipas komisionit materialet kanë ardhur sipas specifikimeve dhe sasive te percaktuara në procedure. Shuma eshte likujduar me urdher shpenzimi nr.170 date 02.08.2020 dhe vlere eshte **659,880** leke me tvsh.

Nga auditimi i procedurës konstatojme se kerkesat e bera nga shoferet nuk janë të argumentuar në fakte. Nderkohe komisioni i specifikimeve teknike ka percaktuar 2 kriteret.

1- Gomat dhe bateria te jene me garanci.

2- Autorizim prodhuesi per shitjen e gomave dhe baterive.

Në specifikimet më siper nuk argumentohet vendosja e ketyre kriterëve dhe nuk percaktohet se sa duhet te jete kohezgjatja e garancise. Nga dokumentacioni i paraqitur nga O.E fituese per kriterin autorizim prodhuesi per shitjen e gomave dhe baterive, O.E ka sjell nje kontrate funitori me subjektin "A. P." sh.p.k por jo nje kontrat ose autorizim te lidhur me prodhuesin e gomave dhe baterive. Nderkohe pavarsisht se ne kontaten e sjell nga OE "G." te lidhur me "A. P." nuk vertetohet se subjekti ka autorizim prodhuesi per shitjen e gomave dhe baterive.

Personat pergjegjes per veprimet dhe mos veprimet e tyre. Znj. R. Sh., znj.M. C. dhe znj. E. M.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

9. Me urdhërin nr.376 prot me nr.56 datë 20.02.2019, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se fondit limit për blerje me vlere të vogla për "Riparim dhe mirmbajte automjetesh". Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkreses nr.371 prot datë 20.02.2020, e cila përmban kerkesat e bëra nga shefja e zyres se hoteleris dhe miratuar nga titullari I AK. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimit me te ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlora e përlllogaritur nga komisioni për fondin limit me shkrese nr.384 prot me datë 21.02.2020 është **744,700** lek pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.393 prot nr.13 date 22.02.2019 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. Komisioni i blerjeve te vogla me shkres nr.393/5 datë 27.02.2020 ka shpallur fitues ofertuesin i renditur i dyti me cmim më të ulet OE "SALATAJ GJ." me vlerën **689,000** lekë pa tvsh, pasi ofertuesi i renditur ne vendin e pare ka mungese dokumentacioni. Nderkoheme date 393/6 prot 28.02.2019 ka lidhur kontraten. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me nr.445 prot nr.70 date 28.02.2019 dhe përbëhet nga E. B., A. L. dhe F. M.

Komisioni i mbikqyrjes me shkresë nr.1001 prot, datë 05.06.2019 ka mbajtur raport paraprak për mbikqyrjen e kontrates së sherbimit. Sipas komisionit sherbimet jane kryer konform kriterëve të vendosora në kontratë dhe shuma është likujduar me urdher shpenzimi nr.115 date 06.06.2019 me vlere **432,600** lek me tvsh. Gjithashtu me shkresë nr.2101 datë 10.12.2019 komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur raportin përfundimtar për mbikqyrjen e kontrates. Sipas komisionit kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe është likujduar me urdhër shpenzimi nr.285 datë 10.12.2019 me vlere **394,200** me tvsh. Në total të dy situacionet janë në vlerën **742,440 me tvsh.**

Nga auditimi i procedurës konstatojme se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara në fakte. Në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar me dokumentuar dhe fatke se përse duhet të nderrohen këto zera. Ne shkresen nr.2101 datë 10.12.2019 "Raport përfundimtar i mbikqyrjes së kontratës" citohet: *se kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike.* Nderkohe nga situacioni i punimeve 1 dhe 2 (përfundimtare) konstatojme se është kryer mirmbajtja e automjeteve dhe e gjeneratorve, por jo sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga A.K, pavaresisht se vlora totale

eshte pak me e vogel se nga oferta e OE. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu konstatohet se shpenzimet e mësipërme për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një defekti ose avaria, apo para se të lindin nevojat për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. Përcaktimi i preventivit është shpenzimi jo i drejtë, dhe në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.**

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre. Z. V. N., z.E. B., z.A. L. dhe z.F. M.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

10. Me urdhërin nr.146 prot me nr.21 datë 22.01.2019, është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogla për “Evadim i mbetjeve spitalore”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkresës nr.138 prot datë 01.01.2019, e cila përmban kërkesat e bëra nga krye/infermieri i përgjithshëm dhe miratuar nga Zyrtari i autorizuar I AK. Argumentimi i fondit limit është bërë nga komisioni me nr.172 prot date 24.01.2019. Komisioni për kg dhe cmimet është bazuar në realizimin e kontratës së ngjashme të vitit 2018. Vlera e llogaritur është 1730 kg * 241.80 leke/kg = **418,314 leke pa tvsh.**

Me urdhër prokurimi nr.195 prot nr.5 date 28.01.2019 është ngritur prokurimi blerje me vlerë të vogël. Me proces-verbal nr 208/1 prot date 30.01.2019 komisioni i blerjeve të vogla njofton se OE i renditur në vendin e parë nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar dhe si pasojë ka njoftuar OE “MEDI-TEL” renditur në vendin e dytë të paraqitur brenda afatit të përcaktuar pranë AK. Me nr.208/3 prot date 01.02.2019 komisioni i blerjeve të vogla pasi shqyrtoj dokumentacionin e sjellë nga OE “MEDI-TEL” vendosi të shpallë fitues. Nderkohe me nr.208/4 date 01.02.2019 ka lidhur kontratë midis OE dhe AK. Komisioni i mbikqyrjes së kontratës është ngritur me nr.445 prot nr.70 date 28.02.2019.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës së sipër përmëndur konstatohet se procedura është në përputhje me kuadrin ligjor.

11. Me nr.123 date 18.01.2019 me urdhër prokurime për shtesë kontratë të mbetjeve urbane, kërkoher kjo procedurë pasi procedura e prokurimit “Kërkese për propozim” është hedhur në sistemin e APP por nuk ka përfunduar akoma, për shkak se ka pasur një anulim të procedurës si rezultat i mosdorzimit të asnjë oferte. Ak e ka hedhur perseri në sistemin e procedurës së prokurimit. Urdhërohet që të lidhet shtesë kontratë deri në 20% të vlerës së kontratës së lidhur me nr.377/11 date 19.03.2018. Afati i shtesës së kontratës është nga data 18.01.2019 deri në datën 28.02.2019.

Komisioni i mbikqyrjes është ngritur me nr.131 prot date 18.01.2019.

Vlera e llogaritur e 20% të kontratës së fundit të lidhur është si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje të parashikuara	kg	2913	54	157,302
2	Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m ²)	m ²	16408	13,120	
3	Disinfektim për 2 pika (1*2)	dite	82	150	12,300
Totali pa TVSH				182,722	

Nga auditimi i procedurës për pikën 2 “Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosur në kontratën me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilin operon Operatori Ekonomik “S. Al”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe

të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapsirës rreth e përfaqësojnë godinave (Objekt ndertimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë të gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë, OE kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimi dhe plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të medhej, të posaçëm, të mbyllur me kapak.*

Për mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjmë me një **dëm ekonomik me vlerë 30,504** me tvsh. **Personat përgjegjës për veprimet ose mos veprimet e tyre:** z. K. Ll., z.V. N.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021.

Pretendimi i Subjektit: bazuar pretendimit tuaj se Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata 5 vjeçare me nr.4558 prot., e lidhur me datë 31.10.2014 e firmes së pastrimit “D.” Shpk me Bashkinë Vlorë, Spitali Psikiatrik i është drejtuar Bashkisë Vlorë me kërkesën nr.577 Prot., datë 30.05.2017 dhe me shkresë në vazhdimësi me shkresën nr.742 prot., datë 15.04.2020 ku i është kthyer përgjigje me shkresën nr.741/1 prot., datë 29.04.2020, për të sqaruar përsëri nëse Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik mbulohet nga kontrata nr.4558 prot., datë 31.10.2014. Nga përgjigjet e kthyerat sqarohet se kjo kontratë nuk e mbulon Evadimin e mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik të Vlores.

Vërtetë bashkia Vlorë në kontratën e saj ka mbulimin e rrugës “Ibrahim Avdullhu”, rrugë në të cilën është vendndodhja e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë por Bashkia nuk ka kontratë për heqjen e mbetjeve urbane brenda territorit të SPV.

Për këtë rekomandim është njoftuar Operatori Ekonomik “D.” shpk me shkresën me nr.1505 prot., datë 20.09.2021 në lidhje me kontratën me objekt “Evadimi mbetjeve urbane”, i cili i është përgjigjur Autoriteti Kontraktor mbi rekomandimet e lëna, me shkresën e ardhur në institucion me nr.1505/1., datë 06.10.2021. (Bashkëlidhur kthim përgjigje)

Gjithashtu sqarohet se në kontratën e shërbimit të pastrimit të brendshëm detyrimet e shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm janë heqja e mbetjeve nga pavionet apo ambienti i jashtëm dhe grumbullimi nëpër vendet përkatëse, por nuk ka për detyrë heqjen e mbetjeve nga territori SPV.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Argumentimet tuaja qëndrojnë pjesërisht për pikën e parë (mbetje të parashikuara) e për pasojë merren në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

Ndërsa për pikën 2 Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²) dhe pikën 3 Disinfektim për 2 pika (1*2) nuk meriton parasysh pasi janë mbivendosje të kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S. Al”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot date 08.04.2016.

Për sa i përket fshirjes ku gjenden koshat OE “S. Al” ka për detyrë në bazë të kontratës të pastroj të gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlorë ku citohet: *Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapësirës rreth e përfaqësojnë godinave (Objekt ndertimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë të gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë.*

Për sa i përket grumbullimit të heqjes së mbetjeve nga firma e pastrimit “S. Al” në kontratë citohet: *Grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimi dhe plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të mëdhenj, të posaçëm, të mbyllur me kapak.*

Për dezinfektimin të pikave ku grumbullohen mbetjet urbane theksojmë se tek specifikimet nuk është përcaktuar se me çfarë do të dizinfektohet (lënd, produkt etj) dhe OE “S. AL” në bazë kontratës kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00.

Obesvacioni merit pjesërisht në konsideratë.

12. Me urdhërin nr.296 prot me nr.45 datë 08.02.2019, është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogla për “Blerje Artikuj Kancelarie për vitin 2019”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në bazë të shkresës nr.295 prot datë 08.02.2019, e cila përmban kërkesën nga sektoret administrative, pavionet dhe shërbimet mbështetëse. Për këto procedurë cmimet janë marrë nga ministria e brendshme me nr.95prot date 14.01.2019 . Vlera e përlogaritjes nga komisioni për fondin limit me shkresë nr.300 prot me datë 08.02.2019 është **708,694** leke pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.331 prot nr.12 date 13.02.2019 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. KVO proces-verbal nr.331/9 date 26.02.2019 ben te ditur se fitues eshte shpallur OE "MIFFEL" me ofert me vlere 688,000. OE "MIFFEL" eshte renditur i 8 per cmimin me te ulet por OE e tjere ose nuk jan paraqitur prane AK ose kane njoftuar terqeqjen nga procedura e prokurimit. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me nr.411 prot nr.60 date 26.02.2019. Komisioni ka mbajtur raportin perfundimtare me nr.427 prot date 28.02.2019 dhe shprehet se gjithcka eshte realizuar konfrom rregullave dhe sasia e artikujve te kancelaris perputhet me sasine e kerkuar.

Eshtë bere likujduar me urdhër shpenzimi nr.68 date 03.04.2019.

Konkluzionet: Nga auditimi i procedurës së sipër përmëndur konstatohet se procedura është ne përputhje me kuadrin ligjor.

13. Me nr.605 date 25.03.2019 me urdher prokurime per shtese kontrate te "Mirmbajte e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise", kerkoher kjo procedur pasi procedura e prokurimi "Kerkese per propozim" eshte hedhur ne sistemin e APP por nuk ka perfunduar akoma, dhe eshte caktuar data 15.03.2019 hapja e ofertave. Urdherohet qe te lidhet shtes kontrate deri ne 20% te vleres te kontrates se lidhur me nr.1019/11 date 05.07.2018. Afati i shteses se kontrates eshte deri me date 31.04.2019. Vlere shtesee kontrates eshte 536,304 lek me tvsh. Kontrata eshte lidhur me date 27.03.2019 dhe afati i shteses se kontrates eshte deri me date 31.04.2019. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me nr.845 prot nr.60 date 10.05.2019.

Nga auditimi i procedure me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, u konstatua se AK nuk ka vërtetuar, argumentuar dhe dokumentuar se nevoja ekstreme apo situata emergjente ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK, si dhe nuk ka vërtetuar nevojën me dokumentacion dhe fakte te tj nevojën e kryerjes së këtyre procedurave, e për pasojë kjo procedure nuk eshte emergjente dhe nuk duhej bere shtese kontrate 20%. *Ne kundeshitim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit i ndryshuar, kreu IV, pika 5, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 36.*

Personat pergjejes per veprimet ose mos veprimet e tyre: Znj.O. G.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

14. Me urdhërin nr.401 prot me nr.46 datë 24.02.2020, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se fondit limit për blerje me vlere të vogla për "Riparim dhe mirmbajte automjetesh". Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në baze të shkreses nr.384 prot datë 21.02.2020, e cila përmban kerkesat e bëra nga shoferat e automjeteve. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimit me te ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlora e përlllogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr.458 prot me datë 02.03.2020 është **777,000** lek pa tvsh.

Me urdhër prokurimi nr.687 prot nr.18 date 01.04.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogel. Kvo me nr.687/3 datë 06.04.2020 ka shpallur fitues ofertuesin i renditur i pari me cmim më të ulet O.E "S.GJ." me vlerën **742,800** lekë me tvsh dhe me date 08.04.2020 ka lidhur kontraten. Komisioni i mbikqyrjes së kontrates eshte ngritur me nr.733 prot nr.86 date 14.04.2020 dhe përbëhet nga Q. K., A. L. dhe F. M.. Komisioni i mbikqyrjes me shkresë nr.1379 prot, datë 22.07.2020 ka mbajtur raport paraprak për mbikqyrjen e kontrates së sherbimit. Sipas komisionit, sherbimet (situacion i pjeshem 1) jane kryer konfrom kriterëve të vendosora në kontratë dhe shuma është likujduar me urdher shpenzimi nr.163 date 28.07.2020. Vlora e pjeshme e punimeve është **520,320** lek me tvsh. Gjithashtu me shkresë nr.2293 datë 28.12.2020 komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur raportin përfundimtar për mbikqyrjen e kontrates. Sipas komisionit kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe është likujduar me urdhër shpenzimi nr.355 datë 29.12.2020. Vlora e punimeve është **222,120** lek me tvsh. Në total të dy situacionet janë në vlerën **742,440 me tvsh.**

Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara dhe për disa zëra si **1.Xham i palem, 2.Fener dhe 3.Pasqyra**. Theksojmë se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferat si dhe në specifikimet teknike, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar me fakte se përse duhet të nderrohen këto zëra. Në shkresën nr.2293 prot date 28.12.2020 “Raport përfundimtar i mbikqyrjes së kontratës” shprehen se kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike. Nderkohe nga situacioni i punimeve 1 dhe 2 (përfundimtare) konstatohet se është kryer mirëmbajtja e automjeteve dhe e gjeneratorve, por jo sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK, pavaresisht se vlera totale është po e njëjte. Në kundërshtim Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, DATË 29.12.2017 Neni 77 Mbikqyrja e kontratës dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu konstatohet se për shpenzimet e mësipërme për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. **Përcaktimi i preventivit është shpenzimi jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit.**

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre. Znj.O. G., znj.L. B., z.A. L., z.Q. K., z.F. M..

Në lidhje me procedurat e mësipërme konstatohet se për automjetin tip Mercedes-Benz me targa VL 8505 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 156,400 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 32,300 lekë për vitin 2020). Ndersa vlera e mbetur e automjetit është në 32,000 leke.

Autoambulaca tip Volkswagen 70x Multivan me targa VL 9512 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 261,300 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 137,200 lekë për vitin 2020). Ndersa vlera e mbetur e autoambulances në vitin 2020 është në 119,253 leke.

Shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e **ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit**, pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeti tejkalon vlerën e mbetur të tyre.

Në lidhje me shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve, grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion për zbatimin e këtyre procedurave të prokurimit pasi mungon gjurma e auditimit, preventivat që kryhen për çdo vit janë thujtë të njëjtat për secilin automjet, nuk ka dokumente për hyrjen e pjesëve të dëmtuara të cilat janë ndërruar për të 5 automjetet, nuk ka një monitorim real të kilometrave të përshkuara dhe kilometrazhit të tyre, bazë për ndërrimin e vajit, filtrave, shërbimeve xhenerike, bateri dhe goma, të cilat kryhen periodikisht, çka vërteton faktin se këto procedura për disa pjesë këmbimi kryen në mënyrë fiktive dhe nuk pasqyrojnë realitetin e riparimit të nevojshëm të tyre. Nevojat dhe preventivat për procedurën janë thjesht parashikime për diçka që mund të ndodhë gjatë vitit dhe jo për nevojat reale që kanë patur automjetet Përfundimisht vlerat e shpenzuara për të dyja procedurave të mësipërme në shumën totale prej 417,700 lekë me tvsh janë kryer jo në përputhje me parimet e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit, në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. **Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin i AK znj.O. G. dhe nen/drejtori i financës znj.L. B.**

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

15. Me urdhërin nr.1729 prot nr.181 datë 02.10.2020, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Blerje Goma, bateri per automjete”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në bazë të shkreses nr.1055 prot datë 16.06.2020 e cila përmban kërkesat e bera nga shoferat e automjeteve. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg, konkretisht nga O.E S., G. dhe A. B., dhe në bazë të cmimit më të ulët ka bërë përlllogaritjen e fondit limit. Vlera e llogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr 1753 prot date 07.10.2020 është **695,040** leke me tvsh.

Me urdher prokurimi nr.1793 prot nr.40 datë 12.10.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Komisioni i vlersimit të ofertave ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit i cili është renditur në vend të parë me oferta me të ulët, O.E “A. K.”. Operatori Ekonomik “A. K.” ka ngarkuar në sistem kërkesë për terheqje nga procedura për arsye shendetesore. Komisioni i vlersimit të ofertave në kushtet e terheqjes nga gara të O.E-se të renditur në vendin e parë, ka kaluar në O.E të renditur në vendin e 2 “A. H.”. Me nr.1793/3 prot date 16.10.2020 është shpallur fitues O.E “A. H.” me vlerë **357,600** leke me tvsh.

Komisioni i mbikqyrjes së kontratës është ngritur me nr.1823 prot nr.189 date 16.10.2020 dhe përbehet nga anëtarët: Q. K., M. H. dhe Th. M.. Komisioni i mbikqyrjes me shkresë nr.1840 prot datë 19.10.2020 ka mbajtur raport-mbikqyrjen për kontratën dhe sipas komisionit materialet kanë ardhur sipas specifikimeve dhe sasive të përcaktuara në procedurë. Shuma është likuajtur me urdher shpenzimi nr.258 date 22.10.2020 dhe vlera është **357,600** leke me tvsh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e bera nga shoferet nuk janë të argumentuar në fakte. Nderkohe komisioni i specifikimeve teknike ka përcaktuar 2 kritere.

- 1- Gomat dhe bateria të jenë me garanci.
- 2- Autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive.

Në specifikimet më sipër nuk argumentohet vendosja e këtyre kritereve dhe nuk përcaktohet se sa duhet të jetë kohezgjatja e garancisë. Nga dokumentacioni i paraqitur nga O.E fituese për kriterin autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive, O.E ka sjellë një kontratë furnitori me subjektin “G.” sh.p.k, por jo një kontratë ose autorizim të lidhur me prodhuesin e gomave dhe baterive. Në dokumentat bashkëngjitur O.E ka paraqitur disa kontrata me prodhuesin e gomave të lidhur me datë 03.01.2017 dhe në pikën 5 të kësaj kontrate shpjegohet se kontrata do të ishte efektive vetëm për vitin kalendarik 2017.

Gjithashtu anëtarja e KVO znj. K. Xh. ka refuzuar kërkesën e OE “A. H.” për arsye sepse nuk ofron shërbimin e kërkuar nga A.K në fushën veprimtarisë së tij. Nderkohe nuk është mbajtur në procedurë nga ana e saj sipas vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATË 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATË 23.11.2016 DHE ME VENDIMIN NR. 797, DATË 29.12.2017 Neni 64 pika 5: Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal.

Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre. Znj. R. Sh., znj. K. Xh. dhe znj. M. C.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

16. Me urdhërin nr.94 datë 30.04.2020, është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit për blerje me vlera të vogël “Evadim i mbetjeve Urbane”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në bazë të shkresës nr.778 prot date 29.04.2020 e cila përmban kërkesën e bërë nga z.E. B., kryeinfermier i përgjithshëm. Vlera e përlllogaritur nga komisioni për fondin limit me shkresë nr.798 prot me date 30.04.2020 është **766,130** leke pa tvsh. Me urdher prokurimi nr.819 prot nr.25 datë 05.05.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël.

Komisioni i vleresimit te ofertave me shkresen nr.819/1 date 08.05.2020 ka skualifikuar O.E “2 h 2016” per arsye se nuk realizon sherbimin e kerkuar nga A.K. KVO me shkresen nr 819/3 date 11.05.2020 ka spallur fitues O.E “D.” i renditur ne vendin e pare dhe kontrata eshte lidhur me nr 819/4 date 13/05/2020 me afat nga firmosja e kesaj kontrate deri ne 31.12.2020.

Komisioni i perlllogaritjes se fondit limit ka bërë përlllogaritjen si me poshte:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Mbetje te parashikuara	kg	11,498.48	53.6	612,064
2	Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m ²)	m ²	9,728.007.9	76,365	
3	Disifektim per 2 pika (1*2)	dite	486.40	150.0	76,472
Totali pa TVSH				764,900	

Nga auditimi I procedures per piken 2 “Siperfaqe fshirese per 2 pika (2*20m²)” dhe piken 3 “Disinfektim per 2 pika (1*2)”, te dyja jane mbivendosje e kontrates me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me te cilen operon Operatori Ekonomik ”S.AL”, me kontrate sherbimi nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020. OE ka për detyre në baze të kontrates të pastrojë gjithë siperfaqen e brendshme dhe të jashtme te territorit te spitalit spikiatrik vlore sic citohet ne kontrate: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjith siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithe siperfaqen e rrugeve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugeve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak. Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me cfare do te kryet disifektimi (lende, produkti ose solucioni).*

Per mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjme me një **dëm ekonomik me vlerë 183,404** me tvsh.

Personat pergjejes per veprimet ose mos veprimet e tyre: znj: L. B., znj: O. G.

Observacion i subjektit mbi Projeket-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

17. Me urdherin nr.19 datë 24.01.2020, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Mirembajte kondicionerash, frigoriferash dhe rezistencash elektrike”. Komisioni per argumentimin e fondit limit eshte ngritur ne baze te shkrese nr.13 prot date 21.01.2020 e cila permban kerkesen e bere nga shefi i zyres teknike. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe vlera e llogaritur nga komisioni per fondin limit me shkrese nr.881 prot me date 15.05.2020 eshte **782,400** leke pa tvsh. Me urdher prokurimi nr.899 prot nr.28 datë 19.05.2020 është ngritur prokurimi me vlere te vogel. Ne vend te pare eshte renditur O.E “IL-AD” me oferten me te ulet. Operatori Ekonomik “IL.AD“ ka ngarkuar ne sistem kerkese per terheqje nga procedura. Komisioni i vleresimit te oferertave ne kushtet e terheqjes nga gara te O.E-se te renditur ne vendin e pare, ka kaluar tek O.E e renditur ne vendin e 2 dhe me radhe deri tek O.E i renditur ne vendin e 7 “J. Z.” i cili eshte shpallur fitues. Ndersa O.E e tjera ose nuk jane paraqitur prane A.K brenda afateve te caktuara, ose kanë ngarkuar ne sistem terheqje nga gara. KVO ka shpallur fitues “J. Z. ” me shkrese nr 899/9 date 01.06.2020 me vlere **905,880** lek me tvsh dhe kontrata eshte lidhur me nr899/10 date 02.06.2020. Komisioni i mbikqyrjes është ngritur me urdher nr.975 prot nr.108 date 03.06.2020 dhe anetaret jane z.A. L., znj.M. H. dhe znj.K. Xh. te cilet kane mbajtur raport paraprak pa numer protokolli me date 18.06.2020 per mbikqyrjen e kontrates se sherbimit. Sipas komisionit sherbimet jane kryer konform kritereve te vendosura ne kontrate dhe vlera e pjeshme e punimeve është likujduar me urdher shpenzimi nr.129 date 29.06.2020 ne vleren **579,660** lek me tvsh. Komisioni i mbikqyrjes ka

mbajtur procesverbal me date 4.12.2020 per pjesen tjetër të punimeve dhe me shkresën date 07.12.2020 ka mbajtur raportin perfundimtar në lidhje me mbikqyrjen e kontratës dhe sipas komisionit kontrata është realizuar plotësisht dhe në përputhje me specifikimet teknike. Vlera e pjeshme e punimeve është likuaduar me urdher shpenzimi nr.318 date 09.12.2020 në vlerën **326,220** lek me tvsh. Në total të dyja situacionet janë në vlerën **905,880 me tvsh.**

Nga auditimi i procedurës së mesipërme konstatohet se tek shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e cillerave, kaldajave, kondicionerave dhe rezistencave, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh difekti. Gjithashtu këto shërbime janë po të njëjta shërbime dhe pjesë që ndërrohen çdo vit.

Nga akt-verifikimi nr.1 i mbajtur nga anetarët e KLSH ku citohet : *“Në pavionin akut gra dhe pavionin kronik burra, ndoheshin të instaluar vetëm në ambientet e menzave rezistenca elektrike, të cilat ishin jashtë funksionit, jashtë përdorimit si dhe u konstatua se në asnjë prej dhomave të pacineteve nuk kishte asnjë sistem ngrohje, ftohje apo rezistenca elektrike.”*, u pa e nevojshme të bëhej një tjetër verifikim.

Në akt-verifikimin nr.2 të mbajtur me datë 31.03.2021 nga anetarët e KLSH znj.E. K. dhe z.A. Z. në prani të 2 prej anetarëve të komisionit të mbikqyrjes së kontratës znj.K. Xh. dhe z.A. L., u bë verifikimi i rezistencave (ngrohese) në pavionet e SPV. Në proces-verbalin e mbajtur me datë 4.12.2020 nga anetarët e komisionit të mbikqyrjes së kontratës citohet: *OE ka realizuar rezistenca elektrike 23 cope, pastrim dhe venien në punë në total 36 cope.* Nderkohe nga verifikimi i bërë rezultoi se në këto pavione punojnë **pjesërisht vetëm 12 rezistenca.**

Nga përcaktimet e këtyre preventivave ky është një shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.**

Mbajn përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: Znj. O. G., znj. L. B. z.A. L., znj.M. H., dhe znj. K. Xh..

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

18. Me urdherin nr. 18, datë 24.01.2020, është ngritur komisioni i përlogaritjes të fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Mirëmbajtje e sistemit qendror (ngrohës-ftohës)”. Komisioni për argumentimin e fondit limit është ngritur në bazë të shkresës nr.132 prot date 21.01.2020 e cila përmban kërkesën e bërë nga shefi i zyrës teknike. Komisioni ka marrë 3 oferta në treg dhe në bazë të cmimit më të ulët ka bërë përlogaritjen dhe vlera e përlogaritur nga komisioni për fondin limit është **790,700** leke pa tvsh. Me urdher prokurimi nr.861 prot nr.26 datë 12.05.2020 është ngritur prokurimi me vlerë të vogël. Në vend të parë është renditur ofertuesi O.E “Superior klima klima” me oferte me të ulët. Ofertuesi duhet të paraqitet brenda afatëve të përcaktuara pranë AK nga momenti i publikimit të njoftimit. Operatori Ekonomik “Superior klima klima” nuk është paraqitur pranë A.K brenda afatëve të përcaktuara dhe nuk ka dërguar në sistem ndonjë arsye. Komisioni i vlerësimit të ofertave në kushtet e mos paraqitjes brenda afatëve të O.E-së të renditur në vendin e parë ka kaluar tek OE e renditur në vendin e dytë e me radhë deri tek O.E i renditur në vendin e katërt “J. Z.” i cili është shpallur fitues. Ndërsa O.E-te e tjera, kanë ngarkuar në sistem terheqje nga gara ose nuk janë paraqitur pranë A.K brenda afatëve të përcaktuara. Është shpallur fitues “J. Z. ” me shkresë nr 861/6 date 20.05.2020 me vlerë **749,900** leke pa tvsh dhe kontrata është lidhur me nr861/7 date 27.05.2020. Komisioni i mbikqyrjes është ngritur me urdher nr.962 prot nr.107 date 02.06.2020 dhe përbehet nga K. Sh., I. S. dhe F. A. Komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur procesverbal pa numer protokollin me datë 18.06.2020. Për mbikqyrjen e kontratës së shërbimit dhe sipas komisionit, shërbimet janë kryer konform kriterëve të vendosura në kontratë. Vlera e pjeshme e punimeve është likuaduar me faturen nr.130 date 29.06.2020 në vlerën **571.680** leke me tvsh. Komisioni i mbikqyrjes ka mbajtur procesverbal me datë 04.12.2020 për pjesën tjetër të punimeve dhe me shkresën nr.2146 date 10.12.2020 ka mbajtur raportin perfundimtar në lidhje me mbikqyrjen e kontratës. Sipas

komisionit kontrata është realizuar plotesisht dhe në përputhje me specifikimet teknike. Vlera e pjeshme e punimeve është likuajduar me urdher shpenzimi nr.326 date 11.12.2020 ne vleren **328.200** lek me tvsh. Ne total te dyja situacionet jane ne vleren **899,880 me tvsh.**

Nga auditimi i procedures se mesiperme konstatojme se tek shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit qendror (ngrohes-ftohes) pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh difekti. Gjithashtu keto shërbime jane po te njejat shërbime dhe pjese qe ndërrohen cdo vite.

Nga përcaktimet e këtyre preventivave ky është një shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit.**

Mbajn pergjegjesi per veprimet dhe mos veprimet e tyre: Znj.O. G., znj.L. B., z.A. L., znj.M. H., dhe znj. K. Xh.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

19. Me urdherin nr.586 prot nr. 69, datë 13.03.2020, është ngritur komisioni i perlllogaritjes te fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Matriale pastrimi “. Komisioni per argumentimin e fondit limit është ngritur ne baze te shkrese nr.579 prot date 12.03.2020 e cila permban kerkesen e bere nga Shefi i zyres se hotelerise. Nevojat e materialeve te pastrimit jane emergjente per institucionin dhe kjo ka ardhur si pasoje e gjendjes se jashtzakonshme te pandemise Covid-19. Vlera e llogaritur nga komisioni per fondin limit me shkrese nr.621 date 18.03.2020 është **339,404** leke pa tvsh. Cmimet jane marre nga ministria e brendshme ne baze te vendimit nr.914. Me urdher prokurimi nr.660 prot nr.16 datë 30.03.2020 është ngritur prokurimi me vlere te vogel. Me shkresen nr.660/1 date 02.04.2020 kvo me ane te sistemit te app-se i kerkon OE-se te renditur ne vendin e pare me cmimin me te ulet “M. D” te paraqese oferten me date 03.04.2020. Operatori Ekonomik “M. D“ nuk është paraqitur brenda afateve te percaktuara dhe nuk ka njoftuar ne sistemin e app-se. Keshtu Kvo ka kaluar ne O.E “A.” i renditur i dyti, dhe O.E duhet te paraqiste oferten me date 06.04.2020 brenda afateve dhe kushteve te caktuara. Kvo ka mbajtur proces-verbal me nr.660/3 prot date 06.04.2020 me ane te ciles njofton se O.E “A.” nuk është paraqitur brenda afatave dhe nuk ka njoftuar per terheqje nga procedura me ane te sistemit te app-se. Kvo keshtu ka proceduar me te gjithë OE deri sa është spallur fitues me nr.660/9 prot date 14.04.2020 OE i renditur ne vendin e 6. OE “M.”. Komisioni i mbikqyrjes se kontrates është ngritur me urdher nr.754 prot nr.93 date 17.04.2020. Komisioni ka mbajtur akt-kolaudim me dt 16.04.2020 pa numer protokolli dhe shprehet se malli është në sasive dhe cilesine e kerkuar nga ana e AK sipas kushteve te kontrates. Fatura është likuajduar me urdher shpenzimi nr.78 date 28.04.2020 dhe vlera është **388,800** leke me tvsh.

20. Me urdherin nr.1341 prot nr.148, datë 17.07.2020, është ngritur komisioni i perlllogaritjes se fondit limit për blerje me vlera të vogël për “Matriale pastrimi“. Komisioni per argumentimin e fondit limit është ngritur ne baze te shkreses nr.1335 prot date 17.07.2020 e cila permban kerkesen e bere nga kryeinfermieri i pergjithshem dhe pergjegjesat e matrialeve. Vlera e perlllogaritur nga komisioni per fondin limit me shkrese nr.1365 datë 20.07.2020 është **775,057** lek pa tvsh. Cmimet jane marre nga ministria e brendshme ne baze te vendimit nr.914. Me urdher prokurim nr.1459 prot nr.36 datë 04.08.2020 është ngritur urdher prokurimi me vlere te vogel. Kvo me nr.1459/3 date 07.08.2020 ka shpallur fitues ofertuesin e renditur ne vendin e pare OE “A.” me vlerën **204,000** pa tvsh. Komisioni ka mbajtur me dt 10.08.2020 pa numer protokolli akt-kolaudim dhe shprehet se malli është ne sasive dhe cilesine e kerkuar nga ana e AK dhe sipas kushteve te kontrates. Fatura është likuajduar me urdher shpenzimi nr.200 date 03.09.2020 dhe vlere është **244,800** lek me tvsh.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se OE "A." duhet të ishte skualifikuar sipas *udhëzimit nr.03 date 08.01.2018 pika 14/b*. Kjo sepse në një procedurë të meparshme ky OE është skualifikuar sepse nuk është paraqitur brenda afatit dhe nuk ka ngarkuar në sistemin ndonjë arsye. Me datë 10.08.2020 është mbajtur akt-koalidim në të cilin shprehen se malli është në sasinë dhe cilësinë e kërkuar nga ana e AK dhe sipas kushteve të kontratës. Është bërë hyrja në magazinë, dhe është firmosur nga komisioni i marrjes në dorezim i ngritur në fillim të vitit me nr.43 prot date 10.01.2020 nga anëtarët znj.O. M. dhe z.M. K.. Ndërsa z. E. B. nuk ka firmosuar pasi ka qenë me leje. Në kundërshtim *Në kundërshtim Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*.

Për periudhën që një person është me leje ose raport, titullari i AK duhet të ngrejë një urdher dhe të komandojë një person tjetër për këtë periudhë.

Mbajne përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: Znj. O. G., znj. L. B., znj. R. B., znj. P. M. dhe znj. K. Xh.

Observacion i subjektit mbi Projekt-Raportin, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.10.2021 nr 149/7 date 08.10.2021. Nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

21. Blerje e vogël "Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike"

Mbështetur në kërkesën e stafit të hotelarisë datë 14.02.2020 dhe të miratuar nga Titullari i AK z. O. G. me Nr.339 Prot. datë 18.02.2020 është lëshuar urdhri i prokurimit nr.17, datë 31.03.2020, komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike" në shumën e fondit limit **399,999 lekë pa TVSH**. Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, ngritur me Urdhër Nr.60 datë 09.03.2020 dhe i përbërë nga: znj. R. B. (Kryetare), znj.P. M. (Anëtare) dhe znj. K. Xh. (Anëtare) ka mbajtur procesverbalin me Nr.671/5 datë 08.04.2020 duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin "F. S.", me ofertë ekonomike **319,900 lekë pa TVSH**. Për këtë midis OE fitues "F. S." dhe AK (Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, është lidhur kontrata Nr.17, me nr.671/6 datë 09.04.2020. Është kryer likuidimi i faturës nr. 84, datë 22.07.2020 ndaj këtij operatori me urdhërxhirimin nr. 164, datë 28.07.2020, në shumën **231,840 lekë pa TVSH ose 278,208 lekë me TVSH** e cila është për situacionin Nr.1, datë 22.07.2020.

Për procedurën me objekt "Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike me urdhër nr. 39 dhe Nr. 346 Prot. datë 19.02.2020 është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit i përbërë nga M. C., K. T. dhe K. Xh.. Komisioni i llogaritjes së fondit limit me shkresën Nr. 372 Prot. datë 20.02.2020 ka argumentuar se për nxjerrjen e fondit limit është bazuar në një kontratë të ngjashme të zbatuar nga vetë Autoriteti Kontraktor, Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë me Nr.532/5 prot. datë 15.03.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se vlerësimi i kërkesës së stafit për mirëmbajtjen e pajisjeve si dhe komisioni i ndjekjes së kontratës nuk kanë një specialist të fushës përkatëse. Kërkesa e paraqitur nga stafi i hotelarisë nuk është e argumentuar plotësisht për zërat, konkretisht: për pjesët e kompjuterëve nuk është sqaruar arsyeja e ndërtimit si dhe në pajisjet printer dhe fotokopje pjesët e kërkuara për zëvendësim kanë një afat kohor pune ose një numër të caktuar përpunim fletësh e cila duhet të bazohet në një raport të gjeneruar nga vetë aparatura dhe ky raport nuk i është bashkëlidhur kërkesës. Për sa më sipër mos argumentimi i kërkesës është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku thuhet se:

Në rastet kur njësitë e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të

mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. O. G.

Shpenzimet për udhëtime e dietat.

Nga auditimi i dokumentacionit për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi rezultoi se:

Për vitin 2017 shpenzimet totale janë kryer në shumën prej 807,600 lekë;

Për vitin 2018 shpenzimet totale janë kryer në shumën prej 838,400 lekë;

Për vitin 2019 shpenzimet totale janë kryer në shumën prej 862,200 lekë;

Për vitin 2020 shpenzimet totale janë kryer në shumën prej 1,050,800 lekë;

Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën urdhër shërbimet, nga ku konstatohet se ***nëtë gjitha rastet nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit***, panvarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të titullarit, veprime të cilat janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 36.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Ak znj. O. G., ish titullarin z.K. Ll., Zv.Drejtorin Ekonomik znj.L. B., shefin e financës znj. Sh. Z. dhe ish-shefin e finances, z.V. N.

Nga auditimi me zgjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së Shpenzimeve për karburant për automjetet e SPV-së, u konstatua se:

Nga sektori i financës, për secilin automjete mbahet si dokument vërtetues për konsumin e karburantit kartela, në të cilat pasqyrohen të gjitha shpenzimet, si kilometra e përshkuara dhe litrat e harxhuara të shoqëruara me flete udhëtimit e tyre përkatëse.

Për asnjë nga automjetet që administrojnë institucioni, në fillim dhe në fund të vitit nuk është evidentuar kilometrazhi i tyre, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike, të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë (kilometrazhin), si dhe për përlllogaritjen dhe planifikimin e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e automjeteve.

Çdo vit nga komisionet e ngritura me urdhër të titullarit janë përcaktuar normativat e konsumit të karburantit nga automjetet.

Nga auditimi me përzgjedhje të kartelave të automjeteve ku pasqyrohen kilometrat e përshkuara dhe totali i litrave të harxhuara për këto distanca për periudhën 2017, 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se sasia e karburantit të harxhuara dhe të evidentuar në këto kartela shoqëruar me fletë udhëtimit nuk korrespondon me sasinë e evidentuar në sistemin e kartave elektronike të karburantit, duke mos pasqyruar vlerën reale të sasisë së konsumuar.

Nga përlllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar u konstatua se në sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve.

Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin nr.561 date 27.06.2016, Per stadartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së pergjithshme.

Si me poshtë vijon:

shoferi / targa	VITI	LITRA TE HARXHARA SIPAS FLETE UDHETIMEVE	LITRA TE HARXHARA SIPAS SITEMIT TE KARTAVE TE KARBURANTIT	Diferenca ne litra	Cmimi ne litra	Vlera ne lek
Qani Kucaj VL8505B	2018	4070	7480	3410	147.985	504,629

shoferi / targa	VITI	LITRA TE HARXHARA SIPAS FLETE UDHETIMEVE	LITRA TE HARXHARA SIPAS SITEMIT TE KARTAVE TE KARBURANTIT	Diferenca ne litra	Cmimi ne litra	Vlera ne lek
Qani Kucaj VL8505B	2019	5622	16684	11062	150.565	1,665,550

shoferi / targa	VITI	LITRA TE HARXHARA SIPAS FLETE UDHETIMEVE	LITRA TE HARXHARA SIPAS SITEMIT TE KARTAVE TE KARBURANTIT	Diferenca ne litra	Cmimi ne litra	Vlera ne lek
Qani Kucaj VL8505B	2020	3190	12169	8979	147.894	1,327,940

Për vitin 2018, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne karte elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference prej 3410 litra * 147,985 lekë/litër = 504,629 lekë.

Për vitin 2019, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference prej 11062 litra * 150,565 lekë/litër = 1,665,550 lekë.

Për vitin 2020, nga përllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr ne kartën elektronike te karburantit dhe flete udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diference prej 8979 litra * 147,894 lekë/litër = 1,327,940 lekë.

Në total në kartë elektonike të karburantit janë hedhur me shumë 23451 litra.

Nga ana e titullarit të SPV, shefit të financës, zv/drejtori ekonomik, magazinierja qe ka ne perdorim sistemin elektronik te kartave te karburantit, dhe shefja e hotelerisë e cila nxjerr autorizimet për lëvizjet e mjeteve, konstatohet se nuk është monitoruar siç duhet konsumi i karburantit, për mjetin me targën VL8505B, pasi sasia e karburantit të konsumuar dhe të reflektuar në kartelën e udhëtimeve te tij krahasuar me sistemin e kartave elektronike rezulton me diferenca.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke sjellë për pasojë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën **3,498,119** lekë.

Mbajne pergjegjesi per veprimet dhe mos veprimet e tyre sipas detyrave funksionale: ish Titillari i Ak z.K. Ll., Titullari i Ak znj. O. G., ish magazinierja znj.E. P., ish shefi i finances z.V. N., znj.O. M., znj.E. M., znj.L. B. dhe z.Q. K.

Në lidhje me konsumin e karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët, konstatohet se:

Çdo vit nga Titullari i institucionit ngrihet komisioni për monitorimin e konsumit të karburantit për kaldajat dhe gjeneratorët, për monitorimin e tyre gjatë kohës që ato janë në funksion, i cili duhet të dokumentojë me një procesverbal.

Në gjeneratorin kryesor, i cili mban ngarkesën e të gjithë ambienteve të SPV, nuk funksiononte matësi i orëve të punës, pra nuk verifikohej se sa orë ka punuar gjeneratori, si rrjedhojë nuk mundëson një proces kontrolli efektiv mbi harxhimin e karburantit për këto kaldaja.

Me shkresën nr.1457/1 datë 07.10.2021 me objekt “Kthim përgjigje të projekt-raportit, bashkangjitur po ju dergojm obervacionert përkatëse”, protokolluar në KLSH me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021 në kuadër të auditimit të ushtruar në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në bazë të programit të auditimit nr.149/1 datë 28.01.2021 i ndryshuar, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga shqyrtimi i obervacionit, pretendimet e ngritura nga Insitucioni nuk sjellin asnjë arsytim/apo fakt shtese, ndryshe nga trajtimi i bere nga grupi i auditmit ne projekt raport.

Për sa trajtuar me sipër, obervacioni nuk merret parasysh

1. Titulli i Gjetjes :	Mangësi në dokumentacion për fillimin e procedurës së prokurimit blerje e vogël.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk vertetohet dhe mungon gjurma e auditimit, konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> • Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjeteve” viti 2017. Nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet, nuk ka kërkesa nga shoferët, gjithashtu nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e difekteve të këtyre automjeteve, nuk ka urdhër nga titullari që automjetet të shkojnë për diagnostimin e difekteve. Gjithashtu konstatohet se nevoja për kryerjen e shërbimeve të automjeteve nuk është reale pasi nuk është kryer diagnostikimi i pjesëve të dëmtuara por është kryer një parashikim i cili mund të ndodhë për ndërrimin e pjesëve dhe dëmtimin e tyre. • Blerje e vogel ”Mirmbajte automjeteve dhe gjeneratoresh” viti 2018. Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara dhe për zërin si Xham i parem, thekësojmë se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fatke se përse duhet të ndrohen ky ze specifikisht. AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. • Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjeteve” viti 2019. Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara në fakte. Në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar me dokumentuar dhe fatke se përse duhet të nderrohen këto zera. AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindë nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. • Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjeteve” viti 2020. Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara dhe për disa zëra si 1.Xham i parem, 2.Fener dhe 3.Pasqyra. Theksojmë se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferat si dhe ne specifikimet teknike, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fakte se përse duhet të nderrohen këto zera.
Kriteri:	<i>Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”</i>
Ndikimi/Efekti:	<i>Mos argumentimin i shpenzimeve si dhe mos plotësim i dokumentave, të kryera për nevojat e spitalit</i>
Shkaku:	Mos njohje e bazës ligjore së sippërpërmendur
Rëndësia:	I Mesëm
Rekomandimi:	Nëpunësu Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa ku për çdo nevojë të Spitalit, nga personat përgjegjës të behet analiza si dhe kërkesat e justifikuar me dokumentat plotësues për shërbimin/mallin e kërkuar.

2. Titulli i Gjetjes : **Mos rakordimi mbi shpenzimet me karburatin ne flete udhëtimet e shoferve dhe sistemit elektronik te karta te karburantit**

Situata:	<ul style="list-style-type: none"> • Nga sektori i financës, për secilin automjete mbahet si dokument vërtetues për konsumin e karburantit kartela, në të cilat pasqyrohen të gjitha shpenzimet, si kilometra e përshkruara dhe litrat e harxhuara te shoqëruara me flete udhëtimet e tyre përkatëse. Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve ku pasqyrohen kilometrat e përshkruara dhe totali i litrave të harxhuara për këto distanca për periudhën 2017, 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se sasia e karburantit të harxhuara dhe të evidentuar në këto kartela shoqëruar me fletë udhëtimet nuk korrespondon me sasinë e
-----------------	--

evidentuar në sistemin e kartave elektronike të karburanti, duke mos pasqyruar vlerën reale të sasisë së konsumuar.

Nga përlllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar u konstatua se në sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shume litra me një diferencë në masën 23,451 litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimit të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve.

Kriteri: Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin nr.561 date 27.06.2016, Per stadartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në **vlerën 3,498,119 lekë**.

Shkaku: Përfitim i pajustificuar i karburantit nga punonjësit përfitues

Rëndësia: E Larte

Rekomandimi: Nga SPVtë kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,498,119 lekë**, si një përfitim i marre nga personat përgjegjës si dhe autorizues nga ish Titullari i Ak z.K.L.L., Titullari i Ak znj. O. G., ish magazinierja znj.E. P., ish shefi i finances z.V. N., znj.O. M., znj.E. M., znj.L. B. dhe z.Q. K.

3. Titulli i Gjetjes : **Kualifikimi dhe shpallja fitues e Operatorit ekonomik pa plotësuar kriteret e vendosura në AK.**

Situata:

- **Blerje e vogël ” Blerje Goma, bateri për automjete” viti 2019.**
Nga auditimi i procedurës konstatohet se kërkesat e bera nga shoferet nuk janë të argumentuar në fakte dhe mungon gjurma e auditimit.
Komisioni i specifikimeve teknike ka përcaktuar 2 kriteret.
3- Gomat dhe bateria të jenë me garanci.
4- Autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive.
Nga dokumentacioni i paraqitur nga O.E fituese për kriterin autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive, O.E ka sjell një kontratë furnitori me subjektin “A. P.” sh.p.k por jo një kontratë ose autorizim të lidhur me prodhuesin e gomave dhe baterive. Nderkohe pavarësisht se në kontratën e sjell nga OE të lidhur me “A. P.” sh.p.k nuk vërtetohet se subjekti ka autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive.
- **Blerje e vogël “Blerje Goma, bateri për automjete” viti 2020.**
Nga dokumentacioni i paraqitur nga O.E fituese për kriterin autorizim prodhuesi për shitjen e gomave dhe baterive, O.E ka sjellë një kontratë furnitori me subjektin G. sh.p.k, por jo një kontratë ose autorizim të lidhur me prodhuesin e gomave dhe baterive. Në dokumentat bashkëngjitur O.E ka paraqitur disa kontrata me prodhuesin e gomave të lidhur me datë 03.01.2017 dhe në pikën 5 të kësaj kontrate shpjegohet se kontrata do të ishte efektive vetëm për vitin kalendarik 2017.

Kriteri: Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 55 pika 2.

Ndikimi/Efekti: *Kualifikim i padrejtë i Operatorit Ekonomik*

Shkaku: *Diskriminim dhe favorizim i Operatorëve ekonomik.*

Rëndësia: E Larte

Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa ku gjatë shqyrtimit të dokumenteve të tenderit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik të vlerësojë dhe krahasoj, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara prej tij.

4. Titulli i Gjetjes : **Shpenzimet për udhëtime e dietat.**

Situata: Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën urdhër shërbimet, nga ku konstatohet se **në të gjitha rastet nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit**, panvarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të titullarit.

Kriteri:	VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 36.
Ndikimi/Efekti:	<i>Mos justifikim i shërbimit të kërkuar dhe kryer</i>
Shkaku:	Parregullsi ne plotësimin e dokumenteve justifikues
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	Institucioni ne bashkëpunim me sektorin e financës të marrë masa ku për cdo udhëtim të kërkuar dhe autorizuar nga NA, te plotësohet ne menyre shkresore kërkesa e argumentuar nga personi përgjegjes, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve tëerkuara si dhe ditët e qëndrimit. Sektori i financës të marrë masa ku pas plotësimit te dokumentave justifikues te cilat argumentojnë në mënyrë shkresone lëvizjet e punonjësve, të kryhej likuidimin e tyre.

5. Titulli i Gjetjes : **Shpenzim te kryera pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficence**

Situata:

- **Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjetesh” viti 2017.**
Nga auditimi i procedurës konstatojme se nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet, pasi nuk ka kërkesa nga shoferët, kërkesat e shoferëve për nevoja të riparimeve të mjeteve janë bërë mbas nenshkrimit të kontrates midis OE dhe AK. Gjithashtu nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e difekteve të këtyre automjeteve, nuk ka urdhër nga titullari që automjetet të shkojnë për diagnostimin e difekteve. AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në vlerën **899,160** lekë. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti.
- **Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjetesh” viti 2018.**
AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi, kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivin përpara se të ndodhë një difekt ose avari, apo nevojë për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve në vlerën **870,720** lekë, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. Gjithashtu kërkesat e shoferëve për riparimi e automjeteve nuk janë të argumentuara dhe për zërin si Xham i parem, thekësojm se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fatke se përse duhet të ndrohen ky ze specifikisht.
- **Shtese kontrate te “Mirmbajtja e kondisionerve, kaldajave dhe cillerave” viti 2018.**
Nga auditimi i procedurës se konstatojme se shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes sëkondisionerve, kaldajave dhe cillerave në vlerën **345,600** lekë, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh. Gjithashtu me process verbal te mbajtur me date 10.11.2017 dhe 18.12.2017 nga komisioni i mbikqyrjes se kontrates eshte bere mirmbajta dhe riparimi e tyre nga kontrate e lidhur me nr.594/11 date 31.07.2017 eshte midis OE ”J. Z. ” dhe AK. Nderkohe ne procesverbalet e mbajtura nuk jane shprehur se kane nevoja te metejshme emergjente per mirembajtjen e tyre.
- **Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjetesh” viti 2019.**
Nga auditimi i procedurës konstatojme se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara në fakte. Në shkresën e bërë nga shoferave dhe ne specifikimet teknike nuk janë argumentuar me dokumentuar dhe fatke se përse duhet të nderrohen këto zëra. AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në vlerën **826,800** lekë. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti.
- **Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajte automjetesh” viti 2020.**
Nga auditimi i procedurës konstatojme se kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara dhe për disa zëra si **1.Xham i parem, 2.Fener dhe 3.Pasqyra.** Theksojme se këto zëra nuk janë pjesë konsumi dhe në shkresën e bërë nga shoferat

si dhe ne specififikimet teknike, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fakte se përse duhet të nderrohen këto zera. Gjithashtu konstatojmë se për shpenzimet e mësipërme për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në vlerën **742,440 lekë**. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekti ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh defekti. Gjithashtu këto shërbime janë po të njëjta shërbime dhe pjesë që nderrohen çdo vit.

- **Blerje e vogël “Mirëmbajtje kondicionerash, frigoriferash dhe rezistencash elektrike” viti 2020.**

Nga auditimi i procedurës së mesipërme konstatojmë se tek shpenzimet për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e cillerave, kaldajave, kondicionerave dhe rezistencave, pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh difekti. Gjithashtu këto shërbime janë po të njëjta shërbime dhe pjesë që nderrohen çdo vit në vlerën **905,880 lekë**.

Ne akt-verifikimin nr.2 të mbajtur me datë 31.03.2021 nga anetaret e KLSH në prani të 2 prej anetareve të komisionit të mbikqyrjes së kontratës, u bë verifikimi i rezistencave (ngrohese) në pavionet e SPV. Në proces-verbalin e mbajtur me datë 4.12.2020 nga anetaret e komisionit të mbikqyrjes së kontratës citohet: *OE ka realizuar rezistenca elektrike 23 cope, pastrim dhe venien në punë në total 36 cope.* Nderkohe nga verifikimi i bërë rezultoi se në këto pavione punojnë pjesërisht vetëm 12 rezistenca.

- **Blerje e vogël “Mirëmbajtje e sistemit qendror (ngrohës-ftohës)” viti 2020.**

Nga auditimi i procedurës së mesipërme konstatojmë se tek shpenzimet për kryerjen e preventiveve të shërbimit të mirëmbajtjes, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi. Kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivi përpara se të ndodhë një difekt ose avaria, apo para se të lindi nevoja për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit qendror (ngrohës-ftohës) pasi këto janë shërbime të cilat kryhen në momentin që ndodh difekti.

Gjithashtu këto shërbime janë po të njëjta shërbime dhe pjesë që nderrohen çdo vit në vlerën **899,880 lekë**.

Kriteri:
Ndikimi/Efekti:
Shkaku:
Rëndësia:
Rekomandimi:

Pika 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar *Shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 5,490,480 lekë*
Mos argumentim i kërkesave dhe shpenzimeve të kryera

I Lartë

Titullari i AK të shqyrtojë **vlerën 5,490,480 lekë** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, gjatë procedurës së prokurimit për rastet e sipërpërmendura. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

6. Titulli i Gjetjes :
Situata:

Tejkalim i vlerës së mirëmbajtjes së makinave kundrejt vlerës së mbetur të tyre
Grupi i auditimit konstatoi se për automjetin tip Mercedes-Benz me targa VL 8505 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 156,400 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 32,300 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e automjetit është në 32,000 leke.

Autoambulaca tip Volkswagen 70x Multivan me targa VL 9512 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 261,300 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 137,200 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e autoambulancës në vitin 2020 është në 119,253 leke.

Shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e ekonomikitetit, efektivitetit dhe efikasitetit, *pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeti tejkalon vlerën e mbetur të tyre.*

Kriteri:
Ndikimi/Efekti:
Shkaku:
Rëndësia:

Pika 109, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar
Vlera e shpenzimit me e madhe se vlera e aktivitetit
Mos rivlerësimi i aktivitetit i cili merr shërbim si dhe është në gjëndje pune
I Mesëm

Rekomandimi:	Nëpunësi Autorizues (NA) të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt respektive, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të tyre, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi I vlerës së makinave. Mbi bazën e aktivitet të rivlerësuar, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.
7. Titulli i gjetjes:	<p>Mbivendosje kontrate Shërbimi Evadim i mbetjeve urbane & Sherbim pastrim gjelberimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtesë kontratë në vlerën 20% të kontratës së mëparshme me objekt “Evadimi Mbetjeve Urbane” datë 29.12.2017 Nga auditimi i procedurës për pikën 2 “Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S. AL”, me kontratë shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm brenda territorit të spitalit psikiatrik Vlorë si citohet: <i>Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapsirës rreth e përfaqë godinave (Objekt ndertimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë, OE kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimi në plerave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të medhej, të posacem, të mbyllur me kapak.</i> Për mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjmë me dëm ekonomik në vlerë 46,428.77 me tvsh. • Blerje e vogël “Evadimi I mbetjeve urbane” datë 30.04.2020 Nga auditimi I procedurës për pikën 2 “Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja janë mbivendosje e kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S. AL”, me kontratë shërbimi nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020. OE ka për detyrë në baze të kontratës të pastrojë gjithë sipërfaqen e brendshme dhe të jashtëm të territorit të spitalit psikiatrik vlorë sic citohet në kontratë: <i>Me pastrim të jashtëm janë të gjitha sipërfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) që do të të kuptojmë të gjithë sipërfaqen e hapsirës rreth e përfaqë godinave (Objekt ndertimi) që aktualisht janë në funksion të këtij spitali. O.E do të pastroj çdo ditë gjithë sipërfaqen e rrugëve brenda SPV me sipërfaqe 4,450m, kur është e nevojshme dhe 2 here në ditë, OE kryen larjen e rrugëve në baze të grafikut të vendosur nga hoteleria, para orës 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave bëhet në koshat e vendosur në çdo dhomë dhe ambientet e veshur me qese të zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet për në vend grumbullimi në plerave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me kosha të medhej, të posacem, të mbyllur me kapak.</i> Nderkohe në specifikimet teknike nuk është përcaktuar se me çfarë do të kryet disinfektimi (lende, produkti ose solucioni). Për mbivendosjet e mesiperme kemi të bëjmë me një dëm ekonomik me vlerë 183,404 me tvsh.
Situata:	
Kriteri:	Kontrata nr.4558 datë 31.10.2014 “Pastrimi i Qytetit” e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe OE “D.” SHPK si dhe kontrata nr.77/13 datë 08.04.2016 dhe nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020 e lidhur midis SPV dhe “S.-AL” shpk.
Ndikimi/Efekti:	Dem ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 229,832.77 leke me tvsh
Shkaku:	Lidhje si dhe likuidim për dy kontrata të ndryshme për një shërbim
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 229,832.77 lekë , nga ish-titullari z. K.Ll., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”Vlorë”.

2.8.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratat e qerave të lidhura ndër vite nga institucioni
- Situacionet e likuidimeve të detyrimeve kontraktuale
- Komisionet e ngritura nga titullari për mbikëqyrjen e realizmit të kontratave
- Procesverbale e mbajtura për marrjen në dorëzim të ambienteve/pajisjeve të dhëna me qera.

Për periudhën objekt auditimi SPV ka realizuar të ardhura dytësore nga qiratë në ambientet dhe qiratë për pajisje

-Në zbatim të VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar të pikës 2/3, kreu VI-të “Monitorimi i kontratave”; pikës 42 e udhëzimit të Ministrit përgjegjës për ekonominë nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar dhe në vijim të rolit të SPV si njësi e administrimit të pronave të dhëna me qera, u shqyrtua dokumentacioni lidhur me kontratat e qerasë për periudhën 2017-2020 dhe përputhshmëria e pagesave të kryera me kriteret e përcaktuara në to. Të ardhurat nga qeratë për periudhën objekt auditimi rezultojnë si më poshtë:

Viti 2017

Nr	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar ne vitin 2017	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	"S.-AI" shpk	26,000	312,000	0	0	312,000
2	"S.-AI" shpk	9,672	58,032	0	0	58,032
3	"AGS" shpk	17,700	212,400	0	0	212,400
4	"D."	21,000	18,900	0	0	189,000
5	"AGS" shpk	41,692	210,118	0	0	210,118
6	"AGS" shpk		390,601	0	0	390,601
7	"AGS" shpk	71,665	429,990	0	0	429,990
Total						1,802,141

Viti 2018

Nr	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar ne vitin 2018	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	"S.-AI" shpk	26,000	312,000	0	0	312,000
2	"S.-AI" shpk	9,672	48,360	0	0	48,360
3	"AGS" shpk	17,700	212,400	0	0	212,400
4	"AGS" shpk	71,665	286,660	0	0	286,660
	"AGS" shpk	61,524	61,524	0	0	61,524
	"AGS" shpk	69,497	69,497	0	0	69,497
	"AGS" shpk	67,624	405,744	0	0	405,744
5	"L. K."	2,278	23,344	0	0	23,344
6	Likujdim debitori V. C.		8,503			8,503
Total						1,428,032

Viti 2019

Nr	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar ne vitin 2019	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	"S.-AI" shpk	26,000	312,000	0	0	312,000
2	"AGS" shpk	17,700	212,400	0	0	212,400
3	"AGS" shpk	66,239	66,239	0	0	66,239
	"AGS" shpk	65,579	327,895	0	0	327,895

	"AGS" shpk	63,923	383,538	0	0	383,538
	"L. K."	1,139	6,835	0	0	6,835
	"L. K."	1,139	13,670	13,670		13,670
Total						1,322,577

Viti 2020

Nr	Subjekti	Vlera mujore e detyrimit sipas kontratës	Vlera e paguar ne vitin 2020	Paguar Paradhënie	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
1	"S.-Al" shpk	26,000	312,000	0	0	312,000
2	"AGS" shpk	17,700	212,400	0	0	212,400
3	"AGS" shpk	63,923	63,923	0	0	63,923
	"AGS" shpk	62,701	62,701	0	0	62,701
	"AGS" shpk	20,039	20,039	0	0	20,039
	"AGS" shpk	62,120	559,080	0	0	559,080
4	"L. K."	1,139	13,670	13,670		13,670
Total						1,243,813

Burimi: Sektori i Financës së SPV

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se janë dhënë ambientet me qira si më poshtë:

1. Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m²,

Ambienti i Lavanderisë 70.5 m² + ambient ndihmës me sipërfaqe 18 m², ku është lidhur kontratë me Qiramarrësin shoqërinë "AGS" SHPK me afat një vjeçare me vlerë 17,700 lekë/muaj, me të drejtë rinovimi.

2. Pajisjet e Lavanderisë, ku është nënshkruar kontrata me Qiramarrësin shoqërinë "AGS" shpk.

Sipas kësaj kontrate janë dhënë me qira:

-Pajisjet e Lavanderisë.

-Kohëzgjatja e qiradhënies është një vjeçare.

Çmimi i qirasë, është përllogaritur në përputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", Kreu III, pika 5, e cila përcakton se: "5. Për përcaktimin e vlerës së detyrimit mujor të qirasë, për pasuritë e luajtshme (makineritë, pajisjet, linjat teknologjike, makineritë e pajisjet në galeritë minerare, etj.) që jepen me qira, institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, përcakton vlerën e qirasë vjetore, që është sa 1/10 e VAM-it (vlerës aktuale minimale), të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite.

3. Gatim me sipërfaqe 130 m², ku është lidhur kontrata e qerasë me Qiramarrësin shoqërinë "S. AL, me vlerë 26,000 lekë/muaj, me afat një vjeçare, me të drejtë rinovimi.

Dhënia me qira e objekteve në pronësi të SPV janë bërë në zbatim të pikës 5/a dhe b, të kreut I, të VKM-së nr.54, datë 05.02.2014.

Tarifat e vendosura nga SPV të dhënies me qira të ambienteve dhepajisjeve është bërë në zbatim të kreut III "Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë", të VKM-së nr.54, datë 05.02.2014.

Pas lidhjes së kontratës më OE të dhënies me qira të ambienteve dhe pajisjeve SPV ka bërë dorëzimin tek qiramarrësi ose enfiteozemarrësi të ambienteve dhe të pajisjeve shoqëruara me proces verbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës.

Në proces verbal të dorëzimit të pajisjeve të dhëna me qira është përcaktuar vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit.

Çdo vit nga Titullari i institucionit janë ngritur grupet për mbikëqyrjen e kontratave të qerasë – për të monitoruar në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrës ose enfiteozmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratë në zbatim të pikës 2/c të kreut VI të VKM-së nr.54, datë 05.02.2014.

- Në rastet e përfundimit ose zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qirasë/enfiteozës institucioni ka marrë në dorëzim me procesverbal pronën/pajisjet që ka në administrim. Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me pikën 42 të udhëzimit të Ministrit përgjegjës për ekonominë nr.13, datë 26.04.2018 e cila përcakton se “ *Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë, për monitorimin e realizimit të kushteve të kontratës nga Qiramarrësi ose Enfiteozëmarrësi, në vijueshmërinë e kontratave të qirasë deri në përfundim të afatit të konsumimit të kontratës së qirasë, hartojnë çdo 6 muaj akte verifikimi me subjektet qiramarrëse, ose enfiteozmarrëse, për realizimin e kushteve të kontratës dhe një kopje e përcjellin në institucionin që ka firmosur kontratën e qirasë*”, si dhe formatit përkatës që i bashkëlidhet udhëzimit, nga SPV **nuk rezultuan të jenë hartuar këto akt verifikime periodike 6 mujore për monitorimin e kontratave të qirave. Nga institucioni janë bërë vetëm raporte monitorimi 1 vjeçare, dhe janë mbajtur vetëm nga komisioni i monitorimit. Nuk ka të bashkëngjitur akte verifikimi me subjektet qiramarrëse.**

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet ne KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.
Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

2.9.Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të pikës nr.9 (nëntë) të programit të auditimit nr.149/1 prot, datë 28.01.2021, i ndryshuar u shqyrtua dokumentacioni mbi verifikimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nga ku u konstatua si më poshtë vijon:

Nga auditimi si dhe vlerësimi nga grupi i auditimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (**MFK**) për periudhën e auditimit 01.03.2017-31.01.2021, rezultoi: Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Komisionin e Prokurimit Publik, **nuk ka funksionuar**, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar pothuajse nga të gjithë hallkat e njësisë, nga ku rekomandojmë që punonjësit të marrin masa mbi planifikimin e trajnimit për njohuri të plota mbi ligjin e MFK-së, duke bërë të mundur kështu vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion nga drejtuesit në mënyrë sa më të drejtë dhe të saktë.

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, në bazë të këtij ligji si dhe referuar urdhrin nr.108 datë 17.11.2016 i Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” dhe udhëzimit nr.16 datë 17.11.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësite publike” do të bëhet vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Komisionin e Prokurimit Publik. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Objektivi i veprimtarisë së Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” është:

- ❖ Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.
- ❖ Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.
- ❖ Krijimi i lehtësive për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

- ❖ Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.
- ❖ Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor në përputhje me aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Për periudhën objekt auditimi 2017, 2018, 2019, 2020 nga auditimi rezultoi se:

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” është institucion publik dytësor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.9106 datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor” i ndryshuar, të ligjit nr.10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin Shëndetësor” i ndryshuar, ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin Mendor” si dhe rregullores nr.11 datë 10.10.2013 “Rregullore e Brendshme e Spitalit Psikiatrik Ali Mihali, miratuar nga titullari i Institucionit, i cili në kundërshtim me nenin nr.21 të ligjit të sipërpërmendur “Për kujdesin shëndetësor” i cili citon se *Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloret lidhur me llojet dhe nivelin e shërbimeve të institucioneve të kujdesit shëndetësor*, kjo rregullore duhej të ishte e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe jo nga titullari i spitalit.

SPV funksionon si institucion varësie nga Ministria e Shëndetësisë dhe ku me shkresën nr.2265/3 datë 09.11.2016 “Struktura Organizative e SPV Vlorë” miratuar nga ministri i shëndetësisë, është përcaktuar struktura për përbërjen e Administratës si dhe Shërbimet Mjekësore. Me shkresën nr.2269/ datë 26.04.2018 “Struktura Organizative e SPV Vlorë” miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, është ridërguar struktura me disa ndryshime në shtimin e numrin të punonjësve, si dhe shtimin e disa pozicioneve të punës, si prsh Nëndrejtor Ekonomik etj. Referuar ndryshimit të strukturës, sipas miratimit dhe dërgimit në SPV të shkresave të sipërpërmendura nga auditimi u konstatua se Institucioni duhet të merrte masa në ndryshimin e Rregullores së Brendshme të institucionit, duke trajtuar te drejtat dhe detyrimet për secilin nga pozicionet e punës të punonjësve si dhe miratimin e kësaj rregullore nga Ministri i Shëndetësisë, dhe jo titullari i njësisë së vartësisë.

Në përputhje me nenin nr.18 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ku nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin i cili përmban përmban informacion si dhe të *dhëna mbi të pestë (5) komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrolli siç janë, Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Aktivitete e Kontrollit , Informimi dhe Komunikimi si dhe Monitorimi dhe Raportimi*, për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që i mbulon si dhe pyetësin e vetëvlerësimit, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji. ***Spitali Psikiatrik nuk ka miratuar dhe as depozituar “Deklaratën dhe Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësin e vetëvlerësimit për asnjë nga vitet 2017,2018,2019 dhe 2020”.***

-Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), sipas nenit 27 të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe sipas pikës 2.2.6 të Manualit të Menaxhimit Financiar i miratuar me Urdhrin nr.108 datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit Financiar” nga Ministri i Financave ku citohet se “*cdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë...*” me urdhrin e brendshëm nr. 217 datë 20.09.2019 “Për krijimin e Grupit Për Menaxhimin Strategjik” i miratuar nga titullari i institucionit, është ngritur GMS, e përberë nga titullari i institucionit, N/drejtor ekonomik, N/drejtor teknik, si dhe shefat e sektorëve. ***Për vitin 2017,2018, nuk është ngritur grup GMS.***

- GMS, për vitin 2019 - 2020 nuk ka mbajtur proces verbal për secilën nga takimet e mbajtura duke trajtuar rendin ditor si dhe problematikat e trajtuara, të firmosura nga të gjithë anëtarët e GMS.

Grupi i menaxhimit Strategjik referuar pikës 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar.....” i miratuar nga Ministri i Financave duhet të mbledhet të paktën tre herë në vit, ku vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren në grup, duke vepruar në interes të publikut dhe në përputhje me standardet e etikës të institucionit. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike.

Në kreun III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, citohet: “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi. Më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit çdo njësi publike duhet të përgatisë planin strategjik për periudhën tre-vjeçare (plani strategjik afatmesëm). Njësia publike duhet të specifikojë dokumentat e planifikimit, duke përfshirë një përshkrim të objektivave në nivel strategjik dhe operacional dhe për të përcaktuar se çfarë do të jetë bazë për përcaktimin e nivelit të riskut të njësive publike.

Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet. Objektivat e programeve, aktiviteteve dhe projekteve duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Për proceset kyçe të punës është e nevojshme të përcaktohen “pronarët” e procesit. Pronarët e procesit janë përgjegjës për monitorimin e objektivave të proceseve të punës dhe menaxhimin e risqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave. Nga auditimi u konstatua se për asnjë nga vitet objekt auditimi ***SPV nuk ka hartuar e për pasojë nuk ka miratuar nga titulli i institucionit Planin Strategji & Vjetor të SPV***, në kundërshtim pika 4, neni 9 e cila citon se “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit ka përgjegjësi në hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike”.

a.Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike. Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, përcaktohet se, punonjësit duhet të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellët, por ky institucion, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, kanë miratuar kodin e etikës dhe të rregullatetë sjelljes të komisionit të prokurimit publik, i firmosur nga titullari i institucionit .

b.Struktura organizative, garantimi indarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. SPV funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën , me ligjin nr.44/2012, “Për shëndetin mendor”, me ligjin nr.9106,

datë 17007.2003, “Për shërbimin spitalor në republikën e Shqipërisë i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore si dhe referuar Rregullores së Brendshme e miratuar nga titullari institucionit e cila duhet të azhurnohet me ndryshimet e reja strukturore që kanë ndodhur në institucionin. (trajtuar si më sipër). Subjekti ka një program buxhetor me qëllim përdorimin me eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit. Nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konflikt interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në nenin 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi me shkresën nr.11387/1 datë 21.06.2018 miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është caktuar nëpunësi zbatues për SPV znj.Sh. Z., me detyrë Shef i Sektorit të Financës.

Referuar struktura se miratuar nga MSH, me shkresën nr.2269/ datë 26.04.2018 “Struktura Organizative e SPV Vlorë”, është shtuar pozicioni i Nën. Drejtor Ekonomik dhe nga ku sektori i financës ka kaluar në varësi direkte të Nën. Drejtorit Ekonomik.

Si rezultat i ndryshimit të strukturës, referuar shkresës së miratuar më sipër, nëpunësi zbatues i institucionit (SPV) duhet të emërohet, *Nën.Drejtor Ekonomik i cili është në varësi direkte nga Titullari i institucionit NA por jo shefi i sektorit të financës i cili është në varësi direkte të zv.Drejtorit Ekonomik dhe jo titullarët të Institucionit, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në nenin 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm.*

Në bazë të kërkesave të këtij neni “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, cilësohet se “Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike dhe raportimit periodik për vendimmairjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislatcionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave”.

c.Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Struktura dhe organika e SPV miratohen nga Ministri i Shëndetësisë, si njësi vartësi e tyre. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues si dhe menaxheret e tjerë të institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, *institucioni nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.* Struktura

dhe procedurat e brendshme garantojnë që të gjithë punonjësit të mbikëqyren në kryrjen e detyrave të tyre nga drejtuesit dhe struktura aktuale e këtij viti nuk është plotësisht e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

d.Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, por kjo rregullore nuk është ndryshuar referuar ndryshimi të strukures së tyre e për pasoj as miratuar nga MSH. Është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkalidhur dosjeve personale të punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në SPV nuk është kryer asnjë trajnim, nuk është hartuar asnjë plan trajnimi në lidhje me nevojat e punonjësve për përmirësimin apo njohjen e punonjësve me ligjin për fusha të ndryshme.

Trajnimet organizohen për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fushën e Informacionit. Nga auditimi u konstatua se *SPV nuk ka program specifik për trajnimin e punonjësve* të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillimim viti mbi nevojat për trajnimi për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur në fund të çdo viti planin mbi realizimin e trajnimeve nga punonjësit e institucionit, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë”, paragrafet “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

Menaxhimi i riskut.

Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t’u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t’i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet. Objektivat e programeve, aktiviteteve dhe projekteve duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Për proceset kyçe të punës është e nevojshme të përcaktohen “pronarët” e procesit. Pronarët e procesit janë përgjegjës për monitorimin e objektivave të proceseve të punës dhe menaxhimin e risqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të jenë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në përputhje të ligjit nr. 10296, datë 05.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, ky institucion për vitin 2019 ka miratuar nga titullari por pa urdher miratimi “Strategjinë e menaxhimit të riskut për vitin 2019-2023”, po kjo strategji nuk është ë përvitësuar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij.

Punonjësit e për periudhën objekt auditimi, *nuk kanë zhvilluar asnjë trajnim* për menaxherët apo stafin të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm hartimin e regjistrit të riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, t’i raportojnë ato si dhe hartimi mbi masat për parandalimin e këtyre risqeve edhe pse referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritare për njësinë, institucioni ka renditur zhvillimin e trajnimeve/seminareve në fushën e menaxhimit të riskut, hartimit të dokumentave si dhe regjistrin apo strategjisë së tij për shkak të njohurive të pamjaftueshme në lidhje me keto procese, por keto trajnime nuk janë realizuar.

Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në vija të përgjithshme në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces.

Grupi i auditimit konstatoi se, SPV për asnjë nga vitet objekt auditimit, ***nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit***, e cila duhet të përgatitet nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi në kundërshtim me nenin 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” dhe nenin 12 “Përgjegjëshmëria menaxheriale e NZ”. ***Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit***, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj.

Informimi komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi nuk janë kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Titullari nuk informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve. *Spektori i Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin.* Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

SPV nuk ka një faqe zyrtare në eëb, ku qytetarët të kenë mundësi të njihen mbi funksionimin, veprimtarinë dhe shërbimet që ofron ky spital.

Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Në këtë institucion, Titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e mesëm dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve apo informacioneve.

Nga auditimi u konstatua se SPV *nuk dërgon raporte monitorimi në kundërshtim me Udhezimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” kapitulli V “Monitorimi”, si dhe në kundërshtim me udhëzimin nr.22 datë 17.11.2016 “Për procedura standarde të monitorimit të buxhetit te shtetit” pika 19 i cili detajon përbërjen e raportit te monitorimit, afatet si dhe dërgimin pas miratimit të tij.* Raportet e monitorimit dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë, si organ nën varësi të tij raporte 4-mujore në lidhje me, performancën e objektivave në sasi dhe në vlerë, performancën për secilin produkt, analiza e shkaqeve të deviacioneve etj. të përcaktuar më saktë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuri të duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke moskryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune.

Me shkresën nr.1457/2 prot. Datë 07.10.2021 nga SPV janë paraqitur observacionet në KLSH protokolluar me shkresën nr.149/7 datë 08.10.2021, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit. Spitali Pikatrik i Vlorës shpreh dakortësinë si dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre dhe pasqyrimin e punës në vijmësi.
Për sa më sipër trajtuar observacioni merret parasysh.

Çështja 1 – Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Titulli i Gjetjes 1	Mos dorëzimi i deklaratës dhe raportit mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm
Situata:	Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Spitali Psikiatrik nuk ka miratuar dhe as depozituar “Deklaratën dhe Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për asnjë nga vitet 2017,2018,2019 dhe 2020”.
Kriteri:	Neni 18, i ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manuali i Auditimit Financiar
Ndikimi/Efekti	Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. I Lartë
Rëndësia	Nëpunës Autorizues për çdo vit duhet të përgatisë deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në të cilin ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomik ashtu si dhe të trajtojë dobësitë e sistemit të kontrollit e planet për trajtimin e tyre.
Rekomandimi	Gjithashtu NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi tek NPA në MF. NA të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe i raportojnë NA, sipas shkallës hierarkike, deri te NA i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Afati për zbatimin e rekomandimit Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 2 Mos hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik

Situata: Nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht plani strategjik 2017-2019, 2018-2020, 2019-2021 si dhe planin strategjik 2020-2022, i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale.

Kriteri: Neni 9, i ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Manuali i Auditimit Financiar

Ndikimi/Efekti Mos hartimi i Planin Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos hartimin e objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve të cilat duhet të realizohen përmes proceseve të punës ku për proceset kyçe të saj, është e nevojshme të përcaktohen “pronarët” e procesit të cilët janë përgjegjës për monitorimin e objektivave të proceseve të punës dhe menaxhimin e risqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave

Rëndësia I Mesëm

Rekomandimi SPV të marrë masa në krijimin e Planit Strategjik i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Afati për zbatimin e rekomandimit Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 3 Mos hartimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme

Situata: Spitali Psikiatrik gjate periudhës së auditimit ka pasur ndryshime ne strukture si pozicione te reja apo sektorë të ndryshëm, institucioni vazhdon te funksionojë me rregulloren e brendshme e miratuar nga Drejtori i Spitalit me urdhrin nr.11 datë 10.10.2013 “*Rregullore e Brendshme e Spitalit Psikiatrik Ali Mihal*” duke konstatuar se nuk janë pasqyruar funksionet të cilat kanë ndryshuar më ndryshmet e ndodhura në strukturë për sa i përket funksioneve shtesë të SPV, funksionimit të tyre si dhe rregullat dhe procedurat për funksionimin e tij.

Kriteri: Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Manuali i Auditimit Financiar

Ndikimi/Efekti Mos hartimi i Rregullores së Brendshme, në institucion ka ndikuar në mos përcaktimin e rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme të SPV.

Rëndësia I Lartë

Rekomandimi SPV të marrë masa për ndryshimin e rregullores se brendshme, duke reflektuar ndryshimet përkatëse, për të ndihmuar anëtarët e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet

ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre. Gjithashtu, institucioni të marrë masa ku pas hartimit të rregullores, miratimi i saj të kryhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 4 Emërimi jo i saktë i Nëpunësit Zbatues

Referuar ndryshimeve të strukturës së miratuar nga MSH, me shkresën nr.2269/. datë 26.04.2018 “Struktura Organizative e SPV Vlorë”, është shtuar pozicioni i Nën. Drejtor Ekonomik dhe nga ku sektori i finances ka kaluar në varësi direkte të Nën. Drejtorit Ekonomik.

Situata: Si rezultat i ndryshimit të strukturës, referuar shkresës së miratuar mësipërm, nëpunësi zbatues i institucionit (SPV) duhet të emërohet, *Nën.Drejtori Ekonomik i cili është në varësi direkte nga Titullari i institucionit NA dhe jo shefi i sektorit të financës i cili është në varësi direkte të zv.Drejtorit Ekonomik por jo nga titullarit i Institucionit.*

Kriteri: Neni 12 i Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manuali i Auditimit Financiar

Ndikimi/Efekti Emerim i Nëpunësit Zbatues në kundërshtim me ligjin.

Rëndësia I Lartë

Rekomandimi Nëpunësi autorizues të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e MFK-së kanë përgjegjësi *caktimin dhe shkarkimin* e NZ. Shkarkimi i NZ kryhet vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga NPA në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të marrë masa në saktësimin dhe emërimin konform ligjit për Nëpunësin Zbatues.

Afati për zbatimin e rekomandimit Menjëhërë

Gjetja nr 5 Mos dokumentimi i takimeve të GMS; Mungesa e trajnimeve të stafit; Mungesa e hartimit të gjurmës së auditimit; Mungesa e hartimit të delegimit të detyrave

Situata a.SPV për asnjë nga vitet objekt auditimit, *nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit*, e cila duhet të përgatitet nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi si dhe përgjegjësi e NA për miratimin e saj. Gjurma e auditimit është një instrument i cili jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

b. Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS për vitin 2019-2020, nuk ka asnjë proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Kordinatorit të Menaxhimit Financiar.....”

c. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues si dhe menaxheret e tjerë të institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësi, *institucioni nuk ka rregulla të*

brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre

d. Nga auditimi u konstatua se SPV nuk ka program specifike për trajnimin e punonjësve të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillim viti mbi nevojat për trajnim për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur në fund të cdo viti planin mbi realizimin e trajnimeve nga punonjësit e institucionit, fakt ky i cili nëse do të ishte realizuar, punonjësit nuk do të kishin mangësi të thella në njohuritë mbi të drejtat dhe detyrimet të cilat lindin nga ligji i MFK, por dhe jo vetëm.

Kriteri	Në zbatim të nenit 9, 12, 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,
Ndikimi/Efekti	Mos dokumentimi i mbledhjeve, si dhe i problematikave të trajtuara gjate takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik për të lenë gjurmë për mbledhjet dhe vendimet e marra, mos lenja e gjurmës për sa i përket dokumentimit të operacioneve të ndryshme të subjektit, mos njohje mbi zbatimin e ligjit.
Rendesia	I Lartë
Rekomandimi	<p>a. NA në bashkëpunim me NZ të marrë masa në hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit në mënyrë që të sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.</p> <p>b. Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa mbi mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, mbi problematikën e trajtuar nga anëtarët e grupit të GMS, më qëllim dokumentimin e tyre.</p> <p>c. Të marrin masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin</p> <p>e. Gjithashtu të marrë masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre</p>

Afati i Zbatimit të Rekomandimit *Menjëherë dhe në Vazhdimësi*

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Spitali Psikiatrik i Vlorës, për asnjë nga vitet objekt auditimi (vitet 2017,2018,2019 & 2020) nuk ka hartuar dhe dorëzuar në MSHMS *raportet e monitorimit* të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm e cila ndikon në mos paraqitjen si dhe deklarin e ndryshimeve brenda programeve në lidhje me realizimin apo jo të artikujve të parashikuar, në kundërshtim me Neni 65, i ligjit nr.57 datë 02.06.2016 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9936, Datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin E Sistemit Buxhetor Në Republikën E Shqipërisë”, Të Ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 44-52 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të SPV të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues (MSHMS), deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të

ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit mbi rregullshmërinë e plotësimit të dosjeve të punonjësve grupi i auditimit konstatoj së Titullari i Insitucionit nuk ka kryer vlerësimin e punonjësve si dhe depozituar ato në MSHMS ku për pasojë nuk janë bërë pjesë e dosjeve të personelit në kundërshtim me VKM Nr. 109, datë 26.2.2014 për “Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë (ndryshuar me VKM nr. 252, datë 30.3.2016)”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-56 të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Spitali Psikiatrik, Vlorë në bashkëpunim me MSHMS, të kryejë vlerësimet periodike të punonjësve të SPV, me qëllim për të ndjekur angazhimin dhe performancën e punonjësve në punë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi analitikë i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se në zërin 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën prej 9,677,600 lekë janë kontabilizuar shpenzimet për “Studime e projekte” të realizuara nga institucioni ndër vite (2007-2016). Vlera prej 9,677,600 lekë nuk ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale por janë “Studim e projekte”, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga SPV duhet të ishin regjistruar në zërin 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe pasi institucioni ka përfunduar dhe marrë në dorëzim godinat për të cilën janë realizuar “Studim projektet” duhej të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit duke bërë veprimin kontabël: debituar llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe kredituar llogarinë 230. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime” si dhe nënvlerësimin e “Aktiveve Afatgjata Materiale” në shumën 9,677,600 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 6, 9 dhe 10; dhe konkretisht me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Sektori i financës së SPV të marrë masa për sistemimin e shumës 9,677,600 lekë nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, sipas zërave për të cilën janë realizuar “Studim e projekte”.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqet e trojeve në llogarinë 210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Nga Institucioni nuk disponohet dokumentacion dhe planimetri (genplan) për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve, që ka në dispozicion për periudhën objekt auditimit, si dhe nuk rezulton kjo sipërfaqe të jetë e regjistruar në zyrat e kadastrës shtetërore dhe në hipotekë në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Sipërfaqja totale e tokës prej 11620m², që ka SPV në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet, Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Nga SPV të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe mbi këtë bazë të

ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

4.2. Rekomandimi: Nga SPV të merren masa për përlllogaritjen e vlerave nga ekspertët e fushës, dhe më pas Sektori i Financës të ndërmarr veprimet e nevojshme të regjistrimit të pasurisë në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve elektronike (IT) janë klasifikuar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*”, dhe jo në llogarinë 2186000 “*Inventar ekonomik*”, ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogaritur me normën 5% dhe jo me normën 25%.

- Një pjesë e aktiveve të tjera janë klasifikuar në llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*”, vlerë e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*”, nga ku rezulton se amortizimi vjetor për këto aktive është llogaritur me normën 5% dhe jo me normën 20%. Veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 25 datë 20.01.2011 “*Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik*” dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës së SPV të marrë masat për ri-klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të kalimit të aktiveve në vitin 2017;2018 dhe 2019, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “*Kalim kapitali pa pagesë*” u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivitetit, si dhe në rastin e kalimit të mjeteve të transportit pa pagesë, autorizimin i personit për tërheqjen e mjeteve të transportit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”.

Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit))

6.1. Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masat, ku përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” janë kontabilizuar detyrimet e krijuara si rezultat i të ardhurave të konstatuara në bazë të kontratave për qiratë e ambienteve, të cilat janë arkëtuar në vitin pasardhës.

Shumat prej 109,939 lekë për vitin 2018 dhe shuma prej 106,401 lekë në vitin 2019 duhet të ishin kontabilizuar në momentin që janë konstatuar, duke debituar llogarinë 411 ose 468 dhe duke kredituar klasën 7. Këto të ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk janë arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi, duke debituar llogarinë 8424

”Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm” dhe duke kredituar llogarinë 4341 ”Operacione me shtetin (detyrime)”. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Sektori i financës në SPV të marrë masa në vijimësi, që për të ardhurat e konstatuara në bazë të akteve ligjore dhe të pa arkëtuara në fund të periudhës ushtrimore, të kontabilizohen duke debituar llogarinë 411 ose 468, dhe duke kredituar llogarinë 4341 ”Operacione me shtetin (detyrime)”.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos u njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë të Vendimit të Gjykatës, por janë njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

1. Si rrjedhojë, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk pasqyron vlerën e saktë në pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Konkretisht nga viti 2017 deri në vitin 2020, ky zë reflektohet me vlerë 0 (zero), ndërkohë që duhet të ishte reflektuar me vlerën e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë mbi 30 ditë, përpara mbylljes së pasqyrave financiare përkatësisht:

- në vitin 2017 në shumën prej 973,643 lekë
- në vitin 2018 në shumën prej 1,139,216 lekë
- në vitin 2019 në shumën prej 1,324,270 lekë

2. Duke ju referuar pagesave të kryera nga SPV për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, rezultoi se nuk është respektuar parimi FIFO, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)

8.1 Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me sektorin e çështjeve juridike, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2 Rekomandim: Sektori i Financës në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

8.3 Rekomandim: Sektori/njësia që mbulon çështjet juridike, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Fondi neto në vlerën 282,080,681 lekë përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 281,806,702 lekë dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 273,979 lekë që përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatit financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës, Nga analiza

e pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto rezulton një keq klasifikim të llogarive, e cilat nuk ka efekt material në pasqyrën financiar.

- Shuma e mbetur prej 273,979 lekë e kontabilizuar në llogarinë 85 është e mbartur dhe e pa sistemuar që nga viti 2010 e cila ka të bëjë me një sponsorizim, të cilën institucioni e ka gjendje në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”. Në mbylljen e pasqyrave financiare nga institucioni në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” në zërin 7207 “Sponsorizime të brendshme (nga të trete)” vendose shumën prej 273,979 lekë si sponsorizim të periudhës ushtrimore, ku kjo shumë është konstatuar një herë si e ardhur që në vitin 2010.

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” në zërin “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve” nga SPV është debituar dhe kredituar njëkohësisht.

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në fund të vitit ushtrimor duhet të paraqitet me vlerën e ndryshimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, ku për vitin 2018 duhet të reflektohej në vlerën 706,305 lekë dhe për vitin 2019 duhet të reflektohej në vlerën (2,389,549) lekë.

Llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë. Për vitin 2019 duhej të paraqitej për vlerën (706,305) lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në SPV të marrë masa, që në fillim të çdo vitit ushtrimor të saktësojë pozicionin e çeljes së llogarive nga vitet e mëparshme, të kryej sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomike kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në fund të procesit të inventarizimit u konstatua se komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga komisioni para fillimit të inventarit u konstatua se, nuk ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjës material dhe komisionit të inventarizimit. Veprim në kundërshtim me pikën 83, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

- Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit, të cilat i ka vlerësuar për jashtë përdorim nuk ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorim, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorim të këtyre aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve. Veprime në kundërshtim me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 56-75 Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Komisioni i inventarizimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të SPV-së të marrë masa në vazhdimësi, që në fund të procesit të inventarizimit, të përpiloj një relacionin, me komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit.

Në vijimësi

10.2 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit i ngritur nga titullari të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktive të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se Spitali Psikiatrik Vlore ka dërguar shkresën Nr.351 Prot. datë 15.02.2019 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, kjo për nevojat e parashikuara, për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, impjantistikës, pajisjeve të zyrave dhe hotelerisë për një periudhë 24 muaj me situacionin përkatës. Situacioni përkatës për punimet e nevojshme është hartuar dhe firmosur nga punonjësi A. L. me profesion teknik i mesëm. Nga auditimi konstatohet se kërkesa e dërguar për mirëmbajtjen nuk është e argumentuar, konkretisht: -nuk përcaktohet se në cilat godina do kryhet riparimi si dhe gjendja aktuale e këtyre godinave (volumet e punimeve të shoqëruara me vizatimet dhe planimetritë e tyre, fotografi, etj.). -nuk ka gjurmë që vërteton kërkuuesin dhe miratuesin për nevojën e kryerjes së këtyre punimeve; -mungon urdhri për caktimin e z. A. L. ose të një grupi pune për hartimin preventiv. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa, që në të ardhmen, për parashikimin e punimeve të nevojshme në mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore të kryej një vlerësim dhe dokumentim real të tyre, nisur nga fakti i amortizimit të madh të këtyre objekteve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për kontratën e zbatimit Nr.34 me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” me Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 konstatohet se Formulari i Garancisë së Kontratës nr. 0002494 datë 15.10.2019 lëshuar nga kompania e sigurimit “S. International” ka afat deri më datë 15.10.2020. Afati i përfundimit të kontratës është 24 muaj, datë përfundimi 15.10.2021. Kontrata me objekt “*Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, impjanistike dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2019*” nuk është e mbuluar me garanci gjatë gjithë kohës së zbatimit të saj e cila e krijon risk për AK në rast të mosplotësimit të detyrimeve kontraktuale nga sipërmarrësi. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 24, pika 1 dhe 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: SPV të kërkoj që sipërmarrësi i punimeve BOE “E. B&B” shpk dhe “A.” shpk të paraqesi një sigurim kontrate deri në afatin përfundimtar të saj.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, ku per proceduen me objekt “*Kërkese per propozim*” me objekt: “*Mirëmbajtje e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave*” për vitin 2017,2018,2019; *procedurën me objekt “Mirëmbajtje e objekteve ndertimore, impjanistikes, pajisjeve te hotelerise” për vitin 2018, 2019 si dhe procedurën me objekt “Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imët” nga dokumentacionit i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në hartimin e dokumentave të tenderit jane vendosur kriteret jo ne përputhje me objektin e prokurimit dhe disa kriteret nuk jane argumentuar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), neni 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punë publike " Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).**

13.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit të marrë masa ku kriteret e vendosura për plotësimin e dokumentave standard të tenderit, të hartohen ne menyre jo diskriminuese apo orinetuese në

mënyrë që të sigurojë trajtim të barabartë për OE duke nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën ndërmjet tyre .

AK duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj OE.

Menjëherë dhe ne vijmësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 në hartimin e dokumentave të tenderit në urdhrin e ngritjes së njësisë së prokurimit dhe KVO miratuar nga Titullari i Institucionit u konstatua se nuk ka të përcaktuar person përgjegjës (Kryetar) i cili është përgjegjës për organizimin e punës dhe mirëfunksionimin e komisioneve në kundërshtim me nenin 57, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Titullari i SPV ose personi i autorizuar prej tij të merren masa ku, për çdo procedurë prokurimi në përbërjen të njësisë së prokurimit apo Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit të përcaktojë personi përgjegjës të grupit (Kryetar grupi).

Menjëherë dhe ne vijmësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën disa urdhër shërbimet për shpenzime udhëtime e dieta, nga ku konstatohet se ***në të gjitha rastet nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit***, panvarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të titullarit në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit”, i ndryshuar, kreu V, pika 2, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Institucioni në bashkëpunim me sektorin e Hotelarisë të marrë masa ku për çdo udhëtim të planifikuar dhe autorizuar nga NA, të plotësohet në mënyrë shkresore kërkesa e argumentuar nga personi përgjegjës, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve të planifikuara si dhe ditët e qëndrimit.

Sektori i financës të marrë masa ku pas plotësimit të dokumentave justifikues të cilat argumentojnë në mënyrë shkresore lëvizjet e punonjësve, të kryhej likuidimin e tyre.

Në vijmësi

16. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se për automjetin tip Mercedes-Benz me targa VL 8505 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 156,400 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 32,300 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e automjetit është në 32,000 leke.

Autoambulaca tip Volsäagen 70x Multivan me targa VL 9512 B janë kryer shpenzime për të dy vitet e fundit 2019 dhe 2020 në shumën 261,300 lekë (124,100 lekë për vitin 2019 dhe 137,200 lekë për vitin 2020). Ndërsa vlera e mbetur e autoambulancës në vitin 2020 është në 119,253 leke.

Shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit, ***pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjetit tejkalon vlerën e mbetur të tyre***. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues (NA) të marrë masa për ngritjen e një komisioni me ekspertë të fushave, për artikujt respektive, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të tyre, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi I vlerës së makinave. Mbi bazën e aktivitetit të rivlerësuar, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

Menjëherë

17.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, me autorizimin nr. 80/9 prot. datë 27.03.2020, nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si Organ Qendror Blerës, pas përfundimit të procedurës së prokurimit “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*”, ka autorizuar SPV të lidhi kontratën me OE shpallur fitues “S.AL” me ofertë ekonomike **166,021,272** lekë pa TVSH. SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*”, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4** lekë pa TVSh, me operatorin ekonomik “S. AL” SHPK.

- Nga titullari i AK dh OE “C. F.” shpk është lidhur kontrata nr. 24, datë 20.07.2020 “*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SPV Vlorë*” me afat 20.07.2020-31.12.2020 në vlerën 6,394,248.2 lekë pa TVSH (7,673,097.84 lekë më TVSH), si dhe kontratën nr.48, datë 30.12.2020, me afat 30.12.2020-31.12.2021 në vlerën 14,775,887 lekë pa TVSH (17,731,064.40 lekë më TVSH).

- Nga titullari i AK dh OE “AGS” shpk është lidhur kontrata me nr. 43, datë 30.12.2020 “*Shërbim Lavanderie dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV*” për periudhën 01.01.2021- 31.12.2021 me fond limit në vlerën 26,546,722.85 lekë pa TVSH.

Në tre kontratat e sipërpërmendura në pikën “Vlera e Kontratës” citohet se...” *Palët bien dakord që çdo vit pas publikimit të inflacionit vjetor nga Instituti i Statistikave të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen*”.

Në bazë të këtij neni të kontratës së pranuar mes palëve, SPV i ka dhënë akteve fuqi prapavepruese, duke cënuar parimin e sigurisë juridik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*” në neni 105 “*Efektet prapavepruese*”, si dhe të VKM-së nr. 914/14 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, në nenin 9 “*Llogaritja e vlerës së kontratës*” pika 2, si dhe me marrëveshjen kuadër të lidhur midis ABP dhe OE pika 1.4, ku citohet se “*Kontraktuesi nuk do të ketë të drejt kompensimi dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.....*” e përcaktuar në kontratën “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të SPV-së të marrë masa të menjehershme për ndryshimin e nenit në të cilën citohet ”.....*të nënshkruajnë amendim kontrate ku të përcaktojnë rivlerësim të periudhës së mëparshme dhe indeksimin e çmimit për periudhën që vjen*”, duke hequr togëfjalëshin “*të periudhës së mëparshme*”, me qëllim shmangien e krijimeve të dëmeve ekonomike të mundshme në të ardhmen.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimit në terren i zbatimit të kontratës së shërbimit të lavdërisë u konstatua se, ndërrimi si dhe ripërtëritja e materialeve të buta për nevoja të pacienteve të SPV nuk kryhej në kohë ashtu si dhe shume materiale të buta si, çarçafë, jastëk, kuverta të cilat janë domosdoshmëri e përditshme e pacienteve, si dhe detyrim nga OE për furnizimin e tyre referuar kontratës, ishin në gjendje të konsumuar në kundërshtim me Kontrata nr. 1 protokolluar me shkresën nr. 1589/32, datë 27.01.2020 “*Draft marrëveshja kuadër, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për “Shërbim Lavanderise dhe Zëvendësim me inventar të imët për nevoja te SPV*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga ana e përgjegjësve mbi ndërrimin dhe ripërtëritjen e materialeve, të kushtohet një vëmendje e veçantë mbi ndërrimin dhe shërbimin në kohë ndaj pacientëve, të cilët në mungesë të aftësive për ti kërkuar këto kushte, tu plotësohen nga punonjësit përgjegjës për kryerjen e shërbimit.

Grupi i monitorimit ngritur nga titullari i institucionit të marrë masa për realizimin e kontrolleve sistematike dhe në mënyrë vigjilente, me qëllim minimizimin e rasteve të cilat sjellin ndikim tek cilësia e shërbimit ndaj pacientit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Në urdhër shpenzimet mbi likuidimin e shërbimit të kontratës “Shërbim Lavanderië” *konstatohet* se proces verbalët e mbajtura nga komisioni i monitorimit të kontratës dhe subjektit, artikujt janë të shënuar në copë pa peshën specifike të secilit artikull, çka sjell mos evidentim të peshave përkatëse për secilën nga produktet me totalin e shënuar në procesverbalin e likuidimit të shërbimit, firmosur nga OE dhe AK në kundërshtim me *Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Nga ana e përgjegjësve të materialit për secilin pavijon si dhe shefit të hotelierisë, të merren masa që në procesverbalin ditor si dhe në përmbledhjen mujore, të shkruhet sasia dhe pesha përkatëse për çdo artikull, pas peshimit të secilit nga produktet e tërhequra nga lavanderia, me qëllim përcaktimin e saktë mbi vërtetësisë dhe rakordimin me tabelën përmbledhëse mujore, si dokument justifikues dhe argumentues për likuidimin e shërbimit.

Struktura përgjegjëse për financat përpara se të kryej likuidimin duhet të kontrollojë dokumentet shoqërues justifikues në lidhje me produktin apo shërbimin e kryer.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: SPV ka lidhur kontratën e shërbimit nr. 13, datë 03.04.2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, për periudhën 4 vjeçare 03.04.2020-03.04.2024, me vlerë të pritshme të parashikuar **166,856,450.4** lekë pa TVSh, me operatorin ekonomik “S. Al” SHPK.

Nga auditimi u konstatua se fondi limit i autorizuar sipas ABP, për ofertën ekonomike të shpallur fituese OE “S. AL” shpk për periudhën 4 vjeçare nuk është i njëjtë me fondi limit të caktuar në kontratën që SPV me OE kanë lidhur, me një diferencë prej **835,178.40** lekë në kundërshtim me VKM-në nr. 914/14 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 47, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Institucionit të merren masa në ri-ndryshimin e vlerës së lidhur të kontratës për shërbimin e Kateringut me OE, ku në zbatim të procedurës së kryer nga organit qendror Blerës për këtë shërbim, të lidhet nënkontrata në vlerën 166.021.272 lekë e cila është oferta ekonomike e shpallur fitues dhe jo në vlerën 166,854,450.4 lekë, e cila përfaqëson fondin e përgjithshëm.

Menjëherë

21.Gjetje nga auditimi: Referuar konstatimeve mbi zbatimin e kontratës së lidhur midis AK dhe OE për “Shërbimin Katering”, grupi i auditimit konstatoi se një pjesë e kushteve të kontratës nuk janë zbatuar, kushte të cilat nën gjykimin e grupit të auditimit përbejnë themelin e krijimit të kësaj kontrate si dhe ofrimi i një shërbimi, i cili është jetik për pacientët në kundërshtim me Kontrata nr.13 prot me nr.692 datë 03.04.2020 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Spitalin Psikiatrik, Vlorë. Nga grupi i auditimit u konstatua se grupi i monitorimit, mbante proces verbale në formë tabelare vetëm në lidhje me numrin e pacineteve dhe numrin e ofrimit të rracioneve ditore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Institucionit të SPV si dhe nga grupet e mgritura nga Titullari për monitorimin e kontratës “Shërbimit Katering”, të merren masa të menjëhershme dhe në vazhdimësi, ku ofrimi i shërbimit të ushqimit, si një shërbim jetik për pacientët të kryhet në standardet dhe kushtet e përcaktuara në kontrate.

Grupi i monitorimit të marrë masa të realizojë kontrole të herpashershme, në lidhje me cilësinë e ushqimit si dhe shërbimit duke mbajtur proces verbale të trajtuara në mënyrë narrative në lidhje me konstatimet apo jo të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin

nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion. Spitali Psikiatrik nuk ka miratuar dhe as depozituar “Deklaratën dhe Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për asnjë nga vitet 2017,2018,2019 dhe 2020” në kundërshtim me Neni 18, i ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Nëpunës Autorizues për çdo vit duhet të përgatisë deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në të cilin ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomik ashtu si dhe të trajtojë dobësitë e sistemit të kontrollit e planet për trajtimin e tyre.

Gjithashtu NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi tek NPA në MF. NA të të gjitha niveleve të njësisë të varësisë janë përgjegjës dhe i raportojnë NA, sipas shkallës hierarkike, deri te NA i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Në vijmësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga SPV nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht plani strategjik 2017-2019, 2018-2020, 2019-2021 si dhe planin strategjik 2020-2022, i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale në kundërshtim me Neni 9, i ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa në krijimin e Planit Strategjik i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Menjëhëre

24. Gjetje nga auditimi: Spitali Psikiatrik gjate periudhës së auditimit ka pasur ndryshime në strukture si pozicione të reja apo sektorë të ndryshëm, institucioni vazhdon të funksionojë me rregulloren e brendshme e miratuar nga Drejtori i Spitalit me urdhrin nr.11 datë 10.10.2013 “Rregullore e Brendshme e Spitalit Psikiatrik Ali Mihali” duke konstatuar se nuk janë pasqyruar funksionet të cilat kanë ndryshuar më ndryshmet e ndodhura në strukturë për sa i përket funksioneve shtesë të SPV, funksionimit të tyre si dhe rregullat dhe procedurat për funksionimin e tij. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa për ndryshimin e rregullores së brendshme, duke reflektuar ndryshimet përkatëse, për të ndihmuar anëtarët e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me të drejtat dhe detyrimet të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre.

Gjithashtu, institucioni të marrë masa ku pas hartimit të rregullores, miratimi i saj të kryhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vijmësi

25. Gjetje nga auditimi: Referuar ndryshimeve të strukture së miratuar nga MSH, me shkresën nr.2269/ datë 26.04.2018 “Struktura Organizative e SPV Vlorë”, është shtuar pozicioni i Nën. Drejtor Ekonomik dhe nga ku sektori i finances ka kaluar në varësi direkte të Nën. Drejtorit Ekonomik.

Si rezultat i ndryshimit të strukturës, referuar shkresës së miratuar mësipërm, nëpunësi zbatues i institucionit (SPV) duhet të emërohet, *Nën.Drejtori Ekonomik i cili është në varësi direkte nga (NA) Titullari i institucionit. Shefi i sektorit të financës i cili aktualisht është emëruar si NZ është në varësi direkte të zv.Drejtorit Ekonomik dhe jo nga Titullarit i Institucionit, në kundërshtim* Neni 12 i Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e MFK-së kanë përgjegjësi *caktimin dhe shkarkimin* e NZ. Shkarkimi i NZ kryhet vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga NPA në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Titullari i Inatitucionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të marrë masa në saktësimin dhe emërimin konform ligjit për Nëpunësin Zbatues.

Menjëhërë

26. Gjetje nga auditimi: a.SPV për asnjë nga vitet objekt auditimit, *nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit*, e cila duhet të përgatitet nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi si dhe përgjegjësi e NA për miratimin e saj. Gjurma e auditimi është një instrument i cili jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

b. Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS për vitin 2019-2020, nuk ka asnjë proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Kordinatorit të Meanxhimit Financiar.....”

c. Lidhur me delegimin e kompetencave, nepunësi autorizues, nepunësi zbatues si dhe meanxheret e tjerë të institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, *institucioni nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre*

d. Nga auditimi u konstatua se SPV *nuk ka program specifike për trajnimin* e punonjësve të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillimim viti mbi nevojat për trajnim për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur në fund të çdo viti planin mbi realizimin e trajnimeve nga punonjësit e institucionit, fakt ky i cili nëse do të ishte realizuar, punonjësit nuk do të kishin mangësi të thella në njohuritë mbi të drejtat dhe detyrimet të cilat lindin nga ligji i MFK, por dhe jo vetëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 180-189 të Raportit të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: NA në bashkëpunim me NZ të marrë masa në hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit në mënyrë që të sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

26.2 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa mbi mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, mbi problematikat e trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, më qëllim dokumentimin e tyre.

26.3 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin

26.4 Rekomandimi: Gjithashtu nga NA në bashkëpunim me NZ të marrin masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre

Menjëherë dhe në Vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të prokurimit për periudhën objekt auditimit në të gjithë rastet, dosjet nuk janë të inventarizuara dhe nuk janë arkivuar, por janë mbajtur në zyrat e specialistes së prokurimeve të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

Menjëherë dhe në Vijimësi

27.1 Rekomandimi: Nga njësia e prokurimit të merren masa të menjehershme, ku të inventarizohen dhe arkivohet të gjitha dosjet e prokurimeve publike të perfunduara për vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 si dhe për procedurat në vijimësi.

Menjëherë dhe në Vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Spitali Psikatrik i Vlorës kryeh procedure prokurimi (blerje e vogël) cdo vit (viti 2017,2018,2019,2020) për “Evadimin e Mbetjeve Urbane”. Nga auditimi u konstatua se koshat të vendosura nga Bashkia e Tiranës ndodhen afër ambjentit të SPV, me pozicion në rrugën kryesore ku dhe është ndërtesa e Spitalit, nga ku referua kontratës së lidhur nga Bashkia me operatorin ekonomik, kryhet pastrimi i mbetjeve urbane të zonës, por referuar shkresës së Bashkisë, SPV nuk përfshihet në këtë kontratë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

28.1 Rekomandimi: Spitali Psikiatrik në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës të marrë masa ku për pastrimin e Mbetjeve Urbane e cila kryet si procedure prokurimi nga SPV, dukë qënë së ky shërbim kryhet nga Bashkia e Tiranës (por SPV është e përjashtuar), gjatë kalimit në rrugën urbane “Reshat Osmani”, të bëjë mbledhjen edhe të mbetjeve urbane të spitalit, veprim në funksion të miremenaxhimit dhe përdorimit sa më me efikasitet, eficence dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në Vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i mëparshëm i auditimit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është relativisht i ulët, tajtuar si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 masa organizative, të cilat, janë zbatuar 2 zbatuar pjesërisht 1, në proces 5 dhe janë pa zbatuar 1.
- Masa për shpërbllim dëmi janë lënë 14 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2, në proces 12.
- Masa për eliminimin e efekteve negative 3E janë lënë 7 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 2, në proces 1 dhe pazbatuar 4.
- Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;
- -4 masa disiplinore nuk janë zbatuar , 2 masë disiplinore janë zbatuar.
- -Sipas Statusit të Nëpunësit Civil janë lënë 0 masa disiplinore
- -Sipas Kodit të Punës, janë lënë 6 masa disiplinore e përkatësisht 4‘ *vërejtje me shkrim*’ deri në ‘*largim nga puna*’ dhe 2 masa ‘*largim nga puna*’.

29.1 Rekomandimi: Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë *rikërkojmë*, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara si dhe për të gjitha

rekomandimet e tjera, që konsiderohen të zbatuara pjesërisht ose në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

Menjëherë dhe në Vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “AGS” shpk për kontratën bazë nr. 26, datë 29.03.2016 “*Shërbimi lavanderisë dhe furnizimin me inventar ekonomik*” rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit “AGS” shpk vlera prej 2,245,711 lekë, si rrjedhojë e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”. Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbllimin e dëmit në vlerës **2,245,711 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “AGS” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “S. Al” shpk për kontratën bazë nr. 568, datë 30.04.2013 “*Shërbim katering për Spitalit Psikiatrik*”. Vlorë rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit “S. Al” shpk vlera prej 3,216,180 lekë, si rrjedhojë e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”. Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 4.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 4.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbllimin e dëmit në vlerës **3,216,180 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Nga përmbajtja e kontratave të rivlerësimit të lidhura çdo vit midis AK dhe OE “S. AL” shpk për kontratën bazë nr. 77/13, prot. datë 08.04.2016 “*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik*” rezulton se nga SPV janë likuiduar në favor të subjektit “S. AL” shpk vlera prej **1,686,701** lekë, si rrjedhojë e rivlerësimit të çmimeve të kontratës çdo vit, për çmimet e shërbimit, të cilat janë realizuar dhe likuiduar në periudhat e mëparshme, duke i dhënë akteve fuqi me efekt prapaveprues. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” në neni 105 “Efektet prapavepruese”. Vendim i marrë nga SPV për rivlerësimin e çmimeve të kontratës për shërbimet e realizuara në një periudhë të mëparshme nuk plotëson asnjë nga kriteret që akti të ketë fuqi prapavepruese. Pikat 2.2 e kontratës, për një interpretim korrekt parashikon aplikimin e çmimit të indeksuar për periudhat në vazhdim, por jo me fuqinë prapavepruese. Si rrjedhojë, *as pika 2.2 e Kontratës Tip dhe as ndonjë dispozite tjetër ligjore* nuk parashikojnë zbatimin e çmimeve të vendosura në mënyrë retroaktive, pra për periudhat e mëparshme të faturimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit*)

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbimin e dëmit në vlerës **1,686,701 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për rivlerësimin shërbimit te periudhave paraardhëse në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë janë likuiduar për zërin e shërbimit “*Pastrim i brendshëm*”, sipërfaqe të brendshme prej 218.5 m² që disponohen nga SPV, por që janë dhënë me qera. Nga periudha 01.03.2017 deri me 13.07.2020 në lidhje me zbatimin e kontratës “*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*” konstatohet se SPV ka paguar OE “S. AL” shpk për “*Pastrim i brendshëm*” të ambienteve të dhëna me qera, ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në **vlerën prej 1,767,275 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin: a. *Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m² në vlerën 715,807 lekë me TVSh* dhe për b) *Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m² në vlerën 1,051,469 lekë me TVSh*.

1.1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës “*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme si dhe sistemimin e ambienteve të gjelbërta të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*” konstatohet se për zërin “*Pastrim i brendshëm*” çdo muaj nga periudha 01 Mars 2017 deri më 20.07.2020 është paguar për sipërfaqen 7354 m². Në kontratën e lidhur midis AK dhe OE, si dhe në DT është përcaktuar se sipërfaqja “*Pastrim i brendshëm*” është në sasinë 7,347 m², çka rezulton me një tejkalim të kontratës prej 7m². Nga SPV për këtë periudhë ka paguar OE “S. AL” shpk më tepër për vlerën 47,181 lekë pa TVSh (**56,618 lekë me TVSH**). duke shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit**. Veprime në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur midis OE dhe AK, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimet publike*” i ndryshuar, neni 59 dhe neni 6060, pika 1, e cila përcakton se: “*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit*)

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbimin e dëmit në vlerës **1,823,892 lekë me TVSH** nga sipërmarrësit “S. AL” shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht “*Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme*” të cilat janë dhanë me qira, si dhe të tejkalimit të sipërfaes së pastrimin përtej kushteve të kontratës dhe Dokumentat e Tenderit (DT).

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi:

Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë për periudhën 20.07.2020 deri me 31.01.2021 në lidhje me zbatimin e kontratës "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë konstatohet se ka paguar OE "C. E." shpk për "Pastrim i brendshëm" të ambienteve të dhëna me qera, prej 218.5 m², ku për pastrimin e këtyre sipërfaqeve duhej të përgjigjeshin vetë qiramarrësit, në vlerën prej **201,894 lekë me TVSh** duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e shtetit** përkatësisht për ambientin a. *Lavanderia me sipërfaqe 88.5 m²*. në vlerën **81,774 lekë me TVSh** dhe b. *Ambienti i gatimit me sipërfaqe 130 m²* në vlerën 120,120 lekë me TVSh. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërbimin e dëmit në vlerës **201,894 lekë me TVSH** ndaj sipërmarrësit "C. E." shpk, për vlerën e përfituar padrejtësisht për "Shërbime për pastrim të ambientit të brendshme" të cilat janë dhanë me qira.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për kontratën me objekt "Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore në Spitalin Psikiatrik 'Ali Mihali' Vlorë", të lidhur midis Spitalit Psikiatrik Vlorë dhe BOE "E. B&B" dhe "A." shpk, Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 me vlerë 4,380,000 lekë pa TVSH ose 5,256,000 lekë me TVSH, me afat përfundimi të punimeve 24 muaj si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt si dhe të kryera jo sipas specifikimeve teknike, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën **159,400 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: SPV të marrë masa për kryerjen e punime brenda afatit të kontratës dhe garancisë së tyre në shumën **159,400 lekë pa TVSH**, e cila në rast konstatimi të moskryerjes së tyre të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve ndaj kontraktorit BOE "E. B&B" dhe "A." shpk me Nr.34/Nr.1842/1Prot. datë 15.10.2019 për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.

Menjëherë

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se KVO ka skualifikuar në menyre të padrejta OE me oferte me të ulët, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "*Per prokurimin publik*", i ndryshuar nëni 1 "*Objekti dhe qëllimi pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh)*", nëni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), nëni 41 pika 1, Nëni 46, Nëni 53 pika 4, Nëni 55 pika 2. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, I Ndryshuar, Kreu III nëni 10 si dhe nëni 66 pika 3, nga ku konkretisht:

- **Procedurës së prokurimit "Kerkese per propozim" me objekt: "Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave" e hapur me date 30/03/2018.**

Nga shqyrtimi i dokumenteve në SPE konstatohet se OE ka paraqitur një kontratë shërbimi të lidhur me një ent publik, kontrata është lidhur me nr.3476/1 prot date 14.08.2015 midis Qendrës Spitalore "Nene Tereza" dhe BOE "C." shpk dhe "A. K.". Në kontratë citohet se 95% të shërbimit do ta kryej "C." shpk ndërsa 5% "A. K.". Ndërkohe me shkresë nr.2720/1 prot date 20.05.2016 ku citohet Vërtetim për realizimin e kontratës: Kontrata është realizuar në vlerën 1,018.850 lek pa tvsh dhe 1,222.620 lek me tvsh shkresa është firmosur nga titullari i QSUT me kërkesë të OE. Tek specifikimet teknike citohet: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë viteve 2015, 2016, 2017 të aktivitetit financiar shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi në vlerën 40% të vlerës së fondit limit. Sasia e punimesh prej 95% të kryera nga ku OE vërteton shërbimet e ngjashme të kryera në masën 40% të vlerës së fondit

limit. Kjo vendimmarrje ka çuar në s'kualifikim e OE me vlerë më të ulët i cili do ti kursente buxhetit të shtetit vlerën **27,000 lekë**, diferencë midis OE të shpallur fitues dhe OE të s'kualifikuar me ofertë më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

- **Procedura e prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lavanterise dhe zëvendësimi me inventar te imët”, e hapur me date 26.09.2019.**

Komisioni i vlersimit të ofertave e ka skulifikuar pa të drejtë OE ”U. S.” me ofertë më të ulët për pikat.

1. *Mungese deklarate per paraqitjen e ofertës se pavarur, sipas shtojcës 1/1.*

2. *Ofertuesi ka paraqitur çertifikata ISO ne gjuhe te huaj, te pa perkthyer ne gjuhen shqipe.* Perkatësisht për pikën e parë pavarshisht se nga Njesia e hartimit të dokumentave standard është kërkuar tek kriteret e vecanta Shtojca 1/1, por nga auditimi rezultoi se ne dokumentat e tenderit nuk gjendet e bashkangjitur kjo shtojce si pjesë përbërëse e dokumentave standarde, fakt i cili nga KVO është trajtuar si arsye skualifikimi për OE.

Ndërkohe për pikën e dytë konstatojmë se ISOT janë hedhur në Sistemit Elektronik të Prokurimeve por nuk janë të përkthyer ne gjuhen shqipe, por theksojme se ISOT jane çertifikata nderkombetare dhe në to mund të përkthehet vetëm numri i ISOS. Referuar nenit 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndrshuar i cili citon se: “*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj*” nga grupi i auditimit është gjykuar së ky është një devijim i vogel i cili nuk prek themelin e procedures. Kjo vendimmarrje ka çuar në skualifikim e OE me vlerë më të ulët i cili do ti kursente buxhetit të shtetit vlerën **14,985,160 lekë**, diferencë midis OE të shpallur fitues dhe OE të s'kualifikuar me ofertë më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Nga SPVtë kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 15,012,160 lekë**, nga Komisionet e Vlersimit si dhe grupi i punës, për skualifikim të padrejtë të OE me ofertë me të ulët të përcaktuar si më poshtë vijon:

1. **Procedurës së prokurimit “Kërkese për propozim” me objekt: “Mirëmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave” arkëtimi i vlerës 27,000 lekë nga Znj.S. N., znj.M. C., z. E. B. dhe ish titullari i AK z.K. Ll.**

2. **Procedura e prokurimit “E hapur” me objekt: “Shërbimi i lavanderise dhe zëvendësimi me inventar te imët” arkëtimi i vlerës 14,985,160.**

Menjëherë

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Kerkes per propozim*” me objekt: “*Evadimi i mbetjeve urbane*”, për vitin 2017,2018,2019, u konstatua se për pikën 2 “*Siperfaqe fshirese për 2 pika (2*20m²)*” dhe pikën 3 “*Disinfektim për 2 pika (1*2)*”, të dyja këto pika janë mbivendosje e kontratës me objekt “*Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm*” në Spitalin Psikiatrik “*Ali Mihali*” Vlorë, me të cilen operon Operatori Ekonomik ”S. Al”, me kontrat shërbimi nr.11 nr.77/13 prot datë 08.04.2016 dhe nr.11 nr.549/10 prot date 13.03.2020. Në bazë të kontratës OE ka për detyrë të pastroj gjithë sipërfaqen e brëndshme dhe të jashtëm brenda territorit te spitalit spikiatrik Vlorë si citohet: *Me pastrim te jashtem jane te gjitha siperfaqet si (rruge, trotuare, sheshe) qe do te te kuptojm te gjithë siperfaqen e hapsires rreth e perqark godinave (Objekt ndertimi) qe aktualisht jane ne funksion te ketij spitali. O.E do te pastroj cdo dite gjithë siperfaqen e rrugëve brenda SPV me siperfaqe 4,450m, kur eshte e nevojshme dhe 2 here ne dite, OE kryen larjen e rrugëve ne baze te grafikut te vendosur nga hoteleria, para ores 7:00. Gjithashtu grumbullimi i mbeturinave behet ne koshat e vendosur ne cdo dhome dhe ambientet e veshur me qese te zeze plasmasi. Si rregull largimi i mbeturinave nga ambientet per ne vend grumbullimin e plerave behet cdo dite, transporti behet me kosha te medhej, te posacem, te mbyllur me kapak.*

Gjithashtu për vitin 2018 dhe vitin 2019 janë kryer nga nje procedurë për secilin vit, shtes kontrate “Evadimi i mbetjeve Urbane”, nga ku vlera e likuiduar për vitin 2018 është 232,943 lekë si dhe vlera e likuiduar për vitin 2019 është 76,933 lekë.

Për vitin 2020 nga auditimi i procedurës blerje e vogël “Evadimi i mbetjeve urbane” për pikën 2 “Sipërfaqe fshirëse për 2 pika (2*20m²)” dhe pikën 3 “Disinfektim për 2 pika (1*2)”, të dyja janë mbivendosje kontrates me objekt “Shërbimi i pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm” në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me të cilën operon Operatori Ekonomik “S. AI”, me kontratë shërbimi nr.11 nr549/10 prot date 13.03.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-153 të Raportit të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **783,244.37 lekë**, nga ish-titullari z.K. Ll., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Menjëherë

8.2 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **30,504 lekë**, nga ish-titullari z.K. Ll. dhe ish shefi i finances z.V.N. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Menjëherë

8.3 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **183,404 lekë**, titullari i Inshtucionit znj.O. G. dhe Shefja e finances z. L. B. për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Evadimi i mbetjeve urbane të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedje të kartelave të automjeteve ku pasqyrohen kilometrat e përshkruara dhe totali i litrave të harxhuara për udhëtimet e kryera, për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se sasia e karburantit të harxhuara dhe të evidentuar në këto kartela shoqëruar me fletë udhëtimet nuk korrespondon me sasinë e evidentuar në sistemin e kartave elektronikë të karburantit, duke mos pasqyruar vlerën reale të sasisë së konsumuar.

Nga përlllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar për një nga automjetet (me targë VL8505B) u konstatua se në sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shumë litra, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimet të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve.

Për vitin 2018, nga përlllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr në kartë elektronikë të karburantit dhe fletë udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diferencë hedhur me shumë në kartat elektronikë prej 3410 litra * 147,985 lekë/litër = 504,629 lekë.

Për vitin 2019, nga përlllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr në kartën elektronikë të karburantit dhe fletë udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diferencë hedhur me shumë në kartat elektronikë prej 11062 litra * 150,565 lekë/litër = 1,665,550 lekë.

Për vitin 2020, nga përlllogaritja e furnizimit me karburant rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr në kartën elektronikë të karburantit dhe fletë udhëtimet e mbajtura nga zyra e financës me një diferencë hedhur me shumë në kartat elektronikë prej 8979 litra * 147,894 lekë/litër = 1,327,940 lekë.

Nga përlllogaritja e litrave të karburantit të konsumuar u konstatua se në sistemin elektronik të karburantit janë hedhur me shumë litra me një diferencë në masën **23,451 litra**, sesa sasia e konsumuar e karburantit të shënuar në fletët udhëtimet të automjeteve, i cili është dokument vërtetues për lëvizjet dhe kilometrazhin e automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)*

9.1 Rekomandimi: Nga SPVtë kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **3,498,119 lekë**, si një përfitim i marre nga personat përgjegjës si dhe autorizues nga ish Titullari i Ak z.K. Ll., Titullari i Ak znj. O. G., ish magazinierja znj.E. P., ish shefi i finances z.V. N., znj.O. M., znj.E. M., znj.L. B. dhe z.Q. K..

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitet 2017,2018,2019,2020 për procedurën me objekt prokurimi *Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajtje automjetesh”, “Mirëmbajtje automjetesh dhe gjeneratorësh” për vitin 2018 si dhe “Mirmbajtja e kondisionerve, kaldajave dhe cillerave”* për vitin 2018 dhe vitin 2020 nga grupi i auditimit u konstatua se nuk verifikohet nevoja e kryerjes së shërbimeve për automjetet, mungon gjurma e auditimit, kërkesat e shoferëve nuk janë të argumentuara, nuk ka procesverbale të mbajtura për problemet e difekteve të këtyre automjeteve, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar fatke se përse duhet të kryeht shërbimi ashtu si dhe nuk mund të përcaktohet preventivi i një shërbimi përpara se të ndodhë një difek në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”* fakte të cilat kanë shkaktuar një shpënzim të realizuar nga AK pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficente, referuar Pika 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktuar në vlerë janë si më poshtë vijon:

1.Procedura “Riparim dhe mirmbajtje automjetesh” viti 2017 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi në **vlerën 899,160 lekë**.

2.Procedura “Riparim dhe mirmbajtje automjetesh” viti 2018 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi, kjo pasi nuk mund të përcaktohet preventivin përpara se të ndodhë një difekt ose avari, apo nevojë për ndërrim pjesësh në lidhje me mirëmbajtjen e automjeteve dhe gjeneratorve **në vlerën 870,720 lekë**.

3. Shtese kontrate të “Mirmbajtja e kondisionerve, kaldajave dhe cillerave” viti 2018, shpenzimet për kryerjen e preventive të shërbimit të mirëmbajtjes së kondisionerve, kaldajave dhe **cillerave në vlerën 345,600 lekë**, AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi.

4. Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajtje automjetesh” viti 2019 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 826,800 lekë**.

5.Blerje e vogel “Riparim dhe mirmbajtje automjetesh” viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi **në vlerën 742,440 lekë**.

6. Blerje e vogel “Mirëmbajtje kondicionerash, frigoriferash dhe rezistencash elektrike” viti 2020 nga ku AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe keto shërbime janë po të njezat shërbime dhe pjesë që ndërrohen cdo vite në **vlerën 905,880 lekë**

7. Blerje e vogel “ Mirmbajtje e sistemit qendror (ngrohës-ftohës)” viti 2020 AK nuk ka analizuar drejtë kryerjen dhe qëllimin e këtij shërbimi si dhe keto shërbime janë po të njezat shërbime dhe pjesë që ndërrohen cdo vit në **vlerën 899,880 lekë**. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.*)

1.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë **vlerën 5,490,480 lekë** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik “Ali

Mihali” Vlorë, gjatë procedurës së prokurimit për rastet e sipërpërmendura. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

1.2 Rekomandim: Nëpunëse Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues të marrë masa ku për cdo nevojë të Spitalit, nga personat përgjegjës të behet analiza e nevojave të spitalit si dhe kërkesat e justifikuara me dokumentat plotësues për shërbimin/mallin e kërkuar.

Menjëherë dhe ne vijmësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Kerkese per propozim*” me objekt: “*Mirmbajtja e kaldajave, kondisionerve dhe cillerave*” grupi i auditimi nga dokumentat e hedhura ne SPE nga OE “C.” konstatohet se Vertetimi i realizimit te kontrates me nje ent publik eshte origjinal. OE ka paraqitur nje kontrate pune e lidhur me nr.2738 prot date 20.12.2016 midis BOE “C.” SHPK dhe Ministria e Integritimit European. Kvo nuk duhet te skualifikonte OE pasi ai ka paraqitur vertetim te realizimit nga nje ent publik, por duhet ti kerkonte informacion në lidhje me kontraten mbi ndarjen e punimeve dhe do të vërtetonte shërbimet e ngjashme dhe kapacitetet e tij veprim në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3. Referuar me siper diferenca midis OE “J. Z.” ofertuesi i shpallur fituese dhe skualifikimi i OE “C” me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vlerën 74,928 leke me tvsh.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)

2.Nga auditimit i procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake te kontrates me objekt: “Shërbimi i lavanderise dhe zevendesimi me inventar te imet”, Skualifikimi i OE ”U. S.” me ofertë me të ulët është i pa drejtë pasi KVO duhet të kërkonë informacion për Çertifikatat iso që ka dorezuar OE të cilat janë në gjuhë të huaj dhe janë përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtesise, të cilat mbajnë vulën dhe firmën e përkthueses në cdo faqe të dokumentacionit si dhe gjithashtu janë të noterizuara me vertetim noterial te perkthimit te certifikatave ISO por në dokumentin e noterizuar nuk rezulton të jetë të shkruara të dhënat e noterit por këto dokumente permbajn pullën, firmen dhe vulën e tij si dhe numrin e repertorit dhe koleksionit në kundërshtim me pikën 2, neni 1 i Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar; *VENDIM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797, datë 29.12.2017, neni 66 pika 3 . Referuar me siper OE ”A G S” difrenca midis ofertuesit të shpallur fituese dhe skualifikimi i OE ”U. S.” me oferte me te ulet, është në mospërputhje me parimet e **efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit në vleren 539,461 leke me tvsh.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 153-177 të Raportit të Auditimit.)

2.1 Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë **vlerën 614,389 lekë** (me tvsh). Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë të konstatuara mbi shpenzime të kryera nga Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, gjatë 2 procedurave të prokurimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Menjëherë dhe ne vijmësi

D. MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë titullarit të Insitucionit që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

ANEKSI I

SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Në Auditimin e Përputhshmërisë:⁴

b. Opinion i modifikuar.

Jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

ANEKSI II:

Përlllogaritje e materialiteti për pasqyrat financiare

Emërtimi i Shpenzimeve 2017	Vlera e	Faktori i Riskut	Çështje për tu shqyrtuar
	Popullatës	(0.7-3)	
Paga (600)	77,744,037	0.7	15
Sigurime Shoqërore (601)	12,895,008	0.7	3
Mallra e Shërbime (602)	152,175,299	0.7	30
Investime të brend. (230-231)	1,062,000	2	1
Te tjera transfer. korrente (606)	299,613	0.7	0
Total	244,175,957		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	4,883,519		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	4,883,519		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	976,704		
Nëntotali	3,906,815		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	3,516,134		

Emërtimi i Shpenzimeve 2018	Vlera e	Faktori i Riskut	Çështje për tu shqyrtuar
	Popullatës	(0.7-3)	
Paga (600)	80,650,243	0.7	15
Sigurime Shoqërore (601)	13,320,687	0.7	3
Mallra e Shërbime (602)	159,609,651	0.7	30
Investime të brend. (230-231)	0	2	0
Te tjera transfer. korrente (606)	2,065,380	0.7	0

⁴ - Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr.63, datë 22.6.2020, neni 4, piaka 2, faqe 16

Total	255,645,961
<i>Materialiteti në %</i>	<i>2%</i>
Materialiteti në vlerë	5,112,919
<i>Kalkulimi i precizionit</i>	
Materialiteti	5,112,919
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	<i>1,022,584</i>
Nëntotali	4,090,335
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>
Vlera e precizionit	3,681,302

Emërtimi i Shpenzimeve 2019	Vlera e	Faktori i Riskut	Çështje për tu shqyrtuar
	Popullatës	(0.7-3)	
Paga (600)	83,931,413	0.7	16
Sigurime Shoqërore (601)	13,866,327	0.7	3
Mallra e Shërbime (602)	157,518,177	0.7	30
Investime të brend. (230-231)	0	2	0
Te tjera transfer. korrente (606)	1,548,670	0.7	0
Total	256,864,587		
<i>Materialiteti në %</i>	<i>2%</i>		
Materialiteti në vlerë	5,137,292		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	5,137,292		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	<i>1,027,458</i>		
Nëntotali	4,109,833		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>		
Vlera e precizionit	3,698,850		

Emërtimi i Shpenzimeve 2012	Vlera e	Faktori i Riskut	Çështje për tu shqyrtuar
	Popullatës	(0.7-3)	
Paga (600)	85,190,000	0.7	17
Sigurime Shoqërore (601)	14,087,000	0.7	3
Mallra e Shërbime (602)	147,434,000	0.7	29
Investime të brend. (230-231)	869,000	2	0
Te tjera transfer. korrente (606)	1,000,000	0.7	0
Total	248,580,000		
<i>Materialiteti në %</i>	<i>2%</i>		
Materialiteti në vlerë	4,971,600		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	4,971,600		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	<i>994,320</i>		
Nëntotali	3,977,280		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	<i>90%</i>		
Vlera e precizionit	3,579,552		

Përgatiti: Grupi i auditimit, bazuar në të dhënat e disponuara nga SPV.

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 0,7-2% për të zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet, niveli i precezionit pranohet në vlerën 3,516,134 lekë për vitin 2017, në vlerën 3,681,302 lekë për vitin 2018 dhe në vlerën 3,698,850 lekë për vitin 2019 dhe për vitin 2020

rezultoi në vlerën 3,579,552 lekë, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të lartë. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (*u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli*);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Peshë specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlogaritjes si më poshtë:

Shënim:

Numri i artikujve për shqyrtim = vlera e popullacionit për kategorinë e shpenzimit (p.sh. vlera e llog 600) : vlera e precizionit nga materialiteti x faktori i riskut.

Referuar përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, paragrafi 2.4, (KLSH, Tiranë 2015, fq.18, në fuqi për periudhën objekt auditimi), përcaktohet se:

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “efektiv”;
- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “pjesërisht efektiv” ose “jo efektiv”.

ANEKSI III:

ANALIZA E RISQEVE:

1.Risku i brendshëm (i trashëgueshëm) IR për SPV:

Risku i brendshëm i shmangies nga përputhshmëria, ose gabimi, është analizuar nga grupi i auditimit duke përdorur gjykimin në vlerësimin e një sërë faktorësh, (në referencë të kreut 4.2 të MAP të KLSH, fq. 33- 35), që përfshijnë:

Shkallëzimi IR:

Risku i ulët: ngjyrë jeshile, deri në 0,5

Risku i moderuar: ngjyrë verdhë, 0.6 deri në 0,9

Risku i lartë: ngjyrë kuqe, 1

- kompleksitetin e strukturave menaxhuese: verdhe, vlerësuar **0,7**
- kompleksitetin e kuadrit normues dhe ligjor: jeshile, vlerësuar **0.4**
- hyrjen në zbatim të dispozitave të reja ligjore ose ndryshimet në rregullat ekzistuese: verdhë, vlerësuar **0,7**
- shërbime dhe programe të realizuara nga palë të treta: jeshile deri tek e verdhë në pak raste, vlerësuar **0,9**
- pagesa dhe fatura të kryera mbi baza pretendimesh ose deklarimesh: verdhe, vlerësuar **0,7**.

- numrin dhe shumë llojshmërinë e përfituesve: verdhë, vlerësuar **0,8** meqenëse nomenklatura e çështjeve që trajtohen dhe operatorëve që operojnë është shumë e shtrirë dhe mund të kërcënohet nga risqet e keqmenaxhimit material.

Mesatarja për 6 zërat e listuar më sipër: $4.2/6 = 0,7$ d.m.th ngjyrës te verdhë, risk i mesëm.

2. Risku i kontrollit (CR) për institucionin SPV:

Risku i kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Kur audituesi parashikon të mbështetet në vlerësimin e riskut të kontrollit për të zvogëluar shkallën e përdorimit të procedurave thelbësore (substantive) sa i takon përputhshmërisë, ai kryen gjithashtu vlerësime paraprake të riskut të kontrollit dhe planifikon e kryen teste të kontrollit, në mënyrë që të mbështesë këtë vlerësim. (Shiko fq. 34 të manualit)

Statusi i kontrollit te brendshëm	Risku i kontrollit	Përshkrimi	Risku i kontrollit për SPV
Shumë i mirë	I ulët Deri në 0.15	kontrollat kanë funksionuar vazhdimisht në mënyrë efektive, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim.	
I mirë	I ulët 0.15 - 0.25	janë vërejtur mangësi në efektivitetin dhe vazhdimësinë e kontrollit, por sistemi në tërësi nuk konsiderohet “jo i besueshëm”.	
dobët	I lartë 0.26 - 1.0	kontrollat janë të pabesueshme, p.sh. kontrollat nuk kanë funksionuar sipas pritshmërive dhe/ose në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës nën shqyrtim, dhe/ose nuk është i mundur testimi i tyre.	I ulët (vlerësuar 0.27)

3. Risku i moszbulimit (DR) për institucionin SPV:

Risku i moszbulimit është risku që grupi i auditimit të mos zbulojë gabime materiale të cilat kanë ndodhur dhe nuk janë parandaluar ose zbuluar dhe korrigjuar në kohë nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

*“Kontrolli i Lartë i Shtetit kërkon një nivel sigurie 95% nga testet e kryera, që mund të vijnë nga kontrollet ose tërësisht nga procedurat thelbësore, në varësi të vlerësimit të audituesit sa i takon riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit” (faqe 35). Për institucionin e KLSH risku i auditimit është pranuar 5 %. Pra **AR= 5%**.*

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit** prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Risku i auditimit AR:

$$AR = IR \times CR \times DR$$

$$5\% = 0.63 \times 0.23 \times DR$$

$$0.05 = 0.7 \times 0.27 \times DR$$

$$DR = 0.05 / 0.189 = 0.26 < 5\%$$

PERZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jostatistikore:

- Përzgjedhja e 100% të artikujve,
- Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
- Testimi i kampionëve
- *Pasqyrat financiare te bilancit: audituar 100 % llogaritë e bilancit për vitin 2017-2019, për të cilin jepet opinion; transaksionet financiare janë audituar me zgjedhje dhe sondazhe llogaritë e tjera (aktivit dhe pasivit);*
- *Audituar 100 % llogaritë e të drejtave të arkëtueshme dhe detyrimeve të pagueshme;*
- *Prokurimet publike e audituar 80 % e tyre për periudhën objekt kontrolli në lidhje me tenderat si dhe 50% në lidhje me blerjet e vogla.*
- *Inventarizimi i pasurisë audituar 100 % për gjithë periudhën objekt auditimi;*
- *Nga kontrolli i sistemit të dokumentacionit justifikuese, për urdhër shpenzimet, u testuan me zgjedhje në lidhje me blerjet e vogla, me urdhër shpenzime dieta, urdhër shpenzime në lidhje me zbatimin e kontratës si dhe shpenzime për karburantet për periudhën objekt auditimi në masën 70%.*
- *Procedurat e MFK audituar 100 % për gjithë periudhën objekt auditimi;*

▪ **Konfirmim nga të tretët,**

Në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht, si më poshtë:

- për vitin 2017 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 20/1, datë 26.02.2018,
- për vitin 2018 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 59/1, datë 26.02.2019
- për vitin 2019 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Vlorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 376, datë 20.02.2020

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit. U verifikuan situacionet dhe akt-rakordimet e mbajtura për vitet objekt auditimi me degën e thesarit.